




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



# **RAPORT VJETOR**

## **Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit**

**1 Janar – 31 Dhjetor  
Viti 2014**



**Tiranë, Shkurt 2015**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

## **RAPORT VJETOR**

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit**

**1 Janar – 31 Dhjetor**

**Viti 2014**

**Tiranë, Shkurt 2015**

## ***Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit***

**I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,**

**Të nderuar deputetë dhe deputete,**

Në mbështetje të nenit 63 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të Ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, kam nderin që, në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t’ju paraqes raportin për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2014. Raporti që unë paraqes para jush është një mundësi për të analizuar dhe vlerësuar progresin dhe sfidat e të drejtave të njeriut në vend, si dhe përpjekjet dhe punën që institucioni ynë ka realizuar për të mbrojtur dhe promovuar më tej të drejtat e njeriut.

Kur punon për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duhet në të njëjtën kohë të kesh një njohje të mirë të rreziqeve dhe sfidave që hasen në një vend të politizuar, ku kritikën në shumë raste nuk pranohen, dhe ku kultura demokratike dhe kultura e të drejtave të njeriut, si dhe respekti për institucionet e pavarura, nuk kuptohen gjithmonë dhe nga gjithkush.

Në këtë këndvështrim, nuk do të jetë e mundur të arrihet një ndryshim i vërtetë në Shqipëri, nëse ne nuk kemi një fokus më të madh në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të të drejtave të njeriut nga ana e publikut, institucioneve të administratës publike dhe aktorëve të tjerë në shoqëri.

**Me respekt,**

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**



## PERMBAJTJA

	Faqe
Fjala pershendetëse e Avokatit të Popullit	3
<b>KREU 1</b>	8
Përmbledhje ekzekutive - Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në shqipëri për vitin 2014	
<b>KREU 2</b>	26
2.1. Roli parandalues në shkeljen e të drejtave të personave të privuar nga liria	
2.1.1. Kuadri ligjor	
2.1.2. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet	
2.1.3. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet	
2.1.4. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare	
2.1.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore	
2.1.6. Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura	
2.1.7. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike	
2.1.8. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuësve	
2.2. Roli Parandalues i Institucionit të Avokatit të Popullit në shkeljen e të drejtave të njeriut në fusha të tjera të veprimtarisë së tij	35
<b>KREU 3</b>	
Roli mbrojtës i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut dhe objektivat sociale	37
3.1. E drejta për informim	37
3.2. Respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar në njësitë policore dhe në Institucionet penitenciare dhe çështje të tjera që lidhen me këto institucione	40
3.2.1. Të drejtat e personave të ndaluar dhe të shoqëruar në njësitë policore dhe çështje të tjera që lidhen me organin e policisë	
3.2.2. Për të drejtën kushtetuese të lëvizjes së lirë të shtetasve dhe çështje të tjera që lidhen me organet e policisë	
3.2.3. Respektim i të drejtave të personave e arrestuar, dënuar në Institucionet penitenciare	
3.2.4. Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare	
3.2.5. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura	
3.3. Respektimi i të drejtës së pronës dhe procedurat e legalizimeve	46
3.3.1. E drejta e pronës	
3.3.2. Procedurat e legalizimit dhe prishjes së ndërtimeve pa leje	
3.4. Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor	54
3.4.1 E drejta për një proces të rregullt ligjor lidhur me veprimet në organin e akuzës dhe në gjyqësor	
3.4.2. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor	
3.4.3. Ndihma ligjore falas	
3.3.4. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe civile	
3 Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës	61

3.5.1. Marrëdhëniet individuale të punës të rregulluara nga Ligji Nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar	
3.5.2. Marrëdhëniet individuale të punës të rregulluara nga Ligji Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar	
3.6. E drejta e sigurimeve shoqërore	66
3.7. E drejta për kujdes shëndetësor	70
3.8. E drejta për arsimim	73
3.9. Mbrojtja e konsumatorit	75
3.10. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim	78
3.11. Ndihma ekonomike	81
3.12. Synimi për një mjedis të shëndetshëm	84
3.13. Fenomeni i gjakmarrjes në Shqipëri dhe roli i Avokatit të Popullit	87
3.14. Disa vlerësime për gjendjen e të drejtave të minoriteteve në vend	89
3.15. Situata e të drejtave të grupeve vulnerabël (të dobëta)	93
3.15.1. Personat me Aftësi të Kufizuara	
3.15.2. Të moshuarit	
3.15.3. Ish të përndjekurit politik	
3.15.4. Të drejtat e Komunitetit LGBTI (Interseks)	
3.15.5. Për të drejtat e fëmijëve	
3.15.6. Të drejtat e grave	
<b>KREU 4</b>	
Roli promovues/proaktiv i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut	103
4.1. Shërbimet ndaj qytetarëve nëpërmjet rritjes së rolit proaktiv të Institucionit dhe funksionimit të zyrave rajonale	103
4.2. Nxitja e të drejtave të njeriut në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Raporteve të Veçanta	106
4.2.1. Raport i Veçantë “Për Problematikat dhe Gjendjen e Spitaleve në Shqipëri”	
4.2.2. Raport i veçantë “Për të drejtën e informimit dhe rolin e Avokatit të Popullit”	
4.2.3. Raporti i Veçantë “Mbi Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës”	
4.2.4. Raporti “Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen”	
4.2.5. Raporti “Për Emigracionin dhe disa prej problematikave shqetësuese që lidhen me të”	
4.2.6. Raport i Veçantë “Mbi Gjendjen e Strehimit në Republikën e Shqipërisë”	
4.2.7. Raporti i veçantë mbi procedurat e legalizimit dhe prishjes së ndërtimeve pa leje nga ana e Inspektoriateve ndërtimore (Rasti i banorëve të Selitës dhe procedurat e ndjekura në kuadër të ndërtimit të segmentit të Unazës së Madhe të Tiranës)	
4.3. Investimi i Gjykatës Kushtetuese nga Avokati i Popullit për rivendosjen në vënd të të drejtave të shkelura	109
4.4. Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në dhënien e mendimeve dhe komenteve për draft ligjet për vitin 2014 në mënyrë proaktive ose me kërkesë së të Institucioneve përkatëse	111
4.5. Forcimi dhe bashkëpunimi me median dhe median sociale	113
4.5.1. Marrëdhëniet me median	
4.5.2. Institucioni i Avokatit të Popullit si burim informacioni	
4.5.3. Intervista të Avokatit të Popullit, në televizionet kombëtare	
4. Intervista në televizionet lokale	

4.5.5. Avokati i Popullit prezent në faqet e opinioneve të gazetave shqiptare	
4.5.6. Faqet Online	
4.5.7. Mediat sociale	
4.5.8. Revista	
4.6. Roli proaktiv dhe bashkëpunës me organizatat jofitimprurëse	116
4.7. Aktivitete promovuese në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut	118
<b>KREU 5</b>	
Sfidat dhe arritjet në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014	122
5.1. Vështirësitë e hasura në marrëdhënien me Institucionet e Administratës Publike	123
5.2. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e Administratës Publike	123
5.3. Vështirësitë në marrëdhëniet me qytetarin	125
5.4. Sfidat në bashkëpunimin me median dhe shoqërinë civile	126
<b>KREU 6</b>	
Avokati i Popullit dhe veprimtaria ndërkombëtare	127
6.1. Institucioni i Avokatit të Popullit në mbajtjen e Presidencës së AOM	127
6.2. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare	128
6.3. Përfaqësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivete ndërkombëtare	129
6.4. Ngritja e kapaciteteve të stafit dhe vizita studimore	130
<b>KREU 7</b>	132
Institucioni i Avokatit të Popullit në shifra për vitin 2014	
7.1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative	132
7.2. Realizimi i buxhetit të Institucionit për vitin 2014	134
7.3. Statistika përmbledhëse të ankesave dhe trajtimit të tyre për vitin 2014	137
ANEKSE	144

# KREU 1

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### OPINIONE DHE REKOMANDIME PËR GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2014

Institucionet e krijuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë aktorë të rëndësishëm shtetformues në sistemet demokratike. Avokati i Popullit si njëri prej tyre dhe si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjat, si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Ky institucion është krijuar më 1998, me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 dhe në vitin 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Kodi i Procedurave Administrative” (nr. 8485, datë 12.5.1999), ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (nr. 9888, datë 10.3.2008), ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit” (nr. 9135, datë 11.9.2003), “Për shëndetin mendor” (nr. 44/2012, datë 19.4.2012), si dhe ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, përbëjnë bazën ligjore, ku përcaktohen thuajse të gjitha të drejtat dhe detyrat funksionale të Avokatit të Popullit.

Në veprimtarinë e tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit. Pavarësia e institucionit është një tipar i garantuar, në radhë të parë tek parashikimi si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Avokati i Popullit, ofron oponencë për mirëqeverisje dhe tipar themelor i Avokatit të Popullit është pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik.

Nëpërmjet kësaj përmbledhje ekzekutive, kemi si qëllim që të japim një paraqitje përmbledhëse dhe transparente të konstatimeve dhe gjetjeve të nxjerra gjatë vitit 2014, si dhe dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve të përgatitura gjatë këtij viti për gjendjen dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.

Gjatë vitit 2014, me ligjin Nr. 155/2014 u miratuan nga Kuvendi i RSH-së ndryshimet e ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të cilat kanë qenë një kërkesë e vazhdueshme e institucionit tonë, si dhe e institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, me qëllim që institucioni ynë të ushtrojë aktivitetin e tij në përbushje të plotë të Parimeve të Parisit për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut. Miratimi i ndryshimeve të kërkuara, përveç se rezultat i problematikave të konstatuara gjatë aktivitetit të institucionit prej ekspertëve tanë, u bë veçanërisht i domosdoshëm në kuadër të vendimit të Nënkomitetit të Akreditimit të ICC-së për “Rivlerësimin e Akreditimit të Institucionit të Avokatit të Popullit”. Bazuar në sa më sipër, në kuadrin e projekteve të BE-së për vendin tonë, hartimi i ndryshimeve në ligjin “Për Avokatin e Popullit”, u përfshi si objekt i punës së



misionit EURALIUS III<sup>1</sup>. Puna për hartimin e projektligjit përkatës nisi në mars 2012 dhe në prill 2013 projektligji ju dorëzua për mendim Ministrisë së Drejtësisë.

Pavarësisht opinioneve tona drejtuar Kuvendit<sup>2</sup>, gjatë shqyrtimit nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend, ju bënë sërish ndryshime projektligjit, ndryshime këto që në vlerësimin e ekspertëve tanë, jo vetëm nuk ishin në harmoni me propozimet e misionit EURALIUS, por përkundrazi vazhdonin të thellonin mugesën e paanësisë dhe pavarësisë së institucionit, si dhe dobësonin rolin e tij.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit organik, ka luajtur një **rol parandalues, mbrojtës, nxitës dhe proaktiv në kuadër të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.**

Gjatë vitit 2014, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar 3969 ankesa, kërkesa, apo njoftime. Nga numri total i ankesave të depozituara gjatë vitit 2014, rreth 65% e tyre, apo 2572 ankesa janë konsideruar “brenda juridiksionit dhe kompetencës” të Avokatit të Popullit dhe 1397 ose 35% prej tyre janë konsideruar si “këshillime dhe orientime” për qytetarët. Kështu, rezulton se gjatë vitit 2014 janë pranuar nga organet e administratës publike dhe ju është dhënë zgjidhje në favor të qytetarit 646 çështjeve, që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Lidhur me pranimin dhe shqyrtimin e ankesave të depozituara pranë institucionit të Avokatit të Popullit edhe këtë vit, një nga masat e rëndësishme që është ndërmarrë, është ngritja dhe funksionimi çdo ditë i një komisioni “ad-hoc”, me përbërje nga ekspertë të tre Seksioneve dhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të cilët në rolin e një “zyre këshillimi”, në varësi të objektit të ankesave bëjnë klasifikimin e tyre. Klasifikimi konsiston në ndarjen në “*ankesa brenda juridiksionit dhe kompetencës*” për t’u shqyrtuar më tej nga ekspertët sipas të drejtës që mbulojnë, si dhe, në “këshillime dhe orientime” për ankesat që nuk janë objekt i kuadrit ligjor. Kjo mënyrë e klasifikimit të ankesave, ka sjellë uljen e numrit fiktiv të ankesave të shqyrtuara, ka shkurtuar kohën e shqyrtimit të çështjeve që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative (KPrA) dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Nga ky riorganizim i praktikës së pranimit dhe trajtimit të ankesave, rezulton se për vitin 2014, prej 2572 ankesash të pranuar për shqyrtim, vetëm 240 ankesa janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së institucionit. Në krahasim me vitet e kaluara, numri i ankesave brenda juridiksionit dhe kompetencës është rritur kjo falë këtij sistemi dhe punës promovuese dhe informuese që Institucioni i Avokatit të Popullit ka realizuar gjatë këtij viti.

Avokati i Popullit duke shfrytëzuar kompetencën diskreionale të shqyrtimit të rasteve me iniciativë, mbështetur në nenin 13, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka vazhduar të shqyrtojë raste të tilla me iniciativë gjatë këtij viti, nisur nga problematika që qytetarët i kanë bërë publike në median e shkruar dhe atë vizive. Rezulton se gjatë vitit 2014 numri i çështjeve me iniciativë, ka arritur në 192 raste, pra një numër më i madh se sa një vit më parë.

Në kuadër të rolit proaktiv të Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2014, rezulton se, janë realizuar gjithsej **138 inspektive** në këto institucione në mbarë vendin (*njësitë policore, paraburgime, burgje, spitale psikiatrike, etj*), si dhe në qendrat rezidenciale për fëmijë (*shtëpitë e fëmijës*), qendrat rezidenciale për të moshuarit etj.

Nga këto inspektive, në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore e Poshtëruese (OPCAT), gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit ka kryer 115 inspektive, apo ri-inspektive të thelluara në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

<sup>1</sup> Misioni i asistencës së BE për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

<sup>2</sup> Shkresa jonë drejtuar Kuvendit nr. 212/1 prot., dt. 02.07.2014.

Lidhur me problematikat e ankesave të paraqitura gjatë vitit 2014, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar raste të shkeljes së të drejtës për informim, shkelje të të drejtave të njeriut nga policia, mosrespektim të të drejtave të të burgosurve, zvarritje të procedurave gjyqësore e administrative, shkelje të së drejtës së pronës, të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, mosplotësim të nevojave të shtetasve për strehim, probleme me përfitimin nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe ndihmës ekonomike, probleme në ushtrimin e lirë dhe efektiv të së drejtës për arsimim dhe kujdes shëndetësor, gjendjen e të drejtave të minoriteteve në vend etj.

Mjeti ligjor kryesor i Avokatit të Popullit është rekomandimi me qëllim vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi i administratës publike. Për të gjitha rastet e trajtuara ku janë konstatuar shkelje të të drejtave, kemi bërë ndërhyrje të nevojshme nëpërmjet paraqitjes së rekomandimeve përkatëse kur prekin një grup individësh dhe rekomandime legjislative. Numri total i rekomandimeve drejtuar organeve të administratës publike gjatë vitit 2014 është 368, prej të cilave 17 janë refuzuar dhe 90 rekomandime janë pranuar plotësisht. *Pjesa tjetër e rekomandimeve janë ose në proces shqyrtimi nga ana e organeve të Administratës Publike, ose nuk ka ende një përgjigje lidhur me to, pavarësisht interesimit tonë të vazhdueshëm në procesin e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve tona.*

Gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit ka vazhduar të analizojë një sërë praktikash, fenomenesh e situatash shqetësuese për shoqërinë shqiptare, që ndikojnë negativisht në gëzimin e plotë të të drejtave të qytetarëve, apo nuk janë në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Gjatë këtij viti institucioni i Avokatit të Popullit ka depozituar pranë Kuvendit të Shqipërisë 7 raporte të veçanta. Nëpërmjet këtyre raporteve, kemi dashur të sjellim në vëmendje të institucioneve ligjbërës dhe atyre ekzekutive probleme dhe tematika emergjente, të cilat janë gjykuar prej Avokatit të Popullit se kanë nevojë për t'u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Në bazë të problematikave të evidentuara nga rastet e trajtuara dhe analizave ligjore të zhvilluara nga institucioni, gjatë vitit 2014 janë përgatitur gjithsej **27 rekomandime legjislative**, për nxjerrje, amendime, apo plotësime të ligjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave, apo Ministrave përkatës, si dhe i jemi drejtuar Gjykatës Kushtetuese me qëllim shfuqizimin e akteve nënligjore, apo ndryshimeve ligjore, që në mendimin tonë, çenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut.<sup>3</sup>

Avokati i Popullit, në ushtrim të funksionit të tij kushtetues, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2014 shqyrtimin me vëmendje të veçantë të ankesave të ardhura nga individë që i përkasin grupeve të dobëta, të cilët janë edhe më të rrezikuarit nga shfaqjet e fenomenit të diskriminimit. Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të grupeve të dobëta në vend, ka qënë një ndër prioritetet e punës së institucionit, dhe një element i domosdoshëm për progresin e mëtejshëm të integritit në struktura e BE-së.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar respektimit të të **drejtave të minoritetit Rom**, i cili vazhdon të përballet me një sërë problemesh, që çenojnë liritë dhe të drejtat e themelore të anëtarëve të këtij minoriteti. Ky minoritet përfaqëson sot një grup vulnerabël dhe në risk, i cili e ka të pamundur të përfitojë nga sistemi ynë social, duke përfshirë këtu strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe çdo përfitim që sistemi ynë social ua siguron qytetarëve shqiptarë.<sup>4</sup> Në këto kushte, Avokati i Popullit ka rekomanduar dhe reaguuar duke e konsideruar

<sup>3</sup> Për një listë të plotë të rekomandimeve për ndryshime ligjore dhe rasteve drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ju lutem shihni Shtojcën I në fund të raportit.

<sup>4</sup> Ende vazhdojnë të mbeten pa një përgjigje zyrtare, apo me reagime jo adekuate rekomandimet tona për:

-Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike"(i ndryshuar) – (drejtuar Ministrat të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë).

-Për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom ne regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku

si mjaft të nevojshme, ndërmarrjen e iniciativave për ndryshime ligjore, të cilat do të mundësonin një diskriminim pozitiv dhe lehtësim të kriterëve ligjore për përfitimin e shërbimeve të sistemit aktual social nga anëtarët e minoritetit rom. Këto iniciativa nuk kanë gjetur ende jetësimin e tyre në legjislacion dhe për rrjedhojë aplikimin e tyre në praktikë gjatë vitit 2014, fakt që ka bërë që të drejtat e këtij minoriteti të vazhdojnë të jenë një çështje sensibil dhe shqetësuese për gjithë shoqërinë. Avokati i Popullit mbetet i mendimit se, si për anëtarët e këtij minoriteti, por gjithashtu dhe për një sërë qytetarësh me probleme të strehimit, nevojitet përgatitja e një strategjie afatmesme dhe afatgjatë për të garantuar një zgjidhje sa më të plotë të problematikës së strehimit të shtetasve shqiptarë dhe anëtarëve të minoritetit Rom në veçanti.

Gjendja e të **drejtave të minoriteteve** në vend, parë në këndvështrimin e të drejtave të afirmuara në Konventën Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, ka qënë objekt i përgatitjes së një raporti të veçantë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Nga gjetjet e këtij raporti është arritur në konkluzionet se, nevojitet përmirësimi dhe pasurimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e minoriteteve, pasi vërehen mangësi. Kemi theksuar shpeshherë se nevojitet marrja e masave adekuate dhe zgjerimi i mundësive për edukimin e minoriteteve, duke përfshirë mësimin e gjuhëve minoritare, promovimin e identitetit dhe zhvillimin e kulturës së minoritetit. Nevojitet gjithashtu, marrja e masave konkrete ligjore dhe administrative për përmirësimin e aksesit në strehim, shërbimet e arsimit, shërbimet sociale dhe pjesëmarrjen në jetën publike në vend. Integrimi real i minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në jetën e përditshme, veçanërisht në strukturat qeverisëse në nivel vendor, apo qëndror. Po kështu, është i nevojshëm realizimi i një procesi të regjistrimit të popullsisë (censusi), të pakontestuar dhe të gjithëpranuar edhe nga minoritetet dhe komunitetet e tjera, i cili do të jepte shifrat reale të popullsisë minoritare, apo edhe të komuniteteve të tjera. Pikërisht dhe konferenca vjetore kombëtare e viti 2014 u organizua mbi diskutimin e gjetjeve për gjendjen e të drejtave të minoriteteve në vend, pa përjashtuar edhe komunitetet e tjera.

Pavarësisht përmirësimit të legjislacionit,<sup>5</sup> **personat me aftësi të kufizuar** mbeten ndër shtresat më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare. Personat me probleme të rënda të shëndetit mendor, nuk përfitojnë shërbime sociale dhe shëndetësore, si kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara. Edhe personat me aftësi të kufizuar që banojnë në zonat e thella rurale, në shumë raste nuk i përfitojnë këto shërbime. Për këtë qëllim del si një domosdoshmëri identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të këtyre dy kategorive. Shqetësues mbetet aksesit i personave me aftësi të kufizuar në drejtësi, strukturat qeveritare në nivel qëndror dhe lokal, media dhe biznes, ndërkohë që vërehet moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Është konstatuar edhe gjatë këtij viti, mungesa e aksesit në transportin urban publik e shoqëruar me mosrimbursimin e biletës në këtë transport, si dhe mungesa e përshtatshmërisë së aksesit në ambiente publike dhe private. Personat me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e tyre, përbëjnë një nga misionet më të rëndësishme të institucionit të Avokatit të Popullit. Ato janë pjesë e një ndër prioritetëve të përcaktuara nga BE për Shqipërinë, dhe në këtë kontekst por jo vetëm, zhvillimet në legjislacionin dhe politikën për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zbatimin e tyre, kanë qënë objekt i diskutimeve, vlerësimeve dhe rekomandimeve të institucionit tonë.

Në këtë kuadër, për të siguruar akses personave me aftësi të kufizuara, institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se duhet të bëhen ndryshimet legjislative në Kodin e Procedurës Civile, Penale dhe atë Administrative si dhe në ligjin “Për noterinë”<sup>6</sup>.

---

ata kanë vendbanimin aktual. (drejtuar Ministrisë të Brendshme).

-Për ndryshimin e ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar)- (drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit).

<sup>5</sup> Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

<sup>6</sup> Duke mbajtur parasysh që këto gjetje janë konstatuar periudhën e fundit të vitit 2014, në periudhën e parë të vitit 2015 të gjitha këto konstatime do të shoqërohen me rekomandimet përkatëse.

Avokati i Popullit ka vazhduar trajtimin e çështjeve të lidhura me të drejtat e komunitetit LGBTI. Lesbiket, gay-it, biseksualët dhe transgjnorët hasen me vështirësi në jetën e tyre të përditshme dhe me kufizime të të drejtave themelore, të cilat parimisht duhet të gëzohen nga të gjithë qeniet njerëzore pa dallim.

Si një vlerësim parësor mbetet ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit në lidhje me çështjen LGBTI. Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit për këtë qëllim me Këshillin e Europës, Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe grupet e interesit dhe me iniciativë të Ministrisë së Mirëqënies Sociale, në muajin Dhjetor 2014, kanë propozuar një pakete rekomandimesh për ndryshime legjislative, përfshirë këtu dhe ndryshime në Kodin e Familjes, ku parashikohet ligjërimi i bashkëjetesës mes personave të të njëjtit seks.

Megjithëse, Shqipëria ka bërë progres drejt pranimin të personave LGBTI, homofobia dhe transfobia mbeten fenomene shumë problematike në të gjithë vendin. Situata e LGBTI në mjedisin e punës mbetet e paqartë dhe për shkak të homofobisë dhe transfobisë së lartë që ekziston, shumë prej tyre zgjedhin të mbajnë të fshehur identitetin e tyre seksual dhe gjinor. E njëjta situatë mbetet dhe në sistemin arsimor si dhe atë shëndetësor duke i gjetur stafet e papërgatitura për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve që hasin më së shumti anëtarët e LGBTI.

Në datën 4 Dhjetor 2014 Avokati i Popullit ka paraqitur në nën/komisionin për të drejtat e njeriut në Kuvend, raportin e veçantë të hartuar nga ky institucion për të drejtat e komunitetit LGBTI, ku edhe janë prezantuar të gjitha këto probleme.

**Dhuna me bazë gjinore**, e veçanërisht dhuna ndaj grave në familje, vazhdon të mbetet një fenomen mjaft i përhapur dhe problematik për shoqërinë tonë, dhe si rrjedhojë, është përgjegjësi e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Për shkak të këtij fenomeni regresiv të ushtrimit të dhunës në familje, veçanërisht ndaj grave, disa prej tyre fatkeqësisht kanë humbur edhe jetën. Gjatë këtij viti nga shqyrtimi i ankesave, në disa raste ka rezultuar se, punonjësit e policisë nuk kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë. Punonjësit e policisë kanë mangësi të theksuara në formimin profesional të tyre, pasi ata nuk njohin dhe për pasojë nuk zbatojnë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga dispozitat e të Kodit të Procedurës Penale, dhe Ligji Nr. 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Në këtë situatë është emergjente konsolidimi i mëtejshëm i mekanizmave të referimit për dhunën në familje, e në këtë drejtim koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore duhet të përmirësohet, si edhe duhet të ngrihen strukturat që mungojnë, konkretisht streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat.

Ndërkohë, edhe gjatë vitit 2014 është rritur numri i individëve, kryesisht i grave, që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës në familje duke shënuar kështu rritje dhe të numrit të vendimeve për urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata. Shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbartimit, të cilat duket se e gjejnë të vështirë në terren zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Edhe pse gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës seksuale, ato kanë dhe barrën e provës në rastin kur ky abuzim seksual ndodh, prova të cilat në të shumtën e rasteve është e vështirë të sigurohen, sidomos në rastet e dhunës psikologjike duke i lënë autorët shpesh të pandëshkuar. Ndërkohë, abuzimet seksuale për shkak të shpërdorimit të varësisë, ose të detyrës mbeten shpesh të heshtura dhe të padenoncuar. Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar ndryshimet në Kodin Penal lidhur me figurën penale të ngacmimit seksual. Me qëllim garantimin e të drejtave të grave në marrëdhëniet e punës lidhur me ngacmimin seksual janë propozuar ndryshimet përkatëse në Kodin e Punës.

Përmirësimi i asistencës e ndihmës ndaj viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve, vijimësia e përpjekjeve me synimin e luftës dhe hetimit të rasteve të dhunës në familje, dhe sigurimi i hetimit dhe gjykimit të tyre me gjithë forcën e ligjit, përbën një nga sfidat e vendit tonë. Së fundmi, konsiderojmë se aplikimi i politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ri-trajnimi me synim përmirësimin e gjendjes ekonomike të grave, janë qasje që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së grave dhe vajzave.

Me miratimin e ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” parashikohen ndër të tjera mekanizmat institucionale për **mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve** në nivel qendror dhe vendor. Megjithëse ka një numër aktorësh të qeverisjes qendrore e asaj vendore, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre këtë kategori sociale, bashkëpunimi ndërmjet tyre mbart probleme të koordinimit, kompetencave dhe shkëmbimit të informacionit. Sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 26.11.2013 “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”, u rekomandua pasja e një Komisioneri për të drejtat e fëmijëve, i cili me ndryshimet në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”<sup>7</sup> u bë e mundur krijimi i një Seksioni specifik për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, si garantues i zbatimit të Konventës së të Drejtave të Fëmijës, promovues i të drejtave të tyre në Kuvend, Qeveri dhe në shoqërinë civile, mediator në marrëdhëniet ndër-institucionale, si dhe ndikues në politikat për fëmijët.

Nevojitet ngritja e mekanizmave eficientë për zbatimin e legjislacionit dhe strategjive ekzistuese dhe fuqizimi, shtrirja dhe forcimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Aktualisht si një produkt i dalë nga inspektimet në të gjitha qendrat rezidenciale të shërbimeve për fëmijët-shtëpi fëmije, shtëpi foshnje dhe qendrat e Zhvillimit, mbetet puna për përmirësimin e infrastrukturës së këtyre institucioneve, si dhe përmirësimi i punës për zbatimin e plotë të standarteve të përkujdesit shoqëror. Gjithashtu, konsiderohet e nevojshme ndërhyrja e shtetit për rregullimin e disa aspekteve që ndikojnë në zhvillimin, mirërritjen e edukimin e kategorisë së fëmijëve autikë.

Rekomandimet tona gjatë vitit 2014, bazuar në raste të shqyrtuara me inisiativë kanë të bëjnë me masat që duhen marrë për përmirësimin e infrastrukturës së dobët në disa shkolla të arsimit publik, pa përfshirë këtu mungesën e aksesit në arsim të kategorisë së fëmijëve PAK.

Mbeten shqetësuese, format e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, sidomos të abuzimit të fëmijëve në rrugë duke përbërë kështu një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve. Rastet e dhunës ndaj fëmijëve në familje janë një tjetër fenomen shqetësues, jo vetëm të dhunës së drejtëpërdrejtë por dhe dhunës së asistuar, për këtë arsye nevojitet sa më mirë adresimi dhe asistimi i tyre. Gjithashtu, fëmijët janë nga kategoritë më të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes. Më shumë vëmendje duhet kushtuar nga të gjithë institucionet përgjegjëse dhe aktorët e shoqërisë civile, në identifikimin e fëmijëve të ngujuar, që janë jashtë sistemit arsimor dhe koordinimit me shërbime për t’ju garantuar atyre të drejtat që ju mohohen me qëllim minimizimin e këtij fenomeni.

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT)**, gjatë vitit 2014 ka ushtruar kontroll të vazhdueshëm me qëllim monitorimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. MKPT ka kryer në total 115 inspektime, ri-inspektime, kontrolle me tematikë të veçantë dhe vizita monitoruese në të gjitha institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, bazat ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktimat e trafikut në Republikën e Shqipërisë.

---

<sup>7</sup> Ligji nr.155/2014 dt.27.11.2014

Një nga problemet më shqetësuese në institucionet penitenciare të evidentuara gjatë vitit 2014 është mbipopullimi në shifra alarmante, i cili ka sjell një sërë shkeljesh të të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar.

Sa i takon nivelit të respektimit të inspektimeve janë evidentuar shkelje të të drejtave të personave të privuar nga liria dhe mozbatim të legjislacionit në fuqi lidhur me moskryerjen e observimit e më pas sistemit në dhoma sipas kriterëve të përshtatshmërisë; mangësi dhe problematika emergjente infrastrukturore të godinave dhe brenda godinave; mungesa e ngrohjes dhe mungesa në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale; mungesa e ambjenteve të përshtatshme për takimin me fëmijë të mitur në të gjitha IEVP-të; problematika lidhur me pagesën e të paraburgosurve e të dënuarve për punën e kryer në të gjitha institucionet (përveç IEVP Burrel), probleme lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar nga stafet e kujdesit social dhe atij shëndetësor; numër i kufizuar i aktiviteteve që ofroheshin në institucione të cilat kushtëzoheshin nga mospasja e ambjenteve të përshtatshme si rezultat i kthimit të këtyre ambjenteve në dhoma banimi, për efekt mbipopullimi dhe mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike; mungesa e prezencës së një mjeku psikiatër (përrjashtuar IEVP Drenovë dhe Instituti i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve) për rastet jo të pakta të të sëmurëve mendorë dhe ish-përdoruesve të substancave, etj. Nga të paraburgosurit dhe të dënuarit ka patur dhe pretendime për keqtrajtme dhe ushtrim dhune, për të cilat sipas rasteve janë bërë rekomandimet përkatëse nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Pavarësisht se u bënë tashmë disa vjet që flitet për ndërtimin e një Institucioni të Posaçëm të parashikuar në Ligjin për Shëndetin Mendor për strehimin në një ambient spitalor, jashtë sistemit të burgjeve, të personave që me vendim gjyqësor është vendosur për ta masa me mjekim të detyruar, ky institucion ende nuk është ndërtuar. Aktualisht këta persona mbahen në Institucione penitenciare në kundërshtim me ligjin dhe me standartet ndërkombëtare.

Sa i takon nivelit të respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore, janë konstatuar; moskryerje të detyrimeve ligjore nga personeli policor dhe ai shëndetësor që shërben në ambientet e sigurisë, për raportimin e rasteve të ushtrimit të dhunës ndaj të arrestuarve ose të ndaluarve; sjellje pa etikë të disa punonjësve të policisë në komunikimin me qytetarët; bllokime dhe mbajtje pa të drejtë të sendeve të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar; infrastrukturë e amortizuar në një pjesë të mirë të komisariateve, sidomos të ambjenteve të shoqërimit në një pjesë të mirë të njërive policore; shoqërime të shtetasve në organet e policisë në kundërshtim me parashikimet ligjore, mospajisja e komisariateve me regjistra të përditësuar për personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/arrestuar si dhe mangësi për evidentimin në regjistra të të dhënave të personave të shoqëruar; mos përshtatja e ambjenteve të sigurisë sipas standardeve, mungesë pankartash për të drejtat ligjore të personave të shoqëruar; mbipopullim në ambientet e sigurisë për shkak të vendosjes në këto të fundit dhe të personave me masë sigurimi “arrest në burg” nga gjykata; mungesa e mjekëve sipas organikës, mosplotësimi korrekt i regjistrave, kartelave mjekësore si dhe mungesa e ambjenteve të përshtatshme për ofrimin e shërbimit shëndetësor në Komisariate.

Në një kohë që gjatë vitit 2014, në trajtimin e ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë, janë konstatuar raste të keqtrajtimit të qytetarëve në mjediset e Komisariateve të Policisë, shoqërime të paligjshme të tyre dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore për shoqërimin e shtetasve, ndërhyrje të paligjshme të punonjësve të policisë gjatë kryerjes së shërbimit pa paraqitur identifikimin policor, mosvlerësime të kallëzimeve të shtetasve për vepra penale të ndryshme, apo dhe për raste të veprave penale të dhunës në familje etj.

Janë konstatuar nga trajtimi i ankesave se ka shkelje të zbatimit të ligjit për Policinë e shtetit lidhur me shoqërimin e personave, sipas parashikimit të ligjit deri në 10 orë. Kjo ndodh për disa shkaqe, si mangësitë e theksuara të njohjes së dispozitave të legjislacionit që trajtojnë

dhe rregullojnë problemin e shoqërimit; mungesa e kontrollit të organeve eprore ndaj punonjësve të policisë në bazë, lidhur me zbatimin në praktikë të të drejtës së policisë për të bërë shoqërimin e personave në organet e saj; përdorimi i shoqërimit shpesh si justifikim për të realizuar qëllime të tjera ndaj personave që kanë dijeni, apo dyshohen si autorë të kryerjes së veprave penale; përdorimi i shoqërimit të autorëve të dyshuar të veprave penale, apo edhe i atyre të kapur në flagrancë përdoret për të kryer veprime procedurale, si marrja e deklarimeve, kryerje të kontrolleve të ndryshme, sekuestrime provash e verifikime të tjera, etj..

Sa i takon nivelit të respektimit të **të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura**, janë konstatuar; mungesë kushtesh të përshtatshme në dhomat e sigurisë, si dhe të zileve elektrike; mungesë sistemi monitorimi me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurimit; kushte të papërshtatshme në dhomën e takimit me familjarët; mosofrim dhe mungesë e paketës me produkte të higjienës personale për personat në dhomat e sigurisë; mungesë ngrohjeje, prani të mjeteve të forcës, shkop gome dhe pranga; plotësim i mangët i rubrikave në regjistrat për ndalimin disiplinor.

Nga inspektimet **në Spitalet psikiatrike** janë konstatuar; mosrespektimi i hapësirës të nevojshme dhe kushteve të papërshtatshme në dhomat e personave të shtruar; mbajtja e personave me probleme të shëndetit mendor në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; mungesa e dhomave të veçimit, mungesa e një sistemi monitorimi me kamera në ambientet e këtyre spitaleve, si dhe mungesa e regjistrave të unifikuar nga Ministria e Shëndetësisë, veçanërisht për sa i përket dokumentimit të shtrimeve të pavullnetshme dhe aplikimit të kufizimit fizik; mangësi në plotësimin e organikës me mjekë psikiatër dhe shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve; ndjekja jo e rregullt e procedurave për shtrimet e pavullnetshme, sipas ligjit të ri për shëndetin mendor dhe akteve nënligjore të tij; mungesa e mjeteve të kufizimit fizik; mungesa e medikamenteve të grupit të antipsikotikëve, antidepressivëve, stabilizuesve të humorit etj; mungesa e një kabinetit stomatologjik konform standardeve, e aparaturës së EKG-së; mungesa e standardeve për kushtet higjieno-sanitare.

Sa i takon nivelit të respektimit të **të drejtave të personave në Qendra**, janë konstatuar; mungesë stafi me jurist, edukatorë, kujdestarë, dhe staf mjekësor; mungesë trajtimi me ndihmë ekonomike siç parashikohet në ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; mungesë furnizimi me veshmbathje, sipas stinës dhe grup-moshave; mungesë e ofrimit të kurseve profesionale dhe të punësimit; mungesa me pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive; mangësi në furnizimin me produkte higjieno-sanitare, pajisje vetjake sipas grup-moshave; mungesa infrastrukurore dhe organizative të aktiviteteve të përditëshme në qendra.

Gjatë vitit 2014 janë pranuar dhe trajtuar ankesa, apo kërkesa të **individëve ish të dënuar politikë të regjimit komunist**, si dhe të trashëgimtarëve të tyre. Problematikat e parashtruara në këto ankesa kanë të bëjnë me pretendimet për: mospërfitimin e kësteve të dëmshpërblimit që përfitojnë si ish të dënuar politikë ose mospërcaktimin korrekt të masës së dëmshpërblimit nga Ministria e Drejtësisë, mospërfitimin në mënyrë të padrejtë të dëmshpërblimit në kushtet e cilësuar nga ligji<sup>8</sup>; mosgjetjen e eshtrave të të afërmeve ish të dënuar politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; zvarritjen e procedurave për caktimin e masës së dëmshpërblimit; zvarritjen e procesit të dëmshpërblimit për grupimin e të internuarve, sipas parashikimeve të ligjit.

Lidhur me *ecurinë e procesit të dëmshpërblimit* të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, sa i përket parashikimeve të bëra në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, theksojmë se mbeten ende problematika të pazgjidhura dhe që kërkojnë veprim të shpejtë dhe konkret. Megjithë rekomandimin tonë të mëparshëm, për nevojën e realizimit të inisiativës legjislative,

---

<sup>8</sup> Ligji nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” i ndryshuar,

për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, për ish të përndjekurit politikë të regjimit komunist, kjo gjë nuk ka ndodhur. Situata gjithashtu nuk ka ndryshuar dhe me miratimin e VKM nr. 684 datë 15.10.2014<sup>9</sup> “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.419 datë 14.04.2011, i cili në thelb është rregullim i çështjeve teknike të mënyrës se, si do të bëhet shpërndarja e fondeve të miratuara nga qeveria për dëmshpërblim. Gjithashtu, duhet të plotësohet baza e nevojshme ligjore, e cila do të mundësojë procesin e dëmshpërblimit financiar për kategorinë e personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist të përcaktuara në gjermën “c”, të nenit 6, të Ligjit 94/2014.

Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të kategorisë së individëve si ish të persekutuar politikë, por edhe në një kuadër më të gjerë angazhimi institucional për krijimin e standardeve të mirëqeverisjes ka vlerësuar dhe vlerëson se duhet të realizohet **procesi transparent i hapjes së dosjeve**. Në këtë këndvështrim, gjykojmë se një nga çështjet e vonuara dhe ende të pazgjidhura të shoqërisë sonë, mbetet miratimi i një ligji gjithpërfshirës e të mbështetur në parimet ekzistenciale të një shoqërie demokratike, për hapjen e dosjeve.

Përmes një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile, institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur dhe i ka dërguar një rekomandim në muajin mars 2014, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, për të realizuar iniciativën përkatëse ligjore. Ndërkohë, konstatohet si pozitiv reagimi për draftimin e një ligji të tillë qoftë nga shoqëria civile, apo edhe nga Ministria e Mirëqënies dhe Çështjeve Sociale, proces i cili mbetet për t’u vlerësuar me produktin që do të dalë pas miratimit të aktit përkatës ligjor dhe efekteve që ai do të sjellë.

Për vitin 2014 gjithashtu vazhdon të mbetet shqetësuese dhe e pazgjidhur çështja për kërkimin, **gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar, gjatë viteve të regjimit komunist, të cilëve ende nuk iu është gjetur vend-varrimi**. Për këtë, institucioni i Avokatit të Popullit ka sugjeruar se duhet të përcaktohet afati kohor i raportimit periodik të anëtarëve të Task Forcës të ngritur për këtë çështje pranë kryetarit të saj, lidhur me ecurinë e punës dhe rezultatet e arritura nga institucioni por gjithashtu një afat përfundimtar lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni. Gjithashtu, mungon ngritja e një zyre e cila do të merrej me depozitimin e kërkesave, si dhe me regjistrimin e ADN-ve të familjarëve, të personave të zhdukur. Me qëllim të zgjidhjes së kësaj situatë njëherë e mirë jo vetëm në aspektin legjislativ por dhe në atë të zbatimit në praktikë, institucioni i Avokatit të Popullit i ka adresuar dy rekomandime Institucioneve përkatëse për bërjen efiçente të strukturës dhe realizimin e qëllimit final për gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist. Në një kohë që nga Ministria e Punëve të Brendshme<sup>10</sup> është theksuar pamundësia e funksionimit real të Task Forcës, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar<sup>11</sup> marrjen e masave për realizimin e iniciativës legjislative, për ngritjen e një strukture të re shtetërore, efektive, me objekt veprimtarie kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist. Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka konfirmuar nisjen e punës për krijimin e zyrës për gjetjen e të zhdukurve, proces i cili pritet të finalizohet së shpejti.

Duke vlerësuar garantimin e **shërbimit shëndetësor** për qytetarët, si një prej elementëve më të rëndësishëm të një shteti social, si dhe pjesë të rëndësishme të së drejtës që ka çdo individ për të jetuar i shëndetshëm, Avokati i Popullit ka vazhduar veprimtarinë e tij gjatë vitit 2014 në këtë fushë të të drejtave të njeriut. Duke pasur në fokus trajtimin me dinjitet të pacientit, mbrojtjen dhe garantimin e jetës, Avokati i Popullit ka ndërmarrë në

<sup>9</sup> Ky vendim është nxjerrë në zbatim të nenit 6, të ligjit 94/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

<sup>10</sup> Shkresa nr. 4320/2 datë 2.06.2014.

<sup>11</sup> Rekomandim drejtuar Kryeministrit të RSH-së dhe Ministrit të Mirëqënies Sociale datë 25.06.2014



vijimësi inspektive në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, Spitalet Rajonale në të gjithë vendin, si dhe ka trajtuar ankesa individuale ardhur pranë institucionit dhe raste me iniciativë në këtë fushë.

Problem shqetësues mbetet cilësia e ofrimit të shërbimit mjekësor, spitalor, në zona të ndryshme të vendit, i infrastrukturës së disa prej godinave ku ushtrojnë aktivitetin spitalet rajonale; furnizimit me medikamente kryesisht në QSUT-Tiranë, për shkak të fluksit nga i gjithë vendi; pajisja me aparatura bashkohore në spitale dhe qendra shëndetësore; cilësia e pajisjeve hotelerike (*krevate, komodina, detergjente, etj*) që në shumë spitale janë në gjendje të amortizuara, ose me cilësi të dobët prokurimi; mungesa e mjekëve specialistë, kryesisht në spitale të zonës veriore të vendit; shtimi i numrit të mjekëve, infermierëve dhe psikologëve, apo punonjësve socialë, në spitale ku është e nevojshme rritja e numrit të tyre; hartimi dhe miratimi i protokolleve mjekësore, të zbatueshme nga uniformat e bardha; mungesën e aksesit të Qendrave shëndetësore për shumë njerëz, të cilët banojnë larg këtyre qendrave, sidomos ata persona që janë me aftësi të kufizuara fizike, të moshuarit dhe nënat me foshnje.

Në këto kushte është e rëndësishme të përmirësohet cilësia dhe standartet e mjediseve të qendrave shëndetësore, të sigurohet që çdo qendër shëndetësore të ketë një sistem për urgjencat dhe për kontaktimin e personelit shëndetësor jashtë orarit të punës në rastet e urgjencave. Duhet të ndërtohen kapacitetet e nevojshme infrastrukturore dhe njerëzore për të punuar në mënyrë më efektive dhe për të ofruar shërbim cilësor për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e familjes, anëtarët e Komunitetit Rom, pacientë me HIV/AIDS, si dhe pjesëtarë të Komunitetit LGBTI. Çdo Qendër Shëndetësore duhet të ketë, udhëzues dhe protokolle të shkruara në lidhje me kujdesin në rast urgjence; mbrojtjen e fëmijëve; dhunën në familje; konfidencialitetin dhe si të ofrojnë shërbime cilësore dhe mosdiskriminuese për anëtarët e Komunitetit Rom dhe komunitetit LGBTI, në mënyrë që të jetë mirëpritëse për çdo person, si dhe të ketë një program aktiv ndërgjegjësimi mbi shëndetin.

Një tjetër problematikë e rëndësishme e trajtuar nga Avokati i Popullit është ajo që lidhet me shqyrtimin e ankesave për **marrëdhëniet e punës**, lidhur me ankimet për largimet nga puna në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil, hartimit të rekomandimeve, për garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes së të drejtave që burojnë nga marrëdhënia e punës. Gjatë vitit 2014, problematike konstatohen largimet nga puna për shkak të rishtrukturuimeve të Institucioneve për ndryshim të strukturave organike, kjo në kuadrin e reformave institucionale, për të cilat në 15 raste janë përgatitur rekomandimet përkatëse, si dhe për punonjësit e larguar në grup, si për ata që trajtohen sipas Kodit të Punës, ashtu edhe për ata që gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Një tjetër problematikë ka të bëjë me moszbatimin e drejtë të neneve të Kodit të Punës, sa i takon ndërprerjes së marrëdhënieve në punë pas përfundimit të afateve të kontratës individuale të punës, apo vazhdimin e saj kundrejt vetëm ofrimit të punës nga ana e punëmarrësit. Në rekomandimet tona kemi theksuar prezumimin ligjor që, nëse punëdhënësi pranon ofrimin e shërbimit të punëmarrësit kundrejt një pagese edhe pas mbarimit të afatit të kontratës, konsiderohet se palët kanë ndryshuar kontratën duke e kthyer në kontratë me afat të pacaktuar.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat vendosin rikthimin në punë të personave në vendin e mëparshëm të punës, mbetet problematike për të cilën kemi adresuar rekomandime të shumta. Po kështu, vazhdon të mbetet problematike situata e personave që kanë dalë në listë pritje përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri, ku shumica e tyre kanë fituar të drejtën për t'u rikthyer në vendet e mëparshme të punës dhe të cilat janë në vështirësi për t'u ekzekutuar për shkak të suprimimit, ose rishtrukturuimit të sektorëve përkatës.

Në dhjetor të vitit 2014, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, janë paraqitur disa ankesa për largime nga puna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe OSHEE, ku motivacioni i përdorur lidhej me mospagesën e detyrimeve për energjinë elektrike, për të cilat

kemi adresuar rekomandimet tona me qëllim konstatimin si të pavlefshëm të aktit administrativ dhe revokimin e tyre.

Gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit ka vazhduar trajtimin e ankesave dhe të rasteve me iniciativë lidhur me **sistemin e sigurimeve shoqërore**. Pretendimet e shtetasve kanë qenë të lidhura me mosllogaritje të drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, për uljen e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë, për kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, për mosmarrje të përgjigjes së shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, për mosvënje në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit, etj. Ndryshimet e bëra me ligjin nr.104/2014 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, kanë sjellë parashikime pozitive lidhur me llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë pas datës 1.01.2015 me formulë të re, bazuar në kontributet e derdhura në vite dhe pagën mbi të cilën paguhen kontributet.

Pavarësisht se sistemi publik i sigurimeve shoqërore po reformohet, mbeten ende të pazgjidhura një sërë çështjesh, të cilat janë raportuar edhe në raportet e viteve të kaluara. Disa prej tyre janë masa e ulët e pensioneve të parakohshme për ata që ju ka lindur e drejta në periudhën 1993 – 1995, pensionet e parakohshme të ushtarakëve, mospërfitimi i rritjes së pensionistëve që u ka lindur e drejta në periudhën 1.04.1996 – 31.04.1996, mospërfitimi i shpërblimit të pensionistëve që gëzojnë statusin e veteranit të LANC, etj. Sugjerojmë se ka nevojë të rishihet pensioni social sidomos për faktin që ai merret në konsideratë në llogaritjen e pensionit mujor të pleqërisë. Njëkohësisht, kemi rekomanduar rishikimin dhe përmirësimin e nenit 62, të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me të drejtën për përfitimet.

Edhe gjatë këtij viti janë paraqitur një numër i madh ankesash kryesisht për përjashtim të përfitimit nga **sistemi i ndihmës ekonomike** të shumë familjeve apo individëve në nevojë. Projekti Pilot që u zbatua në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan nga Shërbimi Social Shtetëror në muajin Qershor 2014 lidhur me ndihmën ekonomike, solli një sërë problemesh. Mungesa e kohës së mjaftueshme për të kuptuar procesin e aplikimit online nga ana e aplikuesve dhe administratorëve shoqëror; mosparashikimi në buxhet nga ana e organeve të qeverisjes vendore të fondeve të detyruara nga ligji dhe aktet nënligjore për të ofruar ndihmë ekonomike edhe jashtë kriterëve për raste të veçanta, si në rastin e familjeve në gjakmarrje; vonesa në dhënien në kohë të pagesës së ndihmës ekonomike, etj. Duke marrë në konsideratë, ankesat e shumta të paraqitura lidhur me ndihmën ekonomike, kryesisht nga zbatimi i projektit pilot, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndërmarrë një sërë takimesh me qytetarët dhe bashkitë përkatëse, si dhe një takim me përfaqësues të të gjitha institucioneve përgjegjëse të qarqeve Elbasan, Durrës, Tiranë, Shërbimin Social Shtetëror dhe Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në datë 27.11.2014, për të diskutuar mbi gjithë këtë problematikë të shfaqur muajt e implementimit të projektit pilot. Avokati i Popullit pas analizës tërësore dhe të kujdesshme të çështjes, në përfundim i ka dërguar një rekomandim Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për marrjen e masave konkrete për rishikimin e formulës së sistemit të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike. Në përgjigje të të cilit, kjo ministri ka shprehur angazhimin për rishikimin e koficientëve të sistemit të pikëzimit, për një përfshirje më të gjërë sociale të kategorive në nevojë bashkë me ekspertë të huaj të Bankës Botërore.

Shqetësues mbetet ofrimi i ndihmës ekonomike për familjet e ngujuara, për të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit, në muajin Shkurt 2014, i ka rekomanduar Ministrinë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë marrjen e masave për një bashkërendim të punës me njësitë e qeverisjes vendore për krijimin e mundësive për aplikimin e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Nga trajtimi i ankesave gjatë vitit 2014, rezulton se aktualisht në Shqipëri **strehimi** mbetet një nga çështjet më të mprehta sociale. Problematikat kryesore të evidentuara lidhen

me mosdhënien e informacionit individëve për aktet, apo dokumentat që duhen dorëzuar; zvarritje të procedurave të shqyrtimit të dosjeve përkatëse; mungesë transparence gjatë procedurave të përcaktimit të kriterëve për përzgjedhjen, si dhe mungesë transparence të vendimmarrjes, e cila kalon për miratim në organet kolegjiale të njësive të qeverisjes vendore. Pamundësia e pjesës më të madhe të familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehëve, në përmbushjen e kriterëve të parashikuara në ligj, për përfitim nga programet sociale; buxhetet e pamjaftueshme të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e alternativës për strehimin të banesave me qera, ose shpërndarjes së banesave sociale, apo rrezikimi i familjeve për daljen nga banesa për shkak të pamundësisë ekonomike në pagimin e detyrimeve mujore të banesës sociale, ndaj Entit Kombëtar të Banesave, janë disa nga çështjet kryesore të identifikuar gjatë këtij viti.

Ndaj edhe në këto kushte, Avokati i Popullit ka rekomanduar; rishikimin e politikave të shpërndarjes së fondeve për njësitë e qeverisjes vendore në rang vendi, duke e bërë këtë pjesë të Reformës Territoriale Administrative; garantimin e respektimit të statusit të të pastrehëve nga njësitë e qeverisjes vendore dhe të rritet transparenca gjatë realizimit të kësaj të drejte, duke i dhënë prioritet rasteve të veçanta dhe grupeve vulnerabël; rishikimin e mekanizmave dhe politikave të programeve sociale duke synuar kryesisht në shmangien e kriterëve dhe politikave bllokuese në dëm të interesave të përfituesve, veçanërisht të shtresave vulnerabël; marrjen e masave për rivënien në përdorim, apo mirëfunksionimin e vendstrehimeve provizore si një alternativë e strehimit për grupet në nevojë.

Edhe gjatë vitit 2014, janë paraqitur një numër jo i vogël ankesash lidhur me pasojat që i kanë ardhur familjeve qiramarrëse në banesat e ish pronarëve të subjekteve të shpronësuara, nga zbatimi i **Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave, Nr.3 datë 01.08.2012**, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara”. Avokati i Popullit ka qenë dhe mbetet i angazhuar tërësisht për të kontribuar në gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë dhe sa më optimale për këto familje dhe individë, të cilët praktikisht janë në një situatë “pa zgjidhje”, pavarësisht çfarë parashikon në dispozitat e tij ky akt normativ. Në këtë këndvështrim, kemi risjellë në vëmendjen e Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit me anë të një rekomandimi të datës 12.12.2014, gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë për trajtimin me strehim të kësaj kategorie familjesh, duke propozuar edhe sugjerime konkrete për mënyrën e trajtimit të tyre me strehim, sugjerime këto që janë bërë prezente edhe nga shoqata e “Qiramarrësve në shtëpitë shtetërore ish pronë private”, me seli në Durrës.

Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor ka qenë gjithashtu në fokusin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014. Edhe gjatë vitit 2014, një numër i madh ankesash na janë adresuar në lidhje me **organet e pushtetit gjyqësor**. Kryesisht problematikat e moszhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, për zvarritje gjyqësore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore, ankesa ndaj vendimeve gjyqësore duke i konsideruar ato si të padrejtë dhe të pabazuar në ligj, për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për mosdhënie të kopjes së vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, është kërkuar në disa raste ndërhyrje për dhënien e ndihmës juridike falas nga shteti, nëpërmjet Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, në Ministrinë e Drejtësisë. Pozitiv është fakti në këtë aspekt se, për shkeljet e pretenduara nga ankuesit dhe të provuara nga ana jonë për gjykime tej afateve të arsyeshme janë bërë rekomandimet përkatëse dhe pasi ato janë shqyrtuar nga gjykatat, janë marrë të gjitha masat organizative dhe këto gjykime kanë përfunduar.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së punës në trajtimin e ankesave të qytetarëve ndaj **organit të Prokurorisë**, ka treguar kujdes në ruajtjen e pavarësisë duke respektuar me rigorozitet dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Problematikat e ankesave të qytetarëve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë gjatë vitit 2014 konsistojnë kryesisht në zvarritje të pajustificuara të veprimeve hetimore të procedimeve penale në ngarkim të

personave; mosrespektim të dispozitave procedurale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin penal, siç janë nenet 105 dhe 110 e Kodit të Procedurës Penale, duke sjellë kështu shkelje të të drejtës për t'u njohur me aktet, mosshqyrtim dhe vlerësim të kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimit paraprak, zgjatja e afateve të hetimit disa herë në të njëjtin procedim penal pa respektuar rregullat e parashikuara në dispozitat ligjore; mosnjohimin ose vonesat në njohimin e palëve për vendimmarrjen e organit të prokurorisë në respektim të nenit 291/2 dhe 318 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, etj. Mendojmë se edhe për këtë rast, ashtu si dhe për vendimet e tjera që merr Prokurori, palët duhet të njohohen, pasi ata kanë të drejtën ligjore, për t'i kundërshtuar, apo ankimuar ato në gjykatë.

Veprimtaria e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror, apo Privat, në përmbushje të misionit për **ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv**, gjatë vitit 2014, në optikën e Institucionit të Avokatit të Popullit lë për të dëshiruar, kjo për sa i përket mosrespektimit në mënyrë rigorozë dhe në afat të procedurave ligjore, sikurse parashikohet në aktet normative. Gjatë këtij viti konstatohet se, e drejta për një proces të rregullt ligjor, shkeljet si rrjedhojë e mosekzekutimit në një afat të arsyeshëm të titujve ekzekutiv, kanë ardhur si rezultat i përmbajtjes së akteve normative në këtë fushë si dhe mosrespektimi i legjislacionit në fuqi nga autoritete përgjegjëse.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të Administratës Publike në cilësinë e debitorit, kemi gjykuar se, vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 142/3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 451/a të K.Pr.C, si dhe me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, të sanksionuara në K.Pr.A. Shkaku kryesor i cili ka çenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor është Udhëzimi nr.2, datë 18.08.2011, i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit". Institucioni i Avokatit të Popullit, pas mosreagimit të institucioneve të tjera përgjegjëse i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin e këtij udhëzimi dhe kjo e fundit ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "d", të pikës 7, të Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011. Pavarësisht shfuqizimit të këtij udhëzimi dhe nxjerrja e Udhëzimit Nr. 1, datë 04.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", mbart problematika, ndaj për përmirësimin e kësaj situate Avokati i Popullit do të ndërhyjë në periudhën në vijim pranë Këshillit të Ministrave për rregullimin e saj.

Një konstatim i kryer në procesin e shqyrtimit të ankesave të individëve të ndryshëm është edhe papajtueshmëria me Kushtetutën, i nenit 45, të Kodit të Procedurës Civile. Për këtë i është rekomanduar në datë 29.09.2014, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ministrin të Drejtësisë, marrjen e nismës për ndryshimin e kësaj dispozite, në përgjigje të të cilit, Ministri i Drejtësisë midis të tjerave shprehet se "...amendimi i Kodit të Procedurës Civile është parashikuar për 4-mujorin e tretë të Vitit 2014..."<sup>12</sup>. Në këtë situatë, Avokati i Popullit ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 45, të Ligjit nr.122/2013 dhe aktualisht është në pritje të shpalljes së vendimit.

Shkaqe të tjera që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, janë edhe mungesa e cilësisë profesionale e përmbarruesve gjyqësor e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv; kryerja e veprimeve jashtë objektit të ekzekutimit si dhe keqinterpretimi i dispozitivit të vendimeve gjyqësore; mungesa e vullnetit të përmbarruesve gjyqësor për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit, të cilët refuzojnë; mosmbështetja e organit përgjegjës për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv me mjete dhe forca, nga organet e njësisë së qeverisjes vendore apo qendrore si dhe

<sup>12</sup> Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.4078 Prot, datë 06.06.2014.

Policisë së Shtetit; mosreflektim nga ana e organeve eprore të përmabruesit gjyqësor për dhënie mase disiplinore sa herë që vërehen shkelje të procedurave për ekzekutim, sidomos në ato raste kur gjykata ka vendosur për anulimin e veprimeve përmbare; shfaqja e veprimeve korruptive prej përmbaresve gjyqësor, etj.

Për të gjitha problematikat e konstatuara, institucioni i Avokatit të Popullit jo vetëm ka **vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese** për dy rastet e lartpërmendura, por gjithashtu ka adresuar pranë Institucioneve përkatëse rekomandime legjislative si dhe ato individuale për rivendosjen në vënd të të drejtës së shkelur.

**E drejta e pronës private**, gjithashtu është një ndër të drejtat që ka patur një fokus të veçantë në punën e Institucionit të Avokatit të Popullit për gjatë këtij viti, kjo për shkak jo vetëm që përbën një prej prioriteteve që Shteti Shqiptar duhet të përmbushë për t'u anëtarësuar në BE por gjithashtu dhe për shkak se vazhdon të mbetet pa progres dhe ende e pa zgjidhur.

Nga gjithë kompleksiteti i realizmit të kësaj të drejte, ajo e kthimit apo kompensimit të pronave tek të shpronësuarit nga sistemi i kaluar, mbetet një nga çështjet më problematike e të mprehta. Centralizimi i procesit të njohjes kthimit dhe kompensimit të pronave në Agjencinë e Kthimit e Kompesimit të Pronave, Tiranë, pas suprimimit të atyre rajonale, ka ndikuar në ngadalësimin e procesit. Problemet e shfaqura më shpesh në veprimtarinë e AKKP të cilët janë evidentuar gjatë punës sonë, janë tejzgjatje e procedurave administrative, mosdërgim rast pas rasti i vendimeve të marra për njohjen me të drejtë kthimi/kompesimit të pasurisë së paluajtshme në rrugë zyrtare pranë zyrës vendore të rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, konform parashikimit të nenit 196, të Kodit Civil, mosekzekutime të vendimeve administrative apo gjyqësore që lidhen me të drejtën e kompesimit të pasurive të paluajtshme, pasaktësi në hartimin e materialit grafik që i bashkëlidhet vendimit, sipas të cilit është vendosur për njohjen e së drejtës së pronësisë, proces shumë i ngadaltë i kompesimit në vlerë për subjektet, që iu është njohur pronësia etj.

Me rëndësi të veçantë paraqitet reforma ligjore që parashikohet të ndërmerret nga Këshilli i Ministrave, sa i takon kufizimit me ligj të së drejtës të kërimit të njohjes dhe kthimit/kompesimit të pasurisë së paluajtshme pranë AKKP, "Përgatitja e Projekt-Ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme" në referim të nenit 5, të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" dhe kalimin për miratim në Kuvendin e Shqipërisë", përmirësimit të kuadrit ligjor dhe pastrimit të legjislacionit nga mbivendosja e kompetencave, si edhe plotësimi i tij me akte nënligjore. Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë konstatimet dhe sugjerimet e tij Ministrisë së Drejtësisë, për Reformën në kthimin dhe kompensimin e pronave sipas objektivave të VKM-së "Për zbatimin e vendimit pilot të GJEDNJ-së, Manushaqe Puto e të tjerë kundër Shqipërisë".

Përveç formave të parashikuara nga Kushtetuta e RSH-së për fitimin e të drejtës së pronës, janë përcaktuar me ligj dhe forma të tjera siç është ajo e **legalizimit të ndërtimeve pa leje**. Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2014 i ka ndjekur me vëmendje të gjitha ankesat që janë adresuar në lidhje me çështjet e legalizimeve dhe prishjes ose jo të ndërtimeve pa leje nga Inspektoriati ndërtimor urbanistik kombëtar dhe atyre pranë bashkive.

Megjithëse kuadri ligjor që formëson materialisht dhe proceduralisht procesin e legalizimit të ndërtimeve informale dhe procesin e kontrollit mbi ndëtimet e reja ka ndryshuar vazhdimisht, kjo edhe gjatë vitit 2014, dhe megjithëse janë ngritur organe specifike për mbarëvajtjen e tyre, përsëri vërehen probleme. Institucioni i Avokati të Popullit gjatë vitit 2014, ka shqyrtuar një numër jo të vogël ankesash ndaj Zyrrave Rajonale të ALUIZNI-t në rrethe, apo edhe ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. Gjatë shqyrtimit të ankesave ka rezultuar se, një pjesë e konsiderueshme e individëve kërkojnë të informohen zyrtarisht, për ecurinë e procedurës së legalizimit të objekteve të ndërtuara prej tyre pa leje ndërtimi, pasi nuk kanë patur asnjë informacion, apo njoftim nga zyrrat respektive të ALUIZNI-t. Avokati i

Popullit ka konstatuar se ka ende një numër shumë të lartë qytetarësh të cilët kanë aplikuar prej vitesh pranë zyrave të ALUIZNI-t në qarqe, por kërkesat e tyre për legalizim nuk janë shqyrtuar ende si dhe ka rezultuar se qytetarëve nuk ju është vënë në dispozicion vendimi i marrë nga ALUIZNI lidhur me legalizimin ose jo të objektit.

Ky problem është evidentuar kryesisht gjatë vitit 2014 për shkak të nismave të ndërmarra në zbatimin e disa projekteve publike, në kuadër të të cilave janë planifikuar ndërhyrje për prishje të ndërtimeve në objektet e ndërtuara të mjaft individëve, të cilët kanë aplikuar prej vitesh për legalizimin e tyre. Të gjitha këto problematika, konstatime dhe rekomandime konkrete në vijim të tyre, janë përmbledhur nga ana e Avokatit të Popullit në një Raport të Veçantë, i cili i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë në fund të vitit 2014.

Një nga problematikat më specifike të konstatuara ka qënë mospërcaktimi i afatit maksimal fundor të mbarimit të procedimit administrativ për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi. Bazuar në praktikat e ankesave që janë paraqitur pranë institucionit tonë për raste të ngjashme që lidhen me veprimtarinë e organit të ALUIZNI-t, apo edhe të INUV-ve përkatëse, kemi konstatuar se individë të ndryshëm të cilët kanë ndërtuar pa leje, kanë aplikuar me vetëdeklarimin për legalizimin e objektit prej shumë vitesh pranë njësive të qeverisjes vendore. Duke qënë se kjo sjell zvarritje pafund të procesit, i kemi rekomanduar Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit ndërmarrjen e inisiativës legislative për rregullimin e kësaj çështjeje në ligj. Gjithashtu një sërë shkeljesh të të drejtave të njeriut, siç është edhe ajo e ankimit ndaj vendimit të Aluizni-t, për shkak të mosvënies në dispozicion të subjekteve të vendimit të marrë nga kjo e fundit.

Pavarësisht bazës së gjerë ligjore për rregullimin e **veprimtarisë të INUV-ve dhe INUK-ut**, gjatë vitit 2014 janë verifikuar probleme dhe mangësi në ushtrimin e kompetencave nga ana e tyre në kuadër të ndjekjes të procedurave administrative, të pasqyruara edhe në ankesat e shumta me objekt mosveprimin në verifikimin e ndërtimeve të paligjshme, marrjen e masave dhe sanksioneve ligjore ndaj kundravajtësve, mosekzekutim të vendimeve për prishje, apo edhe për veprime të padrejta duke shkelur kryesisht procedurat administrative të njoftimit të akteve administrative, në kuadër të njohjes dhe ushtrimit nga ana e individëve të të drejtës së ankimit. Inspektoriatet përkatëse duhet të vënë në dispozicion të subjekteve vendimin për prishjen e ndërtimit pa leje dhe të respektohet afati 5 ditor për atakimin e tij në rrugë gjyqësore me qëllim respektimin e të drejtës së palëve përkatëse për një proces të rregullt ligjor.<sup>13</sup>

Avokati i Popullit ka konstatuar probleme edhe në mënyrën e procedimit nga ana e punonjësve të INUV, përse i takon njoftimit për prishjen e banesave të individëve të caktuar, ndërkohë që objekti ndodhet ende në proces legalizimi. Pavarësisht ligjshmërisë ose jo të ndërtimit të këtyre ndërtimeve, ato i janë nënshtruar brenda të gjitha rregullave procesit për legalizimin e tyre, që nënkupton që pritet vendimi i këtij organi që vendos legalizimin ose jo të ndërtesës. Nga ana tjetër edhe sikur objektet të ishin në kushtet kur ato janë të kundërligjshme, atëherë sipas akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë procedurat e kontrollit të territorit nga ana e INUV-ve dhe INUK-së, duhej që të ndiqen disa hapa proceduriale të përcaktuara konkretisht, për këtë çështje.

**Mbrojtja e konsumatorit** paraqitet një nga fushat kryesore që lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ligji Nr. 9902 datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e

---

<sup>13</sup> Për këtë i kemi rekomanduar në datën 27.10.2014 Kryenispektoret së INUK, analizimin e menjëhershëm dhe të kujdesshëm të të gjitha procedurave të ndjekura nga ana e INUK, për ndërtimet që ndodhen në zonën e Selitës, ku do të zbatohet projekti i “Unazës së Re”, si dhe shfuqizimin e çdo akti që është nxjerrë në shkelje të rëndë të procedurave të përcaktuara nga ligji dhe respektimin e tyre në procedurat që do të ndiqen në vazhdim nga ana e INUK-ut, duke respektuar të gjitha të drejtat që individët gëzojnë në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

konsumatorit”, i ndryshuar, përbën legjislacionin bazë për këtë të drejtë, ku edhe Avokatit të Popullit i njihet një rol i veçantë për mbrojtjen e interesave të konsumatorit.

Ankesat më të shumta në fushën e mbrojtjes së konsumatorit janë kryesisht për shërbimet dhe furnizimin me energji elektrike si dhe ato që kanë të bëjnë me furnizimin me ujë. Sa i takon furnizimit me energji elektrike, gjatë këtij viti janë evidentuar probleme lidhur me respektimin e nenit 7, të Kontratës Tip të Energjisë Elektrike, ku faturimi nuk është bërë në periudhën 30 ditore, por në një periudhë mbi 40 ditore, e cila ka sjellë mbifaturim të sasisë së energjisë elektrike duke marrë në konsideratë fashën mbrojtëse; mungesën e një rregullimi ligjor lidhur me kolaudimin e matësve gjë që lë shteg për abuzim; faturimi aforfe në kundërshtim me Ligjin Nr.9072/2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, për të gjithë personat pa matësa; ofrim i shërbimit të furnizimit me energji elektrike jashtë standardeve dhe ndonjëherë me rrezikshmëri të lartë për pronën dhe shëndetin e individëve, nga ana e OSHEE; aplikimi i kufizimeve zonale të energjisë elektrike që sjell dënim kolektiv të konsumatorit.

Lidhur me ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, veçanërisht në stinën e verës, konsumatorët shpesh herë përballen me mungesa të vazhdueshme të furnizimit me ujë të pijshëm, kjo si pasojë e amortizimit të rrjetit dhe moskryerjes së investimeve. Po kështu janë evidentuar raste të mungesës së cilësisë së ofrimit të furnizimit me ujë të pijshëm, pasi ai është bërë nëpërmjet gropave septike (*puseve*).

Në këto kushte është e nevojshme dhe kemi rekomanduar, marrjen e masave për pajisjen e të gjithë abonentëve me matësa të energjisë elektrike dhe shmangien e praktikave të faturimeve aforfe, me qëllim faturimin sipas leximit korrekt të konsumit të energjisë elektrike; rishikimi i kushteve të Kontratës së Furnizimit me energji elektrike, për penalitetet që duhet të ketë kompania furnizuese, në rast të dëmtimit të pajisjeve elektroshtëpiake të qytetarëve; lidhja e akt-marrëveshjeve dhe krijimin e procedurave lehtësuese për personat debitorë, veçanërisht për ata që janë në varfëri ekstreme dhe që nuk kanë mundësi për pagesë të energjisë elektrike; marrja e masave për kryerjen e investimeve nga “OSHEE” sh.a., për furnizim normal me energji elektrike, ashtu dhe nga “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., për furnizim me ujë të pijshëm, duke ju ofruar qytetarëve shërbime sa më optimale dhe sipas standardeve të kërkuara.

**E drejta për informim** është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila fokusohet tek liria e individit për të marrë informacion nga autoritetet publike. Institucioni i Avokatit të Popullit, është një nga aktorët kryesorë në kuadër të respektimit, promovimit dhe mbrojtjes të së drejtës për informim. Në këtë këndvështrim viti 2014 ka sjellë ndryshime në bazën ligjore që përcakton regjimin juridik të së drejtës për informim, pasi duke filluar nga muaji Nëntor 2014, ka hyrë në fuqi Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që rregullon regjimin juridik të kësaj të drejte.

Këto zhvillime kanë kushtëzuar tashmë edhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit, i cili nga institucioni i cili kujdesej për zbatimin e së drejtës për informim, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk e gëzon më këtë atribut. Për këtë qëllim, institucioni i Avokatit të Popullit ka prezantuar pranë Komisionit të ligjeve dhe të drejtave të njeriut, të gjitha pretendimet e tij lidhur me të drejtën e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe për garantimin e zbatimit të saj.

Problematikat e hasura nga trajtimi i ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, kanë të bëjnë me mosrespektimin e afateve kohore të përcaktuara në ligj, për refuzimin apo pranimin e kërkesës së paraqitur nga subjektet e interesuara për informim, përmbushjen e detyrimit për të dhënë informacionin e kërkuar, mospërgjigje dhe mostrajtim të kërkesave për informim nga ana e organeve të administrates publike, moszbatimi në mënyrë korrekte i dispozitave ligjore që njohin dhe garantojnë të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga Administrata Publike.

Problematika e së drejtës për informim, gjatë këtij viti është trajtuar realisht shumë më gjerë se sa numri specifik i ankesave të dhëna në këtë raport, në kuadër të ankesave të tjera që, si objekt kryesor kanë patur një problematikë të ndryshme nga ajo e së drejtës për informim.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, regjimi juridik i së drejtës për informim konstatohet se është përmirësuar në shumë elementë të rëndësishëm të tij, të cilat janë theksuar prej kohësh nga institucioni i Avokatit të Popullit, por mendojmë se ka ende nevojë për rishikim dhe qartësim të dispozitave të këtij ligji. Konkretisht gjykojmë se, është e nevojshme të bëhet parashikimi shprehimisht në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor për lehtësirat, për formën e dhënies së informacionit në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Po kështu, është i nevojshëm qartësimi i rrugës së ankimit administrativ ndaj shkeljeve të së drejtës për informim dhe pozicionit që ka Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, në këtë proces. Një çështje shumë e rëndësishme mbetet saktësimi dhe qartësimi i kompetencave të Avokatit të Popullit, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të kësaj të drejte, të përcaktuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në fokusin e punës së institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 ka qenë edhe **e drejta e qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm**. Avokati i Popullit, gjykon se zbatimi me rigorozitet i dispozitave të ligjeve në fuqi që rregullojnë këtë fushë, do të ndikojë në përmirësimin e situatës mjedisore në Shqipëri si dhe rritjen e standarteve të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, në përputhje me kërkesat dhe standartet e jetës së qytetarëve të vendeve europiane, në kuadër të proceseve integruese që ka ndër marrë Shqipëria.

Mungesa e koordinimit të strukturave në nivel lokal dhe qëndror ka shkaktuar edhe zvarritje të ushtrimit të kompetencave të tyre respektive. Ndërkohë duhet theksuar në këtë kuadër edhe reduktimi i punonjësve të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Pyjor në rrethe, me argumentimin se ishin struktura jo efektive. Kjo ka lënë hapësira për rritjen e abuzivizimit në prerjen e pyjeve dhe respektimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për shfrytëzimin e tyre. Problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është edhe mungesa e ndëshkimit, apo edhe gjobat mjaft të ulëta për ata individë, apo subjekte, që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj mjedisit.

Problematika të ankesave dhe kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit 2014 kanë qenë ndotjet e ambientit nga agjentë të ndryshëm, apo aktiviteteve të paligjshme e të palçesuara, ndotja e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhja e mbeturinave në vende publike, si edhe ndotjet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në këto zona të prekura nga këto ndotje.

Aktualisht konstatohen ende probleme me hedhjen e mbetjeve dhe trajtimin e përpunimin e tyre, apo edhe respektimin e normave të tjera mjedisore, të cilat në këndvështrimin e parë nuk lënë pasoja, por efektet e tyre janë afatgjata, të ngadalta dhe të padukshme, duke rrezikuar seriozisht shëndetin dhe jetën e individëve. Ashtu si edhe në fusha të tjera, problemi i nivelit të ndotjes së mjedisit në vendin tonë qëndron tek zbatimi i ligjeve mbi çështjet e mjedisit. Ajo që konstatohet nga Institucion i Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen e mjedisit, është se qytetarët në këtë drejtim janë më pasiv në adresimin e ankesave, dhe për këtë arsye, Avokati i Popullit ka luajtur një rol aktiv duke marrë çështje me iniciativë me qëllim adresimin e problematikave me qëllim zgjidhjen e tyre.

**Të moshuarit** mbeten një nga grupet më vulnerabël në Shqipëri. Ata përbëjnë një ndër grupimet më të mëdha numerike të shtresave dhe grupeve në nevojë. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, mund t'i çojë të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri. Ata ndeshen shpesh me barriera shoqërore që ndikojnë në jetët e tyre. Si një masë e



domosdoshme për të garantuar të drejtat e të moshuarve, nevojitet dhe kërkohet miratimi i Statusit të Moshës së Tretë.

Lidhur me këtë çështje, më herët Institucioni ynë ka ndërhyrë pranë ish Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke e pasuar me rekomandime dhe gjatë vitit 2014, në përgjigje të të cilave është përcaktuar se ky projektligj parashikohet të diskutohet gjatë vitit 2015. Në mbrojtje të të drejtave të të moshuarve edhe gjatë këtij viti kemi kryer inspektime në qendrat sociale rezidenciale dhe ditore për të moshuarit, në të cilat janë identifikuar problemet e caktuara që janë adresuar tek Kryetarët e bashkive përkatëse dhe Shërbimi Social Shtetëror. Ndërkohë, institucionet dhe strukturat shtetërore dhe vetë shoqëria jonë duhet të vazhdojnë të forcojnë mekanizmat socialë dhe ekonomikë në mbështetje të të moshuarve.

Duke qenë se **minimumi jetik** është përcaktues në nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes shoqërore, i jemi drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë me një rekomandim për ngritjen e një grupi pune për studimin dhe përcaktimin e nivelit minimal të standarit të jetesës në Shqipëri. Efektivisht deklarimi zyrtar i minimumit jetik do të shërbente jo vetëm si një realizim i detyrimit ligjor nga ana e Këshillit të Ministrave, por edhe si bazë për rikualifikimin e realizimit të një sërë të drejtave të tjera të individëve në vend. Megjithë rekomandimet periodike kohore të përgatitura nga ana e Avokatit të Popullit për këtë qëllim, ende nuk ka një deklaram zyrtar të minimumit jetik në Shqipëri.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 ka luajtur dhe **rol promovues** të të drejtave të njeriut duke kryer një sërë aktiviteteve sensibilizuese për të drejtat e njeriut në fusha të ndryshme me aktorë të shoqërisë civile, me përfaqësues të Institucioneve shtetërore, në arenën ndërkombëtare, me median e shkruar dhe atë elektronike, etj. Gjithashtu për nxitjen në respektimin e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka ndërmarrë një iniciativë të re për publikimin e një reviste periodike, në të cilën trajtohen çështje të ndryshme. Konferenca vjetore e zhvilluar për të drejtat e minoriteteve kishte si qëllim nxitjen e respektimit të të drejtave të tyre.

Avokati i Popullit ka patur një **rol proaktiv** gjithashtu lidhur me të drejtat e njeriut. Në shumë raste Avokati i Popullit ka qënë një hap përpara me ndjekjen e problematikave të shumta që shqetësojnë sot qytetarët, pasi larmia e çështjeve të ndjekura me iniciativë dhe vëzhgimi analitik i fenomeneve të ndryshme, kanë paraprirë ndërhyrjet që ndikojnë, qoftë në përmirësimin e sistemeve që gjenerojnë realizim të të drejtave, qoftë edhe në adresim dhe zgjidhje të çështjeve individuale. Roli proaktiv është parë si pjesë e panadarë e rolit aktiv dhe reagues që institucioni luan natyrshën në punën e tij të përditshme. Gjithashtu hapja e zyrave rajonale, faqja e internetit dhe sistemi online i ankesave kanë patur si qëllim rritjen e aksesit të shtetasve tek institucioni i Avokatit të Popullit.

Pa dyshim që Avokati i Popullit gjendet para sfidave të reja, të cilat lidhen me reformat që pësojnë organet e administratës publike në vend dhe një sërë sistemesh ofrimi të shërbimeve publike. Sfida më kryesore në këtë proces mbetet roli primar që duhet të luajë institucioni, si oponenca e vazhdueshme që siguron balancën e duhur mes ushtrimit të pushtetit në veprimtarinë e organeve të administratës dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj dhe nga ana tjetër, garantimit dhe respektimit real të të drejtave të njeriut në këto procese transformuese.

## KREU 2

### ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT SI MEKANIZËM KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURES

#### 2.1. Roli parandalues në shkeljen e të drejtave të personave të privuar nga liria

##### 2.1.1. *Kuadri ligjor*

Me miratimin e ligjit Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, Avokati i Popullit u vendos nga Parlamenti si autoriteti i duhur për garantimin e funksionimit profesional dhe të pavarur të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Njohja ligjore e MKPT-së, si një strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) funksionon bazuar në legjislacionin kombëtar, duke u udhëhequr nga parimet e instrumenteve ndërkombëtare: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollet e saj shtesë, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996; Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimit Mizor, Çnjerëzor e Degradues, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 7727, datë 30.06.1993; Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9094; Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajttimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8135, datë 31.7.1996. Lista me këto instrumente të drejtave që udhëheqin punën e Mekanizmit nuk është shteruese, pasi ka një sërë rekomandimesh, veçanërisht të Këshillit të Evropës, të cilët janë të rëndësishëm në garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Megjithatë, këta instrumente janë “gurët e themelit” për punën tanimë disa vjeçare të MKPT-së në Shqipëri.

MKPT funksionon në përputhje me legjislacionin vendas, që është një mjet në duart e qytetarëve shqiptarë për të gëzuar të drejtat e tyre të sanksionuara në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”; Ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; Ligjin Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”; Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”; VKM-në nr. 187, datë 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 303, datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”; Ligjin Nr. 9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”; VKM-në nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”. Sërish, kjo nuk është një listë shteruese, pasi ka një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave, si edhe manuale dhe dokumente të tjera pune, zbatimi i të cilave është një garanci për gëzimin e të drejtave.

### **2.1.2 Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet**

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit, me qëllimin për t'i garantuar pavarësi funksionale MKPT-së dhe personelit në shërbim të tij, sikurse parashikohet në OPCAT, ndërmori procedurat e nevojshme të rekrutimit për të strukturuar, plotësuar e rinovuar stafin me anëtarë të rinj, ekspertiza profesionale të cilëve do të mundësonte përmbushjen e nevojave institucionale për një grup multidisiplinar pune. Në prill të vitit 2014, stafit ekzistues të ndihmëskomisionerëve të përbërë nga dy ekspertë ligjorë, iu shtua një eksperte ligjore, një mjekë psikiatre dhe një psikologe klinike në rolin e drejtueses së mekanizmit, në thelb koordinuese e punës mes të barabartëve. Procesi i përzgjedhjes së profesionistëve në përbërje dhe drejtim të zyrës, mundësonte mbarëvajtjen e vijimësinë e punës në bazë merite, e të pakushtëzuar nga terma kohorë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2014, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) dhe Prezencën e OSBE-së në vendet e rajonit, për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta, dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Në tetor të vitit 2014, MKPT-ja Shqiptare, pranoi në mënyrë zyrtare propozimin e anëtarëve të Rrjetit për të drejtuar për një periudhë një vjeçare Presidencën e Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Juglindore. Ky rrjet, i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë, ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një përmbushje sa më të qenësishme të mandatit të MKPT-ve në rajon, siç edhe specifikohen në OPCAT.

MKPT gjatë vitit 2014 ka qenë pjesë aktive e Grupit të Punës mbi Reformën në Burgje të drejtuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Po ashtu, gjatë vitit 2014, MKPT ka bashkëpunuar ngushtësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) në kryerjen e një sërë trajnimesh me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit administrativ e atij të sigurisë brenda sistemit. Gjithashtu, në bashkëpunim me DPB-në, është mundësuar instalimi i kutive postare për ankesat e personave të privuar nga liria në të gjitha IEVP-të e vendit, me qëllim mundësimin e dërgimit të drejtpërdrejtë të ankesave e kërkesave nga vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit në adresë të Avokatit të Popullit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2014 Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me FRONTEx dhe Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Emigracionit, ka monitoruar operacionet e riadhesimi të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen. Qëllimi i këtyre operacioneve, ishte transferimi sa më i qetë dhe në mënyrë dinjitoze i shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të zonës Shengen. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues gjatë operacioneve të riadhesimit, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor dhe kushtetues si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014 MKPT ka qenë pjesë integrale e takimeve të organizuara nga Komiteti Kombëtar për Shëndetin Mendor, në të cilat janë diskutuar çështje të

rëndësishme lidhur me organizimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të shëndetit mendor. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, gjatë vitit 2014 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend. Bashkëpunime të frytshme në kryerjen e vizitave inspektuese dhe në organizimin e trajnimeve e aktiviteteve të tjera me natyrë promovuese mbi të drejtat e njeriut për personat e privuar nga liria, janë zhvilluar me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Shoqatën Përthyerje, Institutin Evropian të Tiranës dhe Shoqatën e Avokatëve Penalistë Shqiptarë.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2014 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave të shtypit, takimeve të përbashkëta me gazetarët, shkrimeve e intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

### ***2.1.3. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet***

Gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer 115 inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita monitoruese në të gjitha institucionet ku privohet liria e individit (*institucione penitenciare, njësi policore, spitale psikiatrike, baza ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktime të trafikut*) në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.
- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse, duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore vendase dhe standardet ndërkombëtare.
- Kushtet materiale të personave të trajtuar në institucione, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjienë personale, kushtet sanitare, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas zërave të parashikuara në rregulloret institucionale dhe specifike të tyre (për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët, për të kryer telefonata, për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptonin, për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, për procedurat e punësimit dhe shpërblimet për punën e kryer, për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër, të drejtën e ushtrimit të riteve fetare, të drejtën për të përfituar ndihmë financiare, etj.)
- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, e kurseve profesionale dhe të aktiviteteve rekreative e rehabilituese sipas specifike të institucioneve.
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor, etj.

Ndryshe nga MKPT-të e tjera, të cilat kryejnë inspektime me përzgjedhje rastësore ose tematike, MKPT-ja shqiptare zgjodhi të ndiqte praktikën më të mirë të viteve të mëparshme të ekzistencës së saj, duke inspektuar në mënyrë të thelluar, së bashku me OJF-të e interesuara në fushë, të gjitha institucionet e sipërpërmendura. Për rastet e tejkalimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, MKPT bashkëpunoi në kryerjen e inspektimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të

Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

I gjithë aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen brenda vitit kalendarik 2014 të 50 rekomandimeve konkrete<sup>14</sup> ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara, ndërkohë 34 të tjera janë dërguar gjatë muajit janar 2015. Nga përgjigjet e marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Gjithsesi, mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të individëve që strehohen në këto institucione. Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

#### ***2.1.4. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare<sup>15</sup>***

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Gjatë inspektimeve u vunë re një sërë problematikash të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Vihej re një gjendje alarmante e mbipopullimit në sistemin penitenciar, me deri 1500 persona mbi kapacitetet. Veçanërisht problematike paraqitej situata në institucionet e paraburgimit. I EVP-të Jordan Misja, Fushë-Krujë, Rogozhinë, Elbasan, Berat, Drenovë, Vlorë, Tepelenë, Sarandë, Durrës e Lezhë funksiononin në pjesën më të madhe të kohës dukshëm mbi kapacitetin zyrtar. Për arsye të mbipopullimit, në disa prej I EVP-ve e më konkretisht në I EVP Jordan Misja, Drenovë e Sarandë nuk realizohej observimi e më pas sistemimi në dhoma sipas kriterëve të përshtatshmërisë.
- Edhe gjatë vitit 2014, marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” nuk ka gjetur zbatim. Trajtimi i kësaj kategorie në I EVP, në kushtet kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe në problematikën e përgjithshme të mbipopullimit.
- Nga të dënuar e paraburgosur kishte pretendime mbi disa punonjës të I EVP-ve për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike, kryesisht në I EVP Mine Peza, Peqin, Korçë dhe Vlorë. Ankesat u pasuan nga hetime të gjithanshme dhe rekomandime ndaj I EVP-ve përkatëse dhe DPB-së për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Procedurat disiplinore në Institutin e të Miturve Kavajë dhe në Seksionin e të Paraburgosurve të Mitur në I EVP Vlorë, nuk zbatoheshin në mënyrë korrekte. Masat e reja edukative disiplinore, nuk ishin marrë në konsideratë nga ana e stafit të edukimit dhe nuk zbatoheshin sipas procedurave dhe politikave disiplinore e edukative për të miturit, sikurse

<sup>14</sup> Rekomandimet e plota të hartuara nga MKPT, do të bëhen pjesë e Raportit Vjetor të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, i cili do të botohet në muajin mars të vitit 2014 dhe do të shpërmdahet në të gjithë institucionet dhe personat e interesuar.

<sup>15</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Institucionet Penitenciare janë hartuar 17 rekomandime.

përcaktohen në udhëzuesin administrativ të DPB-së. Të miturit në këto institucione vendoseshin në kushte që i ngjanin izolimit të vetmuar deri në 20 ditë, masë kjo që mund të komprometojë integritetin e tyre fizik dhe/ose mendor.

- Në disa institucione, si p.sh., në I EVP Lezhë, Lushnje, Vaqarr, Tepelenë, Fushë-Krujë, Burrel, nuk ofrohej arsimit i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit për arsimin 9-vjeçar.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet (përveç I EVP Burrel) bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.
- Nga pikëpamja infrastrukturore, pjesa më e madhe e I EVP-ve paraqisnin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, duzeve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungesës së ambienteve të edukimit apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarisë sportive etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Kosovë e Lushnjës, Rrogozhinë, Burrel, Sarandë, Tropojë, Lezhë, Tepelenë, Jordan Misja, Ali Demi, Mine Peza e në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve.
- Në të gjitha I EVP-të, ambientet e takimit me familjarët ishin të papërshtatshme, veçanërisht për takime me të mitur.
- Sipërfaqet e vogla për ajrim në një pjesë të I EVP-ve kushtëzonin zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër gjatë qëndrimit në to, ndërsa në I EVP Jordan Misja, Sarandë, dhe në ambientet e observimit në I EVP Korçë nuk respektohej e drejta e ajrimit sipas parametrave, për arsye të mungesës së ambienteve.
- Në I EVP-të e pa rikonstruara, mjediset e jashtme dhe të brendshme nuk ishin në përputhje me standardet, duke sjellë pengesa në procesin e rehabilitimit psiko-social të burgosurve/paraburgosurve.
- Numri i kufizuar i aktiviteteve që ofroheshin në institucione, kushtëzohej nga mungesa e ambienteve të përshtatshme, si rezultat i kthimit të tyre në dhoma banimi për efekt mbipopullimi dhe i mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Problematike në këtë drejtim ishin I EVP-të Burrel, Korçë, Durrës, Lezhë, Tepelenë, Jordan Misja, Mine Peza, Kosovë-Lushnje etj.
- Në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatua plotësim në mënyrë formale i dosjeve psiko-sociale, sa i përket objektivave të trajtimit, programeve individuale të trajtimit, shënimeve të përmuajshme, e këshillimeve individuale e në grup, të cilat ndonëse shënoheshin si të kryera, realisht nuk zbatoheshin.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP Vlorë, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Në shumicën e I EVP-ve, vonesa në pajisjen e të gjithë të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore, sillte moszbatimin e skemës rimbursuese dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Në shumicën e I EVP-ve, vëreheshin vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike jashtë këtyre institucioneve.
- Shërbimi stomatologjik në I EVP nuk funksiononte normalisht për shkak të mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me

vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.

- Sistemet qendrore të ngrohjes pothuajse në të gjitha I EVP-të ku ishin të instaluara nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit përdornin batanijet dhe teshat e fjetjes si të vetmet mjete ngrohjeje.
- Në të gjitha I EVP-të, u konstatuan mungesa në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë.
- Në të gjitha I EVP-të, u konstatuan mungesa në përdorimin e uniformave e të dorezave gjatë shpërndarjes së ushqimit.
- Në shumicën e dhomave të banimit të I EVP-ve mungonin dollapët/raftet e rrobave. Ato mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshet kryesisht në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, Jordan Misja, Mine Peza, Sarandë, Kukës e Tropojë.

### ***2.1.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore<sup>16</sup>***

Inspektimet në njësitë policore kishin si qëllim vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe të verifikimit të përmbushjeve të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore, heqjen nga përdorimi të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/arrestimit të shtetasve. Nga inspektimet e kryera në organet e policisë, u konstatuan problematikat sa më poshtë:

- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë, sidomos ndaj atyre që dyshohen si autorë të veprave penale, në Komisaritet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 të DPQ Tiranë, në Komisariatin Shijak të DPQ Durrës, në Komisariatin Lezhë, Mirditë, e Stacionin e Policisë Shëngjin të DPQ Lezhë, në Komisariatin Mat të DPQ Dibër dhe Komisariatin Devoll të DPQ Korçë.
- Moskryerje të detyrimeve ligjore nga personeli policor dhe ai shëndetësor që shërben në ambientet e sigurisë, për raportimin e rasteve ushtrimit të dhunës ndaj të arrestuarve ose të ndaluarve, në DPQ Tiranë dhe në DPQ Lezhë.
- Sjellje pa etikë të disa punonjësve të policisë në komunikimin me qytetarët në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, në Komisaritet e Policisë Nr. 2 dhe 3 Tiranë dhe në Fier.
- Bllokime dhe mbajtje pa të drejtë të sendeve të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar sikurse është konstatuar në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë.
- Shoqërime të shtetasve në organet e policisë, jashtë kriterëve ligjore të parashikuara në dispozitat ligjore, në Komisaritet dhe Stacionet e Policisë Tiranë, Durrës, Kavajë, Shijak, Elbasan, Peqin, Krujë, Kurbin, Fushë Krujë, Mamurras, etj.
- Në shumë komisariate e organe policie nuk ishin ndërtuar apo përshtatur ambientet e shoqërimit sikurse parashikohet në dispozitat e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).

<sup>16</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Njësitë Policore janë hartuar 29 rekomandime

- Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të papastra, të palyera, të pa pajisura me orënditë e nevojshme (karrige, stola, tavolinë) ose edhe atje ku kishte të tilla, ato ishin të dëmtuara.
- Ambientet e sigurisë në rreth 80% të tyre nuk ishin ndërtuar apo përshtatur sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe aktet normative të brendshme.
- Në pjesën më të madhe të komisariateve (*si p.sh., në Komisaritet e Policisë Tiranë, si dhe në Komisariate e Policisë Durrës, Kavajë, Shijak, Elbasan, Peqin, Krujë, Kurbin, Fushë Krujë, Mamurras etj.*), mungonin regjistrat e përditësuar për personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/arrestuar. Kryesisht për këtë arsye, u vunë re mangësi për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në dispozitat ligjore për evidentimin në regjistra të të dhënave të personave të shoqëruar sipas rubrikave në zë mbi arsyet e shoqërimit dhe njoftimin e personave familjarëve apo të afërmeve të të shoqëruarve.
- Në një pjesë të konsiderueshme të Komisaritateve (*Komisariatet dhe Stacionet e Policisë Tiranë, Kavajë, Peqin, Krujë, Fushë Krujë, Kurbin, Mamurras, etj*) mungonin posterat për rastet e shoqërimit dhe të drejtat ligjore të të shoqëruarve.
- Në Komisaritet e Policisë Nr. 4 dhe 6 Tiranë, për shkak të mbipopullimit ishin vënë në funksionim si ambiente për mbajtjen e të arrestuarve e ndaluarve edhe disa mjedise që kanë qenë të mbyllura më parë e që nuk plotësonin asnjë kriter e standard minimal jetese.
- Drejtoria e Qarkut Tiranë, Komisariti i Lezhës, i Elbasanit, si edhe Komisaritet nr. 3 dhe nr. 5 të Qarkut Tiranë punonin në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar, në disa raste deri në 3 apo 4 herë më shumë se kapaciteti. Mbiipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e ndaluar/arrestuar vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për arsye të mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Në ambientet e sigurisë të disa prej DPQ-ve dhe komisariateve të varësisë, mbaheshin edhe persona të arrestuar ndaj të cilëve ishte caktuar masë sigurimi personal nga gjykata deri në 20 ditë.
- Shërbimi shëndetësor i ofruar nga DPQ-të ishte problematik përse i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e shërbimit shëndetësor. Në një pjesë të konsiderueshme të këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.

### ***2.1.6. Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura***

Inspektimet e përgjithshme në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Shkollën e Trupës Bunavi Vlorë, në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, në Komandën e Forcave Tokësore Zall-Herr, Tiranë, si dhe në Komandën e Forcave Tokësore Vau i Dejës Shkodër, kishin si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, zbatimin e rregullave të parashikuara në Instruksionin e Kryerjes së Shërbimit të Ruajtjes nga Përgjegjësi i Dhomave të Ndalimit Disiplinor në Policinë Ushtarake, lidhur me kushtet e dhomave të ndalimit disiplinor, procedurat e dhënies së këtyre masave, respektimin e të drejtave të ushtarakëve të dënuar, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhënë gjatë viteve të mëparshme. Gjatë inspektimeve u vunë re disa problematika të cilat paraqesin nevojë për përmirësim. Përmbledhtazi këto gjetje pasqyrohen si më poshtë:



- Kushtet në dhomat e sigurisë në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë ishin të papërshtatshme për t'u ofruar ushtarakëve me masën e “ndalimit disiplinor” një akomodim dinjitoz dhe konform standardeve.
- Mungonte sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurimit në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë dhe në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës, Shkodër.
- Kushtet e ambienteve të takimit me familjarët ishin të papërshtatshme krahasuar me standardet.
- Mungonin zilet elektrike në dhomat e sigurisë.
- Ushtarakëve që mbaheshin në këto dhoma nuk u ofrohej një paketë me produkte të higjienës personale.
- Plotësimi i rubrikave në regjistrat për ndalimin disiplinor, ishte i mangët si në Batalionin e Policisë Ushtarake Tiranë ashtu dhe në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës Shkodër.
- Kishte prani të mjeteve të forcës, shkop gome dhe pranga në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë së Batalionin e Policisë Ushtarake Tiranë.
- Mungonte ngrohja në dhomat e sigurisë të Batalionit të Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë dhe të Komandës së Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës, Shkodër.

### ***2.1.7. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike<sup>17</sup>***

Vizitat monitoruese në Spitalin Psikiatrik Elbasan, Spitalin Psikiatrik Vlorë dhe në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër në Shkodër<sup>18</sup>, përveç objektit të përgjithshëm të vizitave kishin si qëllim specifik: vlerësimin e respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, vlerësimin e procedurave të kryerjes së shtrimeve të pavullnetshme, masat shtrënguese e kufizimit fizik, kushtet në të cilat mbahen këta persona, trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitues dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të prezantuara për këto ambiente gjatë viteve të mëparshme. Nga vizitat monitoruese të kryera për vitin 2014 në spitalet psikiatrike të lartpërmendura u konstatuan:

- Mosrespektimi i hapësirës jetike, kushte të papërshtatshme në dhomat e personave të shtruar, dhe mbajtja e tyre për një kohë të gjatë/kthimi në rezidentë të Spitalit Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mbajtja e personave me Prapambetje Mendore në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mungesa e dhomave të veçimit, mungesa e një sistemi monitorimi me kamera në ambientet e këtyre spitaleve, si dhe mungesa e regjistrave të unifikuar nga Ministria e Shëndetësisë në të tre Institucionet e lart përmendura, veçanërisht për sa i përket dokumentimit të shtrimeve të pavullnetshme dhe aplikimit të kufizimit fizik.
- Mangësi në plotësimin e organikës me mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Shkodër, dhe shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në atë të Elbasanit.
- Problematika e ndjekjes së procedurave për shtrimet e pavullnetshme sipas ligjit të ri për shëndetin mendor dhe akteve nënligjore të tij në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shkodër, si dhe në disa raste në atë të Vlorës.

<sup>17</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Spitalet Psikiatrike është hartuar 1 rekomandim.

<sup>18</sup> Të cilat kanë në funksionin e tyre trajtimin më të specializuar dhe rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor për të cilët kanë shteruar të gjitha mundësitë ekzistuese për të marrë një shërbim të tillë në komunitet, nuk ka mundësi të trajtimit të tyre në kushte ambulatoro apo nevojitet konsulencë psikiatrike nga kërkesat që vijnë nga urgjencat e spitaleve të përgjithshme.

- Mungesa e mjeteve të kufizimit fizik në Spitalin Psikiatrik Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.
- Mungesa e medikamenteve të grupit të antipsikotikëve, antidepressivëve, stabilizuesve të humorit etj, në Spitalin Psikiatrik Elbasan.
- Vonesa në revokimin e masës “mjekim i detyruar”, për personat të cilët trajtoheshin me këtë masë në Spitalin Psikiatrik Shkodër.
- Mungesa e një kabineti stomatologjik konform standardeve, e aparaturës së EKG-së.
- Kushtet higjieno-sanitare, thuajse në të gjitha ambientet e këtyre Institucioneve, ishin jashtë standardit e me lagështirë të theksuar.

### ***2.1.8. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra<sup>19</sup> Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve***

MKPT, bazuar në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, inspektoi Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, me objekt vlerësimin e trajtimit të shtetasve të huaj që marrin shërbime në këtë qendër, në përputhje me të drejtat e tyre për trajtim dinjitoz dhe rehabilitues. Gjatë vizitës monitoruese në këtë qendër, u konstatuan zbatime të një pjese të rekomandimeve të bëra më parë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Problematikat që vazhdonin të ishin të pranishme, paraqiten si më poshtë:

- Mungesa e një juristi, i cili duhet të merret kryesisht me pjesën e dokumentacionit që secilit individ të strehuar në qendër i duhet, duke marrë në konsideratë faktin se kjo qendër strehon shtetas të huaj.
- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf me edukatorë, kujdestarë, dhe staf mjekësor.
- Nuk ishte hartuar një marrëveshjeje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me ofrimin e mundësive për formim profesional në Qendrat e Formimit Profesional në varësi të kësaj Ministrie, si edhe mundësi për punësim pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, përsëri në varësi të kësaj Ministrie për të gjithë personat e strehuar në QKPA, që janë të interesuar.
- Personat e strehuar në QKPA nuk trajtoheshin me ndihmë ekonomike siç parashikohet në ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.
- Personat e strehuar në QKPA nuk furnizoheshin me veshmbathje sipas stinës dhe grup-moshave.
- Këndi i lojërave për fëmijët, ndonëse ekzistonte si mjedis, nuk ishte i plotësuar me pajisjet e nevojshme.

### ***Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç***

Inspektimi i Qendrës së Mbyllur për Të Huajt, Kareç, të ngritur me VKM nr. 1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83 të ligjit Nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, për strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme. Gjatë vizitës monitoruese në këtë Qendër, u konstatua se:

- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf për komunikime në gjuhën dominante të të huajve, shërbime psiko-sociale, juridike dhe mjekësore.

<sup>19</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Qendra janë hartuar 2 rekomandime.

- Mungonin pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive.
- Mungonin aparatet kartfonike, televizorët e antenat për të mundësuar informimin e të huajve mbi ato çfarë ndodhin jashtë qendrës e në vendet e tyre.
- Mungonin aktivitete kulturore, argëtuese e sportive. I vetmi aktivitet sportiv ishte ai me top në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë.
- Mungonin aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë.
- Kamerat në perimetrin e jashtëm të godinës nuk ishin funksionale.
- Sistemi i ngrohjes ishte jofunksional.
- Kishte mangësi në furnizimin me produkte higjieno-sanitare, pajisje vetjake sipas grup-moshave.

### ***Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë***

Inspektimi i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut e cila strehon personat e identifikuar në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikut, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Kjo qendër e mbyllur, e sigurisë së lartë është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, i cili, ndër të tjera, përveçse nuk parashikon detyrat funksionale të këtij institucioni apo shërbimet që ofrohen në të, parashikon në pikën 3 të tij se në këtë qendër trajtohen edhe emigrantë klandestinë që kalojnë përmes Shqipërisë. Gjatë vizitës monitoruese në këtë Qendër, u konstatuan:

- Nevoja për ndryshime të bazës ligjore të funksionimit të QKPVT-ja, duke marrë në konsideratë vërejtjet sa më lartë.
- Mangësi në furnizimin periodik të përfituesve me pajisje vetjake sipas grup moshave.
- Mungesa e një marrëveshjeje me institucionet përkatëse për arsimimin në vijim të përfituesve.
- Nevoja për të kryer rikonstruktimin e brendshëm dhe të jashtëm të dy godinave ekzistuese.
- Probleme të mosfunksionimit të sistemit ngrohës.
- Mungonte ambienti i përshtatshëm i aktiviteteve për të miturit.
- Probleme të mosfunksionimit të pajisjeve kompjuterike për përfituesit.
- Mangësi në organikë sa i përket pranisë së një psikologu dhe përkthyesi me kohë të plotë në qendër.

## **2.2. Roli Parandalues i Institucionit të Avokatit të Popullit në shkeljen e të drejtave të njeriut në fusha të tjera të veprimtarisë së tij**

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve për vitin 2014 janë kryer inspektime në disa institucione publike të përkujdesit rezidencial<sup>20</sup>. Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore të këtyre grupeve vulnerabël, duhet të jetë i një rëndësie të veçantë.

<sup>20</sup> Ky aktivitet është kryer në mbështetje të përcaktimit përkatës ligjor “Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmijë, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut”. “Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.

Në **Institucionet e përkujdesit rezidencial për fëmijët** janë kryer gjithsej 7 inspektime, konkretisht në: Shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër (parashkollor); Shtëpinë e Fëmijës 0-3 vjeç dhe Qendrën ditore 3-6 vjeç Shkodër; Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç Shkodër; Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” 0-6 Vjeç, Korçë; Shtëpinë e Foshnjës në Vlorë; Shtëpinë e Foshnjës Durrës dhe Shtëpinë e Fëmijës në Sarandë.

Në **Institucionet rezidenciale për kujdesin dhe zhvillimin e personave me aftësi të kufizuara** të moshave të ndryshme janë kryer gjithsej 9 Inspektime: përkatësisht në Qendrën e Zhvillimit Durrës, Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit Korçë, Shkodër, dhe Vlorë, Qendrën ditore ATELIE “Për riintegrimin nëpërmjet punës të PAK” Korçë, Qendrën e Zhvillimit, Edukimit dhe Integritit “Lira”, Berat; Qendrën për trajtimin e Fëmijëve me Autizëm Gjirokastër, Qendrën e Zhvillimit “Unë jam si Ju” Berat, dhe Qendrën Ditore të Zhvillimit në Lezhë.

Ndërsa në **Institucionet Rezidenciale për të moshuarit** janë kryer gjithsej 6 Inspektime, përkatësisht në Shtëpitë e të moshuarve në Tiranë, Fier, Kavajë, Shkodër dhe Gjirokastër si dhe në Qendrën Polivalente për të Moshuarit në Kamëz.<sup>21</sup>

Pas inspektimeve të kryera, në pjesën më të madhe të këtyre qendrave, kemi konstatuar se kushtet e jetesës lënë për të dëshiruar, mungesë funksionimi i sistemit të ngrohjes, janë vënë re që ambjentet e institucioneve kanë qënë me lagështirë, shtretërit nuk ishin specifikë sipas target grupeve. Gjithashtu ka mungesë fondesh për investime, blerje të ndryshme për nevojat e përditshme dhe plotësimin e standartave të përcaktuara sipas ligjit, etj. Pavarësisht përkushtimit të stafit të këtyre qendrave për ofrimin e shërbimeve, në të gjitha qendrat rezidenciale dhe ditore, del si një domosdoshmëri ndryshimi i organikës, pasi kemi konstatuar mungesa në burimet njerëzore.

Një problem që ka mbetur pa zgjidhje, është ai i mungesës së një automjeti, me qëllim që të gjithë përfituesit të kenë mundësi transportimi jo vetëm për aktivitete të ndryshme, por për rastet emergjente. Njëkohësisht mospasja e një automjeti sjell si pasojë mosofrimin e shërbimeve të domosdoshme për një numër të madh personash që kërkojnë të trajtohen në qendra ditore të përkujdesjes sociale dhe nuk kanë mundësi financiare për të ardhur në këto qendra.

Në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve shoqërore, për t’iu përgjigjur sa më mirë nevojave të mirërritjes, mirëedukimit e zhvillimit të fëmijëve, krijimit të mundësive për rehabilitimin dhe integrimin të personave me aftësi të kufizuara, për krijimin e kushteve sa më optimale për të moshuarit, Institucioni i Avokatit të Popullit u ka derguar rekomandime Kryetarëve të Bashkive dhe Drejtoreshës së Shërbimit Social Shtetërore për të gjitha Institucionet e Përkujdesit Social që janë inspektuar gjatë vitit 2014.

Rekomandimet kanë konsistuar në marrjen e një sërë masave, konkretisht për përmirësimin e kushteve të jetesës duke rikonstruktuar pjesërisht ose tërësisht të godinat, vendosjen e ashensorëve, zëvendësimin e shtretërve dhe mobiljeve ekzistuese me të reja dhe funksionale etj, shtimin e fondeve përsa i përket organikës me qëllim shtimin e personelit me kujdestarë, psikologë, fizioterapistë, shofer, punonjës sociale, etj. Rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit janë pranuar dhe janë marrë në konsideratë por mbetet ende për të bërë lidhur me zbatimin e tyre. Gjatë vitit 2015, do të vijojmë me inspektimet për të monitoruar lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve.

---

<sup>21</sup> 12 nga këto institucione, janë inspektuar në bashkëpunim me shoqërinë civile. Konkretisht: Shtëpia e Foshnjës Vlorë, Qendra e Zhvillimit Vlorë, Shtëpia e Fëmijës Sarandë, Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” 0-6 Vjeç, Korçë, Qendra ditore ATELIE “Për riintegrimin nëpërmjet punës të PAK” Korçë, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë, Qendra e Zhvillimit, Edukimit dhe Integritit “Lira”, Berat, Qendra e Zhvillimit “Unë jam si Ju”, Berat, Qendra për trajtimin e Fëmijëve me Autizëm Gjirokastër, Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër, Qendra Ditore e Zhvillimit Lezhë, Shtëpia e të Moshuarve Kavajë.

## KREU 3

### ROLI MBROJTËS I AVOKATIT TË POPULLIT NË RESPEKTIM TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE OBJEKTIVAT SOCIALE

- Të drejtat e njeriut

#### 3.1. E drejta për informim

E drejta për informim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila fokusohet tek liria e individit për të marrë informacion nga autoritetet publike, për mënyrën se si këto të fundit qeverisin dhe se si menaxhojnë burimet shtetërore, në funksion të mirëqeverisjes.

E drejta për informim është një e drejtë themelore e individit, e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duke prezantuar një element kyç të jetësimit të demokracisë funksionale, e drejta për informim është afirmuar në një sërë aktesh ndërkombëtare, të cilat njëkohësisht edhe vendosin standarde të respektimit të saj. Këto standarde të ndihmuara edhe nga procesi i ratifikimit të një sërë aktesh ndërkombëtare në këtë fushë, janë pasqyruar tashmë në një masë të kënaqshme në legjislacionin tonë, i cili përcakton regjimin juridik të kësaj të drejte themelore.

Disa nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në këtë fushë, që japin kuptimin dhe vendosin baza konceptuale për të drejtën e informimit janë DUDNJ, KEDNJ, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata e Këshillit të Europës mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, Konventa e Aarhusit, Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Europian, Kodi Europian i Sjelljes së Mirë Administrative, Rekomandimi 2002 (2) i Këshillit të Europës për Aksesin në Dokumenta Zyrtare.

Konventa e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, më 27.11.2008, krijon detyrime informative edhe për subjekte, si organet legjislative, autoritetet gjyqësore, apo edhe për personat fizikë apo juridikë, për aq sa ata kryejnë funksione publike, apo kur operojnë në fonde publike, në përputhje me legjislacionin vendas. Kjo konventë shumë e rëndësishme nuk është ratifikuar ende nga ana e Shqipërisë, për këtë arsye do të ishte e nevojshme marrja e masave për ratifikimin e saj.

Gjithashtu lind nevoja e ratifikimit të akteve të reja ndërkombëtare që sjellin risi dhe konceptim më të mirë të së drejtës për informim, pasi zhvillimet më të fundit në këtë drejtim kanë sjellë edhe një dimensionim të ri të kësaj të drejte.

Regjimi juridik i së drejtës për informim është përcaktuar nga dy ligje kryesore; Ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe pas shfuqizimit të tij në Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe nga Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, që e parashikon funksionin e së drejtës për informim, si një nga parimet bazë të funksionimit të administratës publike.

Kodi i Procedurave Administrative bën një rregullim specifik të së drejtës për informim, duke ia njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ, ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces. Në parim, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

Gjatë vitit 2014 janë bërë ndryshime të bazës ligjore që përcakton regjimin juridik të së drejtës për informim, pasi duke filluar nga muaji Nëntor 2014, ka hyrë në fuqi Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që rregullon regjimin juridik të kësaj të drejte, sa i takon transparencës së veprimtarisë së përgjithshme të organeve të administratës publike, dhe më gjerë.

Këto zhvillime kanë kushtëzuar tashmë edhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit, i cili nga institucioni i cili kujdesej për zbatimin e së drejtës për informim sipas përcaktimeve të Ligjit nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk e gëzon më këtë atribut, duke u vendosur në një pozitë kompetenciale shumë të diskutueshme.

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim **58 ankesa për shkelje të pretenduara të së drejtës për informim**. Nga numri i ankesave të marra në total, 15 janë ende në shqyrtim, ndërsa për 43 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 9 prej tyre janë jashtë kompetencës, 19 ankesa të zgjidhura pozitivisht dhe 6 ankesa të pabazuara, ndërkohë që për 7 ankesa është hequr dorë për ndjekjen e tyre të mëtejshme, nga ana e vet ankuesve. Ankesat e marra në shqyrtim lidhen me mosrespektimin dhe garantimin e së drejtës për informim gjatë veprimtarisë së organeve të administratës publike, përkatësisht organeve të pushtetit qendror, njësive të qeverisjes vendore dhe të enteve publike.

Në fakt, këto ankesa i referohen regjimit juridik të së drejtës për informim që rregullohej nga Ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe aktualisht Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ndërkohë, janë të pakta ankesat e paraqitura që lidhen me regjimin juridik të së drejtës të përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Problematikat e hasura nga trajtimi i ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, kanë të bëjnë me:

- Mosrespektimin e afateve kohore të përcaktuara nga Ligji nr.8503, datë 30.06.1999, për refuzimin, apo pranimin e kërkesës së paraqitur nga subjektet e interesuara, për informim.
- Dhënia e informacionit, në mënyrë të pjesshme dhe jo në kohë nga ana e organeve të administratës publike, duke rënë kështu ndesh me atë që Ligji nr.8503, datë 30.06.1999, parashikon.
- Mospërgjigje dhe mostrajtim të kërkesave për informim nga ana e organeve të administratës publike, sipas regjimit juridik të përcaktuar nga Ligji nr.8503, datë 30.06.1999.
- Moszbatimi ose zbatimi jo korrekt i dispozitave ligjore që njohin dhe garantojnë të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga Administrata Publike.
- Mosinformim mbi ecurinë e procedurave specifike ligjore (rastet e proceseve të legalizimeve), nga ana e organeve përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe përfundimin e tyre.<sup>22</sup> Këto ankesa janë të bazuara në regjimin juridik të përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Një specifike e cila vërehet gjatë vitit 2014, është se në shumë çështje të zgjidhura në favor të ankuesve për mosveprime apo zvarritje të konstatuara në trajtimin e kërkesave për informim, sipas Ligjit nr.8503, datë 30.06.1999, është ndrequr në mënyrë të shpejtë nga ana e organeve përkatëse të administratës publike, pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit. Kjo gjë ka

---

<sup>22</sup> Ka çështje në të cilat individë të ndryshëm të cilët kanë aplikuar për legalizimin e objekteve të tyre informale, megjithëse kanë aplikuar prej vitesh dhe kanë paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit, përsëri nuk arrijnë të marrin informacion nga ana e ALUIZNI-t, për fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit të objektit të tyre informal. Ka patur edhe shumë raste të tjera, sidomos gjatë trajtimit të ankesave që lidhen me efektet e zbatimit të projektit për ndërtimin e unazës së re, në zonën e Selitës, Tiranë, që megjithëse individë të caktuar kanë aplikuar për legalizim që prej viteve 2005-2006, nuk iu është dhënë asnjë informacion për ecurinë e procesit të legalizimit, pavarësisht kërkesave të tyre për këtë qëllim. Këto individë janë gjetur krejtësisht të surprizuar kur iu është dorëzuar vendimi përkatës i ALUIZNI-t, pas nëntë vjetësh aplikimi, për përjashtim nga procesi i legalizimit të objekteve të tyre informale.

ndodhur, qoftë në dhënien e informacioneve zyrtare të kërkuara, qoftë dhe në dhënien e kopjeve të dokumenteve zyrtare të kërkuara.

Sikurse është theksuar edhe në raportet tona vjetore të mëparshme ka qënë një nevojë e kahershme, përmirësimi i regjimit juridik për të drejtën e informimit, të dhënë në Ligjin “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”. Sot, mund të thuhet se me hyrjen në fuqi të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky regjim është përmirësuar në disa prej elementëve që kanë të bëjnë me: zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim, dhënien e informacionit duke e bërë këtë në përcaktimin e terminologjisë “Autoritet publik”; shtesën e kritereve përjashtimore, që lidhen me parashikimin e një liste shteruese të kritereve për mosdhënien e informacionit, shkurtimin e afateve për dhënien e informacionit, detyrimin për të orientuar kërkuesin të identifikojë dokumentet që kërkon, koston e pagesave për dhënien e informacionit, caktimin konkret të dënimeve administrative dhe të dëmshpërblimit në rastet e shkeljes të të drejtës për informim, etj.. Mbetet ende për t’u realizuar parashikimi shprehimisht për lehtësirat, për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Po kështu, mbetet problem çështja e përcaktimit të rolit kompetencial që Avokati i Popullit ka tashmë, pas hyrjes në fuqi të ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

Në referencë të përmbajtjes së nenit 24, të ligjit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcaktohet si, një organ administrativ, pjesë e ankimit efektiv administrativ ndaj vendimmarrjes së autoritetit përkatës shtetëror, në rastet e trajtimit të kërkesave për informim. Duke marrë në analizë këtë dispozitë në opinionin tonë rezulton se pikat 1–6 të saj bien në kundërshtim me nenet 135-146 të Kodit të Procedurave Administrative. Ka paqartësi gjithashtu nëse i hiqet e drejta e ankimit administrativ subjektit të interesuar që ka paraqitur kërkesën për informim pranë vetë autoritetit shtetëror që pretendohet të ketë kryer shkelje të të drejtës për informim.

Për më tepër, është e paqartë kompetenca që i lihet Avokatit të Popullit, në pikën 7, të këtij neni, ku thuhet shprehimisht se: “*Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me mbikqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar*”.

Mbeten të paqarta nëse do të ketë pasoja për rrugën e ankimit administrativ dhe atij gjyqësor në një kohë të dytë fakti se, subjekti i interesuar është drejtuar tek Avokati i Popullit dhe jo tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Një shqetësim i Institucionit të Avokatit të Popullit është nëse do të mbikqyrë se si zbatohet e drejta nga autoriteti shtetëror, apo se si zbatohen procedurat e shqyrtimit të ankimit nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, në rastin e paraqitjes së ankesave për shkelje të së drejtës për informim. Të gjitha këto çështje, kanë nevojë të sqarohen me qëllim mos krijimin e përplasjeve të kompetencave, shqetësime dhe konsiderata të cilat janë përcjellë gjatë kohës kur diskutohej projektligji përkatës në Kuvend, por vërejtjet tona nuk janë marrë parasysh. Këto përcaktime të ligjit kanë sjellë probleme në funksionimin e përditshëm, sa i takon të drejtës për informim.

Gjatë vitit 2014, problematikat që lidhen me të drejtën e informimit lidhen me zbatimin e dispozitave të ligjit “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”, si dhe me procesin e përmirësimit të regjimit juridik të së drejtës për informim.

Për kohën gjatë së cilës ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” ka qënë në fuqi, janë rishfaqur çështjet që kanë të bëjnë me, zbatimin e afateve procedurale në kthimin e përgjigjeve dhe dhënien e informacionit, si dhe plotësimin korrekt të kërkesave për informacion. Megjithatë në një numër të vogël, kërkesat për informim që i referohen regjimit juridik të së drejtës për informim sipas Kodit të Procedurave Administrative, kanë evidentuar mangësi në funksionimin e administratës publike, të cilat

shpesh ndërthuren edhe me respektimin e të drejtave të tjera, si e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Problematika e së drejtës për informim, realisht është trajtuar shumë më gjerë se sa numri i ankesave të dhëna në këtë raport, por në kuadër të ankesave të tjera që si objekt kryesor kanë patur një problematikë të ndryshme nga ajo e së drejtës për informim. Pothuajse një pjesë e madhe e ankesave me objekte të ndryshme lidhen në mënyrë indirekte me të drejtën e informimit, pasi kanë të bëjnë me aksesin në një dokument, në një informacion, etj.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, regjimi juridik i së drejtës për informim konstatohet se është përmirësuar në shumë elementë të rëndësishëm të tij, të cilat janë theksuar prej kohësh nga institucioni i Avokatit të Popullit, por mendojmë se ka ende nevojë për rishikim dhe qartësim të dispozitave të këtij ligji, i cili tashmë është në fazën e zbatimit të tij. Konkretisht gjykojmë se, është e nevojshme të bëhet parashikimi shprehimisht në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor për lehtësirat, për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Po kështu gjykojmë se, është i nevojshëm qartësimi i rrugës së ankimit administrativ ndaj shkeljeve të së drejtës për informim dhe pozicionit që ka Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale në këtë proces. Pa dyshim, një çështje shumë e rëndësishme mbetet saktësimi dhe qartësimi i kompetencave të Avokatit të Popullit, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të kësaj të drejte të përcaktuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

### **3.2. Respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar në njësitë policore dhe në Institucionet penitenciare dhe çështje të tjera që lidhen me këto institucione**

#### **3.2.1. Të drejtat e personave të ndaluar dhe të shoqëruar në njësitë policore dhe çështje të tjera që lidhen me organin e policisë**

Gjatë vitit 2014, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë adresuar 177 ankesa ndaj organeve të Policisë së Shtetit për problematika të punës së tij, të cilat kryesisht konsistojnë në: 28 për keqtrajttime fizike apo psikologjike nga punonjësit e policisë, 17 për shoqërime të paligjshme në organet e policisë, 19 për mosmarrje apo mosndjekje të kallëzimeve apo ankesave të shtetasve, 7 për arrestime apo ndalime të paligjshme, 6 për bllokim të padrejtë të sendeve, 6 për masa administrative të padrejta, 3 për kontrole të paligjshme banese, 7 për largime nga puna të punonjësve të policisë, 4 për skualifikim të padrejtë nga Shkolla Bazë e Policisë, etj.

Shoqërimi i personave në polici sipas parashikimeve të ligjit “Për Policinë e Shtetit”<sup>23</sup> nuk mund të zgjasë më shumë se 10 orë. Sipas nenit 11, pika 6 të këtij ligji është parashikuar përcaktimi i rastit të shoqërimit të personit në zyrat e policisë, ndërsa në nenin 101, pika 1, janë parashikuar rastet e shoqërimit të personave në mjediset e policisë. Sipas këtyre dispozitave, shoqërimi në zyrat e policisë i një personi bëhet vetëm kur ai ka shkelur një rregull administrativ për të cilin ai duhet të gjobitet apo të procedohet administrativisht dhe nëse kundërvajtësi është i pa identifikuar në kohën dhe vendin e kryerjes së shkeljes. Është me rëndësi të theksojmë se, ligji në këtë dispozitë e ka kushtëzuar shoqërimin në polici të një personi vetëm në rastet kur ai shkel një rregull administrativ dhe jo kur dyshohet apo kryen një vepër penale.

Ky ligj ka parashikuar edhe të drejtat e personit të shoqëruar, si ajo e trajtimit njerëzor dhe e respektimit të dinjitetit të tij, për njoftimin e menjëhershëm të tij lidhur me arsyet e

<sup>23</sup> Ligji Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, shfuqizuar me ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i cili hyn në fuqi më 01.03.2015.



shoqërimit, përcaktimin e kohës që një person mund të qëndrojë i shoqëruar jo më shumë se 10 orë, dhënien e mundësisë për njoftimin e personave të afërm ose një personi të cilit i beson, i njoftimit të personit përgjegjës për mbikqyrjen e të miturit, apo i njoftimit të kujdestarit për të rriturit që kanë të tillë.

Me qëllim respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar dhe atyre të ndaluar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka përgatitur dhe vendosur në përdorim regjistrin për regjistrimin e personave të shoqëruar. Në këtë regjistër shënohen gjeneralitetet e çdo personi të shoqëruar, adresa e tij, arsyeja dhe koha e shoqërimit dhe e lënies të lirë, punonjësi i policisë që ka bërë shoqërimit, personi i afërm që është njoftuar, ora e njoftimit, numri i telefonit të tij, etj.

Ndërkohë lidhur me shoqërimitin e personave në organet e policisë janë të miratuar edhe dy akte nënligjore nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.711, datë 11.10.2007 “Për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për Policinë e Shtetit” lidhur me përdorimin e forcës dhe trajtimin e personave të shoqëruar”, Letër-Propozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1328, datë 23.11.2009 “Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”.

Nga shqyrtimi i ankesave të administruara në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe inspektimet e kryera në organet e policisë lidhur me këtë problem, janë konstatuar një sërë problemesh për të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandimet përkatëse. Në disa raste të shoqërimit të personave është evidentuar se nuk janë respektuar kriteret ligjore të parashikuara në dispozitat përkatëse. Janë konstatuar raste shoqërimi dhe trajtimi si të shoqëruar për arsye nga më të ndryshmet, persona të dyshuar si autorë të veprave penale, persona të shpallur në kërkim policor apo nga organi i prokurorisë, autorë të veprave penale të kapur në flagrancë, etj.

Ashtu siç ka rezultuar dhe nga inspektimet e kryera, ndërtesat e disa njësive policore nuk janë ndërtuar ose përshtatur ende mjediset e shoqërimit sikurse parashikohet në nenin 107/3 i ligjit në fuqi, për shkak se nuk ka ende 3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur.

Si nga aktiviteti parandalues që Institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar në njësitë policore, ashtu dhe në rolin mbrojtës nëpërmjet Seksionit të Veçantë ka rezultuar se dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të tyre janë jo sipas standarteve, të pa pajisura me orenditë e nevojshme, ose edhe atje ku ka të tilla në mjaft raste ato janë të dëmtuara. Është evidentuar mungesa e pankartave informuese për të drejtat ligjore të të shoqëruarve, dhe në ato raste kur ka të tilla ato gjenden në vende jashtë këtyre mjedisëve që praktikisht janë të pa aksesueshme nga të shoqëruarit.

Janë konstatuar mangësi për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në dispozitat ligjore për evidentimin dhe pasqyrimin me korrektësi në regjistra i të dhënave të personave të shoqëruar, nuk pasqyrohet saktë arsyeja e vërtetë e shoqërimit dhe ajo shënohet e përgjithshme “*për verifikim*”, nuk bëhet gjithmonë njoftimi i personave të afërm të të shoqëruarve, nuk pasqyrohen gjithnjë gjeneralitetet e të njoftuarve, numrat e telefonit të tyre, ora e njoftimit, ka dhe raste fiktive të pasqyrimin të tyre, etj.

Disa nga shkaqet e kryerjes së shkeljeve të konstatuara nga Avokati i Popullit lidhur me shoqërimitin e personave në polici, janë mangësitë e njohjes nga punonjësit e policisë të dispozitave të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe të akteve nënligjore që trajtojnë dhe rregullojnë problemin e shoqërimit, ka mungesë kontrolli të organeve eprorë ndaj punonjësve të policisë në bazë lidhur me zbatimin në praktikë të të drejtës së policisë për të bërë shoqërimitin e personave në organet e saj. Shpesh ka rezultuar se shoqërimi përdoret si justifikim për të realizuar qëllime të tjera ndaj personave që kanë dijeni apo dyshohen si autorë të kryerjes së veprave penale. Gjithashtu shoqërimi i autorëve të dyshuar të veprave

penale apo edhe i atyre të kapur në flagrancë përdoret për të kryer veprime procedurale, si marrja e deklarimeve, kryerje të kontrolleve të ndryshme, sekuestrime provash e verifikime të tjera.

Në të gjitha rastet për të cilat janë konstatuar shkelje lidhur me problemin e shoqërimit janë përgatitur dhe dërguar rekomandime organeve të policisë.<sup>24</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar një sërë rekomandimesh drejtuar Komisariateve të policisë, lidhur me zbatimin e kriterëve ligjore për rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë dhe respektimin e të drejtave të tyre. Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandimin “Transferimi i menjëhershëm i të arrestuarve e ndaluarve nga ambientet e sigurimit të Policisë së Shtetit në IEVP-të”, për shkak të mbipopullit, të mungesës së kushteve dhe standardeve minimale për qëndrim e jetesë të tyre, të mungesës së hapësirës, të pajisjeve të nevojshme, si krevate, dyshekë, mbulesa, etj. Gjithashtu mbajtja tej afatit 96 orë në ambientet e sigurimit të policisë është në kundërshtim me afatin e parashikuar në aktet nënligjore të miratuara lidhur me këtë kategori personash.

### **3.2.2. Për të drejtën kushtetuese të lëvizjes së lirë të shtetasve dhe çështje të tjera që lidhen me organet e policisë**

Një ndër rastet e filluara me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 është rasti për moslejimin për të dalë jashtë vendit nga Policia Kufitare dhe Migracionit të drejtuesve të mjeteve dhe të mjeteve të tyre që nuk kanë shlyer gjobat administrative ndaj Policisë së Shtetit. Sipas Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 49, datë 10.01.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete”, *drejtuesit e automjeteve që rezultojnë debitorë, do të lejohen të vazhdojnë udhëtimin jashtë vendit vetëm pasi të kenë paguar të gjitha gjobat e vendosura nga Policia e Shtetit për kundravajtje administrative.*

Institucioni i Avokatit të Popullit konstatoi se, urdhri i cituar më sipër është akt normativ me fuqi të përgjithshme sepse krijon pasoja juridike për një kategori shtetasish, drejtues të automjeteve të paidentifikuar në mënyrë nominative. Nga zbatimi i këtij urdhri shtetasve shqiptarë drejtues të automjeteve, të cilët rezultojnë debitorë ndaj Policisë së Shtetit lidhur me gjobat e vendosura për kundravajtje administrative, për të cilat ka kaluar afati i parashikuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë u mohojë e drejta themelore universale për të dalë lirisht jashtë shtetit<sup>25</sup>. Ndërkohë konstatoam se ky urdhër vinte në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 17 të Kushtetutës,<sup>26</sup> si dhe ishte nxjerrë në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës,<sup>27</sup> sepse neni 20 i ligjit nr. 7947, datë 04.06.2007

<sup>24</sup> Rekomandimi i datës 08.01.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Nr. 6 Tiranë. Rekomandimi i datës 08.01.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, Rekomandimi i datës 08.01.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë; Rekomandimi i datës 08.01.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Nr. 5 Tiranë; Rekomandimi i datës 22.01.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë; Rekomandimi i datës 09.05.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Shijak; Rekomandimi i datës 09.05.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Kavajë; Rekomandimi i datës 02.06.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Mamurras; Rekomandimi i datës 02.06.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Kurbin; Rekomandimi i datës 02.06.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Peqin; Rekomandimi i datës 02.06.2014 dërguar Komisarariatit të Policisë Elbasan.

<sup>25</sup> E drejte e garantuar nga neni 38, paragrafi i dytë, i Kushtetutës neni 13, pika 2, e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; dhe neni 2, pika 2, e Protokollit nr.4 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>26</sup> “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuar në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përjpestim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

<sup>27</sup> “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër”.

“Për Policinë e Shtetit” dhe neni 105 e në vijim i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Adiministrative”, ku ishte bazuar ai, nuk autorizonin nxjerrjen e këtij akti nënligjor, nuk përcaktonin organin kompetent, çështjen që duhej rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret ky akt.

Gjithashtu konstatoam se, “ndalimi i daljes jashtë shtetit” është një nga llojet e masave të sigurimit personal, masë shtrënguese, e parashikuar në nenin 232/1/a të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në bazë të nenit 233/1 të këtij kodi, kjo masë shtrënguese është e drejtë ekskluzive vetëm e gjykatës dhe jepet ndaj të pandehurit. Duke iu referuar Kodit të Procedurave Administrative, respektivisht neneve 115/a dhe 116/c arritëm në konkluzionin se, Urdhri Nr. 49, datë 10.01.2014 ishte akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Për këto arsye në datë 22.04.2014 i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shpalljen e pavlefshmërisë absolute të këtij urdhri dhe zbatimin e nenit 203/1 të Kodit Rrugor për vjeljen e gjobave administrative kur ato nuk paguhen nga të ardhurat e shkelësit.

Gjithashtu gjatë vitit 2014, një nga çështjet që është ndjekur për zgjidhjen e problemit të krijuar ndërmjet shoqërive që ushtrojnë aktivitetin e qiradhënies së automjeteve dhe qiramarrësve për gjobat administrative të vendosura këtyre të fundit, për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit në datë 17.12.2014, adresoi rekomandim Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Transportit për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 199 i Kodit Rrugor lidhur me njoftimin kundërvajtësve brenda 30 ditëve për gjobat e vëna në mungesë nga organet e policisë sepse nuk zbatohet ky detyrim ligjor, si dhe marrjen e masave organizative për shpejtimin e procedurave të pagimit të gjobave. Gjithashtu, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e projekligjit për disa ndryshime dhe përmirësime të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe dërgimin e tij në Këshillim e Ministrave.

Gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit në datë 17.12.2014 adresoi rekomandimin “Për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të projektit të VKM “Për rregullimin e marrëdhënies të Policisë së Shtetit me të tretët, për llojet e shërbimeve policore shtesë që ofron policia dhe tarifat e pagesës për këto shërbime”, në bazë dhe për zbatim të neneve 48 dhe 129 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe rekomandimin “Për sigurimin e fondeve të nevojshme për rritjen e buxhetit të Policisë së Shtetit me qëllim pagimin e punonjësve të policisë për orët e punës shtesë, shërbimet suplementare dhe shpërblimet për punë të mirë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi”.

Duke mbajtur parasysh që lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore ka qënë pjesë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe për faktin që për një vit Shqipëria kishte ngelur pa strategjinë dhe planin e veprimit përkatës, në datën 17.02.2014 u adresua rekomandimi “Për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të “Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore” dhe të “Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit”.

### ***3.2.3. Respektim i të drejtave të personave e arrestuar, dënuar në Institucionet penitenciare***

Gjatë vitit 2014, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 149 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve, nga të cilat 122 janë përfunduar dhe 27 janë ende në shqyrtim. Ankesat janë paraqitur nga të paraburgosur, të dënuar dhe familjarët e tyre. Personat e privuar nga liria kryesisht e kanë kontaktuar Institucionin e Avokatit të Popullit me shkresa por më së shumti duke telefonuar në numrin falas të vënë në dispozicion. Objekti i ankesave është i ndryshëm, por numri më i madh i ankesave të adresuara kanë si objekt për cilësinë e shërbimit shëndetësor, moskthim përgjigje

të kërkesave të ndryshme, refuzimi i kërkesës për të përfituar leje shpërblyese, refuzimi i kërkesës për t'u transferuar në një IEVP që ndodhet më afër vendbanimit të familjes, transferim i padrejtë në një IEVP tjetër, dhënie masë disiplinore e padrejtë, etj.

Një ndër problematikat e hasura gjatë punës së Avokatit të Popullit për vitin 2014 lidhej me shërbimin shëndetësor në burgje dhe paraburgime, në ankesat e adresuara për zgjidhje kërkohet përmirësimi i këtij shërbimi, të cilat në krahasim me vitet e kaluara është rritur. Avokati i Popullit me qëllim përmirësimin e këtij shërbimi ka adresuar rekomandimet përkatëse duke rekomanduar se shërbimi shëndetësor në burgje duhet të realizojë më mirë diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve me ilaçe. Në shumicën e rasteve, IEVP-të kanë kundërshtuar pretendimet e të burgosurve, pavarësisht se në disa raste nga hetimi administrativ pretendimet kanë rezultuar të provuara.

Gjithashtu mbipopullimi i lartë i konstatuar në 2014 ka bërë që administrata e burgjeve të mos i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të të burgosurve për trajtim mjekësor.

Gjatë vitit 2014 ka patur shtim të numrit të ankesave që lidhen me të drejtën e transferimit. Nga hetimi i rasteve ka rezultuar se të burgosurit shpesh nuk janë dërguar për të vuajtur dënimin në një institucion afër vendbanimit të familjes për shkak të mbipopullimit. Në rastet kur nga të burgosurit është pretenduar transferim i padrejtë, D.P.Burgjeve në përgjigje ka bërë me dije se arsyeja e transferimit të të burgosurit në një IEVP larg vendbanimit të familjes ka qenë siguria e tij, provueshmëria e së cilës është e vështirë nga hetimi administrativ i kryer nga Avokati i Popullit.

Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese ka qenë objekt i një numri ankesash të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në rastet e ankesave për leje shpërblyese dhe leje të veçantë, janë kryer verifikimet për procedurën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Nga hetimi ka rezultuar se arsyeja e refuzimit të lejes ka qenë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit. Institucioni nuk ka patur garanci se jeta dhe shëndeti i të dënuarit nuk do të çenohej gjatë lejes ose i dënuari mund të çenonte jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Për të vlerësuar këtë mundësi, institucioni ka marrë informacion nga policia e shtetit dhe familjarët e të dënuarit. Pavarësisht se një pjesë e të dënuarve përmbushin kriteret për përfitimin e lejeve, ata ishin penguar nga Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr.103 datë 17.02.2014 i cili kërkon ndryshim të procedurave të dhënies së lejeve për të dënuarit për disa vepra penale konkretisht të neneve 100, 101, 102, 103 dhe 104 të Kodit Penal, sipas të cilit para se të jepet leje, duhet të merret një miratim paraprak për arsye sigurie nga Komisariati i policisë së zonës. Avokati i Popullit konstaton se kjo është një procedurë e paligjshme dhe në periudhën në vijim do të rekomandojmë marrjen e masave për pezullimin e kësaj praktike në kundërshtim me ligjin.

Punësimi në burg është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve dhe në përgatitjen e tyre për t'u integruar në shoqëri. Puna gjithashtu i jep të dënuarve një ndjenjë disipline dhe qëllimi, ndërsa pjesa më e madhe e të burgosurve të pa punësuar i kalojnë ditët të mbyllur në dhomat e tyre duke shkaktuar mërzë, izolim dhe probleme. Megjithatë puna e të burgosurve duhet të paguhet, kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos zbatohet për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Në lidhje me shpërblyerimin e punës të të burgosurve, nga Avokati i Popullit i është dërguar Rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt VKM-së për përcaktimin e kriterëve të shpërblyerimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Aktualisht ky rekomandim nuk është materializuar dhe puna e të burgosurve, për ata pak të burgosur që punojnë brenda në burgje, vazhdon të mos paguhet.

Ende dhe në vitin 2014 nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për trajtimin e personave me masa mjekësore "mjekim të detyruar" në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka ndjekur këtë çështje ndër vite dhe ka rekomanduar disa herë marrjen e masave konkrete për ndërtimin dhe hapjen e një institucioni

të posaçëm mjekësor. Për këtë qëllim është dërguar rekomandim edhe gjatë vitit 2014, Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hapja e këtij institucioni të ri mjekësor për sistemimin e kësaj kategorie personash. Ende ky Rekomandim nuk ka gjetur zgjidhje përfundimtare. Mbajtja e kësaj kategorie personash në Institucione penitenciare përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2014 fenomeni më negativ i hasur në institucionet penitenciare është mbipopullimi i cili ka arritur deri në 1500 persona më shumë se kapaciteti i lejuar. Duke u nisur dhe nga fenomeni i mbipopullimit së fundimi, Avokati i Popullit sugjeron se masa e sigurisë “arrest me burg” dhe dënimi me burg duhet të zgjidhen si alternativë e fundit në sigurimin dhe ndëshkimin e personave që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të vogël.

### ***3.2.4. Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare***

Për rastet e tejkalimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, MKPT bashkëpunoi në kryerjen e hetimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave. Për vitin 2014, MKPT dhe Seksioni i Veçantë, kanë trajtuar 35 ankesa të shtetasve me pretendime për tejkalim të forcës së domosdoshme e ushtrim dhune nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe punonjësit e Policisë së Burgjeve, më konkretisht 28 në Komisariate dhe 7 në I EVP.

Nga trajtimi i këtyre rasteve, rezultuan 8 ankesa të provuara, 20 të paprovuara si pretendime, dhe 7 jashtë juridiksionit (për të njëjtat ankesa kishin filluar hetimet organi i SHKB ose i Prokurorisë). Nga 8 rastet e provuara të dhunës të konstatuar në Komisariate dhe I EVP, për 2 raste i është rekomanduar organit të Prokurorisë fillimi i hetimeve ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit për veprën penale të “Torturës”, e kryer në bashkëpunim<sup>28</sup>. Ndërsa për 6 rastet e tjera, organeve të Policisë së Shtetit dhe I EVP-ve, i është rekomanduar marrja në shqyrtim e pretendimeve të ankuesve<sup>29</sup>.

Në përgjigje të këtyre rekomandimeve rezulton se: Organi i Prokurorisë ka filluar hetimet ndaj punonjësve të Njesisë Operacionale të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe të punonjësve të Komisarariatit të Policisë Lezhë; Ndaj punonjësve të Komisarariatit Nr. 4, Tiranë është dhënë 1 masë disiplinore; Në përgjigje të rekomandimit mbi dy ankesat dërguar Komisarariatit Nr. 4 Tiranë ka filluar Ecuria Disiplinore; Në përgjigje të rekomandimit drejtuar I EVP Vlorë mbi dy ankesa, megjithëse është marrë përgjigje pranuese, nuk ka pasur asnjë reagim me masa administrative. Rekomandimi për rastin e dhunës së provuar nga ana e MKPT-së dhe Seksionit të Veçantë drejtuar I EVP Drenovë Korçë, rezulton i papranuar.

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit, gjatë vizitave në institucionet e monitoruara ekspertët e MKPT-së dhe Seksionit të Veçantë morën kontakt me autoritetin drejtues, përgjegjësit e sektorëve, si dhe inspektuan të gjitha ambientet në funksion të personave të trajtuar në këto institucione. Vlen të theksohet se inspektimet janë zhvilluar në një frymë të mirë bashkëpunimi në të gjitha institucionet e inspektuara, dhe se MKPT-së iu mundësua përmbushja e detyrave institucionale kushtetuese e ligjore, duke iu garantuar akses i plotë në shqyrtimin e të gjitha ambienteve e dokumenteve, si dhe kontakte pa praninë e stafit të institucioneve me personat e privuar nga liria.

<sup>28</sup> Rekomandimi i datës 25.02.2014 drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Rekomandimi i datës 10.03.2014 drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>29</sup> Rekomandimi i datës 24.06.2014 drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, Shefit të Komisarariatit Nr. 4 Tiranë; Rekomandimi i datës 06.01.2015 drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, Shefit të Komisarariatit Nr. 4 Tiranë; Rekomandimi i datës 14.01.2015 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorit të I EVP Vlorë; Rekomandimi i datës 14.01.2015 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorit të I EVP Drenovë.

### **3.2.5. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura**

Për arsye të karakterit të veçantë të detyrës dhe të shërbimit, pjestarë të FA por edhe familjarë të tyre mund të kenë disavantazhe krahasuar me qytetarë të tjerë. Ligji Nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të F.A. në R.SH.” ka parashikuar disa garanci për të zvogëluar këto disavantazhe. Në vitin 2014 ka patur rënie të numrit të ankesave të paraqitura nga subjekte që janë ushtarakë të shërbimit aktiv apo ushtarakë të dalë në rezervë ose në lirim. Objekti i ankesave të paraqitura ka patur të bëjë me pretendime për lirim të padrejtë nga detyra, mohim i të drejtës për t’u kualifikuar në kurse jashtë vendit, zvarritje e procedurës për plotësimin e dokumentave për të përfituar pension suplementar, mos pagim i kohës së pakryer të lejes vjetore, etj.

Disa nga problematikat e evidentuara nga shqyrtimi i ankesave janë lidhur me kryerjen e kualifikimeve nga ana e ushtarakëve me qëllim për karrierën në ushtri. Nga verifikimi i realizuar nga Avokati i Popullit lidhur me të drejtën e kualifikimit jashtë vendit ka rezultuar se, vlerësimi i ankuesit ushtarak që kërkonte kualifikimin ishte bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit ka rekomanduar ndryshimin e aktit nënligjor që normon procedurat e kualifikimit të ushtarakëve jashtë vendit si dhe përsëritjen e procesit të vlerësimit. Ndryshimi i aktit nënligjor është pranuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, ndërsa përsëritja e vlerësimit, sipas përgjigjes së këtyre institucioneve, nuk ka qenë i mundur.

Një nga të drejtat që gëzon ushtaraku, për të kompensuar vështirësitë që ai ka gjatë karrierës, është ndihma financiare që i jepet në rast se një pjestar i familjes në ngarkim të tij humb jetën. Për shkak të referimit të gabuar ligjor, kjo e drejtë nuk është njohur në rastet që ne kemi hetuar me hollësi. Për këtë qëllim, Drejtorisë së Arsimimit dhe Përkujdesjes Sociale në Ministrinë e Mbrojtjes i është rekomanduar fillimi i procedurës për trajtimin financiar të ushtarakut ankues. Ky Rekomandim është pranuar por, ende nuk ka gjetur zbatim konkret në praktikë.

Një ndër problematikat e konstatuara është dhe mosekzekutimi i një sërë detyrimesh financiare të prapambetura ndaj subjekteve ushtarakë. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është miratuar VKM Nr. 50, datë 25.02.2014 dhe Udhëzimi Nr.5, datë 27.02.2014 i Ministrisë së Financave. Nga informacioni zyrtar që kemi marrë, aktualisht ekzekutimi i pagesave është pezulluar nga Ministria e Financave. Nisur nga ankesat e disa ushtarakëve për mos shlyerje të detyrimeve financiare, Institucioni i Avokatit të Popullit po ndjek në vazhdimësi zbatimin e procedurave të parashikuara në legjislacionin e lartpërmendur. Efektiviteti i Institucionit të Avokatit të Popullit për të zgjidhur në mënyrë të shpejtë ankesat e ushtarakëve varet edhe nga bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe strukturat në varësi të tyre. Referuar komunikimeve zyrtare dhe jo vetëm që Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në vitin 2014 me këto institucione, përgjithësisht bashkëpunimi ka qenë i mirë në vitin 2014, por në disa raste ka patur dhe vonesa në dhënien informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar. Disa nga rekomandimet e pranuar ende nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare, për këtë arsye sugjerohet marrja e masave sa më të shpejta për zbatimin e tyre.

### **3.3. Respektimi i të drejtës së pronës dhe procedurat e legalizimeve**

#### **3.3.1. E drejta e pronës**

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit, një vëmendje të veçantë i ka kushtuar trajtimit të problemit të pronave kujdesin dhe hapësirën e duhur, për më tepër, që kohët e fundit çështja e respektimit të së drejtës së pronës është klasifikuar nga Komisioni Europian si një ndër prioritetet për t’i hapur rrugën marrjes së statusit të vendit kandidat.

Shkelja e së drejtës së pronës si rrjedhojë e kryerjes apo moskryerjes së veprimeve prej organeve të Administratës Publike, në procesin e shqyrtimit të ankesave, konsiston në shkeljen e një apo disa elementëve të së drejtës së pronësisë, si: nëdorësia, gëzimi apo disponim. Kjo e drejtë garantohet nga neni 41 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe se cënimi i saj nuk mund të ndodh jashtë sanksionimit të kryer në nenin 42 të Kushtetutës së RSh, nga neni 1 i Protokollit nr.1, si dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>30</sup>.

Lidhur me zbatimin e parimeve të lartpërmedura, GJEDNJ gjithashtu ka konstatuar shkelje të Konventës dhe Protokollit nr.1 lidhur me vonesat në zbatimin e vendimeve administrative apo gjyqësore të formës së prerë që lidhen me të drejtën e pronësisë, si dhe në mungesën e fondeve ose burimeve të tjera për kompesimin e pronave të njohura në pronësi me të drejtë kompesimi.

Nga gjithë kompleksiteti i kësaj të drejte, ajo e kthimit apo kompensimit të saj tek të shpronësuarit nga sistemi i kaluar, mbetet problematike për ditët e sotme. Regjimi i të drejtës së pronësisë në vitet e zgjatura të tranzicionit ka qenë shpesh i paqëndrueshëm. Proceset e kthimit, por sidomos ai i kompensimit të pronave ka mbetur në kuadrin deklarativ.

Referuar të dhënave të marra nga AKKP-ja gjatë trajtimit të ankesave të subjekteve të ndryshëm, rezulton se, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, janë trajtuar dhe marrë vendime për 54.927 raste dhe se janë në proces shqyrtimi 8.343 raste. Na ka rezultuar, se për periudhën Qershor 2013 e deri më sot nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë vendim prej AKKP lidhur me kërkesat e subjekteve për njohjen me të drejtë kthimi/kompensimi të pasurisë së paluajtshme, edhe pse këto kërkesa janë administruar në vite. Centralizimi i procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohjen me të drejtë kthimi/kompensimi i pronave në AKKP Tiranë, pas suprimimit të zyrave rajonale, ka ndikuar në ngadalësimin e procesit.

Problemet e shfaqura të identifikuar nga institucioni i Avokatit të Popullit më shpesh në veprimtarinë e AKKP, të cilat lidhen me shkeljen e të drejtës së pronësisë, janë:

a) Shkelja e pajustificueshme e kufijve të përgjithshëm kohor për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me shqyrtimin e kërkesave për njohjen, kthimin e kompesimin e pronës.

b) Mosdërgimi rast pas rasti i vendimeve të marra për njohjen me të drejtë kthimi/kompesimit të pasurisë së paluajtshme në rrugë zyrtare pranë zyrës vendore të rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, konform parashikimit të nenit 196 të Kodit Civil.

c) Mosekzekutimi i vendimeve administrative apo gjyqësore që lidhen me të drejtën e kompesimit të pasurive të paluajtshme.

d) Hartimi i materialit grafik (hartës) që i bashkëlidhet vendimit sipas të cilit është vendosur për njohjen e së drejtës së pronësisë, shpesh ka rezultuar i pasaktë lidhur me adresimin e vendndodhjes së pronës

e) Detyrimi i subjekteve që kanë fituar të drejtën e kompesimit të pasurisë së paluajtshme të paraqesin vit pas viti dokumentacion për përfitimin e kompesimit në vlerë të pjesës së pasurisë që kompesohet.

f) Kompesimi në vlerë i subjekteve për pasuritë e njohura në pronësi është në një masë të papërfillshme karahasur me vlerën totale të kompesimit për të gjithë pronat e njohura në pronësi me të drejtë kompesimi.

Tjetër problematikë e konstatuar në marrëdhëniet me organet e përfshira në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, është mungesa e statistikave lidhur me numrin e vendimeve të marra prej AKKP-së, numrit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi të regjistruara në sistem, numri i akteve të cilat janë në gjykim administrativ në Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë ose në gjykatë, sasisë së tokës që

<sup>30</sup> Miratuar me Ligjin Nr. 8134, datë 31.07.1996

duhet për kompensim fizik, ndërkohë që shoqatat e ish pronarëve pretendojnë për një sipërfaqe 50.000 hektarë.

Në situatën në të cilën ndodhet procesi i njohjes me të drejtë kthimi/kompesimi të pronave, si dhe vendimarrjes së kryer nga GJEDNJ, në çështjen “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr. 236, datë 23.4.2014 “Për zbatimin e vendimit pilot të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, lidhur me reformën ligjore që duhet të ndërmerret për kthimin dhe kompensimin e pronave; krijimin e një mekanizmi të ri efikas për kompensimin e subjekteve të shpronësuar gjatë regjimit komunist për format e kompensimit, afatet e realizimit dhe me metodologjinë e hartës së vlerës së tokës në Shqipëri dhe transformimin e rolit të AKKP-së lidhur me këtë proces.

Nga studimi dhe rastet që kemi ndjekur me qëllim marrjen e masave konkrete për të zgjidhur problemin e pronësisë së subjekteve, i kemi sugjeruar Ministrin të Drejtësisë<sup>31</sup> një sërë rekomandimesh lidhur me këtë reformë ndër të cilat mund të përmëndim si më poshtë:

- Kufizimi me ligj i së drejtës të kërimit të njohjes dhe kthimit/kompesimit të pasurisë së paluajtshme pranë AKKP, ashtu siç ka ndodhur në ndryshimet e mëparshme të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, (i ndryshuar), nuk kanë ardhur në përputhje me parashikimin e nenit 113/b të Kodit Civil, në të cilën parashikohet se e drejta e kërimit të njohjes së pronësisë nuk parashkruhet. Në këtë kontekst, gjykojmë se, në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004, i ndryshuar, nuk duhet të gjej pasqyrim vendosja e afateve për kërkimin e njohjes së pronësisë sikurse ka ndodhur më parë. Kjo për shkak se për sa kohë do të vazhdojë veprimtaria e AKKP-së të jetë e mundur dhe pranimi i kërkesave të subjekteve për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pronave,
- Përgatitja e Projekt-Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme” në referim të nenit 5 të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe kalimin për miratim në Kuvënderin e Shqipërisë”, duhet të marrë vëmendjen maksimale, si një detyrim i papërbushur në afat, sikurse parashikohet në nenin 181, pika 1, e Kushtetutës së RSH-së,
- Rishikimi i legjislacionit si dhe nxjerrja rregullisht e aktit nënligjor për kompesimin financiar të të shpronësuarve për çdo vit në bazë të Ligjit nr. 10239, datë 25.02.2010 “Për krijimin e fondit special të kompesimit të Pronave”,
- Bërja publike e fondit të kompesimit fizik sipas V.K.M. nr. 1077, datë 18.06.2008, si dhe V.K.M. nr. 868, datë 18.06.2008,
- Shqyrtimi sa më parë i kërkesave të administruara nga AKKP-së si dhe vendosja e një afati konkret për përfundimin e procesit,
- Dërgimi nga ana e AKKP pranë ZVRPP për regjistrim i të gjithë vendimeve (titujve të pronësisë) të marra prej saj sipas të cilëve është vendosur për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pasurive të paluajtshme,
- Krijimi i databases dhe pozicionimit hartografik të pronave për të cilat disponohen nga AQSH, Kadastrat, (sot - ZAMT) në Qarqe, Hipotekat (sot - ZVRPP), të dhëna pronësie para zbatimit të Ligjit “Mbi reformën agrare”, viti 1946,
- Marrja e informacionit pranë gjykatave lidhur me vendimarrjet e kryera prej saj, lidhur me anulimin, ndryshimin e vendimeve të AKKP-së si dhe pranimin e kërkesës së subjektit për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pronës si dhe pasqyrimi në regjistrin elektronik të AKKP-së të tyre me qëllim përlllogaritjen e kostove të nevojshme në përfundimin e këtyre proceseve,

<sup>31</sup> Me shkresën Nr. 334 datë 4.11.2014., drejtuar Ministrin të Drejtësisë dhe AKKP-së.



- Përfundimi i procesit të regjistrimit fillestar sistematik të pronave në ato zona kadastrale ku është vendosur për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pasurive të paluajtshme dhe atij të vlerësimit të titujve pronësisë dhe dixhitalizimi i të dhënave,
- Zbatimi me korrektësi i ligjit, rritja e efikasitetit dhe shkallës së transparencës në administratë si dhe zvogëlimi i kontakteve të qytetarëve me administratën, sistemi “one stop shop”,
- Rritja e shkallës së koordinimit midis institucioneve që trajtojnë çështjet e pronësisë,
- Kompesimi, siç parashikohet nga ligji nr.9235, datë 29.07.2004, të ndryshuar, të kryhet jo vetëm në të holla, por të shihet me përparësi përdorimi i metodave alternative të kompesimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të 210 rasteve të ndryshme të depozituara gjatë vitit 2014, në të cilat është ngritur pretendimi i shkeljes të së drejtës së pronësisë nga ana e organeve të Administratës Publike, ka konstatuar, se paraqesin problematikat sa më poshtë:

- Lidhur me pasaktësinë e akteve të marrjes së tokës në pronësi sipas Ligjit nr.7501, datë 17.09.1991, “Për tokën”, të lëshuara, të cilat kanë passjell mospërfitim të tokës në masën e parashikuar në ligj për subjektin ankues.<sup>32</sup>
- Lidhur me kryerjen e veprimeve për shpronësim në kundërshtim me Ligjin 8561, datë 22.12.1999, të ndryshuar si çënim të pronësisë së subjektit ankuesi pa respektuar parimin për një proces të rregullt ligjor; për mosdhënie të masës së dëmshpërblimit për shpronësimin e kryer vite më parë subjektit pronar<sup>33</sup>; mospërfshirje të pasurisë në procesin e shpronësimit<sup>34</sup> si dhe mosdorëzim të vlerës së shpronësimit subjektit pronar<sup>35</sup>, etj.
- Lidhur me veprime ose mosveprime të kryera nga Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme si mosdhënia brenda afatit ligjor të dokumentave të pronësisë apo kthimit të përgjigjes për shkakun e moslëshimit të tyre në favor të pronarit<sup>36</sup>; lëshim i dokumentave të pronësisë të cilat përmbajnë të dhëna të pasakta referuar titullit të pronësisë të rregjistruar<sup>37</sup>; mosregjistrim të pronave të njohura në pronësi sipas vendimeve administrative të formës së prerë, referuar parashikimit të nenit 193 dhe 196 të K.Civil<sup>38</sup>; kufizim i së drejtës së disponimit mbi pasurinë e paluajtshme tej afateve ligjore, etj.
- Mosrespektim i detyrimit të përcaktuar në VKM nr.716, datë 18.12.1995, të ndryshuar, nga ana e organit të Prefektit të Qarkut Tiranë, për sistemimin e familjeve të Fshatit Fajzë, të Rrethit Has, në tokat disponibël të kurorës së Tiranës<sup>39</sup>;
- Mosregjistrim i trojeve të banesave të përfutur sipas Ligjit nr.7501, datë 17.09.1991, në favor të banorëve të Fshatit Blacë, Pogradec.<sup>40</sup>
- Zbatim i projekteve publike mbi ndërtime të paluajtshme të ndërtuara para datës 10.08.1991, pa respektuar VKM nr.608, datë 05.09.2012, e cila parashikon kalimin e pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara para datës 10.08.1991<sup>41</sup>.
- Mosnxjerrje e akteve nga AKKP për kompesimin e pasurive të paluajtshme të njohura në pronësi me të drejtë kompesimi.

<sup>32</sup> Komsioni Tokës, Fshati Peshkëpi, Vlorë. Rasti me nr.doculive 201401935

<sup>33</sup> Bshkia, Fier. Rasti me nr.doculive 201401968 dhe nr.201300431

<sup>34</sup> OST, Tiranë. Rasti me nr.doculive 201402212

<sup>35</sup> Bashkia, Tiranë. Rasti me nr.doculive 201402246

<sup>36</sup> ZVRPP, Tiranë. Rasti me nr.doculive 201401111

<sup>37</sup> ZVRPP, Sarandë. Rasti me nr.doculive 201402336

<sup>38</sup> ZVRPP, Berat. Rasti me nr.doculive 201401069

<sup>39</sup> Prefekti I Qarkut, Tiranë. Rasti me nr. doculive 201401669

<sup>40</sup> ZVRPP, Pogradec. Rasti me nr.doculive 201402254

<sup>41</sup> INUK, Bashkia, Tiranë, etj. Rasti me nr.doculive 201402095

- Mosushtrim nga ana e zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të funksioneve sikurse parashikuar në Ligjin nr.33/2012, neni 30, për kryerjen e studimit/rilevimit për pasuritë të cilat krijojnë mbivendosje. Kjo procedurë nuk zbatohet as nga strukturat pranë bashkive apo kumunave ku ndodhet pasuria. Rëndom ky problem haset sot në zyrat regjistrimit të pasurive të paluajtshme për shkak të materialit hartografik të punuar në mënyrë të pasaktë prej saj apo subjekteve privat kontraktues<sup>42</sup>.
- Mosekzekutim i vendimit gjyqësor prej organeve shtetërore të cilat përmbajnë fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, etj”.

Rast pas rasti për problematikat e konstatuara janë kryer rekomandimet, propozimet apo kërkesat pranë organit përkatës të cilat mundësojnë ndërprerjen e veprimeve arbitrare ose mosveprimeve që kanë passjellë cënim të të drejtës së pronësisë subjektivit ankues. Konkretisht janë rekomanduar nxjerrja e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të Urdhërit Nr.2252 Prot, datë 31.10.2014, drejtuar Bashkisë Fier; bërja e korrigjimeve të ndryshme të gabimeve material për korrigjime për dokumentat për vërtetim pronësie, përgatitjen dhe nxjerrjen e aktit i cili mundëson ndryshimin e pikës 3, të VKM nr.81 datë 28.02.1994.

Gjithashtu është rekomanduar dhe nxjerrja e urdhërit për unifikimin e qëndrimit lidhur me dërgimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë që përmbajnë fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, nga ana e gjykatave në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

### ***3.3.2. Procedurat e legalizimit dhe prishjes së ndërtimeve pa leje***

Nisur nga rëndësia që iu dha procesit të legalizimeve, pajisjes së individëve me dokumentacione të rregullta pronësie, si dhe për të ulur nivelin e informalitetit në tregun e pasurive të paluajtshme, në Shqipëri është miratuar kuadri i ri ligjor që shërben si bazë për ndërmarrjen e një procesi shumë të rëndësishëm, por mjaft delikat, siç është legalizimi i ndërtimeve informale<sup>43</sup>. Konkretisht është miratuar Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar si dhe një sërë aktesh normative në zbatim të tij<sup>44</sup> si dhe ky ligj ka pësuar disa ndryshime që kanë ndodhur së fundmi me ligjin 50/2014 datë 15.05.2014. Krahas ligjit bazë dhe ndryshimeve që pasuan ndër vite, nga ana e pushtetit ekzekutiv janë miratuar edhe disa akte nënligjore të miratuar në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, të cilat parashikojnë dhe rregullojnë me detaje procedurat që do të ndiqen për legalizimet.

Kuadri ligjor i miratuar deri tani, i përcakton Agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritimit të zonave/ndërtimeve informale (ALUIZNI), një rol kryesor në procesin e zbatimit të kësaj reforme, bashkërendimin efektiv të punës midis instancave të qeverisjes qëndrore dhe lokale, si dhe në plotësimin e kuadrit juridik të nevojshëm me akte nënligjore, të nevojshme për vënien në zbatim të ligji.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, ka shqyrtuar 84 ankesa ndaj Zyrave Rajonale të ALUIZNI-t në rrethe, apo edhe ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. Gjatë shqyrtimit të ankesave ka rezultuar se, një pjesë e konsiderueshme e individëve kërkojnë të informohen zyrtarisht, për ecurinë e procedurës së legalizimit të

<sup>42</sup> ZRPP, Vlorë. Rasti me nr.doculive 201400337, nr.201401253.

<sup>43</sup> Ky proces dhe rregullimi ligjor i tij kanë qënë pjese e kontestimeve nga pronarët, mbi tokat e të cilëve ishin ngritur ndërtimet pa leje.

<sup>44</sup> Ligji i ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007, ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008, vendimin nr. 35 datë 10.10.2007<sup>44</sup> dhe vendimin nr. 3, datë 02.02.2009, të Gjykatës Kushtetuese<sup>44</sup>, ligjin nr.10 099, datë 19.3.2009, ligjin nr. 10 169, datë 22.10.2009 ligjin nr.10 219, datë 4.2.2010, ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013.

objekteve të ndërtuara prej tyre pa leje ndërtimi, pasi nuk kanë patur asnjë informacion, apo njoftim nga zyrat respektive të ALUIZNI-t. Avokati i Popullit ka konstatuar se ka ende një numër shumë të lartë qytetarësh të cilët kanë aplikuar prej vitesh pranë zyrave të ALUIZNI-t në qarqe, por kërkesat e tyre për legalizim nuk janë shqyrtuar ende.

Ky problem është evidentuar kryesisht gjatë vitit 2014 për shkak të nismave të ndërmarra në zbatimin e disa projekteve publike, në kuadër të të cilave ishin planifikuar edhe ndërhyrje në objektet e ndëtuara të mjaft individëve, të cilët kishin aplikuar prej vitesh për legalizimin e tyre. Në këtë kuadër, ata kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre ligjore dhe financiare, ndërkohë që menjëherë janë përballur me praninë e përforcuar të strukturave shtetërore për të ndërhyrë forcërisht ndaj këtyre objekteve.

Një nga problematikat më specifike të konstatuara nga ana jonë gjatë vitit 2014, ka qënë mospërcaktimi i afatit maksimal fundor të mbarimit të procedimit administrativ për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi. Bazuar në praktikën e ankesave që janë paraqitur pranë institucionit tonë për raste të ngjashme që lidhen me veprimtarinë e organit të ALUIZNI-t, apo edhe të INUV-ve përkatëse, kemi konstatuar se individë të ndryshëm të cilët kanë ndërtuar pa leje, kanë aplikuar me vetëdeklarimin për legalizimin e objektit prej shumë vitesh pranë njësisë të qeverisjes vendore.<sup>45</sup>

Megjithëse ligji “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ka përcaktuar kompetencën e ALUIZNI-t, për legalizimin e ndërtimit informal vërehet se, procesi i legalizimit të një ndërtimi informal, apo edhe i një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi, është kompleks dhe përfshin ndërveprimin ligjor të disa organeve të administratës publike.

Ky kompleksitet shfaqet në kompetencat procedurale kohore të zyrave të urbanistikës në njësitë vendore, që lidhen me vetëdeklarimin e ndërtimeve informale nga subjektet e interesuara, kompetencat e këshillave të qarqeve; KKT-së; autoriteteve vendore të planifikimit; drejtorive rajonale të bujqësisë dhe ushqimit, si dhe agjencive rajonale të mjedisit. Nuk përjashtohet këtu edhe vendimmarrja e Këshillit të Ministrave për pezullimin e procedurave në raste specifike. Po sipas ligjit, në rast se zyrat e urbanistikës dhe këshillat e qarqeve nuk ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara në këtë dispozitë, ALUIZNI merr përsipër ushtrimin e tyre.

Vetëm pas kësaj, zyra e ALUIZNI-t, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave administrative,<sup>46</sup> sikundër shprehet ligji në nenin 28, pajis subjektin me lejen e legalizimit, parashikim ky që me ndryshime specifike zbatohet edhe për “shtesat pa leje në ndërtime me leje”.

Një shumatorë artimetike e të gjitha afateve të vendosura në ligj për të përcaktuar një afat maksimal të procedimit administrativ për trajtimin e një vetëdeklarimi për legalizim, bëhet e pamundur për shkak të mungesës së qartësisë të vetë dispozitave ligjore, si dhe të një procesi kompleks të parashikuar nga ligji, i cili në këtë kuptim dihet që ka një datë fillimi për çdo rast vetëdeklarimi, por nuk dihet se, kur do të ketë afatin përfundimtar të vendimmarrjes nga ana e ALUIZNI-t.<sup>47</sup>

Efektivisht konstatohet se, nuk kemi një afat unik taksativ të përcaktuar qartë në ligj, brenda të cilit duhet të përfundojnë procedimet administrative që lidhen me vendimmarrjen për

<sup>45</sup> Për raste që lidhen me zonën e Selitës ku edhe do të ndërtohet “Unaza e Re”, na rezulton se, aplikime për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje janë kryer subjektet e interesuara, që nga viti 2005.

<sup>46</sup> Ky konkluzion përforcohet edhe me shumë nga fakti se, nuk dihet se çdo të ndodhë me afatet e vendimmarrjes nëse personat e interesuar, nuk paguajnë tarifën e shërbimit të ofruar gjatë këtij procesi nga organet e administratës publike, ose nuk paguajnë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga procesi, përfshirë këtu edhe gjokat që mund të vendosen rast pas rasti.

<sup>47</sup> Ky konkluzion përforcohet edhe me shumë nga fakti se, nuk dihet se çdo të ndodhë me afatet e vendimmarrjes nëse personat e interesuar, nuk paguajnë tarifën e shërbimit të ofruar gjatë këtij procesi nga organet e administratës publike, ose nuk paguajnë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga procesi, përfshirë këtu edhe gjokat që mund të vendosen rast pas rasti.

legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi dhe që sjell zvarritje pafund të procesit<sup>48</sup>.

Në këto kushte mbetet parësor, realizimi i iniciativës legislative për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr.9482 datë 3.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e një afati unik taksativ të përcaktuar qartë brenda të cilit duhet të përfundojnë procedimet administrative që lidhen me vendimarrjen për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi. Një rekomandim për këtë qëllim i është dërguar në datën 19.11.2014, Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, por për të cilin nuk kemi marrë ende një përgjigje.

Përsa i përket prishjes së ndërtimeve pa leje, theksojmë se në Republikën e Shqipërisë ka tashmë një legjislacion të konsoliduar për verifikimin e ligjshmërisë dhe inspektimin e ndërtimeve pa leje<sup>49</sup>. Pavarësisht bazës së gjerë ligjore për rregullimin e veprimtarisë respektive, në fakt janë verifikuar probleme dhe mangësi në ushtrimin kompetencave nga INUK dhe INUV-e vendore në kuadër të ndjekjes të procedurave administrative, të cilat janë pasqyruar edhe në ankesat e shumta të parashtruara pranë institucionit tonë.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, janë shqyrtuar 42 ankesa ndaj INU vendore dhe INUK, me objekt në mënyrë specifike mosveprimin e tyre në verifikimin e ndërtimeve të paligjshme, marrjen e masave dhe sanksioneve ligjore ndaj kundravajtësve, mosekzekutim të vendimeve për prishje, apo edhe për veprime të padrejta duke shkelur kryesisht procedurat administrative të njoftimit të akteve administrative, në kuadër të njohjes dhe ushtrimit nga ana e individëve të të drejtës së ankimimit. Në aspektin konkret, atë të ndërhyrjes fizike ndaj objekteve të ndërtuara pa leje, ose jashtë lejes së ndërtimit, duhet theksuar se është shumë problematik funksionimi i I.N.U.V-ve. Në gjitha rastet, Avokati i Popullit ka adresuar problematikat pranë INU vendore por të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë gjetur zgjidhje, sidomos në INUV-in e Bashkisë Tiranë.

Por nga ana tjetër, shumë problematike mbetet mënyra e procedimit nga ana e punonjësve të INUK, lidhur me njoftimin verbal për prishjen e banesave të individëve të caktuar, pa ndjekur procedurën ligjore normale.<sup>50</sup>

Avokati i Popullit ka konstatuar se, procedura e njoftimit nga ana e punonjësve të INUK për të gjitha këto raste është e mangët dhe njëkohësisht në kundërshtim me ligjin. Bazuar edhe në parashikimet e Ligjit nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, procedura e sanksionimit me vendim për prishje të objekteve që konstatohen si të kundërligjshme, duhet të kalojë në disa faza të detyrueshme procedurale, të cilat respektojnë të drejtën e palëve përkatëse për një proces të rregullt ligjor.<sup>51</sup> Kjo procedurë nuk

<sup>48</sup> Zvarritja e konstatuar nxjerr në konkluzionin se kemi të bëjmë me cënim të së drejtës themelore të individëve, për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42/1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në aspektin administrativ të shqyrtimit të çështjes. Po kështu mungesa e afatit të arsyeshëm për përfundimin e procedimit administrativ, nxjerr në konkluzionin se kemi të bëjmë me cënim të parashikimeve të nenit 6, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe rrjedhimisht edhe të nenit 13, të kësaj konvente.

<sup>49</sup> Kështu mund të përmendim Ligjin nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar; Udhëzimin e MPPTT nr.17, datë 13.08.2007 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar gjatë periudhës kalimtare të transferimit të përgjegjësive dhe detyrave në inspektoratet ndërtimore e urbanistike vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai vendor” ndryshuar me Vendimin e KM nr.625, datë 28.07.2010; Vendimin e KM nr.868, datë 12.12.2007 Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar”, ndryshuar me Vendimin e KM nr.548, datë 07.07.2010.

<sup>50</sup> Ankesa të tilla janë jo të pakta në institucionin tonë dhe për më tepër, ky shqetësim është ngritur nga ana e komunitetit të banorëve që preken nga zbatimi i projektit të ndërtimit të “Unazës së Re”, të Tiranës, në takimin që Avokati i Popullit pati në datën 13.11.2014 me këtë komunitet, pikërisht në zonën ku ndodhen banesat e tyre. Në këtë takim veç mënyrës së komunikimit dhe njoftimit për prishjen e banesave të tyre, banorët kanë ngritur edhe shqetësimin tjetër se, po nga ana e punonjësve të INUK-ut iu është njoftuar po verbalisht se, prishja e banesave të tyre do të fillonte në datën 17.11.2014.

<sup>51</sup> Efektivisht ndërtimi i kundërligjshëm, (pa leje ndërtimi) cilësohet si kundërvajtje administrative, ndaj edhe në këto kushte, konstatimi i tij, vendimarrja administrative që lidhet me të dhe ekzekutimi i vendimit specifik rast pas rasti, duhet t’i nënshtrohet procedurave dhe afateve të detyrueshme ligjore. Përdërisa nuk kemi aplikimin e dënimit me gjobë në vend si një dënim administrativ, atëherë parësore sipas parashikimeve të nenit 13, të Ligjit “Për kundërvajtjet administrative”, mbetet

është ndjekur në rastet e evidentuara nga ana Institucionit të Avokatit të Popullit në rastet e prishjes së ndërtimeve pa leje në zonën e Selitës, Tiranë si dhe në Hudënisht në Pogradec, madje ka rezultuar se janë mjaftuar me një njoftim verbal drejtuar banorëve të zonës.

Kjo mënyrë veprimi që pretendohet të jetë ushtruar nga punonjësit e INUK-ut, është cilësuar nga ana jonë tërësisht e kundërligjshme dhe kemi theksuar që, çdo veprim në këto kushte është shpërdorim i detyrës. Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me disa rekomandime INUK-ut,<sup>52</sup> për analizimin e menjëhershëm dhe të kujdesshëm të të gjitha procedurave të ndjekura nga kjo e fundit, për ndërtimet që ndodhen në zonat ku ka ndërtime të projekteve publike, si zbatimin e projektit të “Unazës së Re”, atë të Hudënishtit në Pogradec etj, si dhe shfuqizimin e çdo akti që është nxjerrë në shkelje të rëndë të procedurave të përcaktuara nga ligji dhe respektimin e tyre në procedurat që do të ndiqen në vazhdim nga ana e INUK-ut, duke respektuar të gjitha të drejtat që individët gëzojnë në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Lidhur me të drejtën e njoftimit të qytetarëve për vendimin e INUK si dhe të drejtën e ankimit që ata kanë, Avokati i Popullit ka adresuar një rekomandim tek INUK me qëllim respektimin e kësaj të drejte.

Avokati i Popullit ka konstatuar probleme edhe në mënyrën e procedimit nga ana e punonjësve të INUV, përsa i takon njoftimit për prishjen e banesave të individëve të caktuar, ndërkohë që objekti ndodhet ende në proces legalizimi. Në këto kushte, objekti në fjalë nuk mund të cilësohet i kundërligjshëm, nëse ALUIZNI, si organi kompetent nuk ka marrë ende një vendim për legalizimin, ose jo të tyre. Nga ana tjetër edhe sikur objektet të ishin në kushtet kur ato janë të kundërligjshme, atëherë sipas akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë procedurat e kontrollit të territorit nga ana e INUV-ve dhe INUK-së, duhej që të ndiqen disa hapa proceduriale të përcaktuara konkretisht, për këtë çështje.

Në pikën 1, të nenit 23, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet shprehimisht se: *“Në qoftë se vendimi përfundimtar në një procedim administrativ varet nga marrja e një vendimi paraprak i cili është në kompetencën e një organi tjetër administrativ apo të gjykatës, organi që ka kompetencën për marrjen e vendimit përfundimtar e pezullon procedimin përkatës, deri kur organi tjetër administrativ ose gjykata e kanë marrë vendimin paraprak.....”*.

Avokati i Popullit ka vlerësuar në rekomandimet e tij se, kushtet kur ALUIZNI nuk ka marrë ende një vendim përfundimtar për legalizim, ose jo, të objekteve në proces legalizimi, atëherë çdo vendimmarrje nga ana e INUV, apo INUK, çënon seriozisht ligjshmërinë e vendimmarrjes.

Funksionimi i organeve të administratës publike në zbatimin e përcaktimeve kompetenciale, kuptuar këtu ALUIZNI-n, INUV dhe INUK, ka evidentuar zvarritje, mosrespektim të procedurave ligjore rast pas rasti, mosinformim të subjekteve të interesuar lidhur me fazën e trajtimit të procedimeve administrative përkatëse, si dhe shkelje ligjore që çënojnë drejtëpërdrejtë të drejtën themelore për një proces të rregullt ligjor.

Gjithashtu një moment i rëndësishëm në aktivitetin e INUV-ve dhe INUK, vlerësojmë se duhet të jetë veprimi në kohë për sanksionimin e ndërtimeve informale, sikundër edhe ekzekutimi i vendimeve të nxjerra ndaj këtyre ndërtimeve. Pa dyshim, ligjshmëria në këtë funksion publik mbetet një parim jetik i veprimtarisë së vet organeve, si dhe tregues i respektimit të të drejtave të njeriut.

---

mbajtja e aktit administrativ (procesverbalit) që konstaton shkeljen, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja dhe në vazhdim, nxjerrja dhe njoftimi i vendimit të organit të ngarkuar nga ligji, palëve kundërvajtëse. Në këtë llogjikë vjen edhe përcaktimi i bërë në nenin 13, të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar.

<sup>52</sup> Rekomandim me datë 27.10.2014

### **3.4. Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor**

#### ***3.4.1 E drejta për një proces të rregullt ligjor lidhur me veprimet në organin e akuzës dhe në gjyqësor***

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese, e cila e vendos organin procedues para një detyrimi për të vënë në dijeni individin menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, pra ta informojë atë në mënyrë të plotë dhe të saktë për akuzat e ngritura. Mandej, gjatë zhvillimit të fazës së hetimit paraprak deri në përfundimin e hetimit dhe dërgimit të çështjes në gjyq, duhet të respektohen të gjitha të drejtat procedurale të personit ndaj të cilit është ngritur një akuzë.

Të drejtat e personave ndaj të cilëve është ngritur një akuzë, parashikohen në nenet 42/2 dhe 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 6 të KEDNJ si, dhe nenet 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, mbrojtja që i ofrohet individit nga klauzola e procesit të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në Kushtetutë, por dhe në të drejtat e njohura nga ligji.

Rreziku i shkeljes së të drejtave të njeriut fillon në çastin kur organet kompetente ngrejné dyshime të arsyeshme e të bazuara se ai ka kryer një vepër penale. Por, personi nën akuzë gëzon një sërë të drejtash në procesin penal, të cilat ai mund t’i ushtrojë, duke patur parasysh të drejtën e informimit dhe mënyrën se si mund t’i realizojë ato praktikisht.

Kushtetuta në nenet 28 dhe 42 të saj, përcakton detyrimin për gjykimin e personit të paraburgosur apo të akuzuar penalisht brënda një “*afati të arsyeshëm*”. Ky afat nënkupton një hark kohor të nevojshëm për zhvillimin e një procesi penal, i cili duhet të sigurojë barazi ta palëve në proces. E drejta për një gjykim të drejtë në proceset penale, evidentohet nëpërmjet një numri të ri, e drejta për një seancë gjyqësore publike, e drejta për t’u mbrojtur ndaj akuzave të ngritura, e drejta për t’u konsideruar i pafajshëm, e drejta për t’u gjykuar pa vonesa të panevojshme, e drejta për t’u mbrojtur vetë ose nëpërmjet një avokati mbrojtës, e drejta për të thirrur dëshmitarë etj.

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 304 ankesa të adresuara nga qytetarët për veprime të padrejta ose mosveprime të kryera nga organi i akuzës dhe veprime të kryera nga gjykata. Një nga problematikat që rezultojnë nga ankesat janë pretendimet për zvarritje të pajustificuara të gjyimit apo hetimit të çështjeve civile dhe penale. Lidhur me organin e akuzës, në jo pak raste, zvarritjet e hetimeve kanë qënë për vepra penale të hetuara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, më e theksuar kjo, në ato raste kur vendimi i mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të çështjes marrë nga Prokuroria, është shfuqizuar nga Gjykata. Më pas organi procedues ka zvarritur hetimet në mënyrë të pajustificuar në disa raste deri në dy vjet, duke mos kryer veprimet hetimore në vazhdimësi shpesh dhe pa realizuar detyrat e lëna në vendimin e Gjykatës.

Si shkaqe për zvarritjet kanë shërbyer kryerja e ekspertimeve të ndryshme, mosparaqitja e palëve sidomos dëshimtarëve dhe në raste më të rralla gjykimi i çështjeve penale në mungesë të të pandehurëve. Për këtë arsye, Avokatit të Popullit, më datën 20.01.2015, i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm me Rekomandimin “Për përmirësimin e punës me qëllim zbatimin nga Prokuroria të dispozitave procedurale, për dhënien e kopjeve të akteve, shqyrtimin e vlerësimin e kërkesave apo memorieve me shkrim, si dhe njoftimit menjëherë të vendimeve përfundimtare, palëve në procesin penal”. Rekomandimi është pa përgjigje.

Me qëllim moszvarritjen e proceseve civile e penale, Avokati i Popullit i është drejtuar me rekomandime gjithashtu Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës së Lartë, për të cilat ka vënë në dijeni dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Vlen të përmëndim se në disa raste ndërhyrja jonë ka patur impaktin e saj pozitiv, çka ka konsistuar jo

vetëm në vlerësimin e rekomandimeve, por dhe marrjen e masave për përshpejtimin e procedurave për përfundimin e hetimit apo gjykimit në afatet ligjore<sup>53</sup>.

Një aspekt tjetër i evidentuar është mosrespektimi i dispozitave procedurale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin civil apo penal, të cilat paraqiten:

a) *Në mosdhënien e akteve të ndryshme (në disa raste origjinale), të sekuestruara gjatë hetimit të procedimeve penale.* Qytetarët në 4 raste, në ankesat e tyre kanë ngritur shqetësimin se organi i Prokurorisë për llogari të hetimit të procedimit penal, ka sekuestruar akte të ndryshme që ata kanë disponuar mbi pasuritë e tyre si, në sipërfaqe trualli, automjete, dhe në disa raste dokumentet e sekuestruara kanë qënë origjinale. Nga mosveprimi i organit procedues dhe zvarritjet për mosdhënie të akteve të procedimit penal në rastet e më sipërme kanë ardhur pasoja nga më të ndryshmet, cënim i interesave të ligjshme të qytetarëve, duke bërë të pamundur rregjistrimin e pasurisë pranë ZVRPP, mos kryerjes së veprimeve me automjetet në pronësi, për të kryer aktivitetin e biznesit privat apo familjar, kontratën për shitjen e tyre ose daljen jashtë shtetit, zvarritje në proceset gjyqësore civile, etj.

b) *Në mos shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave apo memorieve me shkrim, që palët kanë paraqitur në procesin penal, sidomos gjatë fazës së hetimit paraprak, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos u shprehur me vendim brënda pesëmbëdhjetë ditëve, dhe në njaft raste pa njoftuar kërkuuesin.* Raste të tilla kanë qënë 6 ankesa. Mos shqyrtimi i kërkesave apo memorieve të personave nën hetim apo përfaqësuesit të tyre, janë me pasojë si për organin procedues, pasi si rezultat i mosverifikimit të “pretendimeve” që paraqesin personat nën hetim, vijnë zvarritje të hetimit apo mund të ndodhë marrja e një vendimi përfundimtar të pabazuar, deri në cënimin e një procesi të rregullt ligjor.

Përsa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit, më datën 04.12.2014, i është drejtuar Prokurorisë për Krimet e Rënda “Për hetimin e shpejtë dhe pa zvarritje të pajustificuara të procedimeve penale, me qëllim zbatimin e dispozitave kushtetuese e procedurale për një proces të rregullt ligjor”. Për rekomandimin nuk kemi marrë përgjigje.

c) *Në mos njoftimin ose vonesa në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë sidomos kallëzuesit të veprës penale kryesisht në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal.* Ky vendim palëve në 10 raste, nuk i është njoftuar menjëherë ashtu si parashikohet në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale. Vonesa për njoftimet e palëve në procesin penal kanë ndodhur dhe për rastet kur organi i Prokurorisë ka marrë vendim për pushimin e çështjes. Për rastet e pezullimit të hetimit, në përgjithësi organi i Prokurorisë nuk njofton apo nuk iu dërgon palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se “ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale”.

Në përfundim të trajtimit apo hetimit të pavarur administrativ të ankesave të qytetarëve, duke i vlerësuar ato të drejta, Avokati i Popullit ka Rekomanduar marrjen e masave me qëllim përmirësimin e punës. Rekomandimet kanë qënë për raste konkrete, apo duke i grupuar ato sipas të njëjtit objekt të problematikës së paraqitur.

Rastet e ankesave të trajtuara, kanë qënë nga pjestarë të familjeve të grave të dhunuara deri në vrasjen e tyre prej bashkëshortëve, dhe në një rast të filluar me Inisiativë nga Avokati i Popullit, kur një shtetase me moshë 23 vjeç, person me aftësi të kufizuara është dhunuar

<sup>53</sup> Rekomandim dt 29.05.2014, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të një çështje penale për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, të djalit të ankuetit, pasi nga koha e kryerjes së krimit, deri në datën e paraqitjes së ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit kishte kaluar një periudhë prej 2 vjetësh dhe gjykimi nuk kishte përfunduar; Rekomandimi i datës 22.05.2014, drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës për shpejtim gjykimi në çështjen penale për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, me arsyetimin se kishin kaluar afatet ligjore të paraburgimit. Rekomandim i datës 25.04.2014, drejtuar Gjykatës së Lartë për shpejtimin e gjykimit në një çështje civile, pasi kishte kaluar një periudhë kohe prej 2 vjet dhe nuk përfundonte gjykimi.

fizikisht nga babai dhe vëllai i saj. Për këto shqetësime më datën 17.02.2014, i jemi drejtuar me Rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ministrit të Brendshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm, “Për përmirësimin e punës parandaluese dhe luftës me efikasitet të organeve të zbatimit të ligjit, për veprat penale të dhunës në familje”. Rekomandimi është vlerësuar nga Institucionet e mësipërme, dhe në përgjigjet e tyre vihet theksi dhe tek domosdoshmëria e forcimit të bashkëpunimit dhe inicimit të një koordinimi të punës ndërmjet institucioneve. Për rastin e personës së dhunuar nga familjarë të saj, nga Policia e Shtetit, janë marrë masa disiplinore ndaj punonjësit të policisë që ishte ngarkuar me çështjen.

Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë, rastin e bërë publik në një emision të një Televizioni Kombëtar, kur një nënë ankohej ndaj Policisë për ushtrim dhune nga djali i saj, person me probleme të shëndetit mendor, i cili ishte larguar pa lejë nga Spitali Psikiatrik i Vlorës.

Mbi këtë shqetësim, pas kryerjes së hetimit të pavarur administrativ, më datën 14.10.2014, i jemi drejtuar me Rekomandim, Drejtorisë së Policisë së Qarkut dhe Prokurorisë së Rrethit, “Për marrjen e masave për zbatimin korrekt të dispozitave procedurale, kur qytetarët kryejnë veprime që vijnë ndesh me vendimin e gjykatës, me objekt “Lëshim Urdhër Mbrojtje” dhe “dhunë në marrëdhëniet familjare”. Në përgjigje të rekomandimit, organi i Prokurorisë informoi se çështja është dërguar në gjyq, kurse Policia e Shtetit pas analizës së hollësishme e ka përgjithësuar rastin, duke nxjerrë përfundime që lidhen jo vetëm me parandalimin e fenomenit, por dhe zbatimin me përpikmëri të dispozitave të Kodit Penal, të nxjerra për këtë qëllim.

### ***3.4.2. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor***

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2014, në punën e tij gjatë shqyrtimit të ankesave/kërkesave, ka dhënë asistencën e nevojshme, duke adresuar me shkrim, çdo rast të konstatuar për shkeljen e pretenduar, në Ministrinë e Drejtësisë ose në Inspektoriatin e KLD-së, për shkelje të ndryshme në procedurat gjyqësore të kryera gjatë gjykimit nga gjyqtarë të veçantë ashtu edhe për shkelje të tjera të ndryshme të kryera nga administrata gjyqësore. Gjatë këtij viti janë marrë për shqyrtim gjithsej 167 ankesa, ndaj gjykatave të gjitha shkallëve dhe këto ankesa kanë patur për objekt shkelje të ndryshme, për mos zhvillim si duhet të një procesi të rregullt gjyqësor, për zvarritje gjykimi, shkelje të procedurave gjyqësore, ankesa ndaj vendimeve gjyqësore duke e konsideruar atë si të padrejtë dhe të pabazuar në ligj, për mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për mosdhënie të kopjes së vendimeve gjyqësore, etj. Gjithashtu në disa raste është kërkuar ndihmë juridike falas nga shteti nëpërmjet Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike në Ministrinë e Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj me vendimet nr.12/2012 dhe nr. 35/2013 në lidhje me mosgjykimin brenda një afati të arsyeshëm ka vendosur konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm në shkelje të kërkesave të nenit 42, të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ.

Lidhur me shkeljet e pretenduara të ankuesve, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandimet përkatëse dhe pasi janë shqyrtuar nga gjykatat, janë marrë masa organizative dhe këto gjykime kanë përfunduar në afatet ligjore të përcaktuara. Si raste pozitive mund të përmendim atë të një ankuesi nga Vlora, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të autorëve, të akuzuar për krimin e vrasjes së djalit të tij prej dy vjetësh nga data e ndodhjes së ngjarjes. Nga verifikimi i kryer rezultoi se për një vit kanë vazhduar hetimet paraprake nga organi i Prokurorisë dhe një vit tjetër zvarritej gjykimi nga Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë. Mbi Rekomandimin e Avokatit të Popullit për shpejtim gjykimi, u arrit që ky proces gjykimi të përfundonte brenda afteve ligjore të përcaktuara.



Po kështu është vepruar me raste ankesash ndaj Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Lushnje, Elbasan, Shkodër, Durrës, Korçë, Pogradec, Gjirokastrë, Gjykatës së Apelit Tiranë, Durrës, Shkodër. Nga ana jonë pas studimit të akteve janë adresuar rekomandimet përkatëse për përshpejtim të procedurave të gjykimit, të cilat janë pranuar nga gjykatat duke marrë dhe masa për gjykimin brenda afateve ligjore.

Mbi shkeljet e konstatuara, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka dërguar Rekomandim Ministrisë së Drejtësisë me qëllim përmirësimin e dispozitave ligjore, i cili është pranuar dhe ndodhet në shqyrtim dhe përgatitje të akteve. Gjithashtu nga Avokati i Popullit janë bënë komunikime për shpejtim gjykimesh edhe nga Gjykata e Lartë.

### ***3.4.3. Ndihma ligjore falas***

Me daljen e Ligjit Nr.10039 datë 22.12.2008 “Për Nidhmën Juridike”, u krijua dhe funksionon Komisioni Shtetëror për dhënien e ndihmës juridike falas nga shteti, institucion pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ky Komision Shtetëror i Ndihmës Juridike ka për objekt të veprimtarisë së tij shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga qytetarë të ndryshëm të cilët nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të zgjedhur vetë një avokat mbrojtës privat, me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen në Gjykatë. Ndihma Juridike është instrumenti më efikas për t’i garantuar individit aksesin në drejtësi. Ndryshimet e fundit në ligjin Nr. 143/2013 “Për disa shtesa në ligjin Nr.10039 datë 22.12.2008 “Për Nidhmën Juridike”, i kanë dhënë më shumë mundësi individëve në pamundësi financiare për të realizuar të drejtat e tyre para gjykatave në vend, gjithashtu me këto ndryshime është bërë e mundur dhe dhënia e ndihmës juridike nga Klinikat ligjore vendore, të cilat janë vendosur në gjithë teritorin e vendit pranë Gjykatave të Apelit.

Gjatë vitit 2014 na janë adresuar rreth 25 kërkesa për t’i përfaqësuar në procese gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqësorit, duke pretenduar se janë në pamjaftueshmëri financiare për të zgjedhur një avokat privat. Nisur nga mungesa e kompetencës për të përfaqësuar qytetarët në procese gjyqësore, këto kërkesa i janë adresuar për kompetencë shqyrtimi Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, pranë Ministrisë së Drejtësisë, i cili funksionon në bazë të ligjit për këtë qëllim.

Dhënies së ndihmës për qytetarët i ka shërbyer edhe Memorandumi i Bashkëpunimit që është lidhur midis Institucionit të Avokatit Popullit dhe Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike në Ministrinë e Drejtësisë.

Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me Komisionin Shtetëror të Ndihmës Juridike, gjatë vitit 2014 ka qenë I mirë, por megjithë interesimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ndihma juridike falas për individët e ndryshëm që na janë drejtuar, pas adresimit të problematikës pranë Komisionit, vetëm një numër shumë i pakët ka arritur të marrin ndihmën e nevojshme.

### ***3.4.4. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe civile***

E drejta për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm, konsiston në moskryerjen e veprimeve për ekzekutimin e titujve ekzekutiv nga ana e autoriteteve të ngaruar me ligj sipas parashikimeve të kryera në aktet ligjore dhe nënligjore. E drejta për një proces të rregullt ligjor garantohet në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin sanksionohet mbrojtja e së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe nga neni 6/1 i KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare si dhe GJEDNJ, në vendimmarrjet e tyre, e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë të drejtën e kërimit të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë (titujve ekzekutiv) në një afat të arsyeshëm, pjesë integrale të nenit 6/1 të

Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. GJEDNJ ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Ashtu siç theksohet edhe në dokumente të njohura ndërkombëtare, zbatimi i plotë, efektiv dhe efikas i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është me rëndësi thelbësore për shtetin me qëllim që të krijojnë, forcojnë dhe zhvillojnë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë. Shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet ose vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, ka pranuar për shqyrtim mbi 90 raste, në të cilat ankuesit kanë prezantuar shqetësimin për mosekzekutimin në një afat të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e organeve të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre. Gjatë procesit të shqyrtimit të rasteve, mosekzekutimi në një afat të arsyeshëm të titujve ekzekutiv vjen si rezultat i pengesave të natyrës legjislative dhe praktike, si dhe mosrespektimit nga ana e autoriteteve të ngarkuar me ligj i akteve ligjore dhe nënligjore.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të Administratës Publike në cilësinë e debitorit, institucioni i Avokatit të Popullit gjykon se, vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 451/a të K.Pr.C, si dhe me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, të sanksionuara në K.Pr.A.

Mospasja e fondeve financiare për përmbushjen e detyrimeve në të holla nga organet debitore të administratës publike nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore. Kjo është e mirëpërcaktuar në vendimin e GJEDNJ, viti 2004, në të cilin nënvizohet se: *“Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e një vendimi gjyqësor”*.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara gjatë vitit 2014, me objekt si mw sipwr, Institucioni i Avokatit të Popullit, gjykon se, shkak kryesor i cili ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor është nxjerrja nga ana e Këshillit të Ministrave e Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”*. Duke e gjykuar dhe vlerësuar këtë Udhëzim në kundërshtim me disa parime të Kushtetutës së RSh, i është rekomanduar përkatësisht, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, ndryshimi i tij.

Ndodhur në kushtet e mosreagimit ndaj rekomandimit të dhënë, Institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin e Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011. Gjykimi i kërkesës në fjalë është kryer prej Gjykatës Kushtetuese më datë 20.04.2014, duke u vendosur me këtë rast për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shkronjës “d”, të pikës 7, të Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011. Shfuqizimi tërësisht i Udhëzimit në fjalë është kryer nga Këshilli i Ministrave me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*. Edhe ky Udhëzim, sikurse ai i mëparshmi, mbart problematika, pasi përcaktimi në të nuk vjen në përputhje me parashikimet e kryera në disa dispozita ligjore të cilat përcaktojnë veprimet përmbartimore në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, me objekt detyrimin e institucioneve buxhetore të paguajnë shumën të caktuar në të holla. Për përmirësimin e kësaj situate, Avokati i Popullit do të ndërhyjë pranë Këshillit të Ministrave për rregullimin e saj.

Tjetër pengesë e natyrës legjislative e konstatuar është kuadri ligjor i cili rregullon ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë nga ana e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, i cili vjen në çënim të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Për të mundësuar rregullimin e situatës ligjore, është rekomanduar me shkresën nr. K2/I40-2 Prot, datë 07.02.2013, Ministrinë të Drejtësisë; *“Marrja e nismës për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve të cilat parashikojnë procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit pranë zyrës së përmbartimit”*. Ministria e Drejtësisë<sup>54</sup> në përgjigjen e saj ka deklaruar se do të marrë në analizë rekomandimin në të ardhmen.

Tjetër problematikë e konstatuar është antikushtetshmëria e nenit 45 të Ligjit nr.122/2013, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*. Duke e vlerësuar në kundërshtim me disa nga parimet e sanksionuar në Kushtetutën e RSh, përmbajtjen e dispozitës ligjore të lartpërmendur, institucioni i Avokatit të Popullit ka I rekomanduar<sup>55</sup> Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ministrinë të Drejtësisë: *“Marrjen e nismës për ndryshimin e dispozitës ligjore neni 45 i Ligjit nr.122/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i RSh-së”*. Në përgjigje të rekomandimit, Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.4078 Prot, datë 06.06.2014, shprehet midis të tjerave se: *“...amendimi i Kodit të Procedurës Civile është parashikuar për 4 mujorin e tretë të vitit 2014..”*. Në këtë situatë, Avokati i Popullit ka bërë të mundur ngritjen e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 45 të Ligjit nr.122/2013. Shqyrtimi i kësaj kërkesë është kryer nga Gjykata Kushtetuese më datë 17.02.2015. Në pritje të shpalljes së vendimit nga ana e saj.

Mungesa e përcaktimit të minimumit jetik ka bërë që procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të hasë në vështirësi.

Gjatë vitit 2014, konstatohet se një numër i konsiderueshëm vendimesh gjyqësore civile të formës së prerë, me objekt detyrimin e institucioneve buxhetore të paguajnë shumën të caktuar në të holla ndaj subjekteve, kanë gjetur rrugën e ekzekutimit por pa shkak ende një numër vendimesh gjyqësore civile të dhëna në vite nuk po gjejnë të njëjtën zgjidhje edhe pse Avokati i Popullit ka ndërhyrë pranë autoriteteve të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre.<sup>56</sup>

Tjetër problematikë e hasur jo vetëm në ditën e sotme por edhe gjatë viteve të shkuara është moskryerja prej organeve dhe institucioneve shtetërore e veprimeve sikurse është përcaktuar në Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, të Ministrisë të Financave, *“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”*, neni 62 apo Udhëzimin nr.1, datë 13.06.1997 të Ministrisë të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7. Sipas këtyre akteve përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryej auditimin e gjithë procesit i cili passjell sipas vendimit gjyqësor dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura ka sjell dhe sjell çënim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë. Për detyrimet në të holla të rrjedhura sipas vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë, për të cilat organi shtetëror ka detyrimin e pagimit si detyrim jashtëkontraktor rezulton se, nuk respektohet detyrimi i parashikuar në nenin 20 të Ligjit

<sup>54</sup> Përgjigjia e MD-së nëpërmjet shkresës nr.1072/1 Prot, datë 21.03.2014, drejtuar Avokatit të Popullit.

<sup>55</sup> Shkresën nr. K2/I38-2 Prot, datë 29.09.2014.

<sup>56</sup> Mund të përmendim mosekzekutimin prej Bashkisë Tiranë, të detyrimit për pagimin e kontributit të sigurimeve shoqërore në favor të gjyqituesit E.M., sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë nr. 5410, datë 30.06.2010, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si dhe mosekzekutimin prej Ministrisë së Punëve të Brendshme të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.10006, datë 19.11.2008 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme për të nxjerrë aktin administrativ përkatës të tij për shqyrtimin dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes së 168 familjeve të Fshatit Bicaq, Rrethit Kukës, të cilët kanë mbajtur dhe strehuar familjet kosovare gjatë muajit Prill-Maj të Vitit 1999, sipas listës bashkangjitur Vendimit nr.89, datë 21.06.2005 të Këshillit të Komunës Bicaq”*.

nr.8510, datë 15.07.1999, “Për detyrimet jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Disa nga problematikat e tjera të konstatuara dhe që çenojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, janë:

- 1- Mungesa e cilësisë profesionale e përmbaruesve gjyqësor dhe mosnjohja e ligjit e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
- 2- Kryerje veprimesh jashtë objektit të ekzekutimit si dhe keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor.
- 3- Mungesa e vullnetit prej përmbaruesve gjyqësor për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është vendosur.
- 4- Mosmbështetja e organit të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv me mjete dhe forca nga organet e njësisë së qeverisjes vendore apo qendrore si dhe Policisë së Shtetit.
- 5- Mosreflektim nga ana e ana e organeve eprore të përmbaruesit gjyqësor për dhënie mase disiplinore sa herë që vërehen shkelje të procedurave për ekzekutim, sidomos në ato raste kur gjykata ka vendosur për anulimin e veprimeve përmbarimore.
- 6- Mos sigurimi i zbatimit të njëjtë të praktikave në fushën e veprimtarisë proceduriale të ekzekutimit.
- 7- Shfaqja e veprimeve korruptive prej përmbaruesve gjyqësor. Rasti i marrjes në përgjegjësi penale më datë 19.09.2014 i Kryetares së Zyrës së Përmbarimit, Vlorë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, rast pas rasti, ka ndërhyrë pranë organit përkatës të Administratës Publike, duke rekomanduar, kryerjen ose moskryerjen e veprimeve të caktuara të cilat mundësojnë mbrojtjen e të drejtave, lirive apo interesave të ligjshme të individit. Qëndrimet e mbajtura prej organeve të cilave ju është drejtuar rekomandimi, kërkesa apo propozimi, jo në çdo rast mund të mirëkuptohen. Kjo për faktin se, pa asnjë shkak, një numër i konsiderueshëm organesh, të cilave ju kemi drejtuar rekomandimin, kërkesën apo propozimin, nuk kanë përmbushur dhe nuk përmbushin detyrimin për kthimin e përgjigjeve, duke shkelur në këtë mënyrë detyrimin e parashikuar në nenin 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Po kështu, në një numër të caktuar rastesh, organi të cilit i është drejtuar rekomandimi, kërkesa apo propozimi, është shprehur në parim për pranimin e rekomandimit, kërkesës apo propozimit, por nuk është kryer veprimi përkatës i rekomanduar, kërkuar apo propozuar.

Për situatat e konstatuara në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor apo dhe organeve të tjera të ngarkuara me ligj për kryerje veprimesh të caktuara, nxjerr nevojën e marrjes së masave përkatëse lidhur me shmangien e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për të cilat kemi dhënë rekomandimet konkrete, konkretisht:

- Evidentimi në mënyrë vijuese i detyrimeve të organeve të Administratës Publike, të rrjedhura nga vendime gjyqësore të formës së prerë, si dhe kryerja e veprimeve përkatëse për ekzekutimin e tyre në afatin më të shpejt të mundshëm.
- Identifikimi i pengesave të natyrës legjislative dhe praktike në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
- Ushtrimi prej Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror apo Ministrisë së Drejtësisë për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat, i kompetencave sikurse është parashikuar në nenin 31, dhe 35/dh, të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001: “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor” apo Ligjit 10031, datë

11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, do të rrisë përgjegjshmërinë e përmbartuesve gjyqësor në ushtrimin e funksioneve për ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit midis Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor dhe organeve të tjera si Policia e Shtetit, Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor apo Kombëtar, organet e pushtetit vendor, do të sjell kryerjen e procedurave përmbartimore në një afat të arsyeshëm.

- Përmirësimi i njohurive të përmbartuesve gjyqësorë si dhe nëpunësve përgjegjës të Administratës Publike mbi normat, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si dhe rëndësinë e pasojave të moszekutimit, nëpërmjet organizimit të sesioneve të ndërgjegjësimit me funksionar të institucioneve përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, organizimit të sesioneve të trajnimit për nëpunës të përzgjedhur, duke përfshirë, por pa u kufizuar, të gjyqtarëve, përmbartuesve gjyqësor, punonjësit social dhe përfaqësuesit të ministrive.
- Përkthimi dhe shpërndarja nëpunësve respektiv të vendimeve të dhëna nga GJEDNJ, që lidhen me moszekutimin e vendimeve gjyqësore vendase.

### 3.5. Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës

Avokati i Popullit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rregullimit të marrëdhënieve të punës dhe reformës në Administratën Publike. Në këtë kuadër, Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë një sërë rekomandimesh jo vetëm individuale, por edhe atyre me karakter legjislativ me qëllim ndryshimin e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, në përputhje me standartet ndërkombëtare duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të Administratës Publike.

Në plotësimin e kushteve të aderimit të Shqipërisë në BE, një nga prioritetet bazë mbetet kryerja e hapave thelbësorë, përfshirë ndryshimet në Ligjin “Për nëpunësin civil” dhe forcimin e Departamentit të Administratës Publike me synim rritjen e profesionalizmit dhe depolitizimit të administratës publike, si dhe forcimin e qasjes që emërimet dhe ngritja në detyrë të bazohet në transparencë dhe meritë<sup>57</sup>. Në këtë kontekst, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka dhënë kontributin e tij, për monitorimin dhe parashtrimin e problematikave që ekzistojnë<sup>58</sup>, duke qenë proaktiv edhe në nën-komitete të posaçme “Për reformën në Administratën Publike”, mbi raportimet që ndërmerr Shqipëria në përmbushje të detyrimeve përkatëse.

Ligji Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i cili pësoi disa ndryshime në muajin Dhjetor 2014, është një ligj i cili parashikon një sërë rregullash që synojnë dhe garantojnë qëndrueshmërinë, profesionalizimin, meritokracinë, por edhe karrierën si dhe në zbatim e plotësim të tij janë miratuar edhe 10 akte nënligjore. Pavarësisht këtyre rregullave, mënyra e zbatimit të tyre, ka bërë që të ketë disa problematika në praktikë lidhur me vetë zbatimin e ligjit, veçanërisht, në rastet e njësisve të qeverisjeve vendore. Gjithashtu për pjesën më të madhe të punonjësve në Administratën publike, marrëdhëniet e punës rregullohen edhe me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Sipas dispozitave të këtij kodi, marrëdhënia e punës lidhet për një kohë të caktuar apo të pacaktuar.<sup>59</sup> Kodi, me qëllim krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme të punës, parashikon që “si rregull, që kontrata e punës të lidhet për një periudhë të pacaktuar.”

<sup>57</sup>Shih Progres-Raportin e Shqipërisë për vitin 2014.

<sup>58</sup>Vendimi Nr. 330, datë 28.5.2014 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian 2013”

<sup>59</sup>Neni 140 i Kodit të Punës.

Krahas legjislacioneve të brendshme, marrëdhëniet e punës gjejnë rregullim edhe në një sërë aktesh ndërkombëtare sikundër janë konventat e ILO të ratifikuara nga Shqipëria, si dhe në të njëjtën kohë reflektojnë edhe shumë prej direktivave të BE-së.

Për vitin 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 207 ankesa individuale me objekt largimet e padrejta nga puna, nga të cilat në 50 raste kemi hartuar rekomandime me qëllim rritjen e mëtejshme të efektivitetit dhe në mënyrë të veçantë për gjetjen e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve të çdo organi të Administratës Publike në Shqipëri. Nga 207 ankesat e trajtuara, 130 ankesa kanë përfunduar procesin e shqyrtimit nga ana jonë, prej të cilave 48 e ankesave ose 37% e tyre kanë gjetur një zgjidhje pozitive në favor të individëve. Në trajtimin e rasteve nga institucioni i Avokatit të Popullit me qëllim për identifikimin e problematikave i kemi ndarë në dy grupe sipas rregullimit të marrëdhënieve të punës, nëpunësit e shërbimit civil dhe ata që marrëdhëniet rregullohen me Kodin e Punës.

### **3.5.1. Marrëdhëniet individuale të punës të rregulluara nga Ligji Nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar**

◆ Problematika e evidentuar dhe që shpesh herë është bërë pengesë në punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhet me afatet e ankimimit në rrugë gjyqësore të punonjësve të larguar nga puna. Konkretisht, sipas ligjit “Për Nëpunësin Civil”, lind e drejta që brenda 45 ditëve ankuesit të mund të ndjekin rrugën e ankimimit në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cënon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil. Ky afat shpesh herë është bërë pengesë në kryerjen e hetimit të plotë administrativ nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, pasi institucionet shtetërore kanë kthyer përgjigje pas përfundimit të këtij afati dhe nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentat e kërkuara, duke argumentuar se ankuesi i është drejtuar rrugës gjyqësore.

◆ Problematika e evidentuar nga trajtimi i një grupi ankesash në muajin Prill 2014, lidhet me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas dispozitave ligjore të Kodit të Punës, ndërkohë që ankuesit gëzonin “*Statusin e Nëpunësit Civil*”. Nisur nga kjo problematikë e konstatuar dhe parregullsi në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në analizë<sup>60</sup> të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, rastet e mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, kur pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, ndërkohë që ligji nuk ka parashikuar në asnjë dispozitë të mëtejshme ligjor sesi do të bëhej rregullimi i marrëdhënieve të punës për nëpunësin civil në rast të mungesës së vendeve të lira të punës, dhe veçanërisht edhe për institucionet e pavaruara kur ka një kufizim për shkak se transferimi bëhet vetëm brenda institucionit. Një situatë e ngjashme ishte rregulluar me Ligjin e mëparshëm Nr. 8549 datë 11.11.1999, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku sipas nenit 23 të tij nëpunësi civil gëzonte të drejtat e vendit të tij të mëparshëm deri sa t’i ofrohej një vend tjetër por jo për më tepër se një vit. Në kushtet kur në ligjin e ri kjo dispozitë (lista e pritjes), nuk është e parashikuar, del mëse e nevojshme sqarimi i mëtejshëm i statusit të nëpunësit civil nëse do të konsiderohet lirimi i menjëhershëm nga shërbimi civil si dhe efektet financiare që duhet të përfitojë nëpunësi civil në këtë rast.

Përsa më sipër, nisur nga kjo problematikë e konstatuar në ankesa, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar dhe përcjellë me shkresa zyrtare mendimet për rishikimin dhe plotësimin e dispozitave të nenit 50 të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, kur ka ristrukturime të institucioneve në nivel qendror dhe atyre të pavaruara dhe ka raste të

<sup>60</sup> Neni 50 i Ligjit Nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe V.K.M Nr.171 datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, përzullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”

mungesës së vendeve të lira të punës. Aktualisht me ndryshimet e fundit që ka pësuar Ligji “Për nëpunësin civil”, kjo problematikë ka gjetur një rregullim ligjor.

◆ Problematika e evidentuar nga trajtimi i 35 ankesave ka të bëjë me rritjen e numrit të vendimeve gjyqësore të paekzekutuara, në favor të ish-punonjësve, duke sjellë edhe një rritje të faturës financiare që duhet të përballohet nga buxheti i shtetit. Pavarësisht se në pjesën e dytë të këtij viti, janë ekzekutuar një pjesë e madhe e vendimeve gjyqësore përsa i përket detyrimeve financiare, mbeten problematike përsa i përket ekzekutimit, ato vendime gjyqësore të formës së prerë të cilat vendosin rikthimin në punë të personave në vendin e mëparshëm të punës, në një kohë që këto pozicione mund të jenë suprimuar për shkak të ristrukturimeve<sup>61</sup>.

◆ Gjithashtu, nga trajtimi i disa ankesave kemi konstatuar se vijon të mbetet problematike situata e personave që kanë dalë në listë pritje përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri, ku shumica e tyre kanë fituar të drejtën për t’u rikthyer në vendet e mëparshme të punës dhe të cilat janë në vështirësi për t’u ekzekutuar për shkak të suprimimit ose ristrukturimit të sektorëve përkatës.

◆ Problematikë tjetër e evidentuar mbetet shtrirja e veprimit dhe efekteve të ligjit të ri për “*Nëpunësin Civil*” edhe për punonjësit e njësisve të qeverisjes vendore, efektet e të cilit do të vihen re në momentin kur do të fillojë të zbatohet reforma e re territoriale administrative.

Gjatë punës të kryer për vitin 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson frymën bashkëpunuese me Departamentin e Administratës Publike lidhur me diskutimet dhe marrjen e mendimeve për një sërë çështjesh që lidhen me reformën në Administratën publike, si dhe adresimin e shumë prej problematikave të evidentuara në zbatimin e ligjit “*Për nëpunësin civil*” dhe trajtimin e rasteve që lidhen sa më sipër.

Duke marrë në konsideratë të gjitha problematikat për largimet nga puna, institucioni i Avokatit të Popullit, në muajin Maj 2014, depozitoi pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, një Raport të Veçantë (I), mbi Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës, si dhe në vijimësi hartimin e një raporti të dytë me qëllim përfshirjen e të dhënave dhe problematikën për periudhën Janar-Shtator 2014<sup>62</sup>. Nga informacioni që është përfutur nga 14 ministri për periudhën Janar-Shtator 2014, rezulton se ka një numër total prej 2337 punonjësish të larguar nga Administrata Publike. Nga numri total i punonjësve të larguar, rezulton se 227 prej tyre gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërkohë që pjesa tjetër janë punonjës të cilët trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Nga të dhënat e përcjella për këto ministri, 935 punonjës (*duke përfshirë punonjës që trajtohen me Kod Pune dhe Nëpunës Civil*), janë larguar nga puna në mënyrë të menjëhershme si pasojë e ristrukturimeve të institucioneve. 628 punonjës janë larguar me procedura normale, sipas parashikimeve të sanksionuara në Kodin e Punës, ku janë respektuar afatet e njoftimit për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, apo për shkak të përfundimit të kontratave për ato raste kur ka ekzistuar një kontratë me afat. 79 punonjës rezultojnë të larguar nga puna me dorëheqje, kryesisht për pozicionet e stafeve politike, dhe 468 punonjës janë të larguar me masa të rënda disiplinore.

Nga të dhënat e përcjella lidhur me largimet nga puna, konstatohet se në total rezultojnë 816 raste të largimeve nga puna (duke përfshirë nëpunësit civilë/punonjësit me Kod Pune), të cilët kanë ndjekur procedurën e ankimit gjyqësor pranë Gjykatave Administrative përkatëse.

Mbetet për t’u parë sidomos problematika që do të pasojë pas zbatimit të reformës territoriale administrative e cila për shkak të pakësimit të numrit të njësisve vendore, do të bëjë që një numër i lartë vendesh pune të suprimohen.

<sup>61</sup> Për vitin 2014 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur rreth 35 ankesa të cilët kanë si objekt të ankimit të tyre mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pas largimeve nga puna.

<sup>62</sup> Raport i cili pritet të depozitohet në Kuvend gjatë muajve në vijim.

### 3.5.2. *Marrëdhëniet individuale të punës të rregulluara nga Ligji Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar*

◆ Nga analizimi i Kodit të Punës si pasojë e shtimit të problematikave lidhur me largimet nga puna, kemi gjykuar se një vëmendje të veçantë duhet t’i kushtohet disiplinës në punë. Regjimi juridik i disiplinës në punë të punëmarrësve është pasqyruar në nenin 37 të Ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, ku citohet se: “*Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore*”. Pra, në këtë nen nuk jepet as nocioni dhe as rastet e shkeljeve disiplinore, por i referohet akteve përkatëse (kontratave individuale në punës), të cilat në shumicën e rasteve në asnjë nen të tyre nuk parashikojnë masa të tilla dhe asnjë procedurë përkatëse lidhur me masat disiplinore nga ato më të lehta tek më të rëndat, duke lënë vend për abuzime nga ana e punëdhënësit për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të Kontratës së Punës.

Në ndryshim nga Kodi i Punës, në Ligjin Nr. 152/2013, “*Për Nëpunësin Civil*”, parashikohen dispozita të veçanta mbi masat disiplinore sipas rëndësisë dhe pasojave të shkeljes, duke filluar nga më e lehta e duke kaluar shkallë-shkallë tek më e rënda. Në gjykimin tonë parashikimi i një dispozite të veçantë mbi masat disiplinore, vërejtje me shkrim, vërejtje me paralajmërim është i domosdoshëm pasi këto masa nuk çenojnë drejtpërdrejtë marrëdhënien juridike të punës dhe nuk shkaktojnë ndryshimin e përkohshëm dhe as shuarjen e saj. Për këtë arsye, në kushtet kur e drejta për punë është e lidhur ngushtë me të drejtat e njeriut dhe cënimi i saj nga punëdhënësi me veprime të padrejta, mund të çojë në zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve të punës, kemi rekomanduar rishikimin e dispozitave përkatëse të Kodit Punës lidhur me pjesën e masave disiplinore.<sup>63</sup>

◆ Një problematikë tjetër e konstatuar në pjesën më të madhe të ankesave (80 ankesa)<sup>64</sup>, janë largimet nga puna për shkak të ristrukturimeve të Institucioneve për ndryshim të strukturave organike, kjo në kuadrin e reformave institucionale, për të cilat në 15 raste kemi hartuar edhe rekomandimet përkatëse në ankesa individuale, si dhe për punonjësit e larguar në grup, si për punonjësit që trajtohen sipas Kodit të Punës ashtu edhe për ata që gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Shumë prej institucioneve të Administratës Publike duke e konsideruar shkak të justifikuar ristrukturimit, kanë urdhëruar edhe zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës bazuar në nenet 153/1 të Kodit të Punës. Në gjykim të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe në analizë të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet e punës, në rastin konkret Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës*”, i ndryshuar, në nenet 153 dhe 154 të tij përcaktohet zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës për shkaqe të justifikuara. Në rekomandimet që kemi adresuar, kemi arsyetuar faktin se ristrukturimi dhe shkurtimi i vendit të punës nuk janë shkak i justifikuar sipas dispozitës së sipërcituar, pikërisht për të justifikuar zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

Në një pjesë të rekomandimeve efektet financiare janë pranuar në parim nga organet e administratës publike dhe në disa raste edhe janë alokuar deri në 5 paga mujore për dëmshpërblim të largimeve të padrejta nga puna, por në pjesën tjetër rekomandimet nuk janë pranuar këto efekte për shkak se rastet janë bërë edhe objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatat Administrative kryesisht në Tiranë, por edhe në rrethe.

◆ Problematikë në vijim e konstatuar në 30 ankesa<sup>65</sup> ka të bëjë me mos zbatimin e drejtë të neneve, 143, 144, 145, 155 të Kodit të Punës, në drejtim të ndërprerjes së

<sup>63</sup> Rekomandimi me Nr.201400316 datë 28.04.2014 drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

<sup>64</sup>Në 80 ankesa kemi konstatuar largime nga puna për shkak të ristrukturimit.

<sup>65</sup> Problematikë e konstatuar në rreth 30 ankesa të adresuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.



marrëdhëniet në punë pas përfundimit të afateve të kontratës individuale të punës, por pavarësisht mos-rinovimit të saj me shkrim, ka vijuar ndërprerja e marrëdhëniet të punës.

◆ Problematikë tjetër e evidentuar nga trajtimi i një grupi ankesash nga Avokati i Popullit lidhet me detyrimet e vendosura nga Ministria e Kulturës për çdo punonjës të institucioneve në varësi për lidhjen e kontratave të reja të punës. Pas miratimit të strukturave organike për çdo institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës në muajin Qershor 2014, i është kërkuar lidhja e kontratave të reja të punës me afate të përcaktuara 3 apo 6 mujore deri në një vjeçare, megjithëse ekzistonin kontrata kolektive dhe individuale për këta punonjës dhe ndaj punonjësve që nuk kanë pranuar lidhjen e tyre janë marrë edhe sanksione, sikundër ka qenë moskryerja e pagesës mujore të muajit Qershor 2014. Lidhur me këtë problematikë, nëpërmjet rekomandimeve përkatëse kemi kërkuar zbatimin e drejtë të nenit 175 të Kodit të Punës si dhe zbatimin e procedurave të rregullta ligjore lidhur ç’ka nënkupton se në rast se do të ekzistonte suprimimi i vendit të punës duhet të ndiqej një procedurë ligjore për zgjidhje të njëanshme të kontratës së punës, ndërkohë që në rastin konkret jo vetëm që nuk ka patur shkurtime në organikën e këtij institucioni, por në disa pozicione pune është vijuar kryerja e detyrës funksionale<sup>66</sup>.

◆ Në muajin Prill 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë me iniciativë trajtimin e rastit lidhur me një urdhër të Drejtorive Arsimore, sipas të cilit mësuesit duhet të paraqesin librezën e pagesës së energjisë elektrike në drejtori të shkollës për t’u konfirmuar drejtuesve të tyre se kanë shlyer detyrimet përkatëse në tre muajt e parë të këtij viti. Ata punonjës që kanë fatura të papaguara energjie duhet t’i shlyejnë brenda afatit të caktuar, në të kundërt rrezikojnë të largohen edhe nga puna. Kjo kërkesë vjen në zbatim të Vendimit Nr.01 datë 28.02.2014, të Task Forcës “*Mbi përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike*”<sup>67</sup>.

Duke e konsideruar Furnizimin me energji elektrike një shërbim publik dhe të pavaruar nga marrëdhëniet e punës që rregullohen për çdo punonjës të administratës publike nga legjislacioni në fuqi Kodi i Punës apo Ligji “Për nëpunësin civil”, kemi ndërmarrë një rekomandim “*Për rishikimin e Vendimit të Task Forcës Nr. 1 datë 28.02.2014, ndaj punonjësve të administratës publike lidhur me pagesat e detyrimeve të faturave të energjisë elektrike*”.<sup>68</sup> Lidhur me këtë rekomandim nuk kemi marrë asnjë përgjigje zyrtare nga institucioni përkatës.

Si derivat i urdhërit të mësipërm, në muajin Dhjetor 2014, janë paraqitur një grup ankesash për largime nga puna të cilat lidhen me motivacionin e përdorur kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe OSHEE ndaj punonjësve të cilët rezultojnë debitorë në pagesat e detyrimeve për energjinë elektrike<sup>69</sup>.

Lidhur me këto raste duke gjykuar se mospagesa e energjisë elektrike nuk është parashikuar si shkak ligjor për largim nga puna në asnjë prej legjislacioneve që rregullon marrëdhëniet e punës (*Kodi i punës*), dhe në kushtet kur furnizimi me energji elektrike është një shërbim publik kemi rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për revokimin dhe konstatimin si të pavlefshëm të Urdhërave të largimit nga puna në kundërshtim me gjithë

<sup>66</sup> Lidhur me këtë problematikë kemi ndërmarr rekomandim drejtuar TOB dhe Ministrisë së Kulturës lidhur me: 1. Kryerjen e pagesës për pagat mujore për muajin Qershor 2014, ndaj punonjësve të TOB, duke ju referuar Kodit të Punës mbi pagën dhe ndodhur në kushtet kur nuk ekziston një ndërprerje e marrëdhëniet të punës apo njoftim për mosparaqitje e tyre në punë për këtë periudhë. 2. Marrjen në konsideratë të kontratave të mëparshme të punës jo vetëm kolektive por edhe individuale për ata persona të cilët rezultojnë me një kontratë pune të mëparshme duke parë rast pas rasti edhe detyrat funksionale që kryejnë.

<sup>67</sup> Në pikën 3 të këtij vendimi citohet se: “Ministritë përkatëse për subjektet buxhetore dhe jobuxhetore që mbulojnë në bashkëpunim me Prefektët e Qarqeve të marrin informacion çdo tre muaj mbi pagesën e faturave të energjisë elektrike nga ana e punonjësve të këtyre subjekteve”,

<sup>68</sup> Rekomandimi me Nr. 201401030 datë 06.10.2014, drejtuar Zv.Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, për të cilin nuk disponojmë asnjë përgjigje zyrtare

<sup>69</sup> Lidhur me këtë problematikë në muajin Dhjetor 2014, janë paraqitur 20 ankesa individuale.

dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës. Institucioni i Avokatit të Popullit thekson se është një shkëlqje e të drejtave të punonjësve, pasi zbatimi i një marrëdhënie kontraktuale ashtu siç është dhe ajo me OSHEE-në rregullohet me zbatimin e dispozitave të Kodit të procedurës civile, duke ndërprerë shërbimin si dhe duke kërkuar dëmin në rrugë gjyqësore.

Për këtë arsye në datë 29.12.2014 i kemi rekomanduar institucioneve si Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e për dijeni Ministrisë së Drejtësisë si dhe OSHEE-së revokimin e akteve administrative të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, pavarësisht se kemi të bëjmë me punonjës të cilëve marrëdhëniet e punës ju rregullohen me Kodin e Punës dhe jo pjesë e shërbimit civil.

Institucioni i Avokatit të Popullit nisur nga problematikat e trajtuara më sipër si dhe pavarësisht ndërmarrjes së reformave që po bëhen lidhur me administratën publike, ngritja e databazës për çdo punonjës të administratës publike, rekrutimin e punonjësve në bazë të parimeve të meritokracisë, transparencë, etj, ende konstatojmë se ka nevojë për përmirësime të mëtejshme që do të jenë në fokusin e punës për vitin e ardhshëm.

Gjykojmë se duhet treguar një kujdes i veçantë për rastet e largimeve nga puna lidhur me zbatimin rigoroz të standarteve të vendosura nga kuadri ligjor ekzistues që garanton marrëdhëniet e punës (veçanërisht lidhur me efektet financiare), për zgjidhjen e kontratës individuale të punës në mënyrë të njëanshme, të menjëhershme dhe të pajustificuar, me qëllim shmangien e rritjes së mëtejshme të faturës financiare në rastet e largimeve të paligjshme nga puna.

### **3.6. E drejta e sigurimeve shoqërore**

E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në pikën 1 të nenit 52, ka përcaktuar se: “Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”. Legjislacioni aktual u jep të drejtën e personave për të përfituar nga ky sistem, me Ligjin Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Më datë 31.07.2014 u miratua Ligji nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Sipas këtij ligji sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga: a) sigurimet shoqërore të detyrueshme; b) sigurimi shoqëror vullnetar; c) sigurimi shoqëror suplementar; ç) pensionet shtetërore të posaçme; d) pensionet sociale; dh) fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar.”.

Për të gjithë shtetasit që dalin në pension pleqërie pas datës 01.01.2015, llogaritja e masës së pensionit të pleqërisë do të bëhet me formulën e re, bazuar në kontributet e derdhura në vite dhe pagën mbi të cilën paguhen kontributet. Ky ligj heq pensionin tavan, minimal dhe atë maksimal, impakt motivues për të gjithë ata që derdhin kontribute të larta. Gradualisht do të unifikohet kontributi për zonat rurale me ato urbane deri në vitin 2018. Moshja e pensionit u rrit për gratë me dy muaj në vit për tu barazuar me burrat në moshën 67 vjeç në vitin 2056. Ndërsa mosha e daljes në pension për burrat pas vitit 2032 do të rritet me një muaj në vit dhe barazohet me gratë në vitin 2056, në moshën 67 vjeç. Për të gjithë shtetasit, të cilët nuk plotësojnë kushtet për të përfituar pension pleqërie, me moshë 70 vjeç dhe rezidentë në Shqipëri pesë vite të fundit, përfitojnë pension social.

Lidhur me problematikat në këtë fushë, gjatë këtij viti pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë adresuar dhe trajtuar 101 ankesa. Kanë përfunduar shqyrtimin 74 ankesa, nga të cilat kanë rezultuar: 38 ankesa të pabazuara, 22 të zgjidhura në favor të ankuesve, 2 ankues kanë hequr dorë nga ankesa e tyre, 11 rekomandime të pranuar, 1 rekomandim i papranuar.

Janë në proces shqyrtimi 27 ankesa. Kryesisht ankesat për fushën e sigurimeve shoqërore kanë qenë për moslllogaritje të drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, për uljen e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë, për kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, për mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, për mosvënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit etj.

Pavarësisht përfitimit të shtesave të bëra në vite sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, bazuar në vjetërsinë e tyre të punës, ankuesit kanë pretenduar se masa e tyre e pensionit është e vogël dhe kanë kërkuar rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë. Institucioni ynë, pas shqyrtimit të rasteve i ka rekomanduar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, rillogaritje të masës së pensionit të pleqërisë. Rekomandimet tona janë marrë në konsideratë, duke u bërë rillogaritjet e pensionit dhe ankuesit kanë përfituar rritje të masës së pensionit dhe kanë marrë edhe diferencat përkatëse.<sup>70</sup>

Për të ndjekur rrugën e ankimit administrativ dhe atë gjyqësor, shtetasit kanë kërkuar pranë drejtorive rajonale kopje të dokumentave të dosjes së tyre të pensionit, por nga shqyrtimi i Institucionit të Avokatit të Popullit rezultonte se ata nuk kishin marrë asnjë përgjigje. Pas ndërhyrjeve tona institucionale me anë të rekomandimeve, ankuesve ju është bërë e mundur pajisja me dokumentat e kërkuara<sup>71</sup>.

Një problematikë tjetër që është evidentuar nga trajtimi i ankesave, është mungesa e përgjigjes brenda afateve ligjore në rastet e shqyrtimit të ankimit administrativ nga Komisionet e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe atë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Për këtë arsye i jemi drejtuar Komisioneve përkatëse me qëllim vënien në dispozicion të vendimit administrativ. Me ardhjen e përgjigjes së tyre, kemi informuar ankuesit, duke i pajisur me vendimin përkatës të marrë nga komisioni i ankimit.<sup>72</sup>

Për mosnjohjen e viteve të punës gjatë vuajtjes së dënimit me burg për të dënuarit jopolitikë, ordinerë, ka rezultuar se nuk ka asnjë akt specifik normativ që të rregullojë situatën e kësaj kategorie. Në kushtet që këta shtetas kanë qenë të privuar nga liria, nuk kanë patur mundësinë që të plotësojnë vitet e punës. Kanë kryer punë të papaguar në vitet e vuajtjes së dënimit me burg dhe pavarësisht se me punën e tyre kanë kontribuar në dobi të shoqërisë, kjo punë nuk i konsiderohet si kontribut për të përfituar të drejtën e pensionit të pleqërisë. Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Ministrin të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, marrjen e iniciativës ligjore për njohjen e viteve të punës së bërë gjatë vuajtjes së dënimit me burg për të dënuarit jopolitike, ordinerë. Për të siguruar mbrojtjen e këtyre personave, të cilët nuk kanë plotësuar kohën e nevojshme për pension pleqërie, në ligjin e ri të sigurimeve shoqërore është parashikuar trajtimi i tyre me pension social.

Nga trajtimi i ankesave gjatë këtij viti, kemi konstatuar se, pavarësisht se sistemi publik i sigurimeve shoqërore ka ardhur duke u reformuar, mbeten ende të pazgjidhura një sërë çështjesh, të cilat janë raportuar dhe rekomanduar edhe në raportet e viteve të kaluara.

*- Çështja e masës së ulët të pensioneve të pleqërisë, për kategorinë e pensionistëve që kanë dalë në pension të parakohshëm në periudhën 1993-1995.*

Institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite ka adresuar çështjen e masës së ulët të pensioneve të pleqërisë për këtë kategori, me qëllim bërjen e ndryshimeve të nevojshme

<sup>70</sup> Doculive:nr. 20141552, rekomandimi datë 17.09.2014 (DRSSH-Tiranë) Nr.201400492, Rekomandimi datë 07.04.2011 (DRSSH-Tiranë), nr.201400553, Rekomandim datë 07.04.2014 (DRSSH-Durrës), nr.201400589, rekomandimi datë 10.04.2014 (DRSSH-Tiranë).

<sup>71</sup> Doculive nr. 201400032, rekomandimi datë 21.01.2014 (DRSSH-Fier), nr.201400650, rekomandimi datë 17.04.2014 (DRSSH-Durrës), nr.201401746, rekomandimi datë 11.12.2014 (DRSSH-Kukës)

<sup>72</sup> Doculive nr. 201400942, 2014001235

ligjore për të ndryshuar kushtet e daljes në pension të grupit të pensionistëve që kanë dalë në pension në periudhën 01.01.1994 – 31.12.1995.

Në përgjigje të nismës sonë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përgatiti një projekt-vendim të Këshillit të Ministrave “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve të punonjësve buxhetorë të caktuara gjatë vitit 1993-1994”. Por nga Ministria e Financave u përcaktua se ky projekt vendim do të shqyrtohej në një moment të dytë për shkak të efekteve financiare të larta. Në vijimësi të ndjekjes së këtij problemi, në vitin 2014 kërkua informacion pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave. Duke qenë se nga Ministria e Financave u informuam se aktualisht nuk kishin një projekt-akt të propozuar për këtë qëllim, iu drejtua Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëse ishte propozuar projekt-vendimi i sipërcituar për të cilën mbetemi ende në pritje.

*- Çështja e uljes së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionit suplementar.*

Duke marrë në konsideratë se çështja e pensioneve të parakohshme të ushtarakëve mbetet ende një problem shqetësues pas ndryshimeve të ligjit nr. 10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2014 e ka vazhduar trajtimin e kësaj çështje. Duke qenë se gjatë vitit 2014 kemi patur ankesa lidhur me uljen e masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë, kemi vijuar ndërhyrjen tonë institucionale pranë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Nga ana e Ministrisë së Financave, u informuam se në dijeninë e tyre, nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është ngritur një grup pune, i cili po rishikon të gjithë paketën ligjore të lidhur me pensionet suplementare dhe trajtimet e veçanta. Ndërsa nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, na u kthye përgjigje se me gjithë përpjekjet e bëra për shqyrtimin dhe diskutimin e këtij problemi me institucionet përkatëse, rezultoi se nisur nga situata aktuale buxhetore dhe financiare, marrja në konsideratë e këtij problemi do të shqyrtohet në një moment më të përshtatshëm, pasi aktualisht shoqërohet me efekte të konsiderueshme financiare në buxhetin e shtetit. Por pavarësisht kësaj, kjo çështje do të ndiqet në vazhdimësi.

*- Mospërfitim i rritjes së masës së pensionit të pleqërisë për kategorinë e pensionistëve, që e drejta e pensionit u ka lindur në periudhën 01.04.1996-31.04.1996.*

Ndër vite, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar çështjen për masën e pensionit të pleqërisë për kategorinë e personave që u ka lindur e drejta gjatë periudhës 1 – 31 prill 2006. Që në vitin 2009 i jemi drejtuar me rekomandim ish Ministrit të Financave, për ndryshim të gërmës “dh”, të pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003 “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve” si dhe të tabelës “C.f”. Ministria e Financave na vuri në dijeni se kishte kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të paraqiste shpjegimet përkatëse për këtë çështje si dhe propozimet lidhur me rekomandimin tonë. Duke qenë se kjo çështje ende ka mbetur pa u zgjidhur, nisur nga ankesa e bërë gjatë këtij viti, i jemi drejtuar përsëri me rekomandim Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë por që është ende pa përgjigje.

*- Mospërfitim të rritjes së masës së shpërblimit të pensionistëve që gëzojnë statusin e veteranit të Luftës Anifashiste Nacional-Çlirimtare.*

Gjithashtu kjo është një çështje, të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë duke adresuar më datë 23.12.2013 një rekomandim drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë: Për caktimin e organit kompetent, i cili të propozojë në vijimësi projekt-vendimet për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të luftës; Për paraqitjen dhe miratimin sa më të shpejtë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të Ligjit Nr.7874 datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-

Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, për rritjen e shpërblimit të veteranëve të luftës. Në përgjigje të këtij rekomandimi, më datë 16.06.2014, u vumë në dijeni se në kushtet kur kjo e drejtë e ligjshme e tyre nuk ka gjetur zgjidhje, është sugjeruar ngritja e një grupi pune të përbashkët me përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave, i cili të analizojë dhe të rekomandojë zgjidhjen dhe në përfundim të përgatisë projektvendimin përkatës për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, i cili si një detyrim ligjor do të iniciohet nga ministri i linjës dhe do të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave. Aktualisht i jemi drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes nëse është marrë iniciativa për nxjerrjen e akteve nënligjore për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të luftës. Jemi në pritje të përgjigjes.

**Rekomandimet kryesore të cilat dalin si rezultat i problematikave të paraqitura më sipër për përmirësimin e të drejtës së sigurimeve shoqërore, si më poshtë<sup>73</sup>:**

1. Pavarësisht ndryshimeve ligjore të bëra me Ligjin nr.104/2014, në dispozitat e të cilit janë parashikuar llogaritja e masës së pensionit të pleqërisë bazuar mbi pensionin social dhe parimin kontributiv, kemi sugjeruar se pensioni social nuk ka pse të merret në konsideratë në llogaritjen e pensionit mujor të pleqërisë, pasi ai pension është vetëm për kategorinë e personave që nuk kanë arritur periudhën minimale të sigurimit dhe nuk përfitojnë asnjë lloj pensioni. Për më tepër që ende nuk kemi të deklaruar minimumin jetik, që më pas mbi bazën e saj të kemi edhe llogaritjet përkatëse.

2. Avokati i Popullit gjykon se, pavarësisht se u është dhënë e drejta e përfitimit të pensionit social personave që kanë vuajtur dënimin me burg dhe nuk plotësojnë periudhën minimale të vjetërsisë në punë sipas Ligjit nr.7703 datë 11.05.2003 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka ish të dënuar ordinerë, të cilët nuk kanë arritur moshën e përcaktuar ligjore, 70 vjeç. Mospërfitimi i kësaj të drejte, u sjell pasoja shumë të rënda në jetën e tyre të përditshme, pasi shumë prej tyre janë të sëmurë, pa familje, pa të ardhura ekonomike dhe e ndjejnë veten të diskriminuar nga pjesa tjetër e shoqërisë.

3. Duke qenë se personi që përfiton pension social duhet të jetë i moshës 70 vjeç dhe të jetë me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, të paktën për pesë vitet e fundit, kemi rekomanduar:

- që pensioni social të jetë një përfitim që t’i jepet çdo shtetasi shqiptar edhe pse nuk ka 5 vjet qëndrimi të përhershëm në Shqipëri dhe nuk përfiton të ardhura nga shtetet ku ata kanë punuar (për ata persona të cilët kanë qenë emigrantë).

- rritjen graduale të moshës për të përfituar pension social, pasi në këtë periudhë tranzicioni shumë shtetas shqiptar kanë qenë të papunë dhe nuk kanë paguar kontribute, duke i shtuar edhe faktin e pamundësisë financiare për t’u siguruar vullnetarisht. Prandaj ajo kategori personash që mbushin moshën ligjore sipas ligjit të sigurimeve shoqërore për të përfituar pension pleqërie, do të mbeteshin pa asnjë të ardhur deri në moshën e përcaktuar në këtë ligj.

4. Duke qenë se me ndryshimet ligjore, nuk u parashikua asnjë përmirësim i nenit 62, lidhur me të drejtën për përfitimet, rekomandojmë rishikim të këtij neni.

5. Rritjen e masave të pensioneve, të kategorisë së pensionistëve, që kanë dalë në pension të parakohshëm në periudhën 1993-1995, të veteranëve të luftës antifashiste nacional-çlirimtare dhe të kategorisë së pensionistëve, që e drejta e lindjes për pension pleqërie u ka lindur në periudhën 01.04.1996-31.04.1996

6. Përmirësimet ligjore për rregullimin e situatës së përfituesve të pensioneve të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

<sup>73</sup> Këto rekomandime do të adresohen në vazhdimësi nga Institucioni i Avokatit të Popullit drejtuar Institucioneve përkatëse, të cilat janë bërë prezente dhe në takimet e përbashkëta BE- Qeveria shqiptare për zbatimin e 5 prioritetëve, gjatë muajit shtator 2014

### 3.7. E drejta për kujdes shëndetësor

Çdo njeri qoftë grua, burrë, i ri, e re dhe fëmijë ka të drejtë të ketë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor, pa asnjë lloj diskriminimi me bazë gjinie, moshe, aftësie, etnie, race apo orientimi seksual. Gëzimin e së drejtës për të qënë i/e shëndetshme është jetike për të gjitha aspektet e jetës dhe mirëqenies së një personi, dhe është thelbësore për realizimin e shumë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. E drejta për shëndet përfshin aksesin për kujdes shëndetësor cilësor që ofrohet në kohë, e pranueshme dhe e përbalueshme ekonomikisht<sup>74</sup>.

Shërbimi shëndetësor duhet të jetë *i disponueshëm* me numër të mjaftueshëm qendrash shëndetësore dhe ambulanca funksionale, spitale etj, *i arritshëm* për të gjithë në aspektin e jo-diskriminimit dhe fizikisht i arritshëm për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, personat e moshuar dhe grupeve të tjera vulnerable; *i pranueshëm* në aspektin e etikës mjekësore, si dhe i hapur ndaj ndryshimeve kulturore dhe gjinore; me *cilësi të mirë* ku përfshihen staf shëndetësor të trajnuar, të miratuar shkencërisht dhe pajisje e medikamente cilësore si dhe, higjienë të përshtatshme dhe ujë të pijshëm të sigurt.<sup>75</sup>

Përkufizimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për shëndetin është se: “Shëndeti është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjesht mungesa e sëmundjeve apo e pa fuqisë fizike të organizmit”<sup>76</sup>. Gjatë jetës së përditshme njerëzit i referohen herë pas here një apo disa komponentëve të shëndetit të tyre në situata dhe në kontekste të ndryshme, duke e konsideruar atë (shëndetin) si kapitalin më të çmuar në jetës. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit shëndetësor në Shqipëri. Kujdesi shëndetësor ofrohet në tre nivele: parësor, dytësor dhe terciar.

Funksionimi i Kujdesit Shëndetësor Parësor rregullohet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.10138 datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, Ligji nr.7870 datë 13.10 1994 “Per sigurimet shendetësore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjin nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.8092, datë 21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”, Ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore ne Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 neni 97, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” etj. Konventa e Këshillit të Europës “Për të drejtat e njeriut dhe biomjeksionë” (ratifikuar me ligj Nr. 10339, datë 28.10.2010), Konventa kuadër e Organizatës Botërore të Shëndetësisë "Për kontrollin e duhanit"<sup>77</sup>, Konventa e ILO në lidhje me “Sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës” (ratifikuar me ligj Nr. 9147, datë 30.10.2003), Konventa e ILO në lidhje me “Sigurimin dhe shëndetin në miniera”<sup>78</sup>, Konventa Ndërkombëtare e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Kombet e Bashkuara, 1965. Ligji nr. 7580 datë 29.07.1994 “Kodi Civil” etj.

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 63 ankesa në fushën e shëndetësisë në përgjithësi. Kryesisht kanë qënë ankesa me objekt trajtimi mjekësor i pakujdesshëm, kërkesa për kurim jashtë vendit, ankesa për procedurën e konkursit për specializantët e universitetit të mjeksisë, etj. Nga numri i ankesave të marra në total për 60 ankesa ka përfunduar shqyrtimi ndërsa 3 të tjera janë në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 45 ankesa janë zgjidhur në favor të qytetarit dhe 18 ankesa si të pabazuara.

<sup>74</sup> E drejta për shëndetin. Fact sheet N° 323. Rishikuar nëntor 2013. Organizata Botërore e Shëndetit.

<sup>75</sup> Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, General Comment No.14 (2000).

<sup>76</sup> Andrija Stampar, Presidenti i Parë i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 1946.

<sup>77</sup> Ratifikuar me ligj Nr. 9474, datë 9.2.2006.

<sup>78</sup> Ratifikuar me ligj Nr. 8938, datë 12.9.2002.

***Vështrim i përgjithshëm i problematikave të konstatuara në sistemin shëndetësor dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës:***

- Një çështje e cila paraqitet problematike është infrastruktura e disa prej godinave ku ushtrojnë aktivitetin spitalet rajonale më së shumti. Pajisjet hotelerike (*krevate, komodina, detergjentë etj*) janë në shumë spitale në gjendje të amortizuar ose me cilësi të dobët prokurimi. Në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe standartet e mjediseve të qendrave shëndetësore është i nevojshëm rehabilitimi i godinës ku përfshihet aksesimi në godinë dhe komoditetet e brendshme. Kështu, çdo qendër shëndetësore duhet të ketë në mënyrë standarte: furnizim i vazhdueshëm me energji elektrike dhe ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë.
- Gjithashtu problematike mbetet furnizimi me medikamente kryesisht në QSUT, Tiranë për shkak të fluksit nga e gjithë Shqipëria. E njëjta situatë paraqitet edhe lidhur me pajisjet me aparatura bashkëkohore në spitale dhe qendra shëndetësore.
- Mungesa e një qendre të veçantë “Urgjencë Kombëtare në Tiranë”, me përbërje të institucioneve të ndryshme qëndrore dhe lokale kërkon ngritjen sa më të shpejtë të saj.
- Mungesa e mjekëve specialist në spitale të zonës veriore kryesisht ç’ka sjell fluks të pacientëve drejt kryeqytetit. Hartimi i protokolleve mjeksore të miratuara dhe të zbatueshme nga uniformat e bardha. Shtimi i numrit të mjekëve, infermiereve dhe psikologëve apo punonjësve social, në spitale ku është i nevojshëm rritja e numrit të tyre.
- Mitmarrja në sistemin shëndetësor si një gangrenë në rritje dhe me pasoja jetësore ndaj pacientëve.
- Problematike paraqitet edhe identifikimi i familjeve të ngujuara nga gjakmarrja dhe ofrimi me prioritet i shërbimit shëndetësor në këto familje.

Lidhur me problematikën sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar “Raportin e Veçantë për Situatën e Spitaleve”, dërguar Kuvendit të Shqipërisë në Janar të vitit 2014 dhe që është një ndër raportet që është diskutuar në Nënkomisionin e çështjeve sociale dhe të shëndetësisë në muajin dhjetor 2014.

Institucioni i Avokatit të Popullit evidenton dallime të mëdha në cilësinë dhe nivelin e trajtimit dhe kujdesit që ofrohet në varësi të vendit ku jetojnë pacientët, zona urbane në krahasim me zonat rurale si dhe varet nga kualifikimi, aftësitë dhe motivimi i personelit të punësuar në çdo qendër shëndetësore. Aksesimi ndaj Qendrave Shëndetësore mund të jetë i vështirë për shumë njëzëz për shkak të terrenit dhe zonës në të cilën jetojnë, ndërsa aksesimi në ndërtesën e Qendrës Shëndetësore duket pengues për personat me aftësi të kufizuara fizike, të moshuarit ose nënat me foshnje. Për këtë rekomandojmë të sigurohet që çdo Qendër Shëndetësore të ketë një sistem për urgjencat dhe për kontaktimin e personelit shëndetësor jashtë orarit të punës në rastet e urgjencave. Kështu, qendrat shëndetësore duhet të kenë turne nate të gatshëm për të pritur urgjencat. Kjo siguron një sistem proaktiv si dhe ndihmon personelin shëndetësor të jenë pushim pas orarit të punës në rastet kur nuk është në turn.

Mungesa e një niveli standartizimi ose garantimi të cilësisë ose kujdesit për të gjithë, dhe nëse një pacient ka aftësi të kufizuara apo një gjendje shëndetësore kronike që nuk kategorizohet ndër gjendjet mjeksore të lehta për t’u trajtuar. Për këtë arsye institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon vendosjen e një autoambulance në zonat rurale e pajisur me stafin shëndetësor të duhur për të bërë transportimin e pacientëve nga familja në Qendrën Shëndetësore ose në Spitalin e qytetit. Kjo do të ndihmonte mes të tjerash të zvogëlonte stresin e gjetjes së një automjeti për transportim të pacientit në rast urgjence si dhe paratë për transportin.

Ndonëse Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar udhëzues dhe protokollë se si shërbimi shëndetësor në kujdesin parësor, duhet të standartizojë trajtimin për grupe të caktuara

pacientësh, të tillë si: trajtimi në raste urgjencash, të moshuarit dhe sëmundjet kronike dhe akute, mungesa e protokollit për planifikimin familjar cënon orjentimin e shërbimit shëndetësor cilësor dhe efektiv për të gjithë. Shërbimi shëndetësor në kujdesin parësor është kryesisht reagues dhe ofron shumë pak shërbime parandalimi ose ndërgjegjësim në mënyrë të rregullt. Për këtë arsye rekomandohet që çdo Qendër Shëndetësore duhet të ketë një program aktiv ndërgjegjësimi mbi shëndetin ku të përfshihen fletëpalosje, postera dhe sesione informuese për grupe të ndryshme homogjene.

Fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit mbi 66 vjeç, gratë në moshë të mesme dhe ato viktime të dhunës në familje, personat me HIV/AIDS pozitiv, ata me probleme të shëndetit mendor si dhe anëtarët e komunitetit LGBTI ka më shumë gjasa të marrin shërbim më pak cilësor krahasuar me një të rritur të shëndetshëm. Egziston një nivel i caktuar diskriminimi midis anëtarëve të stafit shëndetësor, veçanërisht ndaj atyre të perceptuar si të ndryshëm, të tillë si personat me HIV/AIDS ose nga komuniteti LGBTI. Egziston nevoja për ndërtimin e kapaciteteve dhe trainimin e personelit shëndetësor për të punuar në mënyrë më efektive dhe për të ofruar shërbim cilësor për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e familjes, anëtarët e Komunitetit Rom, pacientë me HIV/AIDS, si dhe pjesëtarë të Komunitetit LGBTI. Çdo Qendër Shëndetësore duhet të ketë udhëzues dhe protokolle të shkruara në lidhje me kujdesin në rast urgjence; mbrojtjen e fëmijëve; dhunën në familje; konfidencialitetin dhe si të ofrojnë shërbime cilësore dhe mos-diskriminuese për anëtarët e Komunitetit Rom dhe komunitetit LGBTI në mënyrë që çdo Qendër Shëndetësore të jetë mirëpritëse për çdo person.

Drejtoria Rajonale e Shëndetit duhet të inspektojë në mënyrë të rregullt Qendrat Shëndetësore dhe të monitorojë performancën dhe praktikën e personelit shëndetësor me pacientë dhe grupe të ndryshme pacientësh. Nëse vihen re mungesa në njohuri ose problem në cilësi, atëherë personelit shëndetësor u ofrohen trainime për ngritje kapacitetesh.

Përmirësimi nivelit të ndërgjegjësimit dhe njohurive të personelit shëndetësor mbi dhunën ndaj fëmijëve dhe të rriturve të ardhshëm. Trainimi personelit shëndetësor dhe zhvillimi procedurave koordinuese për mbrojtjen e fëmijëve në çdo qendër shëndetësore ku përcaktohen detyrat e çdo anëtari të stafit shëndetësor për raportimin e rasteve të dyshuara për dhunë ndaj fëmijëve te Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve ose Njësitë për të Drejtat e Fëmijëve në nivel Qarku si dhe në polici<sup>79</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar në datë 06.02.2014, Ministrisë së Shëndetësisë se kjo e fundit duhet të luajë një rol më të madh pozitiv për familjet e ngujuara për shkak të gjakmarrjes, për përmirësimin e përkujdesjes shoqërore që t'u sigurohet shërbim shëndetësor cilësor për të gjitha kategoritë, si të rritur ashtu edhe fëmijë. Ky shërbim duhet të ndikojë për mirëdukim të brezit të ri me frymën e tolerancës, jo dhunës, pranimin e diversitetit, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Trajnimi i mjekëve të zonave ku është e përhapur gjakmarrja është i rëndësishëm dhe duhet të jetë prioritet i politikave të kësaj ministrie.

Mbështetja që shteti duhet t'i japi këtyre personave me HIV/AIDS nuk duhet të jetë largimi, refuzimi dhe izolimi nga shoqëria, pasi këto element kërcënojnë shpresën dhe mirqënien e tyre. Mbështetja duhet të jetë profesionale, morale dhe njerëzore duke i përkrahur dhe trajtuar me dinjitet. Avokati i Popullit në trajtimin e ankesës së një personi me HIV/AIDS, të cilit i refuzohej trajtimi mjekësor, i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë ofrimin e trajtimit mjekësor në mënyrë profesionale dhe dinjitoze.

Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, ka si qëllim sensibilizimin e punonjësve të administratës, duke e bërë atë të kuptojë rolin e tyre të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të përqëndrohet te arsyeja e vërtetë e ekzistencës së tyre, jo si pronarë dorështrënguar të të

<sup>79</sup> Te gjitha konkluzionet e mësipërme kanë dalë nga "Studimi mbi Shërbimin Shëndetësor në Shqipëri (Raport kërkimor për Av.Popullit dhe "Partnerët për Fëmijë". (The Danish Neighbourhood).



drejtave të qytetarëve, por si shërbetorë të paguar për ofrimin e shërbimeve dhe respektimin e të drejtave të tyre.

### 3.8. E drejta për arsimim

E drejta për arsim është një e drejtë e njeriut e njohur universalisht në të drejtën ndërkombëtare. Edhe pse një e drejtë në vetvete, ajo është mundësuese e të drejtave të tjera, nxit fuqizimin, aksesin ndaj informacionit, rritjen ekonomike, kreativitetin, dhe të kuptuarin midis popujve dhe kombeve.<sup>80</sup> E drejta për arsimim mishërohet në një sërë traktatesh ndërkombëtare, të tilla Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, UNESCO Konventa kundër Diskriminimit në Arsim (1960) Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti Përgjithshëm N.11 (neni 14 Plani i Veprimit për Arsimin Bazë)<sup>81</sup>.

Gjithashtu e drejta e arsimit parashikohet në legjislacionin e brendshëm, në Kushtetutën e RSh-së, Ligjin Nr 69/2012, datë 21.06.2012 “Për Arsimin Parauniversitar”, Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë nr.9741 dt.21.05.2007, ndryshuar me ligjin nr.10 207 dt.21.07.2010.

Gjatë vitit 2014, institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 86 ankesa në fushën e arsimit në përgjithësi. Objekt i këtyre ankesave kanë qënë kryesisht zvarritje e procedurave për transferime studimesh, mungesë informacioni nga punonjësit e universiteteve dhe punonjësve të administratës, transferime të mësuesve në rrethe apo ndërprerje e kontratave të punës si mësues jashtë profili etj. Nga numri i ankesave të marra në total, për 80 ankesa ka përfunduar shqyrtimi dhe 6 janë ende në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 49 ankesa janë të zgjidhura pozitivisht dhe 16 ankesa të pabazuara, ndërkohë që për 15 raste të tjera kanë qënë objekt shqyrtimi me iniciativë e institucionit të Avokatit të Popullit.

Problematikë tjetër për vitin 2014 janë edhe ankesat me objekt “Transferimin e studimeve për studentët që u prekën nga VKM nr.539, dt.06.08.2014 “Për heqjen e licensës disa institucioneve private të arsimit të lartë”. Mungesa e teksteve shkollore në muajin Shtator 2014 për komunitete dhe minoritete të caktuara si komuniteti maqedonas apo minoriteti grek në Gjirokastër kanë qënë objekt shqyrtimi nga ana jonë. Problematikë tjetër ishin grupi i mjekëve aplikantë për vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata. Objekt i këtij ankimi është rregullorja e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjeksisë, në Universitetin e Mjeksisë, Tiranë.

*Një vështrim i përgjithshëm i problematikave të konstatuara në sistemin arsimor si vijon:*

Niveli dhe cilësia e burimeve mësimore është bazike dhe nuk siguron komponentët thelbësore të një mjedisi cilësor ose angazhues të të mësuarit. Mësimi kryhet nëpërmjet përdorimit të librave dhe ushtrimeve që fëmijët në përgjithësi u duhet t’i mësojnë përmendësh në vend që të jenë të tilla që të nxisin bashkëveprim dhe analizim të tyre. Shumë nga librat shihen si të rënduara me pjesë teorike dhe jo relevante në botën e sotme apo për tregun e punës që në të vërtetë kërkon më shumë individë që kanë të zhvilluar aftësitë e tyre analitike dhe të menduarin fleksibël. Shkenca, muzika dhe sporti u mësohen kryesisht teorikisht fëmijëve në vend të të mësuarit përmes të të praktikuarit të tyre e cila do të ndihmontë fëmijët që t’i kuptonin më mirë përmes ushtrimeve praktike. Shumë pak rëndësi i jepet lëndëve

<sup>80</sup> The factsheet on 10 Human Rights Standards for Education Privatisation by the Right to Education Project (RTE); <http://www.right-to-education.org>

<sup>81</sup> <http://www.ohchr.org/en/issues/education/sreducation/pages/internationalstandards.aspx>

krijuese të tilla si arti, drama, të kënduarit apo kërcimit, të cilat do të ndikonin në zhvillimin dhe në të mësuarin e terësishëm të çdo fëmije.

Për këtë arsye Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon ndërtimin e një sistemi efikas dhe gjithëpërfshirës të arsimit për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, duke aftësuar qytetarët për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për pjesëmarrje aktive në jetën demokratike.

Zhvillimi i kapacitetit për avancimin e sistemit të arsimit, arrihet përmes ofrimit të shërbimeve dhe burimeve të cilësisë së lartë, si dhe përmes bashkëpunimit aktiv me të gjitha palët me interes në vend dhe jashtë tij. Niveli i përfshirjes së prindërve në shkolla është shumë i ulët, shumë nga prindërit nuk janë në dijeni të programeve shkollore, ekzistencës së bordit të prindërve ose mbi mënyrën sesi fëmijët e tyre përmes mjedisit mësimor duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre mësimore. Shkolla duhet të hapë dyert e saj dhe të rrisë qasjen ndaj prindërve në mënyre që të rrisë pjesëmarrjen e tyre në planifikim, buxhet dhe procesin e vendimarrjes që përfshin mësimet, aktivitetet ekstrakurrikulare, kujdesin familjar, cilësinë e shërbimit arsimor që ju ofrohet fëmijëve.

Fëmijët që jetojnë në zonat rurale në krahasim me ata që jetojnë në zonat urbane u duhet të përshkruajnë distanca më të gjata në këmbë për të shkuar në shkollë; të braktisin shkollën për të përmbushur angazhimet e tyre në punë me qëllim mbështetjen me të adhura të familjeve të tyre si dhe të përballen me pritshmëritë e ulta që mësuesit/et kanë për këta fëmijë në lidhje me atë se çfarë këta fëmijë mund të arrijnë nga ana akademike. Ekziston legjislacioni që i detyron njësitë e qeverisjes vendore që t'u sigurojnë transport falas për të gjithë fëmijët që ndjekin arsimin fillor dhe që jetojnë mbi 2 km larg shkollës, dhe për të gjithë fëmijët që ndjekin arsimin nëntëvjeçar që jetojnë mbi 5 km larg shkollës. Megjithëse ekziston ky ligj, autoritetet e qeverisjes vendore vazhdojnë të neglizhojnë sigurimin e transportit të fëmijëve për në shkollë, duke u justifikuar që nuk kanë fonde (ose për shkak të infrastrukturës së keqe rrugore) për ta përmbushur një gjë të tillë, gjë që çon që jo çdo fëmijë të ketë akses në shkollë edhe pse kjo është një e drejtë e tyre legjitime.

Për këtë rekomandohet që njësitë e qeverisjes vendore duhet të detyrohen për të vlerësuar numrin e fëmijëve që kanë nevojë për transport për në shkollë dhe të përfshijnë brenda buxhetit të tyre vjetor një alokim fondi që të mbulojë kostot e transportit të fëmijëve në shkollë dhe veçanërisht kjo në zonat rurale, ku distancat dhe infrastruktura e dobët e bëjnë të domosdoshme transportin e fëmijëve qoftë edhe për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.

Është e deklaruar nga disa stafe arsimore dhe drejtorë shkollash që shkak kryesor i braktisjes së shkollës nga fëmijët lidhet me nivelin e të ardhurave të familjes, ndaj për familjet e varfra ne vënd të cilët kanë fëmijë në moshën e shkollës, të bëhet një ndryshim në skemën e ndihmës ekonomike, në mënyrë që fëmijët të qëndrojnë në arsimin e detyrueshëm përmes rritjes së ndihmës ekonomik, për secilën nga familjet të cilët kanë fëmijë që ndjekin shkollën.

Një tjetër konkluzion është që sistemi aktual i rimbursimit të librave të shkollës për familjet e varfra dhe grupet vulnerabël të ndryshojë, dhe në vend të tij të ndërtohet një sistem më i thjeshtë dhe efektiv. Kjo të arrihet dhe të zhvillohet në mënyrë të tillë ku librat e nevojshëm të sigurohen direkt nga shkolla përmes Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, dhe shkolla t'u japë fëmijëve librat falas pa pasur nevojë për rimbursim.

Në nivel komune, për shkak të numrit të ulët të nxënësve që frekuentojnë shkollat në zonat rurale nuk ka shërbim të psikologut, që çon edhe në mungesën e shërbimeve të kujdesit dhe të mbrojtjes së fëmijëve për fëmijët që jetojnë në komuna dhe zona të thella malore.

Infrastruktura e pjesës më të madhe të shkollave në zonat rurale kanë nevojë për rikonstrukcion si dhe t'i përshtasin mjediset e tyre për të qënë më të arritshme për fëmijët, prindërit dhe mësuesit. Ngritja dhe vënia në funksionim i laboratorëve shkencore të mirëpajisura do të përmirësonte shumë të nxënin në fushën shkencore tek të gjithë fëmijët, nëse kjo do të mundësohej në të ardhmen e afërt për shkollat në zonat rurale. Pjesa më e

madhe e këtyre shkollave nuk kanë fusha sportive apo palestra të pajisura me mjete sportive, që nëse do të ishin do të ndihmonin në zhvillimin terësor dhe në procesin e të mësuarit të çdo fëmije, pavarësisht gjinisë së tyre. Niveli dhe cilësia e burimeve mësimore është bazike dhe duhet të sigurojë komponentët thelbësore të një mjedisi cilësor ose angazhues të të mësuarit.

Institucioni i Avokatit të Popullit sa më sipër rekomandon rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e psikologut ose të punonjësit social në shkolla në bashkpunim me stafin dhe gjithë drejtorët e shkollave, duhet marrë në konsideratë si mënyrë për rritjen e nivelit të kuptuarit mbi mënyrën sesi roli dhe përgjegjësitë e psikologut dhe punonjësit social mund të përmirësojë mjedisin e të mësuarit për çdo nxënës, por fokusi kryesor të jetë mbështetja e atyre nxënësve të cilët hasin vështirësi me frekuentimin, neglizhimin e mësimit, gjithashtu edhe me vështirësitë që kanë lidhur me arritjet akademike dhe sjelljen e tyre. Psikologu dhe punonjësi social mund të mbështesë fëmijet, familjet ose mësuesit, gjë që e bën rolin e tij të domosdoshëm për përmirësimin e të mësuarit në shkolla.

Si në nivelin kombëtar edhe në atë lokal, strukturat qeveritare si Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit duhet të sigurojnë mbështetjen për infrastrukturën e duhur, për zhvillimin normal të orëve të mësimit për çdo fëmijë.

Gjithashtu për çdo familje dhe për prindërit një informacion të shkruar mbi të drejtat e fëmijëve për edukim; përmbajtja e programit arsimor të ofruar; alternativat që kanë nxënësit dhe prindërit dhe një sistem diskutimi mbi ankesat dhe pakënaqësitë mbi arsimimin e fëmijës. Është e nevojshme të ofrohet një informacion i cili të inkurajojë prindërit që të përfshihen dhe ofrohen si anëtarë të mundshëm të bordit të shkollës dhe keshillit të prindërve.

Problematike kanë qënë edhe mosfrekuentimi i shumë nxënësve në disa fshatra në Memaliaj dhe Gramsh si rezultat i shembjes së urave në këto zona. Avokati i Popullit ka i rekomanduar këtë problematikë Fondit Shqiptar të Zhvillimit dt.17.09.2014, dhe Bashkisë Memaliaj dt.07.04.2014

### **3.9. Mbrojtja e konsumatorit**

Mbrojtja e konsumatorit paraqitet si një nga fushat kryesore që lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rregullimi i kësaj fushe mbështetet në tre shtylla kryesore sikundër janë shëndeti, sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave e interesave ekonomike të konsumatorit.

Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008, “*Për mbrojtjen e konsumatorit*”, i ndryshuar, përbën legjislacionin bazë për këtë të drejtë, ku në nenin 56, një rol i veçantë i njihet edhe Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e interesave të konsumatorit jo vetëm për ankesa individuale, por edhe raste të një komuniteti më të gjerë në të gjithë vendin.

Për vitin 2014, fokus i punës të Institucionit të Avokatit të Popullit, kanë qënë ankesat në dy drejtime, ofrimi i shërbimit publikime energji elektrike dhe ofrimi i shërbimit publik me ujë të pijshëm.

Në trajtimin e këtyre ankesave krahas legjislacionit kombëtar që rregullon të drejtën për ofrimin e këtyre shërbimeve, jemi referuar edhe në disa direktiva ndërkombëtare si: Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës<sup>82</sup>, për rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, lidhur me ofrimin e shërbimit publik të energjisë elektrike me fokus mbrojtjen e grupeve të cënueshme, i cili duke iu referuar varfërisë ndalon ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorë të tillë në raste kritike”, si dhe Direktiva e Ujit të Pijshëm 98/83/KE, datë 03.11.1998, e cila ka të bëjë me një kompleks normash që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut duke vendosur kritere për

---

<sup>82</sup>Directive 2009/72/EC of the European Parliament and of the Council of 13 July 2009 concerning common rules for the internal market in electricity and repealing Directive 2003/54/EC(Text with EEA relevance).

shëndetin dhe pastërtinë e ujit të pijshëm dhe ofrimin e këtij shërbimi brenda standardeve të kërkuara higjeno-sanitare.

Përgjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 215 ankesa, të cilat kanë patur si objekt të tyre faturimet afrofe nga ana e OSHEE dhe Ndërmarrjeve të Ujësjiellës-Kanalizime, mbifaturime të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, shkeljen e të drejtës për informim nga “OSHEE”, mungesë e ujit të rrjedhshëm, infrastrukturë të amortizuar, etj., sidomos në disa komuna, etj.

Nga ankesat e trajtuara rezulton se 107 prej tyre ose (78%), janë zgjidhur në favor të individëve, 77 rezulton se janë në proces trajtimi dhe në 31 ankesa pretendimet e qytetarëve kanë qenë të pabazuara.

Gjatë punës tonë lidhur me trajtimin e ankesave me këtë objekt, kemi ndjekur si metodologji pune, ngritjen e grupeve të punës së bashku me operatorët furnizues për verifikimet në vend të ankesave, realizimin e seancave dëgjimore mes qytetarëve, operatorit furnizues dhe institucionit tonë, apo realizimin e takimeve të përbashkëta institucionale edhe me praninë e mediave për problematika që prekin një komunitet të gjerë qytetarësh. Kjo metodologji e ndjekur, ka sjellë edhe zgjidhjen e numrit më të madh të ankesave në favor të qytetarëve.

◆ Nga ankesat e paraqitura, problematika kryesore e evidentuar lidhet me mos respektimin e nenit 7 të Kontratës Tip të Energjisë Elektrike, nga ana e OSHEE lidhur me faturimin jo brenda periudhës 30 ditore, por në një periudhë mbi 40 ditore, e cila ka sjellë mbifaturim dhe tarifim mbi 300 kwh të sasisë së energjisë elektrike, me çmim 13.5 lekë/kwh. Mbi këtë problematikë Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar disa rekomandime në mënyrë të vazhdueshme ndër vite duke i trajtuar ankesat rast pas rasti<sup>83</sup>, ku është kërkuar nga drejtuesit përkatës marrja e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit dhe korrektimin e faturave duke bërë ndarjen e sasive të (kwh) dhe aplikimin e tarifave sociale prej 7.7 lekësh.

◆ Gjatë vitit 2014, janë evidentuar një numër ankesash, ku konsumatori rezulton debitor ndaj “OSHEE” sh.a., për shkaqe që lidhen me moskreditimin e faturave të energjisë elektrike të likuiduara në bankë apo në shërbimet postare (problematikë e cila është e mbartuar nga periudha 2007-2008). Lidhur me këtë problematikë të konstatuar gjatë trajtimit të ankesave, për gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë, kemi depozituar kopje të librezave të pagesës së energjisë elektrike nga ana e qytetarëve pranë zyrave të OSHEE, me qëllim vijimin e procedurave nga ana e operatorit për kreditimin e pagesave të kryera dhe heqjen e vlerës së debisë në faturat e energjisë elektrike. Sa më sipër, duhet të shmangen rastet abuzive ndaj qytetarët që i faturohet vlera e debisë në mënyrë të padrejtë, kur ndërkohë nga pagesat e energjisë elektrike rezultojnë pa debi dhe konsumatorë të rregullt.

◆ Problematikë tjetër e konstatuar lidhet me kolaudimin e matësve të energjisë elektrike. Kjo situatë ka lënë shteg për abuzim, për faktin se faturimi tek konsumatori vijon afrofe dhe në asnjë rast nuk është respektuar afati i parashikuar në Kontratën e furnizimit me energji elektrike, duke sjellë edhe mosfaturimin sipas konsumit real të energjisë elektrike. Lidhur me këto raste nëpërmjet seancave dëgjimore të realizuara ndërmjet Entit Rregullator të Energjisë, Kompanisë Furziuese, qytetarëve dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, kemi synuar gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë të kësaj problematike, duke realizuar marrjen e masave për mostejkalim të afateve tridhjetë ditore në pajisjen dhe rivendosjen e matësve për konsumatorin.

◆ OSHEE ka vijuar të ofrojë shërbim të furnizimit me energji elektrike jashtë standardeve dhe ndonjëherë me rrezikshmëri të lartë për pronën dhe shëndetin e individëve. Pra furnizimi me fuqi shpesh herë nën kushtet teknike, ka sjellë si pasojë djegien e pajisjeve elektrike, gjë që vjen në kundërshtim me një sërë nenesh të Ligjit Nr.9135/2003, “Për

<sup>83</sup> Rekomandimi me Nr. 201400341 datë 03.03.2014, drejtuar ish Administratorit të Kompanisë CEZ Shpërndarje sh.a

*Mbrojtjen e Konsumatorëve*”, i ndryshuar. Lidhur me këto raste për shkak se kjo problematikë ka sjellë dëmtime të pajisjeve elektro-shtëpiake, dhe kërkon një ekspertizë për vlerësimin e dëmeve kemi rekomanduar qytetarët të paraqesin kërkesë-padi në gjykata në respektim edhe të detyrimeve kontraktore në fuqi.

♦ OSHEE ka aplikuar në disa raste shkelje të ligjit “*Për Konsumatorin*” dhe të Ligjit “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, për aq kohë sa ka kryer dënime kolektive, duke kufizuar energjinë elektrike edhe për ata klientë që janë të rregullt në pagesat e energjisë elektrike. Raste të tilla mund të përmendim atë të një grupi banorësh në Fushë-Krujë të cilët vuanin mungesën e furnizimit me energji elektrike për shkak se pjesa më e madhe e konsumatorëve në këtë zonë ishin debitorë. Kjo problematikë në mënyrë të vazhdueshme është prezantuar nga ana jonë nëpërmjet takimeve verbale që kemi ndërmarrë me drejtues të OSHEE dhe përveç faktit se kemi bërë thirrje të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me pagesat e energjisë elektrike, kemi kërkuar rishikimin rast pas rasti dhe mospenalizimin e qytetarëve që janë të rregullt në pagesat e energjisë elektrike si dhe në veçanti për rastin konkret marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me energji elektrike për këta banorë.

♦ Problematikë nga rreth 40 ankesa drejtuar Institucioni të Avokatit të Popullit, është mungesa e furnizimit me energji elektrike për shkak të mospagesës së energjisë elektrike. Pavarësisht faktit se për një arsye sot ka një numër të konsiderueshëm qytetarësh debitorë, kemi rekomanduar lidhjen e akt-marrëveshjeve dhe krijimin e procedurave lehtësuese ndaj tyre, ku fokus i veçantë të jenë konsumatorët në varfëri ekstreme dhe pa asnjë mundësi për pagesën e energjisë elektrike, duke mos i privuar nga mundësia e përfitimit të shërbimit publik, sikundër është energjia elektrike.

♦ Lidhur me ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, veçanërisht në stinën e verës, ku qytetarët shpesh herë përballen me mungesa të vazhdueshme të furnizimit me ujë të pijshëm, kjo si pasojë e amortizimit të rrjetit dhe moskryerjes së investimeve. Ndaj këtyre rasteve në mënyrë të vazhdueshme kemi adresuar rekomandime drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-kanalizime sh.a për hartimin e projekteve të reja dhe marrjen e masave për gjetjen e zgjidhjeve për furnizimin me ujë të pijshëm, veçanërisht gjatë stinës së verës kur krijohen edhe vështirësi në furnizimin me ujë të pijshëm. Në përgjigje të rekomandimeve tona vihet në dukje fakti i mungesës së fondeve për kryerjen e investimeve përkatëse. Institucioni i Avokatit të Popullit për këto raste gjykon se pavarësisht vështirësive financiare më të cilat përballen operatorët që ofrojnë shërbime publike, në kushte kur cilësia e shërbimit publik duhet të ofrohet në standartet e kërkuara, do të kërkonim marrjen e masave për kryerjen e investimeve nga “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., për furnizim me ujë të pijshëm, duke mos privuar asnjë konsumator nga ky shërbim publik në cilësi sa më optimale.

♦ Nga trajtimi i disa rasteve rezulton se ka zona ku furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nëpërmjet gropave septike (puseve), duke bërë që edhe cilësia e furnizimit me ujë të jetë jashtë kushteve higjeno-sanitare. Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandime të vazhdueshme drejtuar Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime sh.a ndaj të cilave në mënyrë të vazhdueshme i kemi referuar edhe direktivave të ujit të pijshëm i cili duhet të jetë brenda gjithë kushteve higjeno-sanitare.

Në vijim të problematikave dhe rekomandimeve që Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar ndaj operatorëve që ofrojnë shërbime publike, sikundër është energjia elektrike dhe furnizimi me ujë të pijshëm, mund të përmendim faktin se me të dy operatorët bashkëpunimi ka qenë tepër i mirë dhe pavarësisht faktit se ka një numër të konsiderueshëm ankesash, janë përpjekur për gjetjen e zgjidhjeve sa më të shpejta e pozitive në drejtim të qytetarëve.

Gjithësesi, në kushtet kur janë duke u miratuar edhe ndryshimet e reja në ligjin “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të rishikimit të

kushteve të kontratës tip të furnizimit me energji elektrike, me qëllim shmangien e rasteve të mbifaturimeve të energjisë elektrike duke zbatuar me rigorozitet detyrimet kontraktore mes palëve.

Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit gjykon si të nevojshëm rishikimin e kushteve të Kontratës së Furnizimit me energji elektrike, për penaltitetet që duhet të ketë kompania furnizuese, në rast të dëmtimit të pajisjeve elektroshtëpiake të qytetarëve, pasi ende nuk ka një praktikë të unifikuar lidhur me rastet kur provohet lehtë faji i kompanisë furnizuese në dëm të konsumatorëve.

## - *Objektivat socialë*

### **3.10. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim**

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2014 ka trajtuar një numër të madh të ankesave që lidhen me plotësimin e nevojave të shtetasve me strehim si një prej objektivave sociale. Strehimi si një objektiv social gjen sanksionim në paragrafin 1/b të nenit 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim. Gjithashtu, e drejta për strehim gjen një sanksionim të mirë edhe në modelet e ofruara nga Karta Sociale Europiane<sup>84</sup>, si dhe në nenin 11 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore<sup>85</sup>.

Duke vijuar edhe me legjislacionin e brendshëm kombëtar, çështjet e strehimit rregullohen me Ligjin Nr.9232 datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9719, datë 23.04.2007, nëntë vendime të Këshillit të Ministrave<sup>86</sup>; tre direktiva lidhur me përcaktimin e masës së subvencioneve për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti, apo mbi nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave që kërkohen për të përfituar banesa me kosto të ulët.

Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2014, ka trajtuar në total 159 ankesa individuale me objekt përmbushjen e objektivës sociale të strehimit, prej të cilave në 10 raste janë adresuar rekomandime përkatëse drejtuar njësisë të qeverisjes vendore dhe ministrive përgjegjëse për objektivën e strehimit me qëllim përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave veçanërisht për grupet e cënueshme me qëllim përmbushjen dhe vendosjen e standarteve lidhur me përfitimin e strehimit social. Nga 159 ankesat e trajtuara, 41 ankesa kanë

<sup>84</sup> Karta Sociale Europiane e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2002, neni 31 ku citohet e drejta për strehim.

<sup>85</sup> Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me Rezolutën e saj 2200A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, aderuar me Ligjin Nr.7511, datë 08.08.1991.

<sup>86</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.814 datë 03.12.2004, “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.23 datë 07.01.2005, “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e komitetit kombëtar të strehimit

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.53 datë 28.01.2005, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira”

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 258 datë 28.04.2005, “Për kushtet, normat dhe standardet që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira, të cilat blihen në treg”

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.35 datë 24.01.2007, “Për procedurat dhe format e shitjes së truallit, të pajisur me infrastrukturë, për qëllime tregu”.

6.Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.97 datë 03.02.2008, “Për procedurat e privatizimit të banesave”, objekt i Ligjit Nr.7652 datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe i Ligjit Nr.9321 datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”.

7.Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.148 datë 13.02.2008, “Për përcaktimin e procedurave për blerjen e banesave, me kosto të ulët, në treg”.

8.Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.456 datë 16.4.2008, “Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët”.

përfunduar procesin e shqyrtimit nga ana jonë, prej të cilave 25 ankesa ose 60% e tyre kanë gjetur një zgjidhje pozitive në favor të individëve.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara për strehimin social dhe krijimin e një panorame të qartë mbi numrin e familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehëve, numrin e përfituesve realë nga programet sociale të strehimit, kemi depozituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në datë 04.11.2014 edhe një Raport të Veçantë, “*Mbi gjëndjen e Strehimit në Republikën e Shqipërisë*”.

Në mënyrë të vazhdueshme, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë takime ndërmjetësuese me grupet e interesit në nivel qendror dhe lokal lidhur me ngritjen e problematikave dhe gjetjen e zgjidhjeve afatshkurtra dhe afatgjata për objektivën e strehimit, me fokus kryesor grupet e dobëta, (*Rom, Egjiptian, Jetimë, Persona me aftësi të kufizuar, të moshuar, gratë kryefamiljare etj*). Një nga këto grupe të evidentuara nga trajtimi i ankesave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka të bëjë me komunitetin Rom<sup>87</sup>, në prag të dëbimit nga banesat e tyre, si rezultat i zbatimit të projektit publik të ndërtimit të një segmenti të Unazës së Madhe. Në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, cënimi i banesave të komunitetit rom sjell jo vetëm cënim të objekteve e tyre, por në një këndvështrim më të gjerë, është cënim edhe për jetën e tyre private dhe familjare. Si konstatim i kësaj problematike kemi gjykuar si emergjente harmonizimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së organeve shtetërore duke përfshirë ato të pushtetit qendror dhe vendor të përfshira në këtë proces me qëllim garantimin dhe respektimin e te drejtave të komunitetit rom në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke identifikuar familjet dhe nevojat e tyre për strehim.

Gjithashtu, në rekomandimin tonë kemi kërkuar ngritjen e një Komiteti ad hoc për të marrë masa që t’u jepet mundësia këtyre banorëve të komunitetit rom; ofrimin e mundësive reale të strehimit social për familjet rome të prekura nga zbatimi i projektit të Unazës së Madhe në Selitë në një kohë sa më të shpejtë si dhe lehtësimin e procedurave dhe kritereve për trajtimin me programe të strehimit social të familjeve rome. Pavarësisht angazhimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, çështja e strehimit, legalizimeve dhe shpronësimeve të banesave të komunitetit Rom në zonën e Selitës, mbetet akoma e paqartë dhe e pazgjidhur si dhe nuk disponojmë asnjë përgjigje zyrtare nga institucionet përkatëse.

Problematikë tjetër e evidentuar nga trajtimi i rreth 50 ankesave për të cilën kemi hartuar në mënyra të vazhdueshme edhe rekomandime drejtuar organeve të qeverisjes vendore lidhet me mos dhënien e informacioneve kundrejt individëve që gëzojnë statusin e të pastrehit, lidhur me aktet apo dokumentat që duhen dorëzuar; zvarritjeve të procedurave të shqyrtimit të dosjeve përkatëse; mungesën e transparencës gjatë procedurave të përcaktimit të kritereve për përzgjedhjen si dhe mungesën e transparencës të vendimmarrjes e cila kalon për miratim në organet kolegjiale të njësisë të qeverisjes vendore. Lidhur me këtë problematikë ne gjykojmë se është emergjent rishikimi i ligjit dhe vendosja e sanksioneve ndaj personave që bëhen pengesë në dhëniet e informacioneve apo krijimi dhe përdorimi i metodave të shumta të komunikimit.

Për vitin 2014, duke qenë se nga trajtimi i ankesave, pjesa më e madhe e ankesave që kanë fokus objektivën e strehimit lidhen me Komunitetin Rom, prej vitit 2013 në mënyrë të përsëritur kemi ridërguar rekomandimet legjislativ për ndryshimin e ligjit 9232/2004 “*Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane*” (i ndryshuar) drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizimit si dhe Njësive të Qeverisjes Vendore, në kushtet kur sipas parashikimeve ligjore në fuqi, pjestarët e komunitetit Rom e kanë praktikisht të pamundur të përfitojnë nga këto programe të strehimit. Sa më sipër kemi rekomanduar që në ligjin 9232/2004 “*Për programet sociale*

---

<sup>87</sup> Rekomandim i adresuar për një grup banorësh Rom në Zonën e Selitës me Nr. Dok.201401900, datë 18.11.2014, drejtuar Nënkrjetarit të Bashkisë, Entit Kombëtar të Banesave, Drejtorisë së Shërbimeve Urbane dhe Strehimit si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Sociale

për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), të parashikohen dispozita tranzitore të kufizuara në kohë, të cilat të konsiderohen si masa të veçanta të përkohshme për këtë komunitet, deri në momentin e përthithjes së tyre në sistem apo dhe të integritimit të tyre social. Konkretisht kemi rekomanduar plotësimin dhe qartësimin e pikës 2 të nenit 4, pikës 1, të nenit 6 dhe pikës 1, të nenit 19, të ligjit 9232/2004, apo delegimin e rregullimit të çështjes së kufijve të të ardhurave me një akt nënligjor.

Gjithashtu, në nenin 39/1, “Dispozita tranzitore”, të ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), është rekomanduar bërja e përcaktimeve të cilat do të rregullojnë strehimin e qytetarëve romë, brenda një periudhe pak më shumë se 4-vjeçare.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë një sërë rekomandimesh për plotësimin e ligjit konkretisht si vijon:

1. Njësitë e qeverisjes vendore deri në 31.12.2017, parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre, që jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom. Përcaktimi i kuotës mbi 5%, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore duke u bazuar në numrin e familjeve të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, që kanë paraqitur aplikim dhe plotësojnë kriteret për të përfituar nga programet sociale të strehimit.
2. Familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit, për të gjitha kriteret e parashikuara në nenin 5 të ligjit, si dhe për përparësitë apo pikëzimet e vendosura nga njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të këtij ligji, deri në 31.12.2017.
3. Përfitojnë nga programi i banesave sociale me qera, brenda kuotës së parashikuar në pikën 6 të këtij neni, deri në 31.12.2017, familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, të cilat kanë të ardhura nën nivelin e parashikuar në nenet 6 dhe 19 të ligjit.
4. Familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, përfitojnë subvencion sipas nenit 24 të ligjit, në masën 100% të vlerës së qirasë. Kjo masë subvencioni, ulet për familjen përfituese, në varësi të përfshirjes së anëtarëve të familjes në moshë pune, në programet aktive të nxitjes së punësimit. Masa e subvencionit që ulet, përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, në varësi të të ardhurave të familjes pas përfshirjes së anëtarëve të saj në programet aktive të nxitjes së punësimit.

Problematikë mbeten rastet kur familjet nuk kanë mundësi financiare të paguajnë detyrimin mujor si këst kredie të banesës sociale, ndaj Entit Kombëtar të Banesave. Konkretisht, në vitin 2014 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur rreth 18 ankesa në të cilat sqarohet fakti se këta banorë kishin përfituar në vitin 2007 nga blerja e banesave me kredi lehtësuese ndaj Entit të Banesave, por të ndodhur në kushtet e pamundësisë totale për pagesën e detyrimeve mujore rasti është bërë e konflikt gjyqësor, ndaj të cilëve është lëshuar edhe urdhëri i ekzekutimit për lirimin e banesave.

Pas ndërhyrjeve për këtë rast të Institucionit të Avokatit të Popullit u arrit rishikimi i kushteve të kontratës së kredisë për ato familje të cilat janë në pamundësi pagimi të kësteve mujore për shkak të uljes së të ardhurave të tyre për disa arsye; Zgjatja e afatit të përgjithshëm të kontratës së kredisë meqënëse këto banesa sociale janë ndërtuar me fonde buxhetore; si dhe ndarja e shumës së kamatvonesës në disa këste me qëllim që të jetë e përballueshme nga familjët.

Pavarësisht se kemi arritur zgjidhjen e këtij rasti, duke qenë se strehimi nuk qëndron më vete si objektiv social por përfshin dhe një sërë objektivash të tjerë si ndihma ekonomike, përfshirja sociale e këtyre grupeve, etj dhe duke parë se strehimi është problem kudo në vendin tone, është emergjente rishikimi i programeve sociale për këto grupe në nevojë.

Problematikë tjetër e konstatuar gjatë vitit 2014, është mungesa e marrjes së masave nga njësitë e qeverisjes vendore lidhur me përgatitjen e vend-strehimeve provizore për grupe



në nevojë emergjente me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin veçanërisht për grupe të tilla si fëmijë e të moshuar.<sup>88</sup> Nga përgjigjet e njësisë të pushtetit vendor rezulton se pjesa më e madhe e bashkive kanë mungesë ambjentesh për të mund t'i kthyer për përdorim banesash. Edhe në ato bashki të cilat mund të sigurojnë një vendstrehim alternativ, ambjentet janë jashtë kushteve dhe standarteve më minimale të mundshme.

Si konkulzione të problematikave të përmendura më lart, konstatojmë se pjesa më e madhe e bashkive kanë mungesa fondesh prej vitesh për ndërtimin e banesave sociale.

Aktualisht, megjithëse janë duke u ndërmarrë hapa nga Ministria e Zhvillimit Urban lidhur me hartimin e një strategjie për “Strehimin”, ende ekzistojnë probleme kryesisht në krijimin e programeve të strehimit afatgjatë, alokimin e fondeve për zbatimin e programeve sociale të strehimit, apo edhe njësitë e qeverisjeve vendore lidhur me krijimin e programeve dhe projekteve afat mesme dhe afatgjata, ofrimin e trualleve të lira për ndërtim, si dhe bashkëpunimin me Entin Kombëtar të Banesave. Në vijim do të rekomandonim forcimin e bashkëpunimit mes njësisë vendore dhe qendore veçanërisht, pas shkrirjes së disa bashkive nga reforma territoriale e cila mund të sjellë edhe rritje të numrit të familjeve të pastreha në njësitë e qeverisjeve vendore.

Megjithëse përfituesit përzgjidhen bazuar në kushtet e jetesës dhe rethanat social-ekonomike, (të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, jetimët, familjet rome, familjet egjiptiane etj), aktualisht kuadri ligjor shfaq një sërë problematikash, sikundër është përjashtimi i grupeve të mësipërme vulnerabël nga sistemi i pikëzimit për shkak të pamundësisë së tyre ekonomike. Sa më sipër, do të kemi në vëmendje hartimin e një pakete rekomandimesh legjislativë drejtuar institucioneve përgjegjëse për rishikimin e mekanizmave dhe politikave të programeve sociale duke synuar kryesisht shmangien e kriterëve dhe politikave bllokuese në dëm të shtresave vulnerabël.

Gjithashtu, e gjukojmë emergjente marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen dhe rivënien në përdorim apo mirëfunksionimin e vend-strehimeve provizore si një alternativë e strehimit për grupet në nevoja ekstreme.

### **3.11. Ndhimja ekonomike**

Programi i ndihmës ekonomike ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tyre.

Ndhimja ekonomike si përcaktim ligjor parashikohet në Ligjin nr. 9355 datë. 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji. Ky ligj, përcakton sistemin e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore për të dhënë ndihmë ekonomike familjeve të shtetasve shqiptar, të cilëve ju mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht ose i kanë ato të pamjaftueshme.

Shërbimi Social Shtetëror në qershor 2014, ndërmori një projekt pilot për të shpërndarë ndihmën ekonomike familjeve në nevojë në mënyrë elektronike, e cila u bë sipas formulës së pikëzimit në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Ky sistem pikëzimi ka patur si qëllim identifikimin e familjeve në nevojë, përmirësimin e vlerësimit të përfituesve për familjet aplikante, përjashtimin e rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike. Në një fazë të dytë, ky projekt do të shtrihet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe duke vijuar në të njëjtën linjë, do të shërbejë për ngritjen e moduleve shtesë si Ngritjen e Regjistrimit Elektronik Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, lidhjet e kësaj platforme me Sistemin e Pagesave të Thesarit, etj.

<sup>88</sup> Rekomandimi me Nr. K3/I61-2 Prot (201402017) datë 03.12.2014 drejtuar gjithë njësisë të qeverisjes vendore.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 ka trajtuar 184 ankesa për sa i përket ndihmës ekonomike. Këto ankesa kanë qënë kryesisht individuale, por ka patur dhe ankesa të cilat janë paraqitur nga grupe të interesit. Gjithashtu janë trajtuar me iniciativën e Institucionit dhe raste të bëra publike në media, të cilat objekt kanë patur si individë të veçantë, dhe familjet e tyre, por dhe numër më të madh individësh.

***Disa nga problematikat kryesore të adresuara nëpërmjet ankesave gjatë vitit 2014 janë:***

1. Përjashtimi nga skema e ndihmës ekonomike të shumë familjeve, që kanë qënë përfitues për vite me rradhë, i familjeve
2. me pak anëtar, ose nje individ,
3. të familjeve me kryefamiljare gra, të cilat janë të divorcuara, ose ju ka vdekur bashkëshorti.
4. Pamundësia e kryerjes të vizitave në familje për evidentimin e gjëndjes, sipas mënyrës së parashikuar, nga administratorët shoqëror.
5. Mos lëshimin në kohë e dokumentacioneve të kërkuara për përfitimin e ndihmës ekonomike nga institucione të caktuara, Zyra e Regjistrimit të Automjeteve të Qarkut Korçë, e cila pengoi për muaj me rradhë dhënien e ndihmës ekonomike në Bashkinë Leskovik.
6. Mospasja e një kohe të mjaftueshme për të kuptuar kërkesat e parashtruara në formularin e aplikimit për herë të parë të aplikuesve dhe administratorëve shoqëror, për shkak të fluksit të krijuar. Kjo në zbatimin e projektit pilot për përfitimin e ndihmës ekonomike.
7. Mos parashikimin në buxhetet nga ana e organeve të qeverisjes vendore të fondeve të detyruara nga Ligji dhe aktet nënligjore për të ofruar ndihmë ekonomike edhe jashtë kriterëve për raste të veçanta, si në rastin e familjeve në gjakmarrje.
8. Mos ofrimi i programeve nga organet e qeverisjes vendore për të angazhuar përfituesit e ndihmës ekonomike në të mirën e përbashkët, por dhe të vet përfituesve, duke rritur të ardhurat e këtyre të fundit.
9. Vonesë në mosdhënien në kohë të pagesës së ndihmës ekonomike,
10. Kërkesa për t'u sqaruar lidhur me përfitimet nga Legjislacioni i Ndhmës Ekonomike.

Nga ankesat e trajtuara pranë institucionit tonë nga zbatimi i projektit pilot, rezulton se nga përgjigjet e ardhura nga njësitë e pushtetit vendor, shumë familje nuk kishin marrë pikët e mjaftueshme si pasojë e sistemit dixhital të pikëzimit. Ndërsa Shërbimi Social Shtetëror në përgjigjen e tij, sqaronte mbi procedurat që duheshin ndjekur për përfitimin e ndihmës ekonomike në bazë të VKM-së 904, datë 12.12.2012 si dhe Udhëzimit nr.9, dt.23.06.2014 të MMSR-së. Referuar verifikimit të situatës në vend, përgjigjeve të ardhura nga institucionet, ankesave që disponojmë por edhe rasteve të tjera bërë publike në median e shkruar dhe vizive, Institucioni i Avokatit të Popullit, inicioi një takim me përfaqësues të të gjitha institucioneve përgjegjëse të qarqeve Elbasan, Durrës, Tiranë, Shërbimin Social Shtetëror dhe MMSR, në dt. 27. 11. 2014, për të diskutuar mbi gjithë këtë problematikë të shfaqur muajt e zbatimit të projektit pilot.

Nisur nga qëllimi për gjetjen e një zgjidhje ligjore të këtij problemi, institucioni i Avokatit të Popullit e çmoi me vend ti dërgonte një rekomandim në datën 04.12.2014, Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ku rekomandonte:

- Bërjen e një analize të kujdesshme përmbajtjes së pyetësorit të formularit që aplikohet për përcaktimin e pikëzimit, mbi bazën e të cilit vendosej nëse aplikuesi përfitonte ndihmë ekonomike apo jo;

- Rivlerësimin e të gjitha rasteve të pikëzimit për ato familje që janë përjashtuar nga përfitimi i ndihmës ekonomike;

- Pas përmirësimeve përkatëse duhej bërë trajnimi i administratorëve shoqërore për plotësimin sa më të saktë të pyetjeve të formularëve të aplikimit, me qëllim që familjet pretenduese për ndihmë ekonomike, kur janë vërtetë në kushtet e përfitimit të kësaj ndihme, të përfitojnë këtë të drejtë.

- Gjithashtu, të bëhej verifikimi në familje nga ana e administratorëve shoqërore, por edhe në bashkëpunim me punonjësit e Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, dhe kjo të vihej si një kërkesë e detyrueshme për çdo rast të familjeve aplikuese për përfitim të ndihmës ekonomike.

Në përgjigjen e saj të datës 30.12.2014, kjo ministri shprehej e angazhuar për rishikimin e kofiçientëve të këtij sistemi pikëzimi, për një përfshirje më të gjërë sociale të kategorive në nevojë bashkë me ekspertë të huaj të Bankës Botërore.

Shumë familje, të cilat ishin përfitues të ndihmës ekonomike në Njësinë Bashkiake nr.4 Tiranë, protestuan pasi kishin mbi dy muaj që nuk trajtoheshin me ndihmë ekonomike. Lidhur më këtë rast Avokati i Popullit i ka derguar rekomandimet përkatëse Prefektit të Qarkut Tiranë, Kryetares së Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.4 Tiranë. Pas ndërhyrjes tonë institucionale, këto familje vijuan trajtimin me ndihmë ekonomike.<sup>89</sup>

Në vazhdimësi të veprimtarisë së tij, Institucioni i Avokatit të Popullit shqyrtoi me inisiativë rastin e 1500 familjeve në qarkun Lezhë, të cilat ishin nxjerrë nga skema e ndihmës ekonomike. Arsyeja e ndërprerjes së këtyre ndihmave ishte mosparaqitja çdo muaj e familjeve, pranë njërive të qeverisjes vendore për të firmosur deklaratën e prezencës së tyre, si dhe mosplotësimi i kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike.<sup>90</sup>

Një çështje tjetër që vlen për t'u përmëndur, është dhe rasti i filluar me inisiativë nga Avokati i Popullit për disa familje të cilave u ishte bllokuar ndihma ekonomike në Bashkinë Leskovik.<sup>91</sup>

Problematika e kësaj çështjeje qëndronte në faktin se, organet e administratës kishin zvarritur procedurën e verifikimit të familjeve, të cilat kishin aplikuar për përfitimin e ndihmave ekonomike. Pas ndërhyrjeve të vazhdueshme të Avokatit të Popullit me anë të kërkesave dhe rekomandimit drejtuar ZVRPP-së Kolonjë, problemi i familjeve të cilave u ishte bllokuar ndihma ekonomike, mori rrugën e zgjidhjes.<sup>92</sup>

Në fokusin e punës së Avokatit të Popullit kanë qënë dhe familjet e ngujuara të cilat nuk kishin të ardhura të nevojshme për të përballuar nivelin e jetesës, pasi nuk ishin të përfshira as në skemat e ndihmës ekonomike. Në muajin Shkurt 2014 i kemi rekomanduar Ministrin e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë marrjen e masave për një bashkërendim të punës me njësitë e qeverisjes vendore, që pas identifikimit të familjeve të ngujuara nga gjakmarrja në të gjithë territorin e Shqipërisë, të krijohen mundësitë për aplikim të përfitimit të ndihmës ekonomike. Në përgjigje të këtij rekomandimi, jemi informuar se Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, kanë evidentuar dhe mundësuar përfshirjen e familjeve në gjakmarrje në skemën e ndihmës ekonomike.<sup>93</sup>

<sup>89</sup> Ky rekomandim është nisur në dt.16.04.2014, dhe përgjigja e Njësisë Bashkiake nr. 4 ka dt.20.05.2014, dhe Prefekti i Qarkut Tirane 07.05.2014.

<sup>90</sup> Nr.dok 201402120 dt.24.11.2014 Kërkesë për shpjegime dërguar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Lezhë, dhe përgjigja DRSSHSSH Lezhë ka dt.17.12.2014.

<sup>92</sup> Ky rekomandim është nisur në dt. 24.06.2014, dhe përgjigja e ZVRPP-së Kolonjë ka dt.18.07.2014

<sup>93</sup> Rekomandim drejtuar MMSR ka dt. 12.02.2014, përgjigja e kësaj Ministrie ka dt.02.12.2014

### 3.12. Synimi për një mjedis të shëndetshëm

Në Republikën e Shqipërisë ka tashmë një legjislacion të konsoliduar mjedisor, por gjendja aktuale e mjedisit dhe fokusi që i kushtohet kësaj fushe të rëndësishme, dëshmon për një aplikim të mangët të akteve ligjore dhe nënligjore që janë tashmë të miratuara për këtë fushë. Përsa i përket zhvillimeve dhe risive në legjislacion, gjatë vitit 2014 nuk ka patur miratime të ligjeve të reja në fushën e mjedisit, por vetëm një vendim të Këshillit të Ministrave lidhur me mënyrën e funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, konkretisht Vendimi nr.46, datë 29.01.2014 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave”. Ndërkohë që Avokati i Popullit vlerëson si mjaft të rëndësishëm Ligjin 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Ligji nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjin nr. 91/2013 datë 28.2.2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, si edhe akte të tjera nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të kuadrit ligjor të sipërcituar. Ndërkohë vlerësohen edhe ndryshimet në kuadrin ligjor ekzistues me qëllim të rritjes së efektivitetit të tyre, si edhe përshtatjes së tyre me ndryshimet në fusha të caktuara specifike të mjedisit, si p.sh. ligj nr.28/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të ndryshuar, ligji nr. 29/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar”, ligji nr. 30/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar, si edhe ligji nr. 31/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Avokati i Popullit, gjykon se zbatimi me rigorozitet i dispozitave të këtyre ligjeve, krahas atyre ekzistuese, do të ndikojë në përmirësimin e situatës mjedisore në Shqipëri si dhe rritjen e standarteve të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, në përputhje me kërkesat dhe standardet e jetës së qytetarëve të vendeve europiane, në kuadër të proceseve integruese që ka ndërmarrë Shqipëria. Aktualisht është vënë re ngritja e një sërë strukturash shtetërore në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, të centralizuara apo edhe të shtrira në rang lokal. Mungesa e koordinimit mes tyre ka shkaktuar edhe zvarritje të ushtrimit të kompetencave të tyre respektive. Ndërkohë duhet theksuar në këtë kuadër edhe reduktimi i punonjësve të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Pyjor në rrethe, me argumentimin se ishin struktura jo efektive. Kjo ka lënë hapësira për rritjen e abuzivizmit në prerjen e pyjeve dhe respektimin e kushteve dhe kritereve ligjore për shfrytëzimin e tyre.

Problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është edhe mungesa e ndëshkimit apo edhe gjobat mjaft të ulëta për ata individë apo subjekte që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj mjedisit.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2014 ka vijuar trajtimin e ankesave të paraqitura ndaj organeve të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, si edhe promovimin e një ambienti të shëndetshëm.

Avokati i Popullit është treguar aktiv në shqyrtimin e rasteve të ndryshme, duke ndërmarrë iniciativën e tij për hetimin dhe verifikimin e çështjeve me ndjeshmëri në këtë fushë, por edhe ato raste të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, ku janë konstatuar veprime në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, të cilat çenojnë të drejtën për një ambient të pastër e të shëndetshëm.

Avokati i Popullit konstaton se ka një sensibilizim në rritje të individëve për të kërkuar mbrojtjen dhe reagimin e institucioneve shtetërore përsa u përket çështjeve mjedisore. Por, numri i çështjeve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, tregon edhe për një mosveprim të strukturave rajonale për të ushtruar kompetencat e njohura atyre me ligj. Individët janë të paqartë apo nuk kanë dijeni për ekzistencën e strukturave mjedisore të krijuara me ligj, e në këto kushte kërkojnë ndërhyrjen direkte të Avokatit të Popullit për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të tyre.

Gjatë vitit 2014, janë regjistruar 21 çështje me iniciativë dhe ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë shprehur shqetësimin e tyre për cënim të së drejtës së tyre të ligjshme për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Nga çështjet e sipërcituara, rezulton se pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur për shqyrtim dhjetë ankesa nga individë të ndryshëm, dy ankesa të ardhura nga organizata të shoqërisë civile aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ndërkohë që për nëntë çështje Avokati i Popullit ka filluar shqyrtimin me iniciativë, kjo për shkak dhe të numrit të pakët të ankesave dhe problematikës së shumtë në këtë çështje.

Në këtë kuadër mund të theksojmë çështjet e iniciuara për derdhjen e ujrave të zeza në afërsi të një shkolle në Mbrostar/Fier, ndotjen e mjedisit nga guroret në zonën e Kabashit/Pogradec, vendgrumbullimin e mbetjeve inerte në fshatin Grudë/Shkodër, për mbushjen e liqenit të Shkodrës me inerte si pasojë e dëmtimit të materialit të hedhur për ndërtimin e By-pass të Shkodrës, për ndotjen nga fusha e plehrave në Bradashesh/Elbasan, për rifillimin e punës së furrave të gëlqeres në Krujë, si edhe rrezikimi i shëndetit të fëmijëve në fshatin Dukagjin i Ri/Krujë si pasojë e ndotjes nga bagëtitë përreth pallatit ku banojnë.

Duke iu referuar këtyre rasteve, duhet theksuar fakti se shkak i ekzistencës së një burimi ndotës, ka qenë pikërisht mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj ndaj subjekteve të ndryshme që shkaktonin ndotjen mjedisore.

Nga çështjet e shqyrtuara, dhjetë raste janë zgjidhur në favor të ankuesve, një rast ka rezultuar i pabazuar, ndërkohë që për një çështje është hartuar një rekomandim drejtuar kryetarit të një njësie të qeverisjes vendore, por që nuk është pranuar nga ana e tij. Ndërsa nëntë ankesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2015.

Konkretisht objekti i ankesave kanë qenë ndotjet e ambientit nga agjentë të ndryshëm apo aktiviteteve të paligjshme e të palçesuara, ndotja e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhja e mbeturinave në vende publike, si edhe ndotjet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në këto zona të prekura nga këto ndotje.

Duke iu referuar problemit të ndotjes akustike, theksojmë se Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ nr. 2 datë 25.07.2012 *“Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare”*. Pavarësisht kuadrit ligjor që parashikon dhe rregullon procedurat që duhet të ndiqen në raste të ndotjeve akustike, Avokati i Popullit ka konstatuar sërish se nuk ka patur një zgjidhje efektive të këtij problemi, sidomos gjatë sezonit të verës. Kjo ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së koordinimit të strukturave të mbrojtjes së mjedisit me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Policisë së njësive të pushtetit vendor. Nismat e ndërmarra mbeten në kuadrin e aksioneve dhe fushatave të veçuara, ashtu siç janë shumë të ulëta edhe gjobat administrative ndaj subjekteve, të papërfillshme në raport me aktivitetin që ushtrojnë, edhe gjatë gjithë natës në mjaft raste.

Shqetësuese paraqitet edhe situata gjatë vijës bregdetare përsa i përket largimit të ujrave të zeza të hoteleve dhe shtëpive të banimit. Situata në plazhet publike paraqitet e papajtueshme me synimin për një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm për kryerjen e pushimeve.

Lidhur me ushtrimin dhe përmbushjen brenda standardeve ligjore të së drejtës për ambient të shëndetshëm, Avokati i Popullit ka ushtruar të drejtën e tij të iniciativës për verifikimin dhe inspektimin e ruajtjes dhe respektimit të standardeve mjedisore në tetë raste të ndryshme, duke dëshmuar në vijimësi rëndësinë që i kushtohet mbrojtjes së individit përmes fokusimit në çështjet e mjedisit në të cilin ata jetojnë. Pas kryerjes së procedurave administrative të hetimit dhe verifikimit të qëndrimeve zyrtare të organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për kryerjen e funksioneve dhe detyrave konkrete në fushën e mjedisit, Avokati i Popullit ka hartuar dhe dërguar nëntë rekomandime me qëllim marrjen e

masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në zonën respektive, si edhe shmangien e mosveprimeve të cilat kanë shkaktuar një situatë të tillë ndotjeje. Në vijim të rekomandimeve të dërguara, Avokati i Popullit ka konstatuar se ka patur në përgjithësi reagime dhe qëndrime pozitive të organeve të administratës publike të cilave u jemi drejtuar, duke ndërmarrë masa konkrete për shmangien e problemeve të konstatuara.

*Problematika më e shumtë e hasur në fushën e mjedisit në Shqipëri është si më poshtë:*

- Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore mjedisore në qytete e mëdha shqiptare, sidomos në Tiranë. Ndotja vjen kryesisht si pasojë e shtimit të makinave dhe pakësimit të hapësirave të gjelbërimit, pavarësisht projekteve modeste të njësisive të caktuara të qeverisjes vendore apo edhe strukturave të pushtetit qendror, për mbjelljen e fidanëve të rinj në zona që veçohen për nivele të larta të ndotjes.
- Ndotja e ujërave në Shqipëri vjen si pasojë e hedhjeve të mbeturinave në lumenj e liqene, si dhe derdhjes së ujërave të zeza të papërpunuara.
- Mbledhja e mbeturinave në Shqipëri dhe riciklimi i tyre bëhet në nivele primitive. Mbeturinat pothuajse nuk mblidhen fare nëpër fshatra. Por një fenomen i tillë vihet re edhe nëpër qytete të tjera në mbarë vendin. Në këtë kuadër duhet theksuar edhe fakti se nuk funksionon procesi i ndarjes dhe veçimit të mbeturinave, si një nga fazat që do të shërbente jo vetëm në mbledhjen sa më të shpejtë të mbeturinave nga vendet e tyre të grumbullimit, por edhe në trajtimin e tyre të mëtejshëm të specializuar në impiantet e posaçme të riciklimit.
- Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri, duke dëmtuar në këtë mënyrë një nga burimet e vlefshme të ruajtjes së parametrave të pranueshëm të mjedisit.

Në vendin tonë, zhvillimi ekonomik ka përparësi më shumë se çështjet e mjedisit, ndërkohë që ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm, nëse nuk merren masa dhe parashikohen hapësira për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Ashtu si edhe në fusha të tjera, problemi i nivelit të ndotjes së mjedisit në vendin tonë qëndron tek zbatimi i ligjeve mbi çështjet e mjedisit. Avokati i Popullit, gjykon se zbatimi me rigorozitet i dispozitave të ligjeve në fushën e mjedisit, ndikon në mënyrë direkte në përmirësimin e situatës mjedisore në Shqipëri, si dhe rritjen e standardeve të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, në përputhje me kërkesat dhe standartet e jetës së qytetarëve të vendeve europiane, në kuadër të proceseve integruese që ka ndërmarrë Shqipëria.

Avokati i Popullit thekson rëndësinë që duhet t'i kushtohet situatës mjedisore dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri. Këto fusha kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe bashkëveprim të të gjithë individëve dhe strukturave shtetërore, me qëllim që të garantohet kujdesi për shëndetin dhe rritet cilësia e jetës.

Duke u nisur nga rëndësia që i është kushtuar mbrojtjes së mjedisit, si edhe problematikave të konstatuara, Avokati i Popullit ka ushtruar në disa raste të drejtën e tij kushtetuese për t'iu drejtuar me rekomandime organeve të administratës publike për ushtrimin e kompetencave të tyre në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe garantimit të një ambienti sa më të pastër dhe të shëndetshëm.

Disa nga rekomandimet kryesore të cilat prekin më shumë se disa banorë janë si vijon:

- Rekomandim për marrjen e masave për zgjidhjen përfundimtare të përmirësimin të rrjetit të kanalizimeve në Komunën Mbrostar, Fier.
- Rekomandim për verifikimin e dokumentacionit dhe ushtrimin e vazhdueshëm të kontrolleve në zbatim të kompetencave të përcaktuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit nga funksionimi i guroreve në zonën e Kabashit/Pogradec.
- Rekomandim për marrjen e masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit që shkaktohet nga vendgrumbullimi i mbetjeve në fshatin Grudë e Re/ Shkodër.

- Rekomandim lidhur me marrjen e masave konkrete për mbrojtjen e liqenit të Shkodrës nga ndotja dhe mbushjet me inertet e by-pass të Shkodrës, pasi është një projekt i lënë përgjysëm.
- Rekomandim lidhur me marrjen e masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit nga djegiet në fushën e plehrave në Komunën Bradashesh/Elbasan.
- Rekomandim për ushtrimin e vazhdueshëm të kontrolleve në zbatim të kompetencave të përcaktuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, lidhur me ndotjen e ambientit në qytetin e Krujës nga guroret dhe gropat e gëlqeres.

Nëpërmjet rekomandimeve të parashtruara organeve të ndryshme të administratës publike, Avokati i Popullit ka synuar në sensibilizimin e tyre në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave që u janë njohur me ligj. Në përgjithësi ka patur reagime konkrete pozitive në trajtimin e problematikave të evidentuara në rekomandimet tona, pavarësisht se ka mjaft probleme që vazhdojnë të jenë evidente dhe të pranishme për banorët e zonave në mbarë vendin. Ndërkohë që ka rekomandime për të cilat nuk ka patur qëndrime zyrtare nga autoritetet që u jemi drejtuar, e në këtë kuadër Avokati i Popullit ka vijuar të kërkojë reagimin e tyre institucional, duke angazhuar në këtë proces edhe organe të tjera më të larta në hierarki.

Avokati i Popullit do të vijojë të ndjekë me një prioritet abosolut çështjet mjedisore, duke trajtuar jo vetëm ankesat e parashtruara nga subjekte të ndryshme publike apo private, por duke inspektuar edhe me iniciativën e vet zona potencialisht të rrezikshme mjedisore, me qëllim të rritjes së cilësisë së jetës dhe shëndetit të individëve, si edhe shmangies së rreziqeve të tilla nga mosveprime të organeve të administratës shtetërore të ngarkuara me këtë mision.

### **3.13. Fenomeni i gjakmarrjes në Shqipëri dhe roli i Avokatit të Popullit**

Gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri krahas arritjeve të shumta demokratike dhe kryesisht në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut rilindi edhe fenomeni regresiv i gjakmarrjes. Ky fenomen tashmë është kthyer në një problem shumë shqetësues për shoqërinë tonë sepse cënon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës.

Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni, dhe sidomos vitet e fundit, po e ndiejnë dhe vuajnë edhe disa vende të BE-së për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptar, duke përfshirë edhe ata fiktivë, të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni.

Për shkak të gjakmarrjes në vendin tonë kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative dhe regresive sikurse mund të përmendim *ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe*, apo “vetburgimi” i tyre. Për shkak të ngujimit, këtyre personave iu mohohen një sërë të drejtash kushtetuese themelore, sikurse mund të përmendim atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj. Duket sikur shteti është dorëzuar përballë këtij fenomeni dhe ka zgjedhur rrugën e heshtjes ose të mospranimin të tij si mënyrën e “zgjdhjes” së problemit, ndërkohë që shtetasit e tij që janë prekur nga gjakmarrja vriten, “vetburgosen” ose lenë vendin e tyre dhe kërkojnë ndihmë për sigurimin e jetës në vendet e tjera.

Avokati i Popullit ka arritur në konkluzionin se, për disa vjet nuk ka asnjë investim serioz nga organet e shtetit dhe të drejtësisë për të nxjerrë personat nga ngujimi. Fëmijët e ngjuar janë të destinuar të bëhen kriminelë për shkak të rrethanave ku jetojnë, të gjendjes së mjerueshme ekonomike, të ndjenjës së urrejtjes dhe hakmarrjes me të cilën rriten dhe ushqehen çdo ditë, të mungesës së edukimit e shkollimit etj. Disa masa të marra për shtesa e ndryshme në Kodin Penal, duke rritur dënimin për autorët e “*vrasjes për gjakmarrje*” (jo më pak se 30 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm neni 78/a i KP, miratuar me ligjin nr. 144/2013) dhe parashikimin e dy figurave të reja krimi, si “*kanosja serioze për t’u mbyllur në*

*shtëpi*” (neni 83/a i KP) dhe “*nxitja për gjakmarrje*” (neni 83/b i KP për të cilat parashikohet dënimi me burgim deri në tre vjet, si dhe me gjobë nga njëqind mijë lekë deri në njëmilion lekë), miratuar me ligjin nr. 9686, dt. 26.02.2007, nuk janë të mjaftueshme për të luftuar këtë fenomen.

Ne gjykojmë se fenomeni i gjakmarrjes, ashtu sikundër çdo sfidë tjetër, me të cilën ndeshet shteti dhe shoqëria shqiptare, kërkon një mënyrë tjetër të re sjelljeje të të gjitha strukturave shtetërore, të cilat duhet të shkunden dhe zgjohen nga kjo dremitje. Ai kërkon përmirësim të vazhdueshëm të legjislacionit, forcimin e masave të dënimit ndaj autorëve të veprave penale që lidhen me gjakmarrjen, angazhim të plotë të strukturave ligjzbatuese për zbatimin me fanatizëm të akteve normative në fuqi dhe për kryerjen me korrektësi të detyrave të ngarkuara nga ligji.

Duke vlerësuar ndikimin e madh që mund të ketë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes, institucioni i Avokatit të Popullit përgatiti një raport të veçantë, i cili pavarësisht dorëzimit të tij në vitin 2013, Kuvendi e mori në shqyrtim në datë 17.11.2014. Pas shqyrtimit të raportit që u mbajt nga Avokati i Popullit dhe diskutimeve të bëra nga deputetet dhe të ftuarit, nënkomisioni për të drejtat e njeriut, vendosi që të përgatitet një projekt rezolutë rreth këtij fenomeni dhe t’i dërgohet për miratim Kuvendit, të cilat priten në periudhën në vijim.

*Disa nga problematikat dhe rekomandimet kryesore të përfshira në raport janë:*

- Ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” duhet të vihet menjherë në zbatim. Strukturat qendrore duhet të fillojnë punën intensive duke hartuar e miratuar strategjinë kombëtare për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ etj, dhe përcaktojnë detyrat dhe masat konkrete për organet ekzekutive dhe ato të pushtetit vendor.
- Gjakmarrja mund të luftohet me efektivitet vetëm në qoftë se strukturat shtetërore, shkollat, komunitetet fetare, media dhe shoqëria civile do të punojnë së bashku sipas një strategjie të përbashkët.
- Organet e pushtetit vendor duke përfshirë edhe ato të policisë duhet të evidentojnë saktësisht numrin e familjeve dhe të personave të ngjuar.
- Organet e Policisë së Shtetit duhet të marrin masa të menjehershme për parandalimin e konflikteve, për zbulimin dhe kapjen sa më shpejt të autorëve të krimeve për gjakmarrje.
- Organet e prokurorisë duhet të bashkëpunojnë më mirë me policinë për të bërë hetime të shpejta, të plota, të thella dhe objektive. Nuk duhet mjaftuar vetëm me zbulimin e autorit të vrasjes, ekzekutorit, por duhen zbuluar edhe bashkëpunëtorët e tij, sikurse janë nxitësit e ndihmësit e autorit, si dhe organizatorët e krimit.
- Gjykatat duhet t’i gjykojnë shpejt, me objektivitet, paanshmëri dhe mundësisht me gjykim të pandërprerë çështjet gjyqësore për këtë krim dhe të japin dënime të drejta për çdo fajtor. Çdo dënim i butë, apo pafajësi e pabazuar i lë shteg vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet edukimi i brezit të ri me frymën e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes, si dhe për trajtimin e mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja, duke vazhduar edhe për disa kohë Projektin “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit përfitojnë fëmijët e ngjuar.
- Problemet sociale të familjeve të ngjuara kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit, posaçërisht të Ministrisë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë që, nëpërmjet zyrave rajonale të ndihmojnë ekonomikisht familjet e ngjuara me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe për të ulur nivelin e varfërisë së tyre.



- Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj duhet t'u ofrojë familjeve të ngjuara nga gjakmarrja shërbim shëndetësor në shtëpi sipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj.

Disa nga rekomandimet për problematikat më kryesore që institucioni i Avokatit të Popullit ia ka adresuar institucioneve përkatëse gjatë vitit 2014, janë si më poshtë:

1. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit<sup>94</sup> me organet e pushtetit vendor dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale për regjistrimin e të gjitha vrasjeve për motiv gjakmarrjeje, të familjeve dhe të personave të ngjuar sipas gjinisë dhe grup moshave (meshkuj, femra, të mitur).
2. Ofrimi i mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike atyre familjeve të ngjuara me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim uljen e nivelit të varfërisë, nëpërmjet zyrave rajonale<sup>95</sup>.
3. Ofrimi i shërbimit shëndetësor në shtëpi të familjeve të ngjuara sipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, që çdo qendër shëndetësore nëpërmjet mjekut të familjes u ofron pacientëve që janë regjistruar pranë saj.<sup>96</sup>
4. Ngritja e grupit ndërinstucional të punës dhe përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme, i cili në përgjigjen e tij informoi se ka filluar puna për ngritjen e Sekretariatit Teknik në zbatim të nenit 6 të këtij ligji<sup>97</sup>.
5. Marrjen e masave të nevojshme që nisma pozitive e Prokurorisë së Rrethit Gjuqësor Shkodër “Për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngjuara”, të shtrihet edhe në organet e tjera të Prokurorive të Rretheve Gjuqësore në ato rrethe të vendit të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm<sup>98</sup>.

### 3.14. Disa vlerësime për gjendjen e të drejtave të minoriteteve në vend

Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe vlerëson mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, si një prej prioriteteve kryesore në punën e tij. Vizioni i tij bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit.

Sot në Shqipëri njihen dy lloje minoritetesh, minoritetet etnike kombëtare ku përfshihet minoriteti Grek, minoriteti Maqedon dhe minoriteti Serbo-Malazez, si dhe minoritetet etno gjuhësore, ku përfshihen minoriteti Vllah dhe minoriteti Rom.<sup>99</sup> Pavarësisht kësaj realiteti i shoqërisë sonë nje “de facto” edhe disa komunitete të tjera të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare siç janë komuniteti Boshnjak, komuniteti Egjiptian, apo edhe

<sup>94</sup> Rekomandim i datës 23.01.2014

<sup>95</sup> Rekomandim i datës 12.02.2014 drejtuar Ministrisë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

<sup>96</sup> Rekomandim i datës 06.02.2014 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë që t'u ofrojë personave të ngjuar nga gjakmarrja.

<sup>97</sup> Rekomandimi i datës 07.02.2014 drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme, kthyer përgjigje nga kjo e fundit me shkresën Nr. 3530/2 Prot., datë 22.09.2014

<sup>98</sup> Rekomandimi i bërë në datën 03.03.2014

<sup>99</sup> Të dhënat e mbledhura nga ana e shtetit shqiptar mbi numrin e popullsisë (censuset 1960, 1979, 1989, 2001), janë bazuar tek Censuset mbi popullsinë dhe banesat të kryera nga institucione shtetërore specifike, sikurse Instituti i Statistikave (INSTAT). Në censusin e zhvilluar në vitin 2011, janë përfshirë edhe cilësimi për minoritete etno linguistike Rome dhe Vllahë. Sipas këtij censusi, minoritetet rezultojnë me 1.9% të numrit të popullsisë në vend. Shifrat e dala nga ky census janë kundërshtuar me forcë dhe publikisht nga ana e përfaqësuesve të partive politike, apo shoqatave që mbrojnë ekskluzivisht të drejtat e minoriteteve.

komuniteti Goran.

Njohja e minoriteteve nxjerr nevojën e mbrojtjes, përmes afirmimit të një sërë të drejtave që u njihen posaçërisht atyre. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe ratifikimi, apo nënshkrimi i akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht për minoritetet, ratifikimi pa asnjë rezervë i Konventës Kuadër “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”,<sup>100</sup> si dhe anëtarësimi i Shqipërisë në një sërë organizatash dhe organizmash ndërkombëtarë me fushë veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut flasin për një angazhim serioz institucional.

Zbatimi i parimeve të qeverisjes së mirë, luan një rol jetik në përfshirjen e minoriteteve në shoqërinë tonë, por edhe në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Në këtë drejtim roli i Avokatit të Popullit merr një rëndësi të veçantë.

Nisur nga ky rol specifik, Avokati i Popullit ka përgatitur një raport të veçantë mbi gjendjen e të drejtave të minoriteteve, në kuadër të të drejtave të afirmuara në Konventën Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, i cili do të depozitohet në Kuvendin e RSh-së gjatë muajve të parë të vitit 2015. Ky raport bazohet në të dhënat e vet institucionit, të dhëna zyrtare, si dhe në të dhëna të mbledhura gjatë inspektimeve të kryera në zonat kryesore të vendit ku ka prezencë të dallueshme minoritare, apo të komuniteteve të tjera. Këto inspektime janë kryer në zonën e Dropullit (Gjirokastrë), fshatin “Andon Poçi” (Gjirokastrë), komunën Pustec, (Korçë), fshatin Borakë (Shijak), fshatin Vrakë dhe Boriç (Shkodër), në Fier, (fshati Libofshë), pothuaj në të gjitha zonat e inspektuara paraprakisht për raportin mbi gjendjen e minoritetit Rom, ku ka popullsi Rome dhe Egjiptiane, në Kukës (krahina e Gorës).

Bazuar në eksperiencën e akumuluar nga puna e përditshme e institucionit, si dhe veçanërisht nga informacioni që është marrë nga vet përfaqësuesit e shoqërisë civile që mbron të drejtat e minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend, janë konstatuar disa problematika në çështje që, lidhen kryesisht me njohjen dhe respektimin e të drejtave të afirmuara për minoritetet në Konventën Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.<sup>101</sup>

Nga të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve të formuluar<sup>102</sup> për këtë qëllim e kontakteve me banorë të zonave minoritare, apo të komuniteteve të tjera, rezulton se:

- Perceptimi i përgjithshëm që ekziston tek minoritetet dhe komunitetet e tjera që ekzistojnë në vend është se, barazia formale ekziston por ka elementë të jetës së përditëshme të cilat identifikojnë mungesën e barazisë thelbësore.

- Njohja e akteve normative që garantojnë të drejtat e minoriteteve është në nivel jo të kënaqshëm.

<sup>100</sup> Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, u nënshkrua nga Republika e Shqipërisë në 29.06.1995. Ajo u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999, dhe pasi u depozituan instrumentet e ratifikimit në 28.09.2000, hyri në fuqi në 1.01.2001. Qëllimi i saj është përcaktimi i parimeve juridike që shtetet marrin përsipër për të siguruar mbrojtjen e minoriteteve kombëtare. Konventa nuk jep ndonjë përkufizim të termit “minoritet kombëtar”. Sipas saj, individët janë të lirë të vendosin nëse dëshirojnë apo jo, të bëjnë pjesë në një minoritet kombëtar dhe zgjedhja e tyre duhet të bazohet në kritere objektive, që lidhen me identitetin e personit, siç janë gjuha, feja dhe kultura.

<sup>101</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, dhe legjislacioni në fuqi ku mund të përmendim Kodin e Punës, Kodin Penal, Kodin Zgjedhor e një sërë ligjesh të tjera apo edhe akte nënligjore, janë përafuar kënaqshëm me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.

<sup>102</sup> Problemet e evidentuara evidentojnë zbatimin dhe respektimin e të drejtave që lidhen me mosdiskriminimin; ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore; pjesëmarrja në sistemin arsimor shtetëror; shtypi i shkruar dhe media audiovizive lokale në gjuhën minoritare; ushtrimi i lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar; përdorimi i lirshëm i gjuhës minoritare apo komunitare; kontaktet e lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera; specifikisht, të drejta të fëmijëve që lidhen me aksesin në arsimin shtetëror, tekstet shkollore dhe përmbajtjen e tyre, sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimimit, dhe diskriminimit të mundshëm ndaj tyre në procesin mësimor.

- Sa i takon masave që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, rezulton se nga ana e shtetit janë marrë masa përgjithësisht, por ato konsiderohen ende të pamjaftueshme.

- Pjesëmarrja në sistemin arsimor shtetëror është e lirë dhe pa pengesa. E njëjta situatë shfaqet edhe në ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, apo të shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar. Konstatohet gjithashtu, përdorim i lirshëm i gjuhëve minoritare, apo edhe i informacioneve personale në jetën e përditëshme. Kontaktet me personat e tjerë të së njëjtës kombësi, apo të kombësive të tjera jashtë kufirit janë të lira.

- Ekzistenca e shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive lokale në gjuhën minoritare, ka mungesa që vijnë kryesisht për shkak të mosfinancimit nga ana e shtetit dhe aftësive të pakta që ekzistojnë për financimin e tij nga ana e subjekteve private.

- Sa i takon përfshirjes së njohurive në tekstet shkollore shtetërore mbi minoritetet në vend, konstatohet se, përfshirja është e pakët dhe e pamjaftueshme dhe se, jo të gjithë fëmijët minoritarë, marrin mësim në sistemin shtetëror arsimor në gjuhën e tyre amtare. Shkollat me sistem dygjuhësh ekzistojnë, por jo për të gjithë minoritetet dhe ato janë të nivelit nëntëvjeçar.

- Të drejtat që fëmijët në minoritete dhe komunitete të tjera duhet të gëzojnë specifikisht, për shkak të origjinës së tyre dhe përkatësisë së ndryshme në elementët që trajtojnë diversitetin kulturor dhe gjuhësor nga pjesa tjetër e popullsisë mazhoritare jo adulte, respektohen, por mbetet problematik shfrytëzimi i fëmijëve të minoritetit Rom për punë, ndjekja e procesit arsimor, si dhe rastet e trafikimit.

Nga aktiviteti i institucionit të Avokatit të Popullit veçojmë këto rekomandime kryesore, mbi respektimin e të drejtave të minoriteteve në vendin tone, si më poshtë vijon:

1. Rekomandim për disa përmirësime në ligjin nr.10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për përfshirjen si shkaqe për diskriminim të kombësisë; qëllimit të shpallur për të diskriminuar; nxitjes për diskriminim dhe ndihmesës dhe inkurajimit të diskriminimit, drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Pavarësisht gatishmërisë së shprehur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për bashkëpunim dhe asistencë në draftimin e ndryshimit të kërkuar, ende nuk ka filluar ky proces.

2. Rekomandim për plotësimin e kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, drejtuar Kryeministrit. Hyrja e një ligji ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, po kryhet nga grupi ndërinstytucional, i ngritur në bazë të Urdhërit të Kryeministrit nr.117 datë 10.03.2014 “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe politikave për minoritetet”.

3. Rekomandim për “Marrjen e masave konkrete, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom dhe Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015, “Dekada e Përfshirjes së Romëve”, për të mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme”, drejtuar Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, për të cilin ende nuk kemi një përgjigje.

4. Rekomandim për disa përmirësime në ligjin nr.69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për të cilin nuk kemi ende një përgjigje.

5. Rekomandim për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike” (i ndryshuar), drejtuar Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Për këtë rekomandim nuk kemi ende një përgjigje.

6. Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom ne regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual, drejtuar

Ministrit të Brendshëm për ndërmarrjen e iniciativës për ndryshime në Ligjin Nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”. Për këtë rekomandim nuk kemi ende një përgjigje.

7. Rekomandim legjislativ për ndryshimin e ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), drejtuar Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ku janë propozuar ndryshime që do të krijojnë kushtet e përfshirjes së individëve dhe familjeve romë në programet sociale për strehimin e banorëve. Në përgjigjen e dhënë lidhur me këtë rekomandim nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dilet në konkluzionin se, problematika e minoritetit Rom nuk qëndron tek ligji 9232/2004 i ndryshuar, pasi ai garanton të drejtën e strehimit edhe për individët Romë, pasi është një çështje shumë më komplekse.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve kemi konkluduar në disa gjetje dhe rekomandime, sa i takon gjendjes së të drejtave të minoriteteve në vend.

Realiteti aktual në vend por edhe ai historik, tregon se pavarësisht mungesës së një përkufizim të përgjithshëm mbi minoritetet, shteti shqiptar ka njohur kategori të caktuara minoritetesh, bazuar në tregues të natyrës objektive dhe subjektive të komuniteteve të caktuara në vend. Gjithashtu, është garantuar mbrojtja e minoriteteve, përmes afirmimit të një sërë të drejtave që u njihen atyre, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në akte të tjera ndërkombëtarë të nëshkruara, apo të ratifikuara nga ana e shtetit tonë, si dhe në kuadrin ligjor aktual në fuqi.

Megjithatë, përmirësimi dhe pasurimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e minoriteteve mbetet një nga çështjet kryesore, pasi vërehen mangësi.<sup>103</sup> Në këtë aspekt është i nevojshëm miratimi i një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, të ratifikuar me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999.

Nevojitet gjithashtu përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus disa përmirësime në nenin 1, të Ligjit nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.

Po kështu është i nevojshëm, fillimi dhe përfundimi i procesit për ratifikimin e Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale, ose Minoritare.<sup>104</sup>

Elementët më kryesorë në zgjidhjen e çështjeve me të cilat përballet sot shoqëria shqiptare janë dialogu konstruktiv dhe i vazhdueshëm, si dhe bashkëpunimi ndërkulturor ndërmjet, institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe qytetarëve, me qëllim që adresimi i problematikave dhe procesi i analizimit dhe zgjidhjes së tyre të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar. Kjo mënyrë mendimi dhe veprimi na afron gjithnjë e më shumë me komunitetin European, ku edhe aspirojmë të anëtarësohemi së shpejti. Marrjen e masave adekuate dhe zgjerimin e mundësive për edukimin e minoriteteve, duke përfshirë mësimin e gjuhëve minoritare, promovimin e identitetit dhe zhvillimin e kulturës së minoritetit.

Marrjen e masave konkrete ligjore dhe administrative për përmirësimin e aksesit në strehim, shërbimet e arsimit, shërbimet sociale dhe pjesëmarrjen në jetën publike veçanërisht të minoritetit Rom, por edhe të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend. Integrimin real të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në jetën e përditëshme, veçanërisht në strukturat qeverisëse në nivel vendor, apo qëndror.

Krijimin e kushteve për rritjen e mirëqënies në zonat ku banojnë minoritetet dhe

<sup>103</sup> Kjo nevojë shprehet edhe në pikën 13, të Rezolutës 2019 (2014), të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

<sup>104</sup> Siç bëhet e qartë në Preambulën e Kartës Europiane të Gjuhëve Krahinore ose Minoritare, qëllimi kryesor i Kartës është aspekti kulturor. Qëllimi i saj është mbrojtja dhe nxitja e gjuhëve krahinore dhe të pakicave si një aspekt i kërcënuar i trashëgimisë kulturore të Europës.

komunitetet e tjera, përfshirë këtu edhe financimin me një buxhet më adekuat për njësitë e qeverisjes vendore, ku ka komunitete minoritare dhe komunitete të tjera në një masë dalluese me pjesën tjetër të popullsisë mazhoritare.

Avokati i Popullit vlerëson si prioritet mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Vizioni i tij bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit.

Ky vlerësim kërkon rritjen e rolit dhe veprimtarisë së të gjithë institucioneve shtetërore në kuadër të respektimit të të drejtave të minoriteteve, veçanërisht zgjerimi i aktivitetit të institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe mbështjetja e tyre në funksion të afirmimit, njohjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve.

Efektivisht sot, pavarësisht proceseve të regjistrimit të popullsisë të ndërmarra nga ana e shtetit, (përfshirë këtu censusin e vitit 2011), gjendemi para debatit mes deklarimit zyrtar të shifrave të popullsisë minoritare në vend dhe nga ana tjetër, të mospranimit dhe kontestimit të tyre nga ana e vet minoriteteve. Ky moment konstaton mungesën e të dhënave të sakta statistikore mbi popullsinë minoritare, të dhëna këto që të jenë të besueshme dhe pranueshme nga të gjitha palët.

Në këto kushte, nevojitet realizimi i një procesi të regjistrimit të popullsisë (censusi), të pakontestuar dhe të gjithëpranuar edhe nga minoritetet dhe komunitetet e tjera, i cili do të jepte shifrat reale të popullsisë minoritare, apo edhe të komuniteteve të tjera.

### **3.15. Situata e të drejtave të grupeve vulnerabël (të dobëta)**

#### ***3.15.1. Personat me Aftësi të Kufizuara***

Një ndër grupet e cënueshme, të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në fokusin e tij të punës gjatë vitit 2014 dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Pas ratifikimit të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, në muajin Korrik 2014, u miratua Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Në nenin 16 të tij, Avokati të Popullit i jepet roli si një institucion monitorues për zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

Gjatë vitit 2014 janë depozituar dhe trajtuar 57 ankesa nga anëtarë të këtij grupi. Një ndër problematikat e hasura gjatë vitit 2014 është mospërfitimi i kompensimit të biletave në transportin urban të personave me aftësi të kufizuar. Për këtë arsye, në muajin prill 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me rekomandim Ministrisë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrisë të Financave, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.26/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”; të nenit 11 të Ligjit nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, të ndryshuar; të nenit 11 të Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”; të nenit 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit” si dhe të nenit 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 “Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”. Ende nuk janë nxjerrë aktet nënligjore.

Një çështje tjetër, është ai i mospërfitimit të kompensimit financiar për faturat e energjisë elektrike dhe telefonisë fikse të personave që gëzojnë statusin e të verbërit dhe atij paraplegjik e tetraplegjik, të cilët jetojnë në banesa me qera, pavarësisht se ligjërisht janë

përfitues të atyre kompensimeve, problem i cili ende nuk ka marrë përgjigje dhe pas rekomandimit drejtuar Ministrinë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Për mosdhënien e së drejtës për të përfitur pagesën e aftësisë së kufizuar në Komunën Shalë Dukagjin, Avokati i Popullit i është drejtuar me rekomandim Prefektit të Qarkut Shkodër dhe Kryetarit të Keshillit të Komunës Shalë Dukagjin, për marrjen e masave të menjëherëshme për dhënien e pagesës së aftësisë së kufizuar përfituesve pranë kësaj komune. Duke qenë se këshilltarët nuk kishin konsensus dhe nuk dëshironin të miratonin minimumin jetik për banorët nga të cilët ishin zgjedhur, duke penalizuar të gjithë komunitetin e asaj zone, më datë 24.06.2014 iu drejtua me rekomandim Ministrinë të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrinë të Shtetit për Çështjet Vendore, për ndërhyrjen e tyre në zgjidhjen e çështjes së miratimit sa më të shpejtë të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar në Komunën Shalë, Dukagjin.

Nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, më datë 28.10.2014, jemi informuar se po bashkëpunojnë me Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore për zgjidhjen e problemit dhe çeljen e fondeve për këtë komunë për ndihmën ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar.

Lidhur me heqjen nga skema e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë në institucionet e përkujdesit social, të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe të personave që me vendim të formës së prerë të gjykatës vuajnë dënimin me heqje lirie, në muajin Prill 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka dërguar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë, opinionet dhe vërejtjet lidhur me Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të cilat nuk u morën në konsideratë.

Një sërë problematikash u paraqitën dhe në Projektligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, për të cilën Avokati i Popullit paraqiti sugjerimet e tij pranë Komisionit për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë, por të cilat nuk u morën parasysh. Disa nga sugjerimet tona në këtë aspekt ishte cënimi i përfaqësimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara si dhe konceptimi si ligj kuadër, por që nuk parashikon ndërhyrjet konkrete në legjislacionin ekzistues.

Nga inspektimet e kryera në 9 Qendrat e Përkujdesit Social gjatë vitit 2014, ku trajtohen persona me aftësi të kufizuar me diagnoza të ndryshme, del si një domosdoshmëri, ngritja e qendrave rehabilituese rezidenciale për persona me aftësi të kufizuar mendorë të rëndë.

#### ***Problematikat që kanë personat me aftësi të kufizuara:***

1. Personat me sëmundje të rënda mendore, nuk përfitojnë shërbime sociale dhe shëndetësore si kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu edhe personat me aftësi të kufizuar që banojnë në zonat e thella rurale në shumë raste nuk i përfitojnë këto shërbime. Për këtë qëllim del si një domosdoshmëri identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të këtyre dy kategorive .

2. Personat me aftësi të kufizuar nuk kanë akses në transportin urban publik.

3. Problem shqetësues mbetet aksesimi i personave me aftësi të kufizuar në drejtësi, strukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal, media dhe biznes.

4. Mungesa e përshtatshmërisë së aksesit në ambiente publike dhe private

5. Moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Për t'u siguruar akses personave me aftësi të kufizuar, Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon<sup>105</sup>:

-Në Kodin e Procedurës Civile, në pjesën e parë "Pjesa e Përgjithshme", Titulli i "Parimet themelore të procesit gjyqësor", të shtohet një dispozitë specifike për të garantuar akses në procesin gjyqësor civil për personat me aftësi të kufizuar.

-Në Kodin e Procedurës Penale, te pjesa e parë Dispozita të Përgjithshme të shtohet një dispozitë specifike për të garantuar akses në proces gjyqësor penal për personat me aftësi të kufizuar.

-Në Kodin e Procedurave Administrative, Kreu II, Parime të Përgjithshme, pas nenit 11 të shtohet një dispozitë specifike për të garantuar akses për personat me aftësi të kufizuar në pjesëmarrje në procedura administrative.

-Në Ligjin "Për noterinë", në Kreun II, Hartimi i Akteve, të plotësohen dispozitat specifike për të garantuar shprehjen e plotë dhe të pandikuar të vullnetit të personave me aftësi të kufizuar në hartimin e një akti noterial.

### **3.15.2. Të moshuarit**

Të moshuarit mbeten një nga grupet më vulnerabël në Shqipëri. Problemet e të moshuarve po dalin gjithnjë e më shumë në evidencën sociale të shoqërisë sonë. Duke i parë problemet e kësaj moshe me objektivitet, duhet pranuar dhe kuptuar fakti se situata e të moshuarve në Shqipëri nuk është e mirë. Ato përbëjnë një ndër grupimet më të mëdha numerike të shtresave dhe grupeve në nevojë. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, mund t'i çojë të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri. Ata ndeshen shpesh me barriera shoqërore që ndikojnë në jetët e tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit për vetë natyrën e punës dhe attributeve të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji i ka vlerësuar të gjitha përpjekjet shtetërore dhe publike për t'i parandaluar dhe mundësisht ulur efektin negativ për fenomenet shqetësuese me të cilat përballet aktualisht moshja e tretë. Për të garantuar të drejtat e të moshuarve, kërkohet miratimi i Statusit të Moshës së Tretë.

Lidhur me këtë çështje, më herët Institucioni ynë ka ndërhyrë pranë ish Ministrisë së Punës Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në vazhdimësi të përpjekjeve të mëparshme, gjatë vitit 2014 i jemi drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, nga ana e së cilës kemi marrë përgjigje se është kërkuar rivlerësimi i projektligjit "Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe plotësimi i nevojave për moshën e tretë" si dhe është propozuar që ky projektligj të parashikohet në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2015. Do të vazhdojmë ndërhyrjen tonë institucionale pranë institucioneve përkatëse. Në mbrojtje të të drejtave të të moshuarve edhe gjatë këtij viti kemi kryer inspektive në qendrat sociale rezidenciale dhe ditore për të moshuarit. Pas problemeve të konstatuara, i jemi drejtuar me rekomandime Kryetarëve të bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror për përmirësim të kushteve fizike ku qëndrojnë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre.

Nisur nga ankesa të caktuara, kemi evidentuar problematika që çënojnë më shumë se një individ. Duke marrë shkas nga një ankesë e një pensionisteje të vetme lidhur me tarifat e larta vendore, për kategorinë e shtetasve që përfitojnë pension pleqërie, por që sipas çertifikatës së gjendjes familjare rezultojnë të jenë kryefamiljare, të vetmuar dhe masa e pensionit që ato gëzojnë është shumë e ulët, duke mos përballuar jetesën e përditshme, shlyerjen e detyrimeve mujore, si: shpenzimet për energjinë elektrike, ujin, për medikamentet mjekësore, për ushqimin etj, i sugjeruam Këshillit Bashkiak Pogradec për të parë mundësinë

<sup>105</sup> Këto rekomandime do të adresohen në vazhdimësi nga Institucioni i Avokatit të Popullit drejtuar Institucioneve përkatëse, të cilat janë bërë prezente dhe në takimet e përbashkëta BE- Qeveria shqiptare për zbatimin e 5 prioritetëve, gjatë muajit shtator 2014

e uljes së masës së tarifave vendore për këtë kategori. Kryetari i Bashkisë Pogradec, duke marrë në konsideratë sugjerimin tonë, na informoi se do t'i drejtohet Këshillit të Bashkisë për uljen e masës së tarifave vendore për kategorinë e pensionistëve që janë të vetmuar, e cila do të ndiqet në vazhdim dhe nga ana institucionit tonë.

Shteti dhe vetë shoqëria shqiptare duhet të vazhdojnë të forcojnë mekanizmat socialë dhe ekonomike në mbështetje të të moshuarve.

### ***3.15.3. Ish të përndjekurit politik***

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar ankesa, apo kërkesa të individëve ish të dënuar politikë të regjimit komunist, si dhe të trashëgimtarëve të tyre. Problematikat e parashtruara në këto ankesa kanë të bëjnë me pretendimet për: mospërfitimin e kësteve të dëmshpërblimit që përfitojnë si ish të dënuar politikë ose moscaktimin korrekt të masës së dëmshpërblimit nga Ministria e Drejtësisë, mospërfitimin në mënyrë të padrejtë të dëmshpërblimit në kushtet e cilësuar nga ligji<sup>106</sup>; mosgjetjen e eshtrave të të afërmeve ish të dënuar politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; zvarritjen e procedurave për caktimin e masës së dëmshpërblimit; zvarritjen e procesit të dëmshpërblimit për grupimin e të internuarve, sipas parashikimeve të ligjit.

Edhe gjatë vitit 2014, i është dhënë përparësi dhe janë trajtuar me kujdes ankesat e drejtuara nga këta individë në një këndvështrim shumë më të gjerë se sa një vit më parë dhe konkretisht sa i përket ecurisë së procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, procesit të munguar dhe të vonuar njëkohësisht të hapjes së dosjeve, si dhe funksionimit të Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist.

Lidhur me ecurinë e procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, sa i përket parashikimeve të bëra në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, theksojmë se mbeten ende problematika të pazgjidhura dhe që kërkojnë veprim të shpejtë dhe konkret.

Megjithë rekomandimin tonë të mëparshëm, për nevojën e realizimit të inisiativës legislative, për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, për ish të përndjekurit politikë të regjimit komunist, kjo gjë nuk ka ndodhur.

Ndërkohë, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr.684 datë 15.10.2014<sup>107</sup> “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.419 datë 14.04.2011”, i cili në thelb është rregullim i çështjeve teknike të mënyrës se, si do të bëhet shpërndarja e fondeve të miratuara nga qeveria për dëmshpërblim. Edhe ky vendim, nuk zgjidh atë që ne kemi theksuar në rekomandimet tona, pasi nuk ka të përcaktuar një afat taksativ për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit.

Gjithashtu, duhet të plotësohet baza e nevojshme ligjore, e cila do të mundësojë procesin e dëmshpërblimit financiar për kategorinë e personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist të përcaktuara në gërmën “c”, të nenit 6, të Ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Pavarësisht kërkesave të subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave ende nuk ka miratuar skemën e pensionit me VKM përkatës, skemë nga e cila do të përfitojnë dëmshpërblimin këto kategori

<sup>106</sup> Ligji nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” i ndryshuar,

<sup>107</sup> Ky vendim është nxjerrë në zbatim të nenit 6, të ligjit 94/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politike të regjimit komunist”, të ndryshuar.



ish të dënuarish politikë, për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 ka paraqitur rekomandimin përkatës drejtuar Ministrinë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (*Sot Ministria e Mirëqënies Sociale*) dhe Ministrinë të Drejtësisë.

Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, nisur nga ankesa të paraqitura nga individë ish të persektuar politikë, por edhe në një kuadër më të gjerë angazhimi institucional për krijimin e standardeve të mirëqeverisjes ka vlerësuar dhe vlerëson se, shoqëria jonë meriton të dijë se cilët e qeverisin dhe mbrojnë interesat e saj, përmes një **procesi transparent të hapjes së dosjeve**. Në këtë këndvështrim, gjykojmë se një nga çështjet e vonuara dhe ende të pazgjidhura të shoqërisë sonë, mbetet miratimi i një ligji gjithpërfshirës e të mbështetur në parimet ekzistenciale të një shoqërie demokratike, për hapjen e dosjeve.

Në gjykojmë se, një ligj i tillë, për më tepër pas kaq vitesh tranzicion, nuk duhet të kthehet në një ligj “represiv” ndaj disa individëve të caktuar, por në një mundësi reflektimi për shoqërinë në tërësi. Duke vlerësuar realisht si një proces të nevojshëm hapjen e dosjeve, institucioni i Avokatit të Popullit përmes një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile ka përgatitur dhe i ka dërguar një rekomandim në muajin Mars 2014, Kryeministrin të Republikës së Shqipërisë, për të realizuar iniciativën përkatëse ligjore. Ndërkohë, konstatohet si pozitiv reagimi për draftimin e një ligji të tillë qoftë nga shoqëria civile, apo edhe nga Ministria e Mirëqënies dhe Çështjeve Sociale, proces i cili mbetet për t’u vlerësuar me produktin që do të dalë pas miratimit të aktit përkatës ligjor dhe efekteve që ai do të sjellë.

Në institucionin e Avokatit të Popullit, në mënyrë të vazhdueshme janë paraqitur ankesa dhe kërkesa nga Shoqata të të persektuarve politikë gjatë regjimit komunist, si dhe nga familjarë të personave të ekzekutuar gjatë këtij regjimi, ku kërkohet ndërhyrja e Avokatit të Popullit pranë institucioneve shtetërore kompetente për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar, gjatë viteve të regjimit komunist, të cilëve ende nuk iu është gjetur vend-varrimi.

Në funksion të kësaj veprimtarie dhe për lehtësimin dhe koordinimin e saj, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.133 datë 24.02.2010 “Për Krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist”, ka vendosur krijimin e task forcës në fjalë, duke përcaktuar objektin e punës, përbërjen dhe detyrat e anëtarëve të saj. Problematika e mosfunksionimit normal të Task Forcës, të ngritur me Vendimin nr.133 datë 24.02.2010 të Këshillit të Ministrave, është evidentuar edhe në takimet e shpeshta që, Avokati i Popullit ka zhvilluar me përfaqësues të shoqatave të ish të përndjekurve dhe ish të dënuarve politikë në vend, nga të cilët është kërkuar ndërhyrje sa më e shpejtë për vënien në efikasitet të saj, për t’i shërbyer qëllimit për të cilin është ngritur.

Sipas problematikave me të cilat është ndeshur funksionimi i Task Forcës, bazuar në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e saj, kemi konstatuar se:

- Nevojitet përcaktimi konkret, i afatit kohor të raportimit periodik të anëtarëve të Task Forcës pranë kryetarit të saj, lidhur me ecurinë e punës dhe rezultatet e arritura nga institucioni që, anëtari përfaqëson.

- Kjo Task Forcë nuk ka marrë asnjë financim nga ana e shtetit, si dhe nuk i është krijuar asnjë mjedis pune.

- Mungon ngritja e një zyre (Zyra e personave të zhdukur), e cila do të merrej me depozitimin e kërkesave, si dhe me regjistrimin e ADN-ve të familjarëve, të personave të zhdukur. Do të ishte e llogjikshme në këtë kuptim që kjo zyrë të kryente edhe përcaktimin e ADN-së së eshtrave të gjetura rast pas rasti, me qëllim krahasimin e tyre me AND-në e familjarëve të interesuar.

- Nuk ka një afat fundor të përcaktuar, mbi kohën e veprimit dhe funksionimit të Task Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist.

Task Forca nuk disponon asnjë mjet për të ndërmarrë kërkime në terren, apo zhvarrime.

-Nuk është ngritur ende, pas më shumë se katër vitesh nga koha e hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.133 datë 24.02.2010, Sekretariati Teknik i Task Forcës.

Bazuar në këto problematika të vërejtura kemi gjykuar se, zgjidhja e tyre lidhet tërësisht me efektivitetin dhe eficientësinë që duhet të ketë Task Forca në punën e saj, proces i cili lidhet me realizimin e të drejtave të ish të persekutuarve dhe ish të dënuarve gjatë viteve të regjimit komunist dhe më konkretisht të familiarëve të tyre, të cilët kërkojnë gjetjen e njerëzve të afërt, të zhdukur prej kaq vitesh. Bazuar në të gjitha këto konstatime kemi arritur paraprakisht në konkluzionin e domosdoshmërisë së përmirësimit të dispozitave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.133 datë 24.02.2010, duke shtuar në të parashikime që saktësojnë dhe zgjidhin problematikën që ka shoqëruar dhe shoqëron funksionimin normal dhe efektiv të Task Forcës.

Për këtë qëllim i kemi dëgjuar në datën 16.05.2014, Ministrin të Punëve të Brendshme, Ministrin të Drejtësisë, Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme në cilësinë e kryetarit të Task Forcës, si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përkatësisht dy rekomandime, me objekt:

*“Hartimin dhe miratimin në një kohë sa më të shpejtë të rregullores së funksionimit të Task Forcës, për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist. Për problematikën e financimit nga ana e shtetit nominalisht për Task Forcën; krijimit të një mjedisi pune; ngritjes së një zyre që do të merret me depozitim të kërkesave, si dhe me regjistrimin e ADN-ve të familjarëve, të personave të zhdukur dhe të përcaktimit të ADN-së së eshtrave të gjetura rast pas rasti; përcaktimit të një afati fundor kohor për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të përcaktuara për Task Forcën në VKM nr.133 datë 24.02.2010; si dhe të vënies në dispozicion të mjeteve për të ndërmarrë kërkime në terren, apo zhvarrime; rekomandojmë që në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të realizohet inisiativa legislative, për disa përmirësime të nevojshme, në Vendimin nr.133 datë 24.02.2010 të Këshillit të Ministrave”,*  
*“Marrjen e masave për ngritjen në një kohë sa më të shpejtë, të Sekretariatit Teknik të Task Forcës, për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist”.*

Në përgjigje të këtyre rekomandimeve, me anë të shkresës nr.4320/2 datë 2.06.2014, Zëvendësministri i Punëve të Brendshme në cilësinë e kryetarit të Task Forcës, ka identifikuar disa problematika thelbësore që lidhen me, pamundësinë e funksionimit real të kësaj strukture, nisur nga mënyra e krijimit të saj dhe ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në objektin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore të përfshira në të. Gjithashtu në përgjigje të rekomandimit të Avokatit të Popullit, Zëvendësministri i Punëve të Brendshme thekson se pas ndryshime të bëra me VKM nr. 942 dt 9.10.2013, *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, nuk përfshihen si kompetenca të MPB-së fusha e kërkimit, identifikimit dhe zhvarrimit”.*

Në këto kushte kemi theksuar se, është krejtësisht e pajustificueshme që një strukturë shtetërore e ngritur mbi këto parime të jetë pothuajse inekzistente dhe mosvepruese, kur pritshmëritë e publikut dhe personave të interesuar veçanërisht, janë të mëdha. Sa më sipër, i kemi drejtuar me një rekomandim në datën 25.06.2014, Kryeministrin të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrin të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për realizimin e inisiativës legislative, për ngritjen e një strukture të re shtetërore, efektive, me objekt veprimtarie kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist. Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka

konfirmuar nisjen e punës për krijimin e zyrës për gjetjen e të zhdukurve, proces i cili pritet të finalizohet së shpejti.

#### ***3.15.4. Të drejtat e Komunitetit LGBTI (Interseks)***

Avokati i Popullit i konsideron të drejtat e personave LGBTI-(interseks) si pjesë të pandashme të tërësisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë është shprehur qartë se nuk duhet të ketë pengesa ligjore për personat e komunitetit LGBTI në realizimin e të drejtave, të cilat gëzohen nga pjesa tjetër e shoqërisë. Avokati i Popullit së bashku me Këshillin e Evropës i ka propozuar Ministrisë së Mireqënies Sociale dhe Rinisë disa ndryshime në Kodin e Familjes, ku kjo e fundit me iniciativën e saj ka propozuar disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9062, Datë 05.08.2003 “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”, dhe më konkretisht ndryshimin e neneve 163 dhe 164 në lidhje me Bashkëjetesën midis dy personave të të njejtë seks, si dhe kushtet dhe procedurat e regjistrimit, pasojat e regjistrimit, dhe mënyrat e përfundimit të bashkëjetesës dhe marrëdhëniet personale e pasurore ndërmjet bashkëjetuesve rregullohen me ligj të veçantë.

Rishikimi i Legjislacionit në lidhje me çështjen LGBTI mbetet një domosdoshmëri. Njohja ligjore e gjinisë së tretë apo e të drejtës së qytetarëve për të ndryshuar gjininë sipas mënyrës si ata ndihen mbetet një domosdoshmëri. Në Shqipëri personat LGBTI nuk gëzojnë të drejtën e martesës, unioneve civile etj. Përsa i përket problematikave të Komunitetit LGBTI mund të themi se marrja e masave anti-diskriminim në mjedisin e punës mbetet prioritet. Fëmijët dhe të rinjtë LGBTI vuajnë pasojat të rënda të diskriminimit dhe bulizmit në mjediset shkollore. Stafet mësimore mbeten të pa-përgatitura për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve me bulizmin. Edukimi seksual dhe ai mbi çështjen LGBTI mbetet i cekët dhe i pa-plotë.

Shërbimet mjekësore ndaj personave LGBTI vazhdojnë të jenë jo-miqësore. Ata nuk preferojnë të flasin hapur me mjekët për orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor, ndërkohë që nuk i perceptojnë mjekët si burim informacioni për problemet dhe nevojat e tyre. Në vitin 2014 Avokati i Popullit ka mbledhur mjaft raportime nga persona të Komunitetit që kanë pasur të bëjnë me diskriminimin për shkak të identitetit gjinor, fjalime urrejtjesh në media sociale nga persona publikë, publikime diskriminuese dhe me përmbajtje të lartë urrejtje nga politikanë dhe figura të tjera publike.

Gjatë aktivitetit të Avokatit të Popullit mund të përmendim dhe përgatitjen e një sere fletëpalosjesh, posterash dhe manualesh të cilat do të shërbejnë komunitetit LGBTI, e cila është bërë me mbështetjen e projektit Danez. Duke parë që Shqipëria, nuk ofron mbrojtje ligjore për personat LGBTI, ata janë të detyruar të largohen dhe të kërkojnë azil në shtetet perëndimore. Avokati i Popullit duke u bazuar në këtë problematike ka dhënë kontributin e tij me përgatitjen e një raporti për Azilkërkesit në muajin Shkurt 2014 me emërtimin “Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të Zonës Shengen”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në ligj, do të vazhdojë aktivitetin e tij në drejtim të përmirësimit të situatës së zbatimit të masave të parashikuara për komunitetin LGBTI, e përfshirë në Prioritetin 5 të Komisionit Europian (Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut) . Në datën 4 Dhjetor 2014, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në Nën/komisionin për të Drejtat e Njeriut në Kuvend, lidhur me shqyrtimin e Raportit të Veçantë “Për të drejtat e Komunitetit LGBTI” të hartuar nga ky Institucion në muajin Gusht të vitit 2012.

Gjatë diskutimeve të bëra në këtë Nën-komision, Avokati i Popullit ngriti dhe problematikën lidhur me mos-miratimin e propozimeve të bëra nga institucioni i tij për ndryshim të Kodit Penal, ku ndër të tjera mund të përmendim propozimin e ndryshimit të

neneve 119/a dhe 119/b, ku të parashikohet si vepër penale shpërndarja e materialeve homofobike si dhe fyerjes nëpërmjet rrjetit kompjuterik për motive të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor. Avokati i Popullit ka kërkuar një përfshirje më të madhe të Kuvendit në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBTI.

Në këtë drejtim Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kërkuar Kuvendit të miratojë një rezolutë në mbështetje të këtij komuniteti dhe të monitorojë nga afër respektimin e të drejtave të tyre nga institucionet përkatëse.

### ***3.15.5. Për të drejtat e fëmijëve***

20 Nëntori 2014 shënoi 25 vjetorin e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara të Konventës “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, dokumentin e parë ligjërish të detyrueshëm ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në të gjithë spektrin e tyre: civil, kulturor, ekonomik, politik e social. Rëndësi e veçantë e dhe gjatë vitit 2014, i është kushtuar lobimit për krijimin e një strukture të veçantë e të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Me ndryshimet në Ligjin “Për Avokatin e Popullit” (Ligji nr.155/2014 dt.27.11.2014) është parashikuar krijimi i një Seksioni të veçantë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve brenda Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky seksion do të jetë garantues i zbatimit të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe do të veprojë për të promovuar të drejtat e tyre në Parlament, Qeveri dhe në shoqërinë civile, do veprojë si mediator në marrëdhëniet ndërinstitucionale, do ndikojë gjithashtu në politikat, duke krijuar forume ku do të dëgjohet zëri i fëmijëve, duke riparë aksesin e tyre në sistemin e ankimit dhe për t’ju përgjigjur ankesave individuale.

Ngritja e mekanizmave eficientë për zbatimin e legjislacionit dhe strategjive ekzistuese dhe fuqizimi, shtrirja dhe forcimi i Njërive për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë edhe në kuadrin e reformës territoriale përbëjnë hapa që do të ndihmojnë në eliminimin e fenomeneve të dëmshme për jetën, shëndetin dhe mirëritjen e fëmijëve.

Edhe në kuadrin e mbështetjes së Mbretërisë së Danimarkës, Institucioni i AP, ka vijuar punën për inspektimet në të gjitha qendrat rezidenciale të shërbimeve për fëmijët-shtëpi fëmije, shtëpi foshnje dhe qendrat e Zhvillimit. Problemet kryesore për të cilat janë dhënë rekomandime kanë qenë jo vetëm puna për përmirësimin e infrastrukturës së këtyre institucioneve, por edhe përmirësimi i punës për zbatimin e plotë të standarteve të përkujdesit shoqëror. Vlerësojmë bashkëpunimin e frytshëm të Shërbimit Social Shtetëror jo vetëm në kryerjen e këtyre inspektimeve, por edhe në frymën e mirëkuptimit e iniciativave për të vlerësuar objektivisht rekomandimet tona, për garantimin e interesit më të mirë të fëmijëve. Problemi i autizmit ka prekur një numër të konsiderueshëm fëmijësh, kjo është bërë e ditur nga informacionet në mediat e ndryshme. E konsiderojmë të nevojshme ndërhyrjen e shtetit për rregullimin e disa aspekteve që ndikojnë në zhvillimin, mirëritjen e edukimin e kësaj kategorie të fëmijëve. Ndaj i jemi drejtuar dy ministrive (të Shëndetësisë dhe të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë) për informacion lidhur me iniciativat institucionale për konsiderimin e kërkesave që prindërit me fëmijë autikë kanë paraqitur pranë Zyrës sonë<sup>108</sup>, duke dhënë dhe afatet kohore kur mund të gjejnë zgjidhje këto kërkesa. Duke mos e vënë në dyshim që ka një faturë financiare për këto lloj ndërhyrjesh sidomos për kushte e trajtim më të mirë financiar për familjet në fjalë, e konsiderojmë tejet të rëndësishme vendosjen në “rendin e ditës” edhe të kësaj problematike. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të përbëjë parimin udhëheqës në punën e vendimmarrjes e çdo institucioni. Tashmë kemi marrë vetëm përgjigjen e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkohë që kemi përsëritur kërkesën për Ministrinë e Mirëqënies Sociale

<sup>108</sup> Shkrese 18.06.2014 dhe 8.07.2014

dhe Rinisë. Nga Ministria e Shëndetësisë kemi marrë përgjigjen për ndërgjegjësimin mbi dimensionin social të rëndësishëm që ka mbështetja e trajtimit të fëmijëve të prekur nga autizmi si dhe familjeve të tyre, si dhe të angazhimit të këtij Institucioni për ta bashkërenduar punën me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për të siguruar mbrojtjen e nevojshme sociale. Problematika do të vijojë trajtimin nga ana jonë.

Problem tjetër i konstatuar është mungesa e aksesit në arsim e kategorisë PAK, ndaj e konsiderojmë të rëndësishme bashkërendimin e punës midis disa Ministrive për të siguruar mbrojtjen e nevojshme sociale kësaj kategorie të fëmijëve.

Këtë vit u mblodh Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e Të drejtave të Fëmijëve, ku merr pjesë edhe institucioni i Avokatit të Popullit. Reforma në sistemin e shërbimeve sociale që prek edhe fëmijët fokusohet në deinstitutionalizimin dhe decentralizimin. Në këtë drejtim pushtetit vendor i takon të marrë siç duhet përgjegjësitë lidhur me ofrimin dhe ndihmën për përmbushjen e standarteve të shërbimeve sociale.

Problem tjetër i konstatuar nga disa raste të ndërmarrë me iniciativë shqyrtimi është infrastruktura e dobët në disa shkolla të arsimit publik, e për të cilat i kemi dhënë rekomandimet përkatëse pushtetit vendor dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar:

*1-Marrjen e masave për çeljen e fondeve për rikonstruksionin e plotë të shkollës 9-vjeçare Thanasaj në Komunën Dushk të rrethit Lushnjë dhe të shkollës “Dylber Kurtina” në Komunën Shirgjan të rrethit Elbasan.*

*2-Të shikohet me prioritet vlerësimi i situatës së infrastrukturës së shkollave në nivel kombëtar si dhe financimi i investimeve të shkollave në Komunitet ose Bashkitë me nivel të ulët të ardhurash, duke i dhënë prioritet atyre që kanë kohë që nuk janë rikonstruktuar.*

Për rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare Thanasaj në Komunën Dushk të Lushnjës, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje pozitive nga MAS. Me qëllim planifikimin e fondeve, janë orientuar njësinë e qeverisjes vendore (Komunën Shirgjan) që të aplikojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2015 sipas legjislacionit në fuqi, për rikonstruksionin e shkollës.

### **3.15.6. Të drejtat e grave**

Të drejtat e grave në të gjitha fushat kanë patur një vëmendje më të madhe gjatë vitit 2014 nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në këtë aspekt kemi nxjerrë një sërë të dhënash lidhur me dhunën ndaj gruas në familje ashtu si dhe të dhëna të tjera nga ankesat e trajtuara duke evidentuar elementin me bazë gjinore për të vlerësuar respektimin e të drejtës së grave në Shqipëri<sup>109</sup>.

Dhuna me bazë gjinore, e veçanërisht dhuna ndaj grave në familje, vazhdon të mbetet një fenomen mjaft i përhapur dhe problematik për shoqërinë tonë. Ndaj është emergjente konsolidimi i mëtejshëm i mekanizmave të referimit për dhunën në familje, e në këtë drejtim koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore duhet të përmirësohet, si edhe duhet të ngrihen strukturat që mungojnë, konkretisht streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat. Aplikimi i politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi e formimi profesional, janë qasje që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së grave dhe vajzave.

Përmirësimi i asistencës e ndihmës ndaj viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve përbën një nga sfidat e vendit tonë. E po ashtu edhe vijimësia

<sup>109</sup> Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit po përgatit një raport hije për zbatimin e Konventës CEDAW nga shteti Shqiptar, i cili së shpejti do të depozitohet pranë Komisionit të Kombeve të bashkuara për Konventën CEDAW.

e përpjekjeve me synimin e luftës dhe hetimit të rasteve të dhunës në familje dhe sigurimi i hetimit dhe gjykimit të tyre me gjithë forcën e ligjit.

Në aspektin ligjor, sfida mbetet përafrimi në vazhdimësi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare, si dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit aktual.

Së fundmi, konsiderojmë se aplikimi i politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ri-trajnimi me synim përmirësimin e gjendjes ekonomike të grave, janë qasje që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së grave dhe vajzave.

## KREU 4

### ROLI PROMOVUES/PROAKTIV I AVOKATIT TË POPULLIT NË RESPEKTIM TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

#### 4.1. Shërbimet ndaj qytetarëve nëpërmjet rritjes së rolit proaktiv të Institucionit dhe funksionimit të zyrave rajonale

Viti 2014 shënoi një qasje të re të institucionit të Avokatit të Popullit në marrëdhënie me qytetarët, përmirësimin e shërbimeve ndaj tyre, si dhe respektimin e afateve ligjore në shqyrtimin e ankesave.

Vizioni i Avokatit të Popullit i shprehur dhe në strategjinë 3-vjeçare të institucionit (2012-2015) e cila mbështetet dhe financohet nga Qeveria e Danimarkës, ka patur në fokusin e tij mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve, përmes kultivimit të një kulture të re dhe standarteve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe në rritjen e aksesit të qytetarëve për të adresuar në kohë ankesat e tyre ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Tashmë institucioni i Avokatit të Popullit, funksionon me zyrën e pritjes dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve jo vetëm në Tiranë, por gjatë vitit 2014 është shtrirë me zyrat rajonale edhe në shtatë prej qendrave më të mëdha administrative nga veriu në jug të vendit dhe konkretisht në bashkitë Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Pogradec, Sarandë dhe Dropull. Zyrat rajonale me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, janë pika të rëndësishme kontakti me qytetarët për marrjen e ankesave, por njëkohësisht prania e tyre në këto rajone, ka ngushtuar distancën dhe ka afruar institucionin e Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve. Ndërkohë zyra rajonale e Dropullit është e një rëndësie dhe specifike të veçantë për Avokatin e Popullit. Në fokusin e saj, përfshihet marrja e ankesave dhe informacionit rreth problemeve që shqetësojnë popullsinë minoritare që jeton aty. Por njëkohësisht ajo është dhe një simbol i garantimit të të drejtave kushtetuese të minoriteteve në Shqipëri dhe prezencës të shtetit me mekanizma që ju vijnë sa më parë në ndihmë kësaj popullate.

Ngritja dhe funksionimi i zyrave rajonale, është kontribut i një bashkëpunimi institucional të Avokatit të Popullit me drejtuesit e njësisve të qeverisjes vendore për sigurimin e zyrave, mbështetjen financiare të Qeverisë të Danimarkës për kompletimin e zyrave me të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme të punës, si dhe një bashkëpunimi efikas me organizatat e shoqërisë civile të cilat bënë të mundur sigurimin e personave që sot janë përfaqësues të Avokatit të Popullit në këto rajone, duke punuar me përkushtim ndaj kësaj detyre në mënyrë tërësisht vullnetare, pa asnjë lloj përfitimi financiar.

Forcimi i kapaciteteve të punonjësve në zyrën e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarëve dhe në zyrat rajonale, ka qenë dhe mbetet në fokusin e punës të Avokatit të Popullit. Për këtë qëllim, me specialistët e pritjes të qytetarëve janë organizuar trajnime, seminare, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe vizita pune brënda dhe jashtë vendit, aktivitete këto që kanë ndikuar në ngritjen profesionale, rritjen e performancës, përmirësimin e etikës dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Një nga mjetet efikase, është forcimi i një komunikimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët, për t'ju përgjigjur interesimit të tyre rreth objektit të ankesave dhe rrugët që duhet të ndjekin për zgjidhjen e të drejtës të pretenduar prej tyre.

Ngritja e zyrave rajonale ka sjellë një prezencë të re të institucionit të Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve, duke ju mundësuar informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve, si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brënda një kohe të shkurtër dhe optimale.

Në kushtet që ofron zhvillimi i teknologjisë dhe informacionit, Avokati i Popullit ka hapur gjithashtu dhe një sërë shërbimesh online në interes të qytetarëve që kanë mundësi aksesit në internet, për të kryer plotësimin e ankesave online.

Kështu në faqen zyrtare të Eëb-it të institucionit është krijuar një Portal i veçantë, ku qytetarët mund të bëjnë ankesat e tyre dhe në çdo kohë mund të kontrollojnë se kush nga ekspertët e institucionit e trajton ankesën, njihet me përgjigjet e institucioneve me të cilët lidhet objekti i ankesës, si dhe mund të marrë përgjigjen përfundimtare të ankesës, pa prituri afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Duke qënë se kjo është një praktikë e re (aplikuar për herë të parë në muajin shtator 2014) dhe e pa njohur nga qytetarët, numri i ankesave të qytetarëve gjatë këtij viti nuk ka qënë tepër i lartë.

Aplikimin e ankesës online përmes Portalit, ne e konsiderojmë si një mundësi mjaft efektive për qytetarët pasi ajo shkurton distancën, kohën e plotësimit dhe shqyrtimit të një ankese, por ndërkohë kjo mënyrë rrit së tepërmi dhe transparencën e institucionit përballë qytetarëve. Qytetari në çdo kohë përmes kodit të tij personal, ndjek rrugën si qarkullon ankesa, emrin e ekspertit, kohën e trajtimit të saj prej institucioneve publike përgjegjëse, cilësinë e përgjigjeve të shkresave, deri në mbylljen përfundimtare të praktikës.

Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve kanë adresuar ankesat e tyre edhe nëpërmjet adresave zyrtare të email-it të Avokatit të Popullit, adresave zyrtare në rrjetet sociale Facebook dhe Tëiter, si dhe numrit të telefonit të publikut **0689034648** i cili qëndron hapur gjatë 24 orëve, si dhe numrit jeshil **0800 1111**.

Në rastet e këtyre ankesave, pasi qytetari dërgon ankesën e tij online apo me telefon, specialistët e zyrës të pritjes bëjnë verifikimin e objektit të ankesave, identifikimin e të dhënave personale të ankuesit, si dhe adresat me kontaktet e tyre, me qëllim që ankesa të mos konsiderohet pa objekt dhe anonime. Këto alternativa ne i konsiderojmë si një mundësi për të marrë sa më shumë ankesa nga qytetarët, por njëkohësisht dhe si një mënyrë komunikimi me miqtë e Avokatit të Popullit, rreth temave dhe debateve në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Organizimi i “Ditëve të hapura” nga Avokati i Popullit, komisionerët dhe stafi i institucionit, janë kthyer në një traditë të suksesshme në marrëdhëniet e Institucionit të Avokatit të Popullit me qytetarët, me administratën e pushtetit vendor, drejtuesit e njësisve të qeverisjes vendore, si dhe me përfaqësuesit dhe rrjetin e shoqërisë civile në nivel lokal.

Në takime, qytetarët janë informuar mbi objektin e punës të Institucionit, është komunikuar me ta mbi rrugën e ndjekur për zgjidhjen e ankesave, si dhe janë pranuar për shqyrtim ankesat që kanë si objekt, kundërshtimin e veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike. Më tej, trajtimi i ankesave i është nënshtruar një hetimi dhe ekspertizë më të gjërë nga ana e ndihmës/komisionerëve, duke konsideruar qytetarin jo vetëm një subjekt të së drejtës dhe detyrimet që ka administrata publike për plotësimin e tyre, por si janë zbatuar këto detyrime në raport me standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e së drejtës. Gjithashtu në kushtet e mungesës të informacionit, një pjesë e qytetarëve janë këshilluar dhe orientuar, për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për të kërkuar dhe vendosur në vend të drejtën e pretenduar prej tyre. Të tilla aktivitete janë zhvilluar në bashkitë Vlorë, Sarandë, Dropull, Fier, Lushnjë, Berat, Pogradec, Korçë, Lezhë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Durrës dhe Tiranë. Më tej, problematikat e shtruar nga qytetarët janë bërë prezent drejtuesve të njësisve vendore për t’i konsideruar në punën me administratat e tyre, si dhe kemi



bërë sensibilizimin e shqetësimeve të qytetarëve në takimet me grupet e shoqërisë civile dhe median lokale.

Për periudhën e vitit 2014 në zyrën e shërbimeve ndaj qytetarëve, zyrat rajonale dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit atij postar dhe online, janë depozituar **3969** ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat **2572** ankesa kanë qenë pjesë e objektit të punës së institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar “*brenda juridiksionit dhe kompetencës*“ dhe **1397** ankesa janë trajtuar në formën e “*këshillimeve dhe orientimeve*”, mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t’u drejtohen.

Për vitin 2014, situata e përgjithshme e ankesave të hyra dhe të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit paraqitet si më poshtë:

- Zyra e Shërbimeve ndaj Qytetarëve	<b>1449</b>	<b>ankesa</b>
- Ankesa në rrugë postare	<b>1394</b>	“
- Ditë të Hapura	<b>367</b>	“
- Zyrat Rajonale	<b>249</b>	“
- Ankesa online ( <i>Portali, e-mail dhe rrjete sociale</i> )	<b>380</b>	“
- Ankesa me telefon ( <i>telefon fix, mobil dhe numrin jeshil</i> )	<b>130</b>	“

Rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin dhe ngritjen e cilësisë së punës të stafit të institucionit, ka luajtur Zyra e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarit. Nisur nga përmbajtja e ankesave të prezantuara nga qytetarët, të cilat nuk janë objekt i punës të Avokatit të Popullit, specialistët ju kanë ofruar qytetarëve këshillimin ligjor, mbi rrugët që duhet të ndjekin për rivendosjen e së drejtës së pretenduar prej tyre.

Krahas detyrës për pritjen e qytetarëve dhe dhënien e informacionit të nevojshëm mbi procedurat e marrjes të ankesave, zyra e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarit ka shërbyer dhe si një “filtër” për ndarjen e ankesave me objekt “*brenda juridiksionit dhe kompetencës*” dhe në “*këshillime dhe orientime*”, mbi bazën e kërkesave të ligjit për “*Avokatin e Popullit*”.

Numrin më të madh të ankesave të vlerësuara jashtë objektit të punës të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 e përbëjnë ankesat e qytetarëve që kundërshtojnë vendimet e formës së prerë të gjykatave si dhe vendimet e prokurorive për pushim të çështjeve të caktuara. Ndaj këtyre ankuesve, qytetarëve u është dhënë këshilla ligjore për të ndjekur shkallët e ankimit sipas shkallëve të sistemit gjyqësor. Gjithashtu, në lidhje me ankesat me objekt kundërshtimin e vendimeve për pushim të çështjeve në prokuroritë e rretheve gjyqësore, qytetarët janë këshilluar t’u drejtohen me ankesë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Një grup i konsiderueshëm qytetarësh janë drejtuar tek Avokati i Popullit me ankesa që kanë objekte të ndryshme si, probleme punësimi, për mos përfitim të tokës bujqësore, për kundërshtim të vendimeve të marra nga ana e KMCAP-it rajonal dhe qendror në lidhje me pagesat e aftësisë së kufizuar etj, për të cilat qytetarët janë këshilluar t’u drejtohen institucioneve përkatëse ligjzbatuese, apo tu drejtohen dhe gjykatave në rastet kur e përmban dhe ligji.

Konflikti brenda familjes ngelet shqetësues për shoqërinë dhe shtetin shqiptar. Në rastet e këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar dhe orientuar të parandalojnë ngjarjet e rënda duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e policisë dhe të prokurorisë dhe në rastet e konstatimit të vonësive dhe zvarritjeve nga ana e këtyre organeve, t’i drejtohen menjëherë Avokatit të Popullit për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese dhe ligjore. Në lidhje me ankesat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të grave nga dhuna e ushtruar nga persona brenda dhe jashtë familjes, personat e ankuar janë këshilluar t’i drejtohen organeve të policisë dhe më tej gjykatës për t’u pajisur me urdhëra mbrojtje sipas ligjit.

## **4.2. Nxitja e të drejtave të njeriut në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Raporteve të Veçanta**

Gjatë vitit 2014 institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur gjithësej 7 raporte të veçanta, të cilat janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë. Përgatitja dhe paraqitja në Kuvend e Raporteve të veçanta bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 63, pika 2 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”*, si dhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku thuhet se: *“Përveç raportimit vjetor, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh”*. Raportet e veçanta të Avokatit të Popullit janë munduar të sjellin në vëmendje të Kuvendit dhe Ekzekutivit probleme dhe tematika emergjente, të cilat janë gjykuar se kanë nevojë për t’u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Ajo që ka rëndësi në këtë proces dhe që të konsiderohet si një cikël i mbyllur i punës sonë është jo vetëm paraqitja e këtyre raporteve të veçanta në Kuvend por edhe shqyrtimi nga Kuvendi i tyre, me qëllim adresimin e problematikës në mënyrë të përshtatshme dhe marrjen e masave të përshtatshme për përmirësimin e situatës të të drejtave specifike.

Nga një numër total rreth 20 raportesh të veçanta të depozituara në Kuvendin e RSH-së gjatë këtyre 3 viteve të fundit, vetëm këto muajt e fundit ka filluar shqyrtimi i tyre nga Komisionet e përhershme pranë Kuvendit të RSH-së.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar 4 raporte të veçanta të depozituara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 dhe 2013, konkretisht si Raporti i veçantë për gjakmarrjen, raporti për monitorimin e spitaleve, raporti për LGBT dhe raporti për dhunën ndaj gruas. Gjatë gjithë këtyre viteve, diskutimi dhe shqyrtimi i raporteve të Avokatit të Popullit nuk është realizuar, dhe vetëm muajt e fundit nentor – dhjetor 2014, filluan të shqyrtohen raportet e para të veçanta nga Komisionet ose nënkomisionet e përhershme të Kuvendit. Avokati i Popullit gjatë periudhës në vijim do ta ketë fokus të punës së tij, monitorimin e masave që do të propozojë Kuvendi për përmirësimin e situatës dhe për reflektimin të gjetjeve dhe rekomandimeve lidhur me këto çështje.

Për të krijuar një panoramë të qartë mbi problematikën të cilën Avokati i Popullit e ka konsideruar tepër të rëndësishme gjatë këtij viti, si vijon do të gjeni një përmbledhje të shkurtër për secilin raport të veçantë të depozituar pranë Kuvendit gjatë vitit 2014.

### ***4.2.1. Raport i Veçantë “Për Problematikat dhe Gjendjen e Spitaleve në Shqipëri”***

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë veprimtarisë së tij i ka kushtuar rëndësi të veçantë kujdesit shëndetësor. Duke vlerësuar këtë të drejtë, si një prej çështjeve më të rëndësishme të një shteti social, si dhe element të rëndësishëm të se drejtës që ka çdo individ për të jetuar i shëndetshëm, veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë viteve 2011-2012-2013, është fokusuar në inspektime në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, në Spitalet Rajonale në të gjithë vendin si dhe ankesat individuale ardhur pranë institucionit tonë.

Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në evidentimin e gjendjes së respektimit dhe zbatimit të ligjit, i cili reflekton respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në këto institucione, por dhe për vlerësimin e funksionimit të strukturës institucionale, të përshtatur me profesionalizëm, sipas standardeve të kërkuara konform ligjit, si dhe vlerësimit të kushteve infrastrukturore ekzistuese në ambientet e këtyre institucioneve.

Në këtë raport u prezantuan gjetjet kryesore dhe rekomandimet për përmirësimin e shërbimit shëndetësor. Në çështjet e diskutuara në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale

dhe Shëndetësinë në 19 dhjetor 2014, vënd të rëndësishëm zunë problematikat e konstatuara në këtë raport si më poshtë vijon: menaxhimi dhe alokimi i keq i fondeve, keqpërdorim dhe abuzim me to; mungesa persistente e medikamenteve dhe materialeve të tjera mjekuese në spitale; Pamundësi për kryerjen e analizave për të sëmurët në institucionet publike për mungesa të kiteve dhe reagentëve; menaxhimi jo i mirë i burimeve njerëzore; mungesa e mjekëve specialistë që largohen apo dalin në pension në një pjesë të konsiderueshme spitalesh në mbarë vendin; mungesa e rregullit dhe organizimi në institucionet shëndetësore, kryesisht spitalore.

Gjithashtu nuk kontrollohet dhe nuk monitorohet për cilësinë e kujdesit shëndetësor që u ofrohet të sëmurëve nga mjekët dhe profesionistët e tjerë të shëndetit në këto institucione; përmbushjen e standardeve të ushtrimit dhe cila është shkalla e profesionalizmit e kompetencës dhe performancës së tyre; nuk ka interesim të stafeve drejtuese për edukimin e vazhdueshëm mjekësor dhe formimin profesional brenda institucioneve të tyre. Për rrjedhojë, hasen gabime mjekësore dhe kequshtrim profesioni. Në këtë kontekst, nuk ekziston një sistem për identifikimin dhe raportimin e gabimeve mjekësore për të mos u përsëritur ato dhe për të përmirësuar e rritur sigurinë e të sëmurëve në shërbimet spitalore dhe jashtë tyre.

Një preokupim i veçantë në të gjithë sistemin, por kryesisht në atë spitalor duhet të jetë lufta kundër korrupsionit dhe mitmarjes si fenomen shumë i përfolur.

#### ***4.2.2. Raport i veçantë “Për të drejtën e informimit dhe rolin e Avokatit të Popullit”***

Mbrojtja e të drejtës së aksesit në dokumentat zyrtare, e afirmuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe një sërë aktesh ndërkombëtare, përcakton dhe vendos rregulla në mirëfunksionimin dhe transparencën e Administratës Publike, karshi publikut të gjerë, në veprimtarinë e saj të përditshme. Referimi juridik i kësaj të drejte bazohet në një, i cili përgjithësisht ka përthithur mire standardet ndërkombëtare të fushës, por që prej vitesh aplikimi ka nxjerrë nevojën e përmirësimit të tij.

Duke u fokusuar tek regjimi juridik i përcaktuar nga Ligji Nr.8503 datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, ky raport bën një vlerësim të nevojave për ndryshime dhe përmirësime ligjore, sikundër analizon pozitën e institucionit të pavaruar, të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe njëkohësisht të kujdestarit për zbatimin e këtij ligji, Avokatit të Popullit.

#### ***4.2.3. Raporti i Veçantë “Mbi Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës”***

Hartimi i këtij raporti të veçantë nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në vijimësi të monitorimeve lindi si një nevojë për pasqyrimin e problematikave të konstatuara gjatë rasteve të largimeve nga puna, me qëllim hartimin në vijim të rekomandimeve për rritjen e mëtejshme të efektivitetit dhe në mënyrë të veçantë për gjetjen e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve të çdo organ i Administratës Publike në Shqipëri.

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij Raporti të Veçantë është bazuar në të dhënat statistikore dhe problematikat e konstatuara gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën Shtator 2013- Shkurt 2014, si dhe në informacionet e mbledhura nga çdo Institucion i Administratës Qendrore, me qëllim krijimin e një panorame më të qartë mbi numrin e punonjësve të larguar nga puna për periudhën Shtator 2013-Shkurt 2014, motivacionet e largimeve nga puna, institucionet që kanë patur numrin më të madh të largimeve nga puna, apo edhe nxjerrjen e të dhënave mbi rastet e zgjidhjeve të marrëdhënieve të punës të cilat janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

Raporti i Veçantë “Mbi Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës” pas diskutimit të draftit të tij me aktorë të ndryshëm është depozituar në datë 22.05.2014, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, por ende nuk është shqyrtuar.

#### ***4.2.4. Raporti “Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen”***

Raporti trajton problematikat e hasura nga shtetet e zonës Shengen me azilkërkuesit nga Shqipëria, duke konstatuar dhe analizuar të dhënat si dhe shkaqet e paraqitura për azil nga shtetasit shqiptarë. Në mënyrë të veçantë, raporti thekson gjendjen e krijuar në hapësirën Shengen nga shtimi i numrit të azilkërkuesve nga Shqipëria por edhe nga Ballkani Perëndimor gjatë viteve të fundit dhe gjithashtu përqendrohet në problematikat dhe rekomandimet përkatëse për grupe sociale dhe etnike të tilla si minoriteti rom, viktimat e gjakmarrjes, komuniteti LGBT, gratë e dhunuara, fëmijët e pashoqëruar nga prindërit, etj., të cilët rezultojnë se gjenerojnë numrin më të madh të azilkërkuesve shqiptarë.

Në hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga raportet e ndryshme nga organet e specializuara të BE për azilkërkuesit, përkatësisht Agjencia Evropiane për Mbështetjen e Azilkërkuesve (EASO), të dhënat nga përfaqësitë diplomatike të shteteve të hapësirës Shengen në Shqipëri, si dhe raportet e veçanta të institucionit të Avokatit të Popullit. Raporti përmban një sërë rekomandimesh të ndara sipas kategorive përkatëse, të cilat trajtojnë dhe adresojnë të gjitha problematikat e konstatuara përgjatë hartimit të këtij dokumenti.

Raporti pasi iu nështrua një analize të thellë dhe shkëmbimi informacioni rreth konkluzioneve përfundimtare të tij, me institucionet përgjegjëse shtetërore, organizmat ndërkombëtarë që monitorojnë këtë fenomen në vendin tonë dhe me grupet e interesit, ju dërgua Kuvendit të Shqipërisë në datë 10 Qershor 2014, për shqyrtim.

#### ***4.2.5. Raporti “Për Emigracionin dhe disa prej problematikave shqetësuese që lidhen me të”***

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, ka treguar vëmendje për çështjet e emigracionit duke i përmbledhur të gjitha problematikat e konstatuara në një raport të veçantë. Ky raport tenton të sjellë në vëmendjen e parlamentit dhe institucionet e shtetit shqiptar disa prej problematikave që lidhen me emigrimin e kontrolluar (*Marrëveshjet për Punësim midis Shtetit Shqiptar dhe vendeve të treta*); njohjen e kontributeve shoqërore; dokumentet e identifikimit të shtetasve shqiptarë të lidhur jashtë vendit (*Problematika lidhur me pasqyrimin e toponimeve në dokumentet e udhëtimit*; integrimi i fëmijëve shqiptarë të familjeve që janë kthyer nga integrimi në sistemin shkollor; të drejtën e votës, etj.

Nëpërmjet problematikave dhe sugjerimeve të këtij dokumenti, Avokati i Popullit ka si qëllim të kontribuojë sadopak për të qartësuar më tej hapat që duhet të ndërmerren për të përmirësuar jetën dhe integrimin e plotë të këtyre shtetasve në shoqëri.

Raporti është depozituar për shqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë në datë 16 Qershor 2014, por që ende nuk është shqyrtuar.

#### ***4.2.6. Raport i Veçantë “Mbi Gjëndjen e Strehimit në Republikën e Shqipërisë”***

Duke marrë shkas nga ankesat e shumta të adresuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2014, u hartua një raport i veçantë me qëllim evidentimin e problematikave tek institucionet ligjberëse. Hartimi i këtij raporti nga Institucioni i Avokatit të Popullit lindi si një nevojë për pasqyrimin e problematikave dhe parashtrimin e

rekomandimeve për përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave për grupet e cënueshme me qëllim përmbushjen dhe vendosjen e standardeve lidhur me një ndër objektivat sociale sikundër është edhe strehimi. Kjo, veçanërisht edhe pas daljes së Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.3 datë 01.08.2012, “Për lirim të banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar”, i cili rriti në mënyrë të ndjeshme rastet e familjeve të pastreha, ndaj të cilave ende nuk është ofruar ndonjë mundësi reale për sistemimin e tyre në banesa sociale me qira.

Në të shumtën e rasteve, individët e pastrehë që kanë përfituar nga këto shërbime janë trajtuar me banesa me kosto të ulët. Numri i personave që kanë përfituar nga dhënia e kredive të subvencionuar nga Shteti me përqindje të ulët (3%) është i pakët për arsye të pamundësisë të përballimit të kushteve të bankës nga ana e individit.

Aktualisht strehimi mbetet një nga çështjet më të mprehta sociale për faktin se pothuajse në shumicën e bashkive, buxheti i alokuar për ndërtimin e banesave sociale është zero, duke e bërë të vështirë kështu përmbushjen e objektivave të strehimit.

Raporti i Veçantë “Mbi Gjëndjen e Strehimit në Republikën e Shqipërisë” është depozituar në datë 04.11.2014 pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

#### ***4.2.7. Raporti i veçantë mbi procedurat e legalizimit dhe prishjes së ndërtimeve pa leje nga ana e Inspektoriateve ndërtimore (Rasti i banorëve të Selitës dhe procedurat e ndjekura në kuadër të ndërtimit të segmentit të Unazës së Madhe të Tiranës)***

Nisur nga problematikat e hasura në trajtimin e rastit të banorëve të Selitës në Tiranë lidhur me procedurat e ndjekura në kuadër të ndërtimit të segmentit të Unazës së madhe të Tiranës, Institucioni i Avokatit të Popullit e pa të nevojshme që të adresonte këtë çështje në organet ligjbërëse.

Nevoja për hartimin e një raporti të veçantë nga Institucioni i Avokatit të Popullit mbi procesin e legalizimeve dhe ndërhyrjeve të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar lindi për shkak të problemeve të ndryshme me të cilat po përballëshin shtetasit në Republikën e Shqipërisë. Këto i referoheshin konkretisht respektimit dhe garantimit të të drejtës së tyre të pronësisë në përgjithësi, si dhe zvarritjeve të konstatuara në respektimin e afateve të legalizimit dhe respektimin elementeve të tjerë të procesit të rregullt ligjor, në këndvështrim edhe të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Avokati i Popullit e gjykoi si të domosdoshme hartimin e këtij raporti të veçantë nisur edhe nga ngjarjet e fundit që po ndodhnin në zonën e Selitës, ashtu si edhe në disa zona të tjera në mbarë vendin, ku nga ankesat e administruara në institucionin tonë, rezultoi që veprimet ndaj të cilit ankoheshin individë të ndryshëm, kishin të bënin me procesin e legalizimeve dhe që pasoheshin me procedurat e ndjekura nga INUK- u për ndërhyrje në prishjen e këtyre ndërtimeve që deri në ato momente i ishin nënshtruar procedurave të legalizimit.

Raporti i Veçantë mbi procedurat e legalizimit dhe prishjes së ndërtimeve pa leje nga ana e Inspektoriateve ndërtimore u depozitua në datë 31.12.2014 pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

#### **4.3. Investimi i Gjykatës Kushtetuese nga Avokati i Popullit për rivendosjen në vënd të të drejtave të shkelura**

Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e ushtrimit të detyrës së tij për mbrojtjen e të drejta, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e

paligjshme e të parregullta të arganeve të administratës publike, sikurse parashikohet në nenin 2 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka vlerësuar në procesin e shqyrtimit të ankesave të subjekteve të ndryshëm, se realizimi i kësaj detyre do të mundësohej në raste të caktuara me shfuqizimin e aktit nënligjor të nxjerr prej një organi të administratës publike. Për vitin 2014 Avokati i Popullit ka investuar dy herë Gjykatën Kushtetuese për çështjet sa më poshtë.

Mund të përmendim veprimtarinë e kryer prej Avokatit të Popullit për shfuqizimin e Udhëzimit Nr.2, datë 18.08.2011, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, të Këshillit të Ministrave. Duke e vlerësuar këtë akt nënligjor në kundërshtim me parime të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin Nr.8137, datë 31.07.1996”, Avokati i Popullit, në ushtrim të detyrës së tij kushtetuese, sikurse është sanksionuar në nenin 60 e vijues, bazuar në nenin 134/dh të Kushtetutës, ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, me kërkesën datë 20.06.2013, me objekt: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e RSh të Udhëzimit Nr.2, datë 18.08.2011, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”.

Gjykata Kushtetuese me rastin e pranimit për shqyrtim të kërkesës, ka vendosur me Vendimin Nr.20, datë 04.04.2014, për: “Pranimin pjesërisht të kërkesës. Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të pikës 7, të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”.

Gjykata Kushtetuese në vendimarrjen e kryer, ka gjetur me vend pretendimet e ngritura për cënimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe, lidhur me këtë të drejtë, edhe për pretendimin për mosrespektimin e hierarkisë së akteve ligjore, të parashikuar në nenin 118 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), si dhe detyrimi për organet shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (neni 142/3 i Kushtetutës), nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Në këtë kuptim, ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë është konsideruar pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.

Përmbajtja e shkronjës “d”, të pikës 7, të udhëzimit të kundërshtuar, është gjetur nga Gjykata Kushtetuese në kundërshtim me nenin 17/1, pasi nuk respekton kriterin e kufizimit me ligj të së drejtës, të sanksionuar në këtë nen të Kushtetutës.

Rasti i dytë i investimit të Gjykatës Kushtetuese nga Institucioni i Avokatit të Popullit është në muajin Tetor 2014, ku Avokati i Popullit ka bërë të mundur depozitimin pranë Gjykatës Kushtetuese, të kërkesës, me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të nenit 45 të Ligjit Nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Seanca gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës është zhvilluar më datë 17.02.2015. Pritet shpallja e vendimit.

#### **4.4.Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në dhënien e mendimeve dhe komenteve për draft ligjet për vitin 2014 në mënyrë proaktive ose me kërkesë së të Institucioneve përkatëse**

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol proaktiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke dhënë konstatime dhe sugjerime në procesin ligjberës. Kjo është bërë e mundur me kërkesë të organeve të ndryshme, kryesisht Komisionet e përhershme të Kuvendit, si Komisioni i ligjeve, administratës publike dhe të drejtat e njeriut, Ministria e Drejtësisë, etj. Por gjithashtu gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit ka luajtur një rol proaktiv në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve për draftligje dhe me iniciativën e tij.

Institucioni i Avokatit të Popullit përveç konstatimeve dhe sugjerimeve për projekt ligje dhe akte nënligjore me shkrim, ka marrë pjesë në mënyrë aktive për të paraqitur këto mendime dhe në seanca dëgjimore pranë Komisionit të ligjeve, administratës publike dhe të drejtat e njeriut, konkretisht për të drejtën e informimit, për ligjin për të përndjekurit politik, për projekt ligjin për personat me aftësi të kufizuar, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pjesën më të madhe të problematikave të konstatuara dhe të evidentuara në projektligjet për diskutim nëpërmjet dhënies së mendimeve dhe sugjerimeve për projektligje të ndryshme e ka marrë nëpërmjet ankesave të shtetasve drejtuar institucionit tonë, nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare, etj.

Një ndër projektligjet që iu kushtua vëmendje të veçantë nga institucioni i Avokatit të Popullit është projektligji për të *Drejtën e Informimit*. Me kërkesë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë, në muajin Korrik 2014<sup>110</sup>, kontribuoi me mendime dhe opinione mbi këtë projektligj. Në komentet dhe sugjerimet e dhëna, është theksuar se projekt ligji prek dhe çënon seriozisht kompetencat<sup>111</sup> e Avokatit të Popullit, pasi i heq atij kompetencën e kujdestarit të zbatimit të ligjit mbi të drejtën e informimit. Janë sugjeruar disa rregullime terminologjish të përdorura në projekt ligj, si dhe të përcaktimit nominal financiar të shumave për dënimet administrative që vendosen nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto sugjerime janë marrë parasysh.

Avokati i Popullit bazuar në kërkesën e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë, paraqiti konstatimet dhe sugjerimet e tij për projekt ligjin "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*"<sup>112</sup>. Në komentet dhe sugjerimet tona janë identifikuar disa rregullime terminologjish të përdorura në projekt ligj, si dhe të përcaktimit më të qartë të termave si "grup interesi", të palëve të interesuara në procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik. Është sugjeruar edhe saktësimi i rolit të organit publik që hap procesin e konsultimit publik, si dhe të procedurave që ai ndjek me pranimin, apo refuzimin e komenteve që i vijnë rast pas rasti. Kemi kërkuar gjithashtu që të qartësohet në projekt ligj, nëse ankimi administrativ në rastet e shkeljes së të drejtës për informim në thelb, gjatë procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, shtyn në aspektin kohor procesin e përgatitjes së draftit përkatës nga ana e organit publik, apo jo.

Komente dhe sugjerime janë dhënë nga Institucioni i Avokatit të Popullit mbi projekt ligjin "*Kodi i Procedurave Administrative*", i cili ende nuk është diskutuar dhe miratuar nga Kuvendi i RSH-së.

Një ndër projektligjet për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme është projektligji "*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave*

<sup>110</sup> Bazuar në kërkesën drejtuar institucionit tonë me anë të shkresës nr.2271 datë 26.06.2014

<sup>111</sup> Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", në nenin 18, i njeh Avokatit të Popullit rolin e kujdestarit të zbatimit të këtij ligji.

<sup>112</sup> Bazuar në kërkesën drejtuar institucionit tonë me anë të shkresës nr.2271 datë 26.06.2014,

*me aftësi të kufizuara*". Në muajin Korrik 2014, Avokati i Popullit ka dhënë mendimet dhe sugjerimet, pranë Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë për këtë projektligj. Disa nga sugjerimet janë: riformulimi i nenit 17 të këtij projektligji që lidhen me kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit; ndryshime të pikave 8 dhe 9 të nenit 3 dhe të pikës 3 të nenit 13 lidhur me cënimin e parimit të përfaqësimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara; riformulimin e nenit 4 i cili nuk garanton parimin e sigurisë juridike të personave me aftësi të kufizuara; plotësim të nenit 20 për ta bërë këtë ligj të disponueshëm në formate të aksesueshme; etj. Cënimin e përfaqësimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara; konceptimin si ligj kuadër, por që nuk parashikon ndërhyrjet konkrete në legjislacionin ekzistues dhe përqëndrimin e financimit vetëm tek një ministri.

Duke patur në vëmendje çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën dhe shërbimit shoqërore të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014, janë dërguar mendime e vërejtje për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" të ndryshuar, në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë të Kuvendit të Shqipërisë. Duke e vlerësuar praktikën e konsultimit të ligjvënësit me grupet e interes, kemi theksuar se opinioni i përgjithshëm i ombudsmanëve është që politikat anti-krizë nuk duhet të prekin shtresat dhe grupet vulnerabël. Gjithashtu prioritare konsiderojmë faktin e mosuljes apo përkeqësimit të standarteve tashmë të arritura sidomos nga shtresat vulnerabël. Thelbi i vërejtjeve tona kishte të bënte me faktin se ky projektligj duhet t'i jepte një zgjidhje më të mirë koncepteve për ta ndarë përfundimisht kompensimin e aftësisë së kufizuar nga burimet e tjera të jetesës dhe për ta trajtuar atë si një pagesë sociale të pavarur në përputhje me ligjet e veçanta mbi aftësinë e kufizuar në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu mendime dhe sugjerime janë dhënë për projektligjin "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë" dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Propozimet tona lidhur me këtë projektligj kanë synuar përmirësimin e dispozitave të tij me qëllim që të garantohet respektimi i të drejtave të azilkërkuarëve, sidomos ato që lidhen me kufizimin e lirisë dhe procedurat e ankimit të tyre pas refuzimit të azilit. Pothuajse gjysma e propozimeve tona u morën në konsideratë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe u përfshinë në projektligjin e dërguar në Kuvend dhe në ligjin e miratuar tashmë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë komentet dhe sugjerimet e tij për projektligjin "Për faljen", dërguar nga Ministria e Drejtësisë. Propozimet tona për këtë projektligj kanë synuar për lehtësimin e procedurave të faljes dhe shtimin e disa kriterëve përfituese me qëllim që të zgjerohet mundësia e personave të dënuar penalisht për kryerjen e veprave penale që të përfitojnë nga instituti i faljes që aplikohet nga Presidenti i Republikës. Këto propozime janë pranuar nga Ministria e Drejtësisë, por nga verifikimi i bërë rezultoi se projektligji nuk është shqyrtuar akoma nga Kuvendi.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë mendimet dhe sugjerimet dhe për projektligjin "Për Policinë e Shtetit" dërguar nga Komisioni Parlamentar i ligjeve dhe për të drejtat e njeriut, si një nga projektligjet më të rëndësishme. Për këtë projektligj janë bërë shumë propozime konkrete duke synuar që ligji të jetë me standarde bashkëkohore, me qëllim që policia të përmbushë me sukses misionin e saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, por edhe të garantojë zbatimin dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve. Gjithashtu është propozuar parashikimi në ligj i detyrës për sigurimin dhe trajtimin në ambientet e saj, të personave të arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masës së sigurimit me vendim gjykatë, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Pjesa më e madhe e propozimeve të Avokatit të Popullit janë marrë në konsideratë gjatë procesit legjislativ për shqyrtimin dhe miratimin e ligjit.



Një vëmëndje të veçantë këtë vit në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve, ka patur dhe projektligji për *dëmshpërblimin e të përndjekurve politik*, me kërkesë të Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë të Kuvendit të Shqipërisë. Këto mendime janë prezantuar në seancë dëgjimore. Një nga sugjerimet konkrete të prezantuar ishte afati përcaktues final për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit të ish të të përndjekurve politik, etj.

Gjatë vitit 2014 disa institucione kanë dërguar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për mendim projekt VKM dhe projektligje të hartuara për të përmirësuar legjislacionin në fuqi. Projekt VKM-të dhe projektligjet për të cilat kemi dhënë sugjerime janë: Projektligji “*Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”; projekt VKM “*Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*”, etj. *Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë* janë dhënë sugjerime duke ju referuar problematikës që kemi konstatuar gjatë punës tonë në zbatimin e ligjit të shfuqizuar. Në projekt VKM-ën “*Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*” kemi konstatuar disa referime të gabuara ligjore dhe disa rregulla që në të ardhmen mund të jenë premisë për shkelje të të drejtave të burgosurve.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2014 ka patur një rol te veçantë në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve në reforma dhe dokumenta strategjike dhe të progresit në kuadër të zbatimit të 5 prioriteteve për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, një pjesë të mirë të sugjerimeve sidomos për administratën publike, janë dhënë në dy takime të përbashkëta të nënkomitetit të BE-së dhe Qeverisë shqiptare. Mendime dhe sugjerime janë dhënë dhe për reformën territoriale – administrative përpara Komisionit ad-hoc për ndarjen territoriale – administrative.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka luajtur një rol proaktiv dhe në dhënien e sugjerimeve për dokumenta strategjik të ndryshëm të hartuar nga shteti shqiptar. Konkretisht Projekt Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Udhërrëfyesit të miratuar nga Qeveria shqiptare në kuadër të zbatimit të 5 prioriteteve, për Projekt Strategjinë Kombëtare Antitrafik dhe Planin e saj të Veprimit 2014-2017 në të cilën është kërkuar rishikimi i afeteve të përcaktuara për zbatimin e disa prej objektivave të strategjisë. Strategjia dhe plani i veprimit për luftën kundër korrupsionit, në të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit jo vetëm që ka dhënë sugjerimet e tij për përsosjen e dokumentave por dhe ka luajtur një rol aktiv në marrjen përsipër të masave për luftën kundër korrupsionit, siç është përfshirja e tij në planin e veprimit për masat që ka marrë gjatë vitit 2014 në kuadër të transparencës, rritjes së aksesit të qytetarëve, shtrirjes së veprimtarisë nëpërmjet zyrave rajonale, etj.

Pjesë e grupeve të punës, Institucioni i Avokatit të Popullit ka qënë edhe për hartimin e strategjisë për reformën në administratën publike e cila është në proces hartimi ende, duke kontribuar jo vetëm me problematikat e evidentuara gjatë trajtimit të ankesave por edhe me rekomandime konkrete për përmirësimin e respektimit të të drejtave të shtetasve.

## **4.5. Forcimi dhe bashkëpunimi me median dhe median sociale**

### **4.5.1. Marrëdhëniet me median**

Institucioni i Avokatit të Popullit bazohet mbi transparencën dhe si i tillë konsideron që marrëdhëniet me median kanë një rëndësi të veçantë. Ky institucion prej vitesh funksionon mbi bazën e një strategjie që parashikon promovimin e rolit të Avokatit të Popullit dhe të të drejtave të njeriut si edhe rrugët e komunikimit të përditshëm me median. Duke synuar njohjen sa më të gjerë nga publiku, qëllimi ka qënë dhe mbetet rritja e autoritetit të Institucionit të Avokatit të Popullit në të mirë të zgjidhjes sa më të shpejtë të problemeve që qytetarët ngrejnë pranë këtij institucioni. Informacioni mbi veprimtarinë e Avokatit të Popullit duhet të jetë gjithnjë i arritshëm nga qytetarët, partnerët ndërkombëtarë, apo palët e

interesuara, nëpërmjet pasqyrimit të tij në media. Synimi konstant i tërheqjes së vëmendjes së autoriteteve qendrore dhe vendore mbi domosdoshmërinë e përmirësimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve nëpërmjet prezantimit publik të problematikës së tyre, ka sjellë rrjedhimisht një bashkëpunim të fortë dhe të vazhdueshëm edhe gjatë vitit 2014 mes Avokatit të Popullit dhe mediave në vend. Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë shpesh e përzgjedhur si tematikë qendrore në median e përditshme, por nga ana tjetër edhe mediat kanë shërbyer për nxitjen e veprimeve institucionale me inisiativë nga ana e stafit të Avokatit të Popullit, në fushat që lidhen me të drejtat e njeriut.

Aktivitetet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit kanë gjetur interesimin e mediave në televizionet, gazetat dhe saitet online kryesore në vend. Avokati i Popullit, anëtarë të stafit dhe kabinetit kanë qenë po ashtu në vijimësi prezent në media në të gjitha rastet kur publiku ka kërkuar përfshirjen dhe angazhimin tonë, por veçanërisht në rastet kur detyra dhe ligji obligon mbajtjen e një qëndrimi të shprehur me rekomandime mbi problematikat që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në Shqipëri.

#### ***4.5.2. Institucioni i Avokatit të Popullit si burim informacioni***

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2014 ka qenë në vazhdimësi pikë referimi, si burim lajmi për mediat dhe operatorët e tyre: Çështjet të cilat janë trajtuar gjerësisht në vitin 2014 janë:

- Çështjet që lidhen me të drejtat e minoritet rom
- Çështjet e prishjeve të ndërtimeve pa leje
- Çështjet që lidhen me të drejtat e komuniteti LGBT
- Çështjet që lidhen me të drejtën e pronës
- Çështjet e minoriteteve
- Fenomeni i gjakmarrjes
- Çështjet e azilkërkuesve
- Çështja për hapjen e dosjeve
- Problemi i pagesave të personave me aftësi të kufizuar
- Skema e ndihmës ekonomike
- Administrata publike dhe largimet nga puna
- Problemet që lidhen me strehimin
- Monitorimi në burgje dhe problematika e mbipopullimit
- Dhuna ndaj grave
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
- Dëmshpërblimi i ish-të përndjekurve
- Abuzimet me faturat e energjisë elektrike

#### ***4.5.3. Intervista të Avokatit të Popullit, në televizionet kombëtare***

Edhe gjatë vitit 2014 vetë Avokati i Popullit, z.Igli Totozani, ka qenë i pranishëm në studiot televizive, të cilat kanë qenë të fokusuara mbi aktivitetin institucional si dhe për trajtimin e temave të caktuara me ndjeshmëri publike. Me daljet e drejtpërdrejta të Avokatit të Popullit në media është synuar veçanërisht promovimi i të drejtave të grupeve vulnerabël, si dhe mbrojtja që institucioni i Avokatit të Popullit u bën të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës. Gjatë kësaj periudhe Avokati i Popullit, z.Igli Totozani ka qenë prezent në emisionet dhe në edicionet informative në pothuajse të gjitha televizionet kryesore të vendit si Top-Channel, Tv Klan, Neës 24, Ora-neës, Abc-neës, Vizion +, Albanian Screen, Top Neës, Tv Koha, Channel

One, Scan Tv, UTV. Gjithashtu edhe komisionerët, përfaqësues nga kabineti, ndihmës komisionerë dhe anëtarë të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë të pranishëm për të diskutuar mbi çështje të cilat lidhen drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në studiot televizive të Top Channel, Tv-Klan, Neës 24, Ora Neës, AS, Vizion +, Channel One, Top Neës, Abc-neës.

#### ***4.5.4. Intervista në televizionet lokale***

Veç mediave qendrore në vend, Avokati i Popullit ka qenë prezent në mediat lokale të qyteteve që ka vizituar. Kështu gjatë 2014, Avokati i Popullit ka qenë në intervista televizive të këtyre televizioneve, Tv lokal në Gjirokastrë, në Elbasan, Tv Riviera në Sarandë, Tv Aulona në Vlorë dhe Tv Apollon në Fier.

Intervistat në televizionet lokale kanë patur si qëllim informimin e komunitetit të zonës mbi veprimet dhe mosveprimet, kompetencat dhe aktivitetin e institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe përgjigje direkte mbi problematika lokale që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor të detyrave dhe prioriteteve të Avoktit të Popullit.

#### ***4.5.5. Avokati i Popullit prezent në faqet e opinioneve të gazetave shqiptare***

Në kuadër të bashkëpunimit me median, duhet theksuar fakti se shtypi i përditshëm përbën një nga burimet kryesore për vjeljen e informacionit me interes publik, gjë që i jep mundësi ekspertëve të institucionit për të filluar çështje të ndryshme me inisiativë. Kontrolli i imët i shtypit të përditshëm ka qenë dhe mbetet detyrë parësore për evidentimin e problematikave që shqetësojnë qytetarët. Falë kësaj qasje aktiviteti i Avokatit të Popullit është pasqyruar gjithashtu edhe në shtypin e shkruar. Gazetat më të mëdha të vendit si Gazeta Panorama, Gazeta Dita, Gazeta Shqiptare, Gazeta Telegraf, Gazeta Shqip, Gazeta Shekulli, Gazeta MAPO, Gazeta Tema, Gazeta 55 etj, kanë pasqyruar rekomandimet dhe problematikat e ngritura nga Avokati i Popullit në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut, çështje të legjislacionit dhe zbatimit të tij dhe se çfarë mund të ndryshohet për të përmirësuar cilësinë e jetesës kryesisht të grupeve më në nevojë.

#### ***4.5.6. Faqet Online***

Edhe gjatë vitit 2014, lajmet e Avokatit të Popullit kanë pasur një pasqyrim të gjerë në mediat dhe portalet më të mëdha online si: Balkanëeb, Ora-neës, AS, Abc-neës, Top Channel, Tema, Panorama, Republika, Shekulli, Mapo, Shqip, Dita, Telegraf, Gazeta Idea etj.

Kjo ka sjellë që informacioni dhe lajmi mbi aktivitetin e Avokatit të Popullit është bërë universal, pra i aksesueshëm nga çdo vend i botës si dhe analiza e veprimtarisë së Institucionit e parë nën këndvështrimin e ri të krijuar nga reagimet e publikut dhe lexuesve.

Reagimet e publikut dhe sugjerimet e qytetarëve të ardhura direkt nëpërmjet mediave ose nëpërmjet publikut që reagon ndaj informacionit të tyre, kanë shërbyer si ndihmë për të ripërcaktuar pika orientimi në punën e Avokatit të Popullit bazuar në prioritetet, pritshmëritë dhe ndjeshmëritë e opinionit publik.

#### ***4.5.7. Mediat sociale***

Mediat sociale tashmë për institucionin e Avokatit të Popullit përfaqësojnë një kanal komunikimi, i cili nuk mund të nënvlerësohet nëse dëshirojmë të arrijmë një komunikim sa më të gjerë me qytetarët. Ditë pas dite rëndësia e përdorimit të këtyre mediave rritet. Përdoruesit që kanë një profil, në të paktën në një nga llojet e mediave sociale rritet, elementët

(foto, video, dokumente, audio, etj) që shpërndahen nëpërmjet tyre, rriten dhe koha e kaluar në mediat sociale po rritet gjithnjë e më tepër. Duke marrë në konsideratë të gjithë këto aspekte dhe argumenta roli i mediave sociale jo vetëm është i rëndësishëm, por përbën në vetvete një strategji të tërë komunikimi. Mediat sociale shërbejnë jo vetëm për të informuar dhe për të komunikuar, por edhe për të ndërtuar një marrëdhënie besimi, për të dëgjuar dhe për të monitoruar shqetësimet prioritare dhe sensibilitetet e qytetarëve.

Nëpërmjet pasqyrimin të aktiviteteve në profilin tonë në Facebook, kemi arritur të bëjmë të njohur për qytetarët:

- Pasqyrimin e aktiviteteve në kohë reale me foto e video, njoftime për media, etj.
- Përcjelljen e shqetësimeve dhe ankesave të tyre nëpërmjet mënyrës elektronike (kjo duke marrë në konsideratë që përdoruesit e internetit, numri i zotëruesve të një smartphone dhe një tablet rritet çdo ditë e më shumë, një numër i madh ankesash dhe shqetësimesh qytetarësh arrin në institucionin e Avokatit të Popullit nëpërmjet profilit të facebook-ut. )
- Përfshirjen e qytetarëve në vendosjen e prioriteteve dhe vëmendjes, duke kërkuar mendimet e tyre herë pas here

Të gjithë përdoruesit e internetit tashmë kanë akses të përditshëm në median sociale, konkretisht Facebook. Të qenurit pjesë e këtyre mediave, institucionit të Avokatit të Popullit i është dhënë mundësia të ketë një dialog të drejtëpërdrejtë me qytetarët, paralelisht me kanalet e komunikimit tradicional.

#### **4.5.8. Revista**

Me mbështetjen e projektit “Mbështetja e Danimarkës për Ombudsmanin Shqiptar – më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias”, institucioni i Avokatit të Popullit në muajin nëntor nxori numrin e parë të revistës. Një revistë, të cilën e konsiderojmë jo vetëm një tjetër formë komunikimi, por edhe një formë të re bashkëpunimi mes institucionit të Avokatit të Popullit, qytetarëve, administratës publike dhe shoqërisë civile. Sigurisht që kjo revistë nuk është thjesht një “zë” më tepër i institucionit të Avokatit të Popullit, revista është një kanal komunikimi që i drejtohet qytetarëve, administratës publike dhe shoqërisë civile dhe në të njëjtën kohë, në këtë revistë mund të shkruajnë qytetarë, përfaqësues nga administrata publike dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Revista e Avokatit të Popullit prej janarit të vitit 2015 do të jetë e përmuajshme. Ka një tirazh prej 1500 kopjesh, do të shpërndahet falas dhe do të mund të gjendet në tezgat e shitjes së gazetave, në çdo qytet të Shqipërisë.

Brenda revistës gjenden informacione të ndryshme lidhur me problematikat që shqetësojnë qytetarët, të shprehura këto në zhanre të ndryshme si: intervista, editoriale, informacione, lajme aktuale, analiza, debate, etj.

#### **4.6. Roli proaktiv dhe bashkëpunues me organizatat jofitimprurëse**

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe përgjatë vitit 2014 vazhdoi bashkëpunimin e tij me shoqërinë civile. Siç dihet, më 10 Dhjetor 2013 me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, Avokati i Popullit prezantoi Bordin Këshillimor me anëtarësi nga shoqëria civile. I ndërtuar në përputhje me mendimin strategjik të institucionit për mirëqeverisjen dhe vendim-marrjen, që në zanafillën e vet, Bordi u konceptua për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me organizatat e shoqërisë civile dhe, përmes tyre, me të gjithë grupet e interesit, faktorët socialë dhe hapësirën publike në tërësi. Për këtë qëllim, anëtarët e bordit u përzgjedhën nga vetë shoqëria civile dhe koalicionet e organizatave, duke siguruar kështu pluralitetin e opinioneve dhe qëndrimeve të të gjithë shoqërisë shqiptare, në përputhje me Parimet e Parisit për institucionet kombëtare të drejtave të njeriut.

Një nga aktet e para të Bordit ishte hartimi i një rregulloreje të punës së tij dhe i një deklaratë për opinionin publik. Ndër të tjera Deklarata theksonte: “ ... në cilësinë tonë si përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe koalicioneve ku bëjmë pjesë, ne të nënshkruarit, biem unanimisht në një mendje për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj deklaratë, me anë të së cilës i bëjmë me dije publikut vendimin për krijimin e Bordit për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut dhe vullnetin e anëtarëve të tij për të ofruar shërbimin e tyre në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të qytetarit në Shqipëri. Të gjithë ne, të udhëhequr nga parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë publik në përgjithësi dhe mbrojtja e interesit të individit, në veçanti, do të punojnë së bashku për çdo çështje që shqetëson opinionin publik shqiptar duke e përmbushur rolin tonë me profesionalizëm, efektivitetet dhe paanshmëri.”

Përgjatë vitit 2014, Bordi Këshillimor për të Drejtat e Njeriut i siguroi Avokatit të Popullit konsulencë dhe këshilla për një numër çështjesh të rëndësishme që lidhen me të drejtat e njeriut si, promovimi i të drejtave, veçanërisht të fëmijëve, personave në nevojë dhe grupeve vulnerabël; identifikimin dhe propozimin e fushave kryesore të ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, etj. Anëtarët e Bordit u mblodhën kryesisht në mënyrë *ad hoc* përgjatë vitit 2014, për të diskutuar çështjet që u gjykuan të rëndësishme për shoqërinë civile dhe Avokatin e Popullit në raport me të drejtat e qytetarëve, punën e administratës, të drejtat e minoriteteve, të grave, fëmijëve, dhunën në familje, etj.

Në vijim të lidhjeve të ngushta me organizatat e shoqërisë civile, Avokati i Popullit në fundvitin 2013 lëshoi një thirrje të hapur për plotësimin e vendeve bosh të komisionerëve të institucionit. U ftuan organizatat dhe koalicionet e shoqërisë civile të paraqisnin kandidaturat e tyre për dy nga komisionerët. E organizuar në koalicione dhe aleanca, shoqëria civile paraqiti kandidaturat e veta, po ashtu edhe grupet e pesonave me aftësi të kufizuara. Pas paraqitjes së kandidaturave, Avokati i Popullit ngriti një grup pune me përfaqësues nga shoqëria civile që bënë shqyrtimin e kandidaturave dhe më pas organizuan një dëgjësë me të ftuar nga përfaqësuesit e të gjithë sektorit. Gjatë seancës dëgjimore, kandidatët shpalosën vizionin e tyre për punën e Avokatit të Popullit dhe paraqitën platformat e tyre në rast zgjedhjeje. Pas kësaj, Komisioni Vlerësues i Shoqërisë Civile finalizoi listën e kandidaturave të përzgjedhura, të cilat institucioni i Avokatit të Popullit ia përcolli zyrtarisht Kuvendit të Shqipërisë. Si rezultat i kësaj procedure të hapur dhe transparente, sot institucioni ka në krye një Komisioner që përfaqëson dhe mbron interesat e grupit të personave me aftësi të kufizuar ku bën pjesë dhe ai vetë, duke e bërë mbrojtjen e tyre një kauzë të besueshme dhe të sigurtë. Ndërsa komisionerja e ardhur si kandidaturë e shoqërisë civile sjell në institucion këndvështrimin civil dhe publik për punën dhe rezultatet e administratës dhe shtetit në tërësinë e vet.

Më datë 20 dhjetor 2014, në përputhje me Ligjin e Avokatit të Popullit, institucioni organizoi Konferencën e tij vjetore në të cilën u ftuan organizatat e shoqërisë civile, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të organizatave ndërkombëtare në Tiranë, autoritete shtetërore, etj. Nisur nga rëndësia e problemit, këtë vit Konferenca pati si temë situatën e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Posaçërisht me këtë rast, Institucioni prezantoi edhe një raport special për situatën e minoriteteve në Shqipëri, i cili bazohet mbi një studim disamujor të institucionit realizuar edhe me ndihmën e organizatës jofitimprurëse “Save the Children.” Raporti përmban informacion të mbledhur me metoda shkencore kërkimore dhe të dhëna të validuara gjatë diskutimeve dhe takimeve me një numër aktorësh shtetërore dhe të shoqërisë civile ndër të cilët mund të përmendim anëtarët e grupit ndërinstitucional për përmirësimin e situatës së minoriteteve, ngritur nga Kryeministri i vendit, anëtarët e Komitetit Shtetëror të Minoriteve, shoqatat e ndryshme që përfaqësojnë minoritetet në Shqipëri si atë grek, serb, vllah, rom egjiptian, etj.

Një kontribut shumë të madh në zhvillimin e marrëdhënieve dhe ndihmën e ndërsjellë midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në të gjithë

vendin ka dhënë edhe projekti për forcimin e komunikimit të ndërsjellë të Avokatit të Popullit me njësitë e pushtetit vendor dhe organizatat e shoqërisë civile, financuar nga Programi DANIDA i Mbretërisë së Danimarkës. Një ndër tre komponentët e këtij projekti i kushtohet zgjerimit dhe forcimit të marrëdhënieve të Avokatit të Popullit me shoqërinë civile në të gjithë vendin. Për organizatat e shoqërisë civile, projekti danez organizoi një thirrje të hapur për propozime, në të cilën morën pjesë duke konkurruar me projektet e tyre një numër organizatash me seli në të gjithë vendin. Për çdo komponent të projektit, u financuan nga dy projekte, në total gjashtë të tillë. Për realizimin e tyre organizatat fituese punuan ngushtësisht me Avokatin e Popullit. Vlen të përmendet në mënyrë të veçantë realizimi i studimeve, “Studim mbi shërbimin arsimor në Shqipëri” dhe “Studim mbi shërbimin shëndetësor në Shqipëri” realizuar nga organizata jofitimprurëse Partnerë për Fëmijët.

Me ndihmën e projektit danez u realizuan edhe një numër inspektimesh të përbashkëta midis punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të OJF-ve të përzgjedhura në disa prej qendrave të kujdesit social për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, etj. Rrethet ku u zhvilluan këto inspektime përfshijnë: Vlorën, Gjirokastrën, Durrësin, Lezhën, Korçën dhe Beratin. Vlen të përmendet se të gjitha rastet e inspektimeve u kurorëzuan me rekomandime konkrete si për autoritetet e pushtetit lokal, ashtu edhe ato të pushtetit qendror përgjegjëse për mbarëvajtjen e këtyre institucioneve.

Përveç inspektimeve të përbashkëta, projekti danez mundësoi edhe një numër tryezash të përbashkëta me shoqërinë civile në nivel lokal. U organizuan 8 tryeza të tilla në qytetet Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Berat, Lezhë dhe Fier. Në këto tryeza, Avokati i Popullit dhe shoqëria civile diskutuan rreth problematikave që shqetësojnë popullsinë në këto rrethe, cilësisë së shërbimeve që iu ofrohen qytetarëve si nga pushteti lokal, ashtu edhe ai qendror, situatës së të drejtave të njeriut në vend dhe nevojës për ndërhyrje të mundshme, problemeve mjedisore, etj. Në fundvitin 2014, u mbajt edhe një auditorium në qytetin e Vlorës kushtuar problemeve të pronësisë dhe legalizimeve. Aktiviteti mundësoi bashkëbisedimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit me autoritetet përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror.

Gjithashtu, dy organizata të tjera, “Përthyerje” dhe “Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë” punuan ngushtësisht me Mekanizimin Kombëtar kundër Torturës dhe çdo Trajtimi të Egër, Degradues e Çnjerëzor. Bashkëpunimi i tyre, ndër të tjera, ngërtheu një numër të madh aktivitetesh në të gjithë vendin ku spikatën monitorimet e përbashkëta në institucionet e ndalimit dhe vuajtjes së dënimit.

Gjatë vitit 2014, një vënd të veçantë patën takimet të herëpashershme me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendase si dhe përfaqësive diplomatike për të diskutuar çështje të ndryshme të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit me qëllim jo vetëm shkëmbimin e informacionit por njëkohësisht edhe shfrytëzimin e sinergjive për të përmirësuar situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në vend.

#### **4.7. Aktivitete promovuese në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut**

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka realizuar një sërë aktivitetesh promovuese në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut. Një pjesë e tyre janë realizuar në kuadër të mbështetjes së Mbretërisë së Danimarkës nëpërmjet projektit që asiston Institucionin e Avokatit të Popullit “Mbështetja e Danimarkës për Avokatin e Popullit Shqiptar më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)”. Në këtë kuadër, është realizuar një cikël prej 14 trajnimesh *i pari i këtij lloji me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të pushtetit vendor mbi të drejtat e njeriut.*

Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qënë përfaqësues të pushtetit vendor nga të gjitha qarqet e Shqipërisë, të cilët janë trajnuar lidhur me disa nga aspektet më të rëndësishme të të

drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me të drejtën për arsimim, të drejtat e pronësisë, të drejtën për ndihmë ekonomike, të drejtat mjedisore, të drejtën për informim, pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e grupeve të marxhualizuara, etj. Këto trajnime janë ofruar me ekspertizën e përbashkët të stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe organizatave më të spikatura të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e pushtetit vendor. Trajnime me përfaqësues të pushtetit vendor e qëndror (stafe nga Prefektët e Qarqeve, Këshillat e Qarqeve, Bashkitë dhe Komunitatet e vendit) janë zhvilluar përkatësisht në këto njësi vendore: Vlorë, Sarandë, Dropull, Fier, Berat, Lushnjë, Kukës, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Pogradec, Korçë, Durrës dhe Tiranë.

Në këto trajnime janë ngritur dhe trajtuar problematika që përfaqësuesit e pushtetit vendor kanë hasur gjatë punës së tyre të përditshme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Por nga ana tjetër janë rritur në një masë të konsiderueshme njohuritë për Institucionin e Avokatit të Popullit, në aspektin e njohjes nga afër të objektit të punës dhe praktikave që ndjek ky Institucion, në rastet e marrjes së ankesave të qytetarëve, kompetencat dhe aktivitetin e tij, mënyrën e trajtimit të ankesave nga qytetarët, etj. Krahas temave teorike është bërë kujdes që të trajtohen edhe kazuse praktike nga puna e përditshme e Institucionit si dhe të sillen në vëmendjen e pjesëmarrësve raste konkrete ku zgjidhja e problematikave të trajtuara është bërë konform rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit. Disa nga problemet më shqetësuese që hasen në punën e përditshme të pushtetit vendor dhe që janë debatuar gjerësisht me ekspertët e Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë ciklit të trajnimeve kanë qënë këto: ndërprerja e ndihmës ekonomike dhe formula e llogaritjes së saj, çështja e strehimit, problemi i pronës, trajtimi i grupeve vulnerabël si romët dhe egjiptianët, etj.

Në këto aktivitete promovuese është konkluduar në nevojën e një bashkëpunimi më efikas midis Avokatit të Popullit dhe administratës së pushtetit vendor, sa i takon shqyrtimit dhe cilësisë së përgjigjeve në rastet e ankesave të qytetarëve brenda afateve ligjore.

Në mënyrë të vazhdueshme është theksuar nevoja e vazhdimin e sesioneve trajnuese të stafeve të njësisve vendore duke i konsideruar të nevojshme në drejtim të rritjes së kapaciteteve dhe mirëpresin organizimin e tyre edhe në të ardhmen.

Një aktivitet tjetër në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut gjatë vitit 2014 ka qënë *organizimi i Ditëve të Hapura* për pritjen dhe marrjen e ankesave të qytetarëve. Ankesat e prezantuara nga qytetarët janë trajtuar sipas procedurave ligjore, një pjesë e tyre janë marrë për tu trajtuar nga ekspertët e institucionit, ndërsa pjesa tjetër janë trajtuar si “këshillime dhe orientime”, duke i orientuar qytetarët drejt institucioneve të tjera, në varësi të objektit të ankesës së tyre. “Ditët e hapura” janë kombinuar për aq sa ka qënë e mundur me trajnimet e administratës vendore dhe sipas rastit janë realizuar në ambjentet e bashkive respektive apo në zyrat rajonale të Avokatit të Popullit. Disa nga qytetet ku janë organizuar ditët e hapura janë: Vlora, Elbasani, Pogradeci, Dropull i Sipërm, Durrës, Fier, Lezhë, Shkodër, Korçë, Berat, Sarandë. Në qytetet ku janë ngritur probleme dhe ankesa ndaj administratës vendore, ekspertët e Avokatit të Popullit kanë marrë kontakt të menjëhershëm me autoritetet e pushtetit vendor për ti sensibilizuar ato lidhur me shqetësimet që ngrejné qytetarët. Takime të tilla janë realizuar kryesisht me kryetarë bashkish apo anëtarë të këshillave bashkiake, të cilëve ju janë ngritur problemet dhe ankesat e qytetarëve.

Një ndër partnerët më të rëndësishëm të Institucionit të Avokatit të Popullit është *shoqëria civile*. Gjatë vitit 2014 në bashkëpunim me Projektin Danez u hartua një *plan takimesh me shoqërinë civile në disa prej qarqeve kryesore të vendit*. Tryezat e rrumbullakta janë mbajtur në kuadër të bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me rrjetin e OJF-ve, si dhe për shkëmbimin e informacionit, shqetësimet dhe problematikat që hasin këto shoqata në punën e përditshme në raport me pushtetin vendor, çështjet me interes lokal, etj.

Qëllimi i këtyre tryezave të rrumbullakta ka qënë diskutimi për çështjet e të drejtave të njeriut si dhe rritja dhe forcimi i bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me

shoqërinë civile në nivel rajonal. Tryezat e rumbullakta me përfaqësues të shoqërisë civile janë organizuar në këto qytete: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Vlorë, Berat, Lezhë, Fier. Në këto takime përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse kanë ngritur kryesisht shqetësime që hasin në marrëdhënie me administratën vendore, përgjigjet e cunguara që marrin nga administrata vendore, mungesa e marrjes së mendimit paraprak për probleme që shqetësojnë komunitetin lokal, etj. Përfaqësuesit e shoqatave kanë ngritur shqetësimin se shpeshherë i janë drejtuar me kërkesa me shkrim organeve të pushtetit vendor, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje për problemet për të cilat janë ankuar. Disa shoqata kryesisht të personave me aftësi të kufizuar janë ankuar për problemin e mospagesave në kohë të kompensimit të energjisë elektrike dhe telefonisë fikse për këtë kategori. Shqetësime janë ngritur edhe për shërbimin social lokal dhe moskoordinimin siç duhet të këtij shërbimi me pushtetin vendor.

Në disa nga këto takime një numër i konsiderueshëm qytetarësh, kryesisht pjesë e komunitetit rom/egjiptian apo edhe pjesëtarë jashtë këtij komuniteti, kanë ngritur pretendimin se ndihma ekonomike u është ndërprerë prej muajsh, me arsyetimin se nuk plotësojnë kriteret e kërkuara. Megjithatë është konstatuar edhe nga vetë administratorët se ka një vështirësi të kuptuarit e zbatimit të formulës në bazë të së cilës llogariten pikët e personave që përfitojnë ndihmë ekonomike. Qytetarëve u jepet një përgjigje e cunguar nga administrata vendore, se nuk kualifikohen për t'u trajtuar me ndihmë ekonomike pasi nuk plotësojnë pikët, por nuk sqarohen mbi kriteret dhe mënyrën e përlllogaritjes së këtij sistemi pikëzimi.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar gjatë vitit 2014 *auditoriumin e parë për të drejtën e pronës, shpronësimet dhe legalizimet*. Në këtë aktivitet u ftuan të marrin pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë. Qëllimi i këtij eventi ishte rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve publike mbi praktikën e mirëadministrimit dhe të përgjegjshmërisë, transparencës dhe të drejtave të njeriut. Tema e zgjedhur është prezantuar nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe folës të tjerë të rëndësishëm në panel dhe më pas është debatuar me të gjitha palët e interesuara dhe grupet e interesit. Në vijim është hartuar një plan me temat e auditoriumeve që parashikohet të realizohen përgjatë gjithë vitit 2015. Ambicia e Institucionit të Avokatit të Popullit është që të organizojë tryeza kombëtare sa më gjithëpërfshirëse, për çështje madhore që shqetësojnë qytetarët e vendit, si dhe çështje që kanë lidhje me objektin e punës së Institucionit lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit në *bashkëpunim me shoqatat jofitimprurëse ka realizuar trajnime me personelin e burgjeve dhe paraburgimeve në Tiranë, Elbasan dhe Fushë-Krujë*. Në këto trajnime janë trajnuar rreth 90 punonjës të personelit të burgjeve dhe paraburgimeve. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qënë rritja e cilësisë dhe qasja interaktive për të ndryshuar mentalitetin e personelit në burgje dhe paraburgime për çështje të lidhura me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shëndetin mendor, trajtimin e të paraburgosurve, mekanizmat mbikëqyrës si dhe shpjegimi i rolit dhe funksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me një shoqatë tjetër jofitimprurëse ka realizuar dhe prezantuar dy studime përgjatë vitit 2014: një në lidhje me sistemin arsimor dhe tjetri në lidhje me sistemin shëndetësor në Shqipëri. Po ashtu ka organizuar një konferencë të përbashkët vjetore në bashkëpunim me shoqërinë civile lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve dhe së fundmi ka botuar edhe një revistë periodike të Institucionit me dëshirën që ky botim ti shërbejë gjithë qytetarëve.

Në çdo aktivitet, pjesëmarrësit janë pajisur me *materiale promovuese dhe informuese si fletëpalosje, postera, manuale*, ku kanë gjetur informacion për punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, mënyrat e kontaktimit, mënyra e trajtimit të ankesave, etj.



Pjesemarresve ne aktivitetet e rritjes se ndergjegjesimit ju jane shpjeguar menytrat e kontaktimit te zyres se Avokatit te Popullit, jane njoftuar se ku ndodhen zyrat vendore si dhe eshte shpjeguar mundesia per tu ankuar online nepemjet eebsite te ri te Institucionit. Institucioni i Avokatit te Popullit ka pasur ne vemendje qe per 9do aktivitet te ftoje mediat lokale apo edhe kombetare per pasqyrimin e eventeve ne kohe reale.

## KREU 5

### SFIDAT DHE ARRITJET NË VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2014

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues i vetëm në llojin e tij, gjatë veprimtarisë së tij 15 vjeçare ashtu si ka korrur arritje në punën e tij ashtu edhe ka hasur një sërë sfidash.

Roli dhe veprimtaria e një institucioni të tillë i bën mirë shoqërisë dhe kontribuon në pasjen e një demokracie të shëndetshme, por që kërkon një kulture demokratike të të gjithë shoqërisë, e cila në Shqipëri shfaqet e vakët. Në këtë kontekst për të patur kulturën demokratike ku të pranohet mendimi ndryshe, të pranohet kritika ashtu si dhe të pranohen propozime për zgjidhje të situatës dhe asaj që çfarë ekziston, puna e Institucionit të Avokatit të Popullit bëhet akoma dhe më e vështirë.

Emri i këtij institucioni është i madh dhe në syrin e publikut kompetencat e tij janë shumë të gjëra dhe fuqiplotë në krahasim me ato që vetë ligji organik i atribuon. Arma më e fortë e Avokatit të Popullit është rekomandimi i cili në vetvete nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar dhe kjo passjell një sërë pakënaqësish tek shtetasit që i drejtohen për zgjidhjen konkrete të shqetësimeve të tyre. Shumë shtetas shqiptarë të cilët jetojnë në një varfëri të tejskajshme adresojnë kërkesën e tyre tek Institucioni i Avokatit të Popullit për më shumë të ardhura ose për një strehë, duke patur bindjen e tyre të plotë se kjo mund të zgjidhet menjëherë në mënyrë të suksesshme, por realiteti është shumë ndryshe.

Në një kohë që rekomandimi i Institucionit tonë nuk ka fuqi ligjore dhe detyruese por varet në zbatim nga vullneti i punonjësve të administratës publike fillimisht për të kthyer përgjigje ose për të pranuar konstatimin dhe sugjerimin dhe më pas për ta vënë në jetë atë.

Kjo mënyrë e tillë, kjo mungesë e mjeteve të fuqishme ligjore bën shpesh që puna e Institucionit tonë të jetë jo e mjaftueshme për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

Roli i Avokatit të Popullit është i dyfishtë, nga njëra anë është rojtari i respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe nga ana tjetër duhet të jetë një mediator i pranuar nga organet e administratës publike me qëllim ndërmjetësimin e çështjeve të ndryshme që adresohen nga ankuesit. Dhe kjo në një vend ku polarizimi politik është dominant, ekziston mundësia që reagimet e Avokatit të Popullit të politizohen nga kahet e ndryshme politike sipas interesave përkatëse, duke e bërë shpeshherë si institucion jo vetëm të papranueshëm por edhe të politizuar. Kjo është sfiduese dhe dobëson rolin dhe veprimtarinë e një institucioni si Avokati i Popullit i cili duhet të dalë mbi palët dhe mbi interesat politike.

Sfiduese është edhe mungesa e njohurive demokratike dhe të të drejtave të njeriut dhe nga vetë shtetasit të cilët kthehen në paragjykes të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit në rastet kur mbrohen të drejtat e grupeve vulnerabël, siç mund të jenë komuniteti rom, grupi i LGBT, etj.

Por pavarësisht nga të gjitha, jemi të mendimit se me rritjen e kulturës demokratike në organet e administratës publike por edhe me forcimin e kompetencave dhe nxitjen që mjete të tilla si rekomandimi që ndihen si “ligje të buta” të konsiderohen si një detyrim për t'u zbatuar me qëllim forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë.

## **5.1. Vështirësitë e hasura në marrëdhënien me Institucionet e Administratës Publike**

Tashmë Institucioni i Avokatit të Popullit dhe aktiviteti i tij 15-të vjeçar nuk është më i pa njohur në vend nga qytetarët, institucionet publike dhe jo vetëm. Me prezencën në media, në organizime dhe forume të ndryshme publike në krah të shoqërisë civile, të shtresave apo grupeve shoqërore më pak të mbrojtura kanë bërë që gjithnjë e më shpesh të kërkohet mendimi dhe opinioni i tij institucional në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të tyre në çdo herë që tentohet të cënohen apo vihen në diskutim ato.

Me institucionet e Administratës Publike, qendrore dhe vendore, komunikimi dhe bashkëpunimi i Avokatit të Popullit përgjithësisht ka qenë korrekt dhe i dobishëm për qytetarët, por dhe ky bashkëpunim ka pasur herë pas here luhatjet e veta sidomos në prag fushatash elektorale, kohë në të cilën është vërejtur një zbehje e këtij komunikimi apo bashkëpunimi.

Tregues pozitiv dhe rezultat i bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me institucionet publike kanë qenë trajtimi dhe zgjidhja në dobi të qytetarëve ankues/kërkuar të një numri të konsiderueshëm të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2014.

Por krahas këtij bashkëpunimi të mirë ka pasur dhe raste të neglizhencës apo mungesës së kthimit të përgjigjeve të kërkesave tona nga institucionet e administratës publike qendrore dhe vendore, herë nga pamundësia e plotësimit të kërkesave tona për çështje/ankesa të shoqëruara me detyrime financiare dhe herë nga mos angazhimi si duhet i strukturave të vartësisë të shtrira në të gjithë vendin<sup>113</sup>.

## **5.2. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e Administratës Publike**

Së bashku me Raportet e veçanta, Rekomandimet drejtuar organeve shtetërore për vënien në vend të së drejtës së shkelur janë akti më i rëndësishëm që nxjerr Avokati i Popullit. Konform nenit 21 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” - i ndryshuar, mjeti me efikas i reagimit që ligji i ka njohur Avokatit të Popullit pas përfundimit të hetimit administrativ, është Rekomandimi. Rëndësia e rekomandimeve është e dyfishtë në raport me shtetasin i cili i është drejtuar me ankesë Avokatit të Popullit.

Në raport me *institucionin shtetëror*, rekomandimi (*i cili është rezultat përfundimtar i një hetimi administrativ të ndërmarrë prej Avokatit të Popullit*) konfirmon ekzistencën e shkeljes së pretenduar prej ankuesit dhe për rrjedhojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të individit prej administratës shtetërore dhe i rekomandon asaj vënien në vend të së drejtës së shkelur. Në raport me *ankuesin*, rekomandimi konfirmon pretendimet e tij, si dhe i legjitimon ato duke i mbështetur me provat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ i Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur dhe i specializuar në trajtimin e këtyre lloj ankesave.

Duke patur parasysh statusin e veçantë kushtetues që ka institucioni i pavarur i Avokatit të Popullit, Rekomandimi është i një rëndësie të veçantë dhe duhet të ketë impakt të rëndësishëm për administratën shtetërore, pavarësisht se nga ana ligjore rekomandimi nuk krijon pasoja juridike, pra as detyrimin për t'u zbatuar automatikisht prej organit të administratës të cilit i drejtohet.

Për këtë arsye në projektin e përgatitur nga misioni Euralius III për ndryshimet e dispozitave të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, në kuadrin e forcimit të institucionit, ishte parashikuar edhe mundësia e penalizimit të zyrtareve të cilët nuk bashkëpunonin me Avokatin e Popullit, citojmë: “Për të siguruar bashkëpunimin e administratës gjatë shqyrtimit të ankesave, do të ishte me vend të vlerësohej nëse duhet të

<sup>113</sup> Për më shumë shih aneksin e rekomandimeve pa përgjigje


rriten kompetencat e Avokatit të Popullit, për shembull duke përcaktuar një procedurë për vënie gjore në rast mosbashkëpunimi”, por fatkeqësisht një rekomandim i tillë nuk u mor parasysh.

Jo vetëm në projektin e përgatitur nga projekti Euralius III të cituar më sipër, por edhe në mjaft raporte të organizatave ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut, jo vetëm theksohet rëndësia e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit, por rekomandohet edhe rritja e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Gjithashtu kujtojmë se në pothuajse të gjitha raportet e BE-së<sup>114</sup> dhe Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me Shqipërinë, rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit kanë shërbyer si pika reference dhe burim i besueshëm të dhënash.<sup>115</sup>

Nisur nga organizimi i brendshëm i punës në institucion, në varësi të rëndësisë së Rekomandimit, apo në varësi të subjektit që i drejtohet, Rekomandimi mund të dërgohet si nga Avokati i Popullit, ashtu edhe nga Komisionerët. Numri total i rekomandimeve të bëra gjatë vitit 2014 nga institucioni i Avokatit të Popullit, ka qenë 302, ndër të cila rezultojnë 209 rekomandime të pranuar, 24 rekomandime të refuzuara, 61 rekomandime pa përgjigje, 8 në proces.

Shqetësues mbetet fakti se për 20% të rekomandimeve nga institucionet shtetërore nuk është kthyer fare përgjigje<sup>116</sup>.

Sa më poshtë shprehet edhe në përqindje me paraqitje grafike:



Tabele nr. 1

Mos bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Popullit (që kryhet si nëpërmjet moskthimit përgjigje ashtu edhe moszbatimit të rekomandimeve), dobëson dhe cënon jo vetëm reputacionin e institucionit të Avokatit të Popullit (për shkak se zbeh forcën dhe besueshmërinë e tij tek shtetasit ankesat e të cilëve ai trajton), por mbi të gjitha dëmton liritë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri, pasi cënohet dhe ulet shkalla e mbrojtjes së këtyre lirive

<sup>114</sup> Shih Progres Raportin e Fundit të BE-se, faqe 10 dhe

45. [http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu\\_albania/swd\\_304\\_-\\_albania\\_-\\_final\\_prov\\_8.10.14.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/swd_304_-_albania_-_final_prov_8.10.14.pdf)

<sup>115</sup> Shih Raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit: [http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti\\_per\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_per\\_vitin\\_2013-26-shkurt-2014.html](http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti_per_te_drejtat_e_njeriut_per_vitin_2013-26-shkurt-2014.html)

<sup>116</sup> Lista e plote e anekseve bashkangjitur

dhe të drejtave (parashikuar si në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar, ashtu edhe nga Kushtetuta, apo pjesa tjetër e legjislacionit vendas), si dhe dëmtohet imazhi i vendit në raport me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

### 5.3. Vështirësitë në marrëdhëniet me qytetarin

Përsosja e marrëdhënieve dhe komunikimi me qytetarët, roli aktiv dhe ndërmjetësues mes qytetarit dhe administratës publike, gjithmonë në anën dhe në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, janë themeli mbi të cilin është ngritur dhe funksionon institucioni i Avokatit të Popullit, nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore. Në praktikën e funksionimit të institucioneve publike, të organeve ligjzbatuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sistemit të drejtësisë, ky mision përcillet me sfida dhe me vështirësi. Por nuk është i pamundur.

Kontributi i Avokati i Popullit në këtë fushë është konkret dhe i vazhdueshëm. Ai i ka kushtuar një rëndësi të veçantë krijimit të një klime të re bashkëpunuese në marrëdhëniet me qytetarët dhe me aktorët e tjerë publik dhe jo publik, të cilët ndikojnë në uljen e problematikave që kanë qytetarët në jetën e tyre të përditshme. Reformat strukturore që janë ndërmarrë, kanë konsistuar në forcimin e rolit qëndror të qytetarit, duke e konsideruar atë si një partner të rëndësishëm dhe jo thjesht si një ankues. Kështu, ngritja dhe konsolidimi i zyrave të pritjes dhe të shërbimeve ndaj qytetarit në Tiranë dhe në 7-të zyrat rajonale, kanë përmirësuar teknikat e komunikimit duke sjellë Institucionin e Avokatit të Popullit më afër qytetarit dhe problemeve të tij. Organizimi i “Ditëve të hapura” në Vlorë, Sarandë, Dropull, Fier, Lushnje, Shkodër, Lezhë, Kukës, Elbasan, Berat, Durrës, Tiranë etj, e ka bërë bërë më atraktiv procesin e marrjes dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve. Nëpërmjet kontakteve të drejtëpërdrejta me qytetarët, këshillimit, orientimit, dhënies të informacionit dhe zgjidhjes së problemeve, Avokati i Popullit ka synuar të rrisë besueshmërinë e Institucionit të tij si dhe të ndikojë maksimalisht në përmirësimin e praktikave dhe shërbimeve të administratës publike ndaj qytetarëve.

Gjithashtu, qytetarët në mënyrë të veçantë kanë nevojë për zgjidhje konkrete të problemeve dhe shqetësimeve të tyre dhe vendosjen në vend një të drejtë të mohuar nga administrata publike. Në këtë aspekt Avokati i Popullit ka krijuar një bashkëpunim të ngushtë dhe institucional me administratën publike, shoqërinë civile dhe median, të cilat luajnë një rol kyç në zgjidhjen e shumë prej ankesave të qytetarëve.

Gjatë vitit 2014, rezultoi se numrin më të lartë të ankesave e përbëjnë ankesat e qytetarëve të adresuar ndaj administratës të pushtetit vendor. Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të projektit “Mbështetja e Qeverisë së Danimarkës për Avokatin e Popullit Shqiptar – më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias”, ka zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme që kanë në fokus mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve dhe rritjen e rolit të administratës publike në nivel vendor, shoqërisë civile dhe të medias lokale. Të tilla kanë qënë, trajnimi i rreth 500 përfaqësuesve të administratës publike në 14 prej bashkive të vendit në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut (trajnim që do të vazhdojë dhe gjatë vitit 2015), organizimi i auditoriumeve (debateve midis përfaqësuesve të qeverisë, qytetarëve dhe grupeve të interesit) për problemet madhore që shqetësojnë shoqërinë shqiptare, tryezat e përbashkëta me përfaqësues dhe rrjetin e shoqërisë civile në nivel qarku, si dhe organizimi i “ditëve të hapura” në takime me qytetarët për marrjen e ankesave.

Nëpërmjet rritjes të rolit proaktiv të institucionit në nivel vendor, pikërisht aty ku dhe problemet e qytetarëve janë më të shumta, Avokati i Popullit ka synuar në arritjen e dy prej objektivave të rëndësishme dhe strategjike për të ardhmen e institucionit. **Së pari**, në nxitjen e metodave të reja dhe të qëndrueshme të komunikimit në marrëdhëniet me qytetarët, me përfaqësuesit e shoqërisë civile, me median lokale por kryesisht me administratat e pushtetit

në nivel vendor. Dhe **së dyti**, në ngritjen e kapaciteteve dhe nivelin e etikës së stafëve të administratës së qeverisjes vendore, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e jetës të qytetarëve, krahasuar këto me standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut.

#### **5.4. Sfidat në bashkëpunimin me median dhe shoqërinë civile**

Funksioni i komunikimit dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile ka marrë një rol kryesor në panoramën e aktorëve dhe faktorëve të vëna në dispozicion të administratës publike për të përmirësuar shërbimet. Arsytet e këtij roli kryesor janë të shumta dhe të lidhura me disa ndryshime të rëndësishme në planin institucional, në planin social dhe në raportet mes institucionit dhe shoqërisë. Fuqizimin e marrëdhënieve me median e shohim jo vetëm si një mjet jetik të demokracisë, por edhe si një mjet të prodhimit të opinionit publik. Një mjet, nëpërmjet të cilit mund të dëgjojmë, mund të japim informacion, mund të japim akses dhe në këtë mënyrë mund të bëjmë një vetëvlerësim të kualitetit të “shërbimeve” që ne ofrojmë. Shoqëria civile, nga ana e vet është një aktor shumë i rëndësishëm dhe i fuqishëm në jetën e përditshme. Ne kemi nevojë për shoqërinë civile jo sepse ata “përfaqësojnë popullin”, por sepse me ata mund t’i bëjmë gjërat më mirë duke marrë parasysh vlefshmerinë e presionit të tyre, vlerat që ata promovojnë, debatet që ata nxisin, propozimet që ata japin, por kuresesi kapacitetin e tyre për të përfaqësuar popullin. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë se shoqëria civile është kompletuese e jo rivale e demokracisë përfaqësuese dhe se demokracia përfaqësuese nuk është perfekte, por është gjëja më e mirë që mund të kemi për t’u qeverisur. Një komunikim i sukseshëm varet shumë nga mjetet dhe qasja që zgjidhet.

Me qëllim arritjen e objektivave janë përdorur disa elementë të komunikimit:

- Dokumente, përfshi strategjinë e komunikimit, strategji bashkëpunimi me shoqërinë civile
- Takime të rregullta mes Avokatit të Popullit dhe gazetarëve dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe Avokatit të Popullit
- Trajnime të stafit që mbulon pjesën e komunikimit dhe gjithashtu trajnime dhe shkëmbime eksperiencash me organizatat e shoqërisë civile dhe stafit të Avokatit të Popullit
- Konferenca për media, qofshin këto të Avokatit të Popullit dhe stafit të tij, po ashtu dhe të Avokatit të Popullit me organizata të ndryshme të shoqërisë civile, në rastet e lobingjeve të përbashkëta
- Nëpërmjet faqes web [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al), ku një zë të veçantë zenë dhe organizatat e shoqërisë civile, duke pasqyruar praktikat e tyre më të mira
- Prezantime, botime, artikuj, publikime, opinione qofshin këto të përfaqësuesve të shoqërisë civile (të cilët shpesh herë janë pjesë e përmbajtjes të revistës së Avokatit të Popullit) po ashtu dhe material të institucionit të Avokatit të Popullit
- Konsultime të herëpashershme me gazetarët dhe me organizatat e shoqërisë civile për çështje aktuale që kërkojnë vëmendjen e opinionit publik.
- Të gjitha këto mjete janë përdorur për një synim të caktuar:
- Të krijojmë një kulturë komunikimi
- Të mbajmë dhe të krijojmë një komunikim të vazhdueshëm me median dhe shoqërinë civile.

## KREU 6

### AVOKATI I POPULLIT DHE VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE

#### 6.1. Institucioni i Avokatit të Popullit në mbajtjen e Presidencës së AOM

Viti 2014, u karakterizua nga një veprimtari e ngjeshur diplomatike, si në rrafshin dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Në këtë veprimtari morën pjesë dhe u aktivizuan krahas titullarit të institucionit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e të tre seksioneve në përbërje të Avokatit të Popullit. Në mënyrë të veçantë, viti 2014 shënoi një intensifikim të madh të akvitetit rajonal të institucionit. Falë këtij aktivizimi të shtuar, në prill 2014, zoti Totozani u zgjodh anëtar i Bordit Drejtues për Rajonin e Europës të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, ndërsa në qershor 2014 ai u zgjodh President i Organizatës së Ombudsmanëve të Mesdheut. Por viti 2014, sollti edhe një qendrim më proaktiv të z. Totozani edhe në struktura të tjera ku ai bën pjesë nga viti 2012 e në vazhdim dhe veçanërisht në Komitetin Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve të Drejtave të Njeriut (NHRI ICC) dhe në Organizatën e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Vendeve Frankofone ku ai ishte zgjedhur më herët anëtar i Bordit Administrativ. Por siç u tha edhe më lart, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët kanë qenë pjesë aktive e të gjitha organizimeve rajonale e ndërkombëtare, një përmbledhje e të cilave do të jepet më poshtë.

#### Gjashtëmujori i parë i Presidencës së Organizatës së Ombudsmanëve të Mesdheut

Më 26-27 qershor 2014, institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në Tiranë Konferencën e 8 të AOM-it me temë: “Fuqizimi i demokracisë: cilët partnerë për Ombudsmanin?!” Në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar morën pjesë 28 ombudsmanë nga vendet anëtare të AOM-it, përfshirë këtu Ombudsmanin e Spanjës, Greqisë, Izraelit, Portugalisë, Marokut dhe shumë vende të tjera nga rajoni i Mesdheut. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Ndërkombëtare të Ombudsmanëve të Mesdheut me rastin e zgjedhjeve të përgjithshme, për të gjitha organet drejtuese të kësaj organizate, Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë, z.Totozani u zgjodh me unanimitet të plotë president i kësaj organizate.

Temat e diskutuara në këtë konferencë, ndër të tjera përfshinin: ombudsmanët dhe pushteti legjislativ, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare si dhe bashkëpunimi me mediat. Gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme u miratuan disa deklarata të rëndësishme në lidhje me çështje sensitive të drejtave të njeriut në rajonin e Mesdheut, si deklarata e Tiranës për bashkëpunimin multilateral, deklarata mbi migracionin dhe azilin në hapësirën e Mesdheut, deklarata e përbashkët mbi rrëmbimin e nxënësve nigeriane, etj.

Pas zgjedhjes në postin e Presidentit të AOM-it, zoti Totozani paraqiti objektivat e mëposhtme për mandatin e tij 2 vjeçar në krye të kësaj organizate:

- krijimi i një strukture më operative në organizatë (përmes krijimit të pikave fokale, publikimi i një buletini elektronik informativ 4 herë në vit);
- sigurimi i financimeve (përmes vizitave dhe negociatave me zyrtarë të Brukselit, Strazburgut, donatarë të ndryshëm, etj.) për projekte dhe ndërtim kapacitetesh në organizatat anëtare;



- krijimi i një instituti të ri trajnimi në Maltë,
- vazhdimi i mbështetjes për kursin e trajnimit në Rabat;
- krijimi brenda organizatës i grupeve të punës të përhershme për tematika të caktuara sipas nevojave të anëtarëve;
- zgjerimi i organizatës me anëtarë të rinj;
- realizimi i ndryshimeve të kërkuara në statut etj.

## **6.2. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare**

Një komunikim të dëndur Avokati i Popullit mban me Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit mori pjesë në sesionin e 27 të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Vizita në Gjenevë u shfrytëzua nga Avokati i Popullit për një ndërveprim aktiv me të gjitha strukturat e Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, por edhe me homologët e tij që drejtojnë institucione në të gjitha rajonet e botës. Në mënyrë të veçantë, duhet përmendur ndërveprimi i Avokatit me Mekanizimin Rajonal të Institucioneve të të Drejtave të Njeriut, falë të cilit është bërë e mundur që një nga punonjësit e institucionit të kryejë një periudhë stazhi gjashtëmujore pranë këtij Mekanizmi. Kjo vizitë, ndër të tjera përkon çdo vit edhe me një numër takimesh që organizon ICC për 4 grupet rajonale që bëjnë pjesë në të (Europa, Azia, Amerika dhe Afrika).

**IOI** është organizata më e madhe e ombudsmanëve në botë në të cilën bëjnë pjesë 150 ombudsmanë nga Europa, Afrika, Azia, Australia dhe Paqësori, Amerika Latine dhe Karaibet si dhe Amerika e Veriut. Duke iu referuar rolit, rëndësisë dhe shtrirjes së kësaj organizate në botë mund të themi pa hezitim se përfaqësimi i Avokatit të Popullit në këtë nivel drejtimi shënon një nga arritjet më të rëndësishme deri më sot për institucionin tonë në arenën ndërkombëtare. Mbledhja e Bordit për Rajonin e Europës të Institutit të IOI-së, anëtar i të cilit është edhe z.Totozani, për vitin 2014, u mbajt më 27 tetor, dhe ritheksoi edhe një herë nevojën për bashkëpunim dhe mbështetjen që institucionet homologe të të drejtave të njeriut duhet të ofrojnë veçanërisht për anëtarët më të rinj.

Po kaq aktiv, institucioni ka qenë edhe në kuadrin e organizatave dhe rrjeteve europiane. Më datat 20-22 janar 2014 Avokati i Popullit Iglj Totozani priti në zyrën e tij Presidenten e Institutit të Ombudsmanëve të Europës (EOI), znj. Burgi Volgger, Presidenten e Këshillit Koordinues të Ombudsmanëve Rajonalë të Italisë, Znj. Luchia Franchini dhe Ambasadorin italian në Shqipëri, Z. Massimo Gaiani. Anëtarë të tjerë të delegacionit ishin Ombudsmani i Rajonit të Campagna në Itali, Z. Francesco Bianco, Përgjegjësi i Mediatorit European, Z Vittorio Gasparrini dhe Sekretari i Ombudsmanëve të Italisë, z. Filippo Tognoni. Qëllimi i kësaj vizite ishte thellimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave mes institucioneve. Në këtë kuadër, u nënshkrua dhe një Memorandum Mirëkuptimi për forcimin e rolit të këtyre institucioneve në funksion të ndihmës që u duhet dhënë qytetarëve, të cilët përballen me administratat përkatëse të dy vendeve. Nga ana e saj Znj. Franchini pas nënshkrimit të memorandumit, u shpreh se ky memorandum është një angazhim i rëndësishëm pasi administratat e dy vendeve, Shqipërisë dhe Italisë duhet të jenë të gatshme për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me qytetarët.

Më datën 18-19 Shtator 2014, tre përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën Vjetore të Rrjetit të CRONSEE në Beograd me Teme: “Kriza ekonomike: Sa po mbijetojnë shërbimet për fëmijët. Çfarë bëjnë Ombudsmanët?” Synimi i kësaj konference ishte shkëmbimi i ideve për gjetjen e rrugëve më të mira në mënyrë që kriza ekonomike të mos ndikojë në jetën dhe zhvillimin e fëmijëve. Në fund të konferencës u miratua deklarata e përbashkët e Rrjetit të Ombudsmanëve të Fëmijëve të Evropës Juglindore “Të investosh për fëmijët është investim për të ardhmen.”

Më 9 Dhjetor 2014, Komisionerja e Avokatit të Popullit mori pjesë në seminarin mbi dhunën kundër grave, që u zhvillua në Bruksel, organizuar nga Agjensia për të Drejtat Themelore në Europë (FRA) dhe rrjeti i institucioneve të barazisë (EQUINET).

Komisioni Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), është një nga ato organizma me të cilin Avokati i Popullit, mban një komunikim të përhershëm, përfshirë edhe në kuadrin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të Këshillit në Europës në këtë fushë, për raportimet dhe pjesëmarrjen në eventet europiane e rajonale për parandalimin e torturës dhe trajtimeve degraduese.

Në mënyrë të veçantë, duhet nënvizuar vemendja dhe serioziteti me të cilin Avokati i Popullit ndjek proceset e integritetit evropian të Shqipërisë. Siç dihet, një nga pesë kriteret që duhet të përmbushë Shqipëria në vijim të perspektivës së saj europiane është edhe respektimi i të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit është pjesëmarrës në takimin e nivelit të lartë Shqipëri-BE dhe rregullisht bën rekomandime dhe shpreh opinione lidhur me situatën e të drejtave të njeriut. Por veprimtaria e tij nuk mbetet vetëm këtu. Si ndërmjetës midis qytetarëve dhe administratës publike në nivel qendror e vendor, ai vë në dukje problemet në funksionimin e saj dhe jep sugjerime për mënyrën e përmirësimit të tyre. Në anën tjetër, edhe zyrtarët e BE-së në Tiranë dhe në Bruksel mirëpresin kontributin e Avokatit të Popullit në këtë drejtim duke theksuar rëndësinë e institucionit në proceset demokratizuese dhe përparimin e vendit drejt standardeve europiane.

### **6.3. Përfaqësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivete ndërkombëtare**

#### *Ndërveprime dypalëshe të Institucionit të Avokatit të Popullit*

Avokati i Popullit mban marrëdhënie shumë aktive edhe në rrafshin dypalësh me përfaqësuesit e shteteve të ndryshme në Tiranë si dhe me përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare. Në këtë kuadër, zyrtari i Departamentit Amerikan të Shtetit për Evropën Jugore dhe Qëndrore, Z.Thomas K. Yazdgerdi, bëri një vizitë në institucionin e Avokatit të Popullit. Zyrtari i lartë i DASH u interesua mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vend dhe për punën e Avokatit të Popullit, punë që edhe më parë ishte vlerësuar me nota tejet pozitive edhe nga ambasadori amerikan në Tiranë. Përveç të tjerave, Zoti Totozani vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin e shkëlqyer dhe ndihmën e madhe që ambasada amerikane në Tiranë i jep institucionit si dhe rëndësinë që ka raporti vjetor i DASH për të drejtat e njeriut në punën e Avokatit të Popullit.

Më 9 Maj 2014, Avokati i Popullit Igli Totozani ka zhvilluar një vizitë zyrtare dy ditore në Beograd. Gjatë vizitës ai bisedoi me homologun e tij serb Miroslav Jankoviç, Ambasadorin e OSBE në Serbi si dhe zyrtarë të tjerë nga OSBE. Në takimin me përfaqësuesit e zyrës së Avokatit të Popullit në qytetin e Bujanovcit , Totozani tha se Avokati i Popullit nuk merret me çështje politike, por me promovimin e të drejtave të qytetarëve.

Më 15 korrik 2014 vizitoi Tiranën zyrtarisht Ombudsmania e Greqisë znj. Calliope Spanou. Qëllimi i kësaj vizite ishte thellimi i bashkëpunimit midis dy zyrave homologe në të mirë të qytetarëve të të dy vendeve. Gjatë këtij takimi në mënyrë të veçantë u diskutua në lidhje me fëmijët që kalojnë kufirin të pashoqëruar nga prindërit në mënyrë ilegale. Një ndër çështjet e diskutuara në takim ishin toponimet dhe situata në burgjet greke ku ndodhen një numër i konsiderueshëm qytetarësh shqiptarë. Ndërkohë, në 16 korrik, Avokati i Popullit së bashku me homologen greke inaguruan hapjen e zyrës rajonale të Avokatit të Popullit në Komunën Dropull, zonë ku jeton një pjesë e konsiderueshme e minoritetit grek në Shqipëri.

Me ftesë të Ombudsmanit të Turqisë, Z. Mehmet Nihat Omeroglu, një delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit mori pjesë në simpoziumin e dytë ndërkombëtar për institucionet e Ombudsmanit, që u zhvillua në 21-22 tetor 2014 ne Ankara, Turqi. Qëllimi i

këtij aktiviteti ishte zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Ombudsmanit në Europë.

Me 29 nëntor 2014, me ftesë të Ombudsmanit të Francës, Jacques Toubon, Avokati i Popullit, Igli Totozani bëri një vizite zyrtare në Francë. Takimi me homologun francez kishte një qëllim të dyfishtë, bashkëpunimin midis dy institucioneve homologe si dhe në kuadër të aktiviteteve të AOM-së, duke pasur parasysh se z. Totozani kryeson Organizatën e Ombudsmanëve të Mesdheut, ndërsa z. Toubon është Sekretar i Përgjithshëm i kësaj Organizate. Pjesë e vizitës së Avokatit të Popullit ishte edhe një takim me përfaqësues të Organizatës Botërore të Frankofonisë (Organisation Internationale de la Francophonie). Gjatë këtij takimi u shkëmbyen ide rreth rolit dhe kontributit të Avokatit të Popullit në respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, si një aktor kyç në shtetin e së drejtës. Po kështu, u diskutua mbi mundësinë e mbështetjes së projekteve të ndryshme në kuadër të frankofonisë.

Më 3-4 Nëntor 2014, një përfaqësues i Institucionit të Avokatit të Popullit mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Institucioneve për të Drejtat e Fëmijëve, me temë “Të drejtat e fëmijëve - Nga koncepti në realitet,” organizuar nga Ombudsmani i Bosnje-Hercegovinës në bashkëpunim me Parlamentin e këtij vendi dhe financuar nga Save the Children. Në dy ditët e zhvillimit të kësaj konference, diskutuan përfaqësues nga mbi 20 vende të botës mbi rolin e Ombudsmanit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të bashkëpunimit me Save the Children Kosovë, dy përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën e përvitshme Euro Child 2014, organizuar nga “CRONSEE”, që u zhvillua në Bukuresht të Rumanisë më 26-28 nëntor 2014. Takimi kishte si synim kryesor njohjen me praktikën më të mirë dhe përvojat e vendeve të BE-se në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Kështu, më 25-26 shtator institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Programin TAIEX organizoi seminarin me temë “Roli i Ombudsmanit në proceset e integritetit evropian.” Seminari u mbështet nga misioni i Komisionit Evropian në Tiranë në kuadër të programit TAIEX të Bashkimit Evropian. Qëllimi i seminarit ishte forcimi i punës së Ombudsmanit në rajonin e Ballkanit Perëndimor në kuadër të proceseve integruese. Përfaqësues të institucioneve nga Shqipëria, Greqia, Sllovenia, Polonia, Maqedonia, Kosova, Kroacia, Bosnjë Hercegovina, Turqia dhe Serbia ndanë përvojat dhe praktikën e tyre më të mirë. Në përfundim Ombudsmanët e vendeve të rajonit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit përsa i perket rolit të institucioneve të të drejtave të njeriut në proceset integruese evropiane.

#### **6.4. Ngritja e kapaciteteve të stafit dhe vizita studimore**

Të njëjtën rëndësi që i kushton performancës së administratës publike në shërbimet që ofron për qytetarët, institucioni i kushton edhe forcimit të kapaciteteve njerëzore brenda tij. Kështu, me qëllim që ankesat e qytetarëve të trajtohen me efektivitetin maksimal, që të drejtat e njeriut të promovohen dhe të mbrohen duke synuar standardet më të larta evropiane, institucioni shfrytëzon të gjitha mundësitë e brendshme si dhe ato që ofrohen nga shtete e organizata të ndryshme. Po ashtu, Programi TAIEX i Komisionit Evropian mundësoi tre vizita të punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit pranë institucioneve homologe në vende anëtare të BE për shkëmbim përvojash dhe ndërtim kapacitetesh. Kështu, në janar 2014 u bë një vizitë pranë Mbrojtësit të të Drejtave në Francë nga tre ndihmëskomisionerë për të mësuar më shumë rreth të drejtave të njeriut në institucionet e privimit të lirisë; më 22-26 shtator tre përfaqësues të zyrës së Avokatit të Popullit bënë një udhëtim studimor pranë zyrës së Ombudsmanit në Hungari për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, grave, personave të privuar nga liria, si dhe trajtimin e ankesave të qytetarëve. Ndërsa një

grup tjetër vizitoi Ombudsmanin në Portugali për të mësuar më shumë rreth trajtimit të fëmijëve të rrugës, në përgatitje për krijimin e seksionit të fëmijëve pranë Avokatit të Popullit.

Më 29-30 Shtator 2014 tre përfaqësues të zyrës së Avokatit të Popullit morën pjesë në aktivitetin e trajnimit rajonal të programit TAIEX të BE-së mbi aksesin e lirë ndaj informacionit publik: “Zbatimi dhe Aplikimi”, që u zhvillua në Shkup të Maqedonisë.

Një përfaqësues i institucionit të Avokatit të Popullit mori pjesë në seminarin trajnues për të drejten për vendimarrje dhe pjesëmarrje të fëmijëve në jetën sociale, që u zhvillua në Moncton - Kanada, në 11 - 18 Korrik 2014. Synimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve të ekspertëve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve që veprojnë pranë Ombudsmanëve të fëmijëve si pjesë e rrjetit të ombudsmanëve të fëmijëve pranë Frankofonisë.

Më tej, nga 2-13 qershor dhe 1-15 tetor 2014 dy përfaqësues të zyrës së Avokatit të Popullit morën pjesë në intershipin dyjavor pranë Ombudsmanit të Maltës si pjesë e një programi bashkëpunimi mes institucioneve anëtare të Shoqatës së Ombudsmanit të Mesdheut (AOM). Ky intership u krye në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave pranë këtij institucioni. Pjesë e programit ishte funksionimi institucional, trajtimi i ankesave, hetimet e pavaruara, hartimi i raporteve dhe rekomandimeve, marrëdhënia me shtypin dhe informimi publik.

Me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Polonisë dhe Ombudsmanit Polak të Fëmijëve dy përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në datat 30 shtator-1 tetor 2014, në Varshavë. Seminari synoi shkëmbimin e eksperiencave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në vendet e Ballkanit, përfshirë këtu edhe Turqinë.

Me ftesë të Ombudsmanit hollandez të Fëmijëve katër përfaqësues të zyrës së Avokatit të Popullit morën pjesë në vizitën studimore pranë Ombudsmanit të Hollandës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në datat 14-17 Dhjetor 2014. Kjo vizitë u krye në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave dhe u mbështet nga Save the Children.

## KREU 7

### INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT NË SHIFRA PËR VITIN 2014

#### 7.1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Menaxhimi i burimeve njerëzore përmes krijimit të një administrate civile profesionale, të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme, është një nga sfidat më të rëndësishme për çdo institucion publik, duke synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standartet dhe praktikatat me të mira evropiane. Kjo nënkupton në rradhë të parë përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil, si dhe përmirësimin të sistemit të trajnimit.

Caktimi i strukturës administrative nga vetë institucioni konsiderohet një faktor i rëndësishëm i pavarësisë së tij. Aftësia e institucionit për të krijuar strukturat e veta dhe fleksibiliteti i përshtatjes së tyre në mënyrë që t'u përgjigjen sa më mirë funksioneve e detyrave të institucionit, është mjaft e rëndësishme për funksionimin efikas të një institucioni të pavarur kushtetues, siç është Avokati i Popullit.

Pasja e një strukture eficiente për realizimin e objektivave dhe angazhimeve institucionale dhe ligjore, ka qenë dhe mbetet një nga qëllimet kryesore të punës së institucionit të Avokatit të Popullit. Që nga krijimi i institucionit (viti 2000), struktura dhe organika e tij ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fushën e shërbimit civil.

Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme dhe për vetë specifikën e institucionit, janë konstatuar probleme të ndryshme në këtë drejtim të cilat janë identifikuar edhe nga rekomandimet e lëna nga Komisioni i Shërbimit Civil (maj 2012), të cilat shërbyen në fakt si instrumente orientuese për ndryshimet që u miratuan në lidhje me strukturën e institucionit.

Duke pasur në konsideratë rekomandimet e lëna nga KSHC, praktikën dhe eksperiencën e fituar deri më tash si dhe parimet dhe metodologjinë e strukturimit të institucioneve publike, Avokati i Popullit miratoi Urdhërin nr.82, datë 21.04.2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit", ku u bënë disa ndryshime në strukturën ekzistuese duke u përpjekur për ta sjellë atë në përputhje me parimet e përgjithshme të shërbimit civil si dhe të disa standardeve të përcaktuara në këtë drejtim.


Këto ndryshime u mbështeten jo vetëm në rekomandimet e lëna nga Komisioni i Shërbimit Civil, por në mënyrë të veçantë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 16.06.2011, "Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike".

Këto ndryshime synuan pasjen e një strukture të qëndrueshme në kohë, relativisht homogjene me strukturat dhe kategorizimet e punonjësve të institucioneve të tjera shtetërore, plotësimin e standardeve në drejtim të formatimit të njësive të strukturës, që lidhen me drejtoritë dhe sektorët përkatës.

Gjithashtu, ndryshimet e miratuara synuan përcaktimin e një raporti të rregullt midis pozicioneve të punës me karakter manaxherial, drejtues dhe atyre të nivelit ekzekutues, si në organizimin e njësive të strukturës, drejtori dhe sektorë, ashtu edhe në drejtim të numrit të pozicioneve të punës që nevojiten për të ndërtuar këto njësi të strukturës.

Për më tepër, këto ndryshime kishin për qëllim edhe adresimin e saktë të kategorizimit të pagave të punonjësve, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, si dhe reflektimin e ndryshimeve të bëra në numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga ligji nr.185/2013, datë 28.12.2013 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2014”, në të cilën numri i përgjithshëm i miratuar i punonjësve të institucionit për vitin 2014 nga 48 u bë 50 punonjës. (Me miratimin e nënseksionit për fëmijë me dy ndihmës komisioner).

**Struktura e Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2014, e paraqitur sipas organigramës së mëposhtme:**



Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë për projekt-buxhetin e vitit 2015 (nëntor 2014), nga ana e Avokatit të Popullit u propozua nevoja e shtimit të numrit të punonjësve të institucionit me një specialist finance duke e argumentuar me nevojën e mbulimit dhe adresimit të të gjitha çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar të institucionit, duke pasur parasysh edhe mbështetjen financiare të ofruar nga donatorë të ndryshëm për realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të ndryshme të institucionit, ç’ka kërkon një ndjekje në vazhdimësi në zbatimin dhe miradministrimin financiar të këtyre fondeve.

Propozimi i paraqitur u morr në konsideratë dhe është reflektuar tashmë edhe në ligjin nr.160/2014, datë 27.11.2014, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2015”, sipas të cilit numri i përgjithshëm i punonjësve në institucionin e Avokatit të Popullit është 51.

Trajnimi i nëpunësve civil është një institut shumë i rëndësishëm i legjislacionit në fushën e shërbimit civil dhe nga niveli i zbatimit të tij mund të vlerësohet edhe niveli cilësor i administratës së këtij institucioni në realizimin e misionit të tij. Parë në këtë këndvështrim, edhe për vitin 2014, një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe ngritjes profesionale të punonjësve të institucionit duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre në trajnime të organizuara si brenda ashtu dhe jashtë vëndit.

Vlen të theksohet këtu bashkëpunimi me Shkollën e Administratës Publike në trajnimin e punonjësve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e organeve të administratës publike si dhe pjesëmarrja në shumë aktiviteteve ndërkombëtare (trajnime, seminare, konferenca) të cilat kanë mundësuar shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me standardet praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Për shkak të rëndësisë që ka rritja e nivelit profesional të punonjësve në realizimin e objektivave të institucionit, Avokati i Popullit miratoi urdhërin nr.167 dt.12.09.2014 “Për rritjen e aftësive profesionale dhe trajnimin e punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit”, duke synuar përmirësimin e performancës dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të institucionit të Avokatit të Popullit, përmes nxitjes së programeve të të mësuarit të vazhdueshëm dhe ofrimit të trajnimeve afatshkurtra dhe atyre afatgjata.

Këtij qëllimi do t'i shërbejë dhe hartimi i Planit Vjetor të Trajnimeve, duke iu përshtatur nevojave të brendshme në nivel kombëtar si dhe të kombinuara me përparësitë e përcaktuara në nivel ndërkombëtar, duke patur në konsideratë pjesëmarrjen aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në organizatat ndërkombëtare dhe rrjetet rajonale të Ombudsmanit.

Edhe gjatë këtij viti raportues, është bërë një përpjekje e vazhdueshme për të krijuar kushte sa më optimale pune nëpërmjet organizimit, ndjekjes dhe realizimit të shërbimeve të ndryshme, për të plotësuar nevojat dhe për të zgjidhur problematikat e ndryshme të hasura gjatë punës së përditshme të institucionit.

## **7.2. Realizimi i buxhetit të Institucionit për vitin 2014**

Në mbështetje të ligjit nr. 185/2013, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrisë të Financave nr. 3/1 datë 17.01.2014 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2014", performanca e produktit të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2014, paraqitet si më poshtë:

### **Programi - “Shërbimi Avokatisë”**

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2014-2016 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2014-2016).

### **Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2014**

Me Ligjin Nr. 185/2013, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

## Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1

Nr. Llog.	Emërtimi	Planifillestar	Shtesa & Pakësimi	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	66.000.000		66.000.000	56.601.784
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	9.500.000		9.500.000	7.587.253
602	Mallra dhe shërbime të tjera	15.000.000	- 830.000	14.170.000	12.254.477
604	Transf.korente të brendshëm		226.079	226.079	226.079
605	Transferta. Korente të Huaja	1.000.000	830.000	1.830.000	1.814.426
606	Trans. për Buxh. Fam. & Individ		128.800	128.800	128.800
231	Investimet	4.000.000	747.168	4.747.168	3.646.345
	<b>TOTALI</b>	<b>95.500.000</b>	<b>1.102.047</b>	<b>96.602.047</b>	<b>82.259.164</b>


## Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2014

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	66.000.000	56.601.784	9.398.216	85,76
2	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	9.500.000	7.587.253	1.912.747	79,87
3	Mallra dhe shërbime të tjera	14.170.000	12.254.477	1.915.523	86,48
4	Transf.korente të brendshëm	226.079	226.079	0	100
	Transferta. Korente të Huaja			34%	
5	Transferta. Korente të Huaja	1.830.000	1.814.426	15.574	99
6	Transf. për Buxh. Fam. & Individ	128.800	128.800	0	100
7	Investimet.	4.747.168	3.646.345	1.100.823	76,80
	<b>Totali</b>	<b>96.602.047</b>	<b>82.259.164</b>	<b>14.342.883</b>	<b>85,15</b>



## Struktura e Shpenzimeve 2014



### 1-Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fond i akorduar për vitin 2014, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli është 66.000.000 lekë, ndërsa realizimi është 56.601.784 lekë ose 85,80%, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në plan 9.500.000 lekë, ndërsa realizimi është 7.587.253 lekë ose në masën 79,90%. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2014 janë realizuar në masën 85%. Gjatë vitit 2014, numri mesatar i punonjësve ka qenë 44 punonjës nga 50 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2013 dhe gjatë vitit 2014.

### 2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Shpenzimet operative të miratuara për institucionin tonë, megjithë ndryshimet gjatë vitit ushtrimor, janë në vlerën prej 14.170.000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit, niveli i realizimit të shpenzimeve operative rezulton në vlerën prej 12.254.477 lekë ose 86,50% përkundëjt planit të ndryshuar. Për vitin 2014 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e energjisë elektrike, ujë, Albtelekom, Vodafonë, abonime gazeta, shërbimi postar, kancelari, materiale pastrimi, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, karburant, siguracion automjesh, dieta brenda dhe jashtë vendit, shërbime mirëmbajtje fotokopje e printer, shpenzime pritje-përcjellje të huajve.

Gjithashtu, duke qenë anëtare e organizatave ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsmen (AMO), International Ombudsman Institute (IOI), International Coordinating Committee (ICC), European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI), një pjesë e buxhetit është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që lidhen me kuota anëtarësimi, të cilat janë kryer në kohën e duhur dhe që

pasqyrohen sipas tabelës më sipër. Ky fond për transfertë korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2014, është 1.000.000 lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 1.830.000 lekë. Realizimi i këtij artikulli është 1.814.426 lekë ose 99 % i buxhetit të rishikuar.

### 3- Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2014 është 4.000 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 4.747 mijë lekë ndërsa realizimi është 3.646 mijë lekë ose 76,80% i buxhetit të rishikuar. Për përmirësimin e kushteve të godinës të institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë këto investime (shiko tabelën e mëposhtme).

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
1. Hidroizolim tarrace (debitor)	M660007	747	710	95
2. Rikonstruksion godine	M660005	1.000	521	52,10
3. Përshtatje e ambienteve për personat me aftësi të kufizuar (PAK)	M660010	1.500	1.150	76,67
4. Pajisje - Kompjuterike	M660009	750	551	73,46
5. Mjete dhe pajisje të tjera	M660011	270	270	100
6. Inventar ekonomik (pajisje e orendi zyre)	M660012	480	444	92,50
<b>TOTALI</b>		4.747	3.646	76,80

### 7.3. Statistika përmblendhëse të ankesave dhe trajtimit të tyre për vitin 2014

Një vënd të veçantë në Raportet Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit që i paraqiten Kuvëndit zënë edhe pasqyrimi i statistikave për prezantimin e numrit të ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë për gjatë gjithë vitit. Konkretisht më poshtë gjenden te detajuar këto statistika, të cilat lejojnë të krijohet përshtypja mbi objektin e ankesave, numrin e tyre, mënyrën e trajtimit nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, reagimi i administratës publike, çështjet e hapura për vitin 2014 dhe ato të mbartura, etj.

Të dhënat e paraqitura sa më poshtë i përkasin periudhës 1 janar-31 dhjetor 2014. Në total janë trajtuar nga zyra e Avokatit të Popullit 3969 ankesa, kërkesa dhe njoftime (*duke përfshirë dhe ato të pritjes së qytetarëve*).


Ankesa, kërkesa, njoftime gjatë vitit 2014 që kanë qenë pjesë e objektit të institucionit të Avokatit të Popullit janë 2572 gjithsej. Nga zyra e pritjes së qytetarëve, 793 ankesa i janë dhënë përgjigje menjëherë, ndërsa 604 ankesa i janë dhënë përgjigje në formën e këshillimeve shkresore.

**Gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit rezultojnë se janë mbyllur 1481 ankesa si më poshtë vijon:**

- 88 ankesa jashtë Juridiksionit
- 152 ankesa jashtë Kompetence
- 527 ankesa të pabazuar
- 24 Rekomandime të Refuzuar
- 209 Rekomandime të Pranuar

- 437 ankesa të Pranuara pa Rekomandim (të zgjidhura në favor të qytetarëve)
- 44 ankesa me heqje Dorë


**Paraqitja grafike Nr. 1- Trajtimi i ankesave**



**Grafiku më poshtë tregon mënyrën e shpërndarjes së ankesave, kërkesave dhe njoftimeve sipas seksioneve në Institucionin e Avokatit të Popullit, konkretisht:**


Seksioni i Administratës	1024 ankesa
Seksioni i Veçantë	720 ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	700 ankesa
Njësia e Parandalimit të Torturës	128 ankesa

**Paraqitja grafike Nr. 2 – Shpërndarja e ankesave**




Tabelat në vijim japin në mënyrë grafike një informacion rreth ankesave që janë trajtuar gjatë viteve nga Institucioni i Avokatit të Popullit.


**Paraqitje grafike Nr. 3 - Ankesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit ndër vite**




**Paraqitje grafike Nr. 4 – Mënyra e zgjidhjes së ankesave në favor të qytetarëve nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë viteve 2000-2014**




**Paraqitja grafike Nr. 5 - Shpërndarja e ankesave përgjatë vitit 2014 sipas qyteteve**




**Paraqitja grafike Nr. 6 - Ankesat e regjistruara gjatë vitit 2014 sipas të drejtës që i janë shkelur qytetarëve**



**Paraqitja grafike Nr. 7 - Shpërndarja e ankesave drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit drejt Institucioneve Shtetërore**




**Paraqitja grafike Nr. 8 - Ndarja e ankesave sipas mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes 2014**



Më poshtë gjendet paraqitja grafike në lidhje me ankesat e punuara gjatë vitit 2014. Nga 1481 ankesa që janë trajtuar, 646 ankesa ose 44% janë zgjidhur në favor të qytetarit, ndërsa 835 ankesa ose 56% e tyre janë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të Avokatit të Popullit.


### Paraqitje grafike Nr. 9 – Ankesa qe jane mbyllur ne vitin 2014



### RASTET E MBARTURA NE VITE


Gjatë vitit 2014, 666 ankesa janë mbartur nga viti 2013, prej të cilave 364 ankesa janë përfunduar në vitin 2014, ndërsa 302 ankesa kalojnë të mbartura për vitin 2015. Më poshtë i kemi paraqitur si janë zgjidhur sipas Seksioneve këto ankesa:

### Paraqitje grafike Nr. 10



Gjithashtu për vitin 2014 ankesat që kanë mbetur pa u mbyllur janë 1091 dhe këto ankesa kalojnë për t'u trajtuar në vitin 2015. Nga rastet e mbartura të cilat kanë kaluar në vitin 2014 janë bërë gjithsej 94 rekomandime nga të cilat: 77 rekomandime janë pranuar dhe 17 të tjera janë refuzuar.

**Paraqitje grafike Nr. 11 - Ankesa që janë zgjidhur pa rekomandim por në favor të qytetarëve**



**Paraqitje tabela Nr. 12 – Ankesa jashte kompetences dhe juridiksionit**

Nr.	Grupi i Ankesave	Numi i Këshillimeve Verbale dhe Shkresore
1	Ankesa ndaj vendimeve të gjykatave dhe prokurorive	380
2	Ankesa për konflikte civile	250
3	Ankesa ndaj subjekteve private	180
4	Kërkesë për përfaqësim në gjykatë	130
5	Konflikte në familje:	75
6	Ankesa ndaj institucioneve të shteteve të huaja	45
7	Të ndryshme: (Ankesa të paqarta, kërkesa për ndihmë financiare, kërkesa për punësim, ankesa për mos përfitim të tokës bujqësore, shkresa vënie djene)	337
8	<b>Total</b>	<b>1397</b>



## **Anekset**

1. Lista e institucioneve shtetërore që kanë zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.
2. TABELA E REKOMANDIMEVE PA PERGJIGJE GJATE VITIT 2014
3. TABELA E REKOMANDIMEVE TE REFUZUARA SIPAS INSTITUCIONEVE GJATE VITIT 2014
4. TABELA E REKOMANDIMEVE LEGJISLATIVE TE NISURA GJATE VITIT 2014
5. TABELA E VIZITAVE STUDIMORE DHE TRAJNIMEVE GJATE VITIT 2014
6. TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2014

**Aneks 1 – Lista e institucioneve shtetërore që kanë zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI QË I ËSHTË DËRGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>NUMRI I REKOMANDIMEVE TE ZBATUARA OSE PJESËRISHT TË ZBATUARA</b>
1	Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Zyrës së Shërbimit Përmbartimor Tiranë, në dijeni edhe Ministrinë e Financave	1 rekomandim
2	Kryetari të Bordit të Qendrave Shëndetësore, Qendrës Shëndetësore Saux Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë	1 rekomandim
3	Kryetari të Bashkisë Korçë	1 rekomandim
4	Drejtorit të ARM Shkodër, Kryetari të Komunës Rrethina/Shkodër, si dhe Drejtorit të Kabinetit pranë Ministrisë së Mbrojtjes	1 rekomandim
5	Drejtorit të ALUIZNI Elbasan, në dijeni edhe Kryetarin e Bashkisë Elbasan si dhe Kryeinspektorin e INUV Elbasan	1 rekomandim
6	Kryeinspektorit të INUK, duke vënë në dijeni edhe Drejtorin e Përgjithshëm të ALUIZNI	1 rekomandim
7	Kryeinspektorit të INUV Elbasan, në dijeni edhe Kryeinspektorin e Degës së INUK Elbasan, Kryeinspektorin të INUK Tiranë	1 rekomandim
8	INUK Tiranë	5 rekomandime
9	Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbartimor Gjyqësor	1 rekomandim
10	Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve	6 rekomandime
11	Degës së Thesarit, Gjirokastrë	1 rekomandim
12	Prokurorit të Përgjithshëm	1 rekomandim
13	Shefit të Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë	1 rekomandim
14	Ministrit të Punëve të Brendshme	1 rekomandim
15	Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë	2 rekomandime
16	Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë	1 rekomandim
17	Drejtorisë së Policisë të Qarkut Lezhë	1 rekomandim
18	Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr.4 Tiranë	1 rekomandim
19	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	1 rekomandim
20	Komisariatit të Policisë Sarandë	1 rekomandim
21	Komisariatit të Policisë Nr.3 Tiranë	1 rekomandim
22	Zyra Përmbartimore “Andani Bailiff Office” Tiranë	1 rekomandim
23	Drejtorit të Policisë Kufitare e Migracionit Durrës	1 rekomandim
24	Ministrit të Financave	1 rekomandim
25	Gjykata e Lartë	2 rekomandime
26	Ministria e Drejtësisë	1 rekomandim
27	Gjykata Apelit Tirana	3 rekomandime
29	Gjykata Apelit Durrës	1 rekomandim
31	Gjykata Apelit Vlorë	1 rekomandim
32	Gjykata e Rrethit Tiranë	1 rekomandim
34	Ministria e Drejtësisë	1 rekomandim
36	Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brëndshëm	1 rekomandim
37	Komisariatit të Policisë nr.3 Tiranë, për dijeni Drejtorisë të P.Q.Tiranë	1 rekomandim
38	Komisariatit të Policisë nr.2 Tiranë, për dijeni Drejtorisë së P.Q.Tiranë	1 rekomandim
39	Komisariatit të Policisë Kavajë, për dijeni Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tirane	1 rekomandim
40	Prokurorisë së Rr.Gj.Tiranë; Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë.	1 rekomandim
41	Drejtorisë së Policisë të Qarkut Fier; Prokurorisë së Rr.Gj.Fier	1 rekomandim
47	IEVP Peqin	1 rekomandim
48	DRSSH, Fier	1 rekomandim
49	MMSR	1 rekomandim
50	DRSSH Tirane	3 rekomandime
51	DRSSH Durres	1 rekomandim
52	ZVRPP Kolonje	1 rekomandim
54	DRSSH Kukes	2 rekomandime
55	DRSSH Gjirokastrë	1 rekomandim
58	Kryetari të Komunës Paskuqan	1 rekomandim
59	Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit	3 rekomandime
62	Rektorit të Universitetit Fan Noli, Korçë	1 rekomandim
63	Drejtorit të DAR Pogradec	1 rekomandim

64	Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror	1 rekomandim
65	Bashkia Tirane	1 rekomandim
66	Bashkia Gjirokastr	1 rekomandim
67	Bashkia Shkoder	1 rekomandim
68	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; I EVP Rrogozhine	1 rekomandim
69	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; I EVP Peqin	1 rekomandim
70	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; I EVP Zahari, Krujë	1 rekomandim
71	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Institutit të të miturve Kavajë	1 rekomandim
72	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Durrës	4 rekomandime
73	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP "Ali Demi" (325)	1 rekomandim
74	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Vaqar	1 rekomandim
75	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Kosovë, Lushnjë	1 rekomandim
76	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Elbasan	5 rekomandime
77	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Lezhë	4 rekomandime
78	Drejtoria të Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit	1 rekomandim
79	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Peqin	1 rekomandim
80	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Shën Koll, Lezhë	1 rekomandim
81	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Dibër	3 rekomandime
82	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Kukës	1 rekomandim
83	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Kukës	3 rekomandime
84	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Tropojë	1 rekomandim
85	Ministrit të Shëndetësisë; Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Drejtoria të Spitalit Psikiatrik Elbasan	1 rekomandim
86	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Elbasan	1 rekomandim
87	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP "Jordan Misja"	1 rekomandim
88	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Durrës	2 rekomandime
89	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	1 rekomandim
90	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut	1 rekomandim
91	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Berat	3 rekomandime
92	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Berat	1 rekomandim
93	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP "Mine Peza"(302)	1 rekomandim
94	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Korçë	3 rekomandime
95	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Gjirokastr	3 rekomandime
96	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtoria të Policisë së Qarkut Vlorë	1 rekomandim
97	Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtoria të I EVP Vlorë	1 rekomandim
98	Ministrit të Drejtësisë; Drejtoria të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	1 rekomandim

**Aneks 2 – TABELA E REKOMANDIMEVE PA PERGJIGJE GJATE VITIT 2014**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI QE ESHTË DERGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>NUMRI I REKOMANDIEMVE PA PERGJIGJE</b>
1	Zevendes.Kryeministrit të RSH-së	1 Pa përgjigje
2	Ministrit të Drejtësisë	1 Pa përgjigje
3	Ministrit të Mbrojtjes	1 Pa përgjigje
4	Ministrit të Shëndetësisë	2 Pa përgjigje
5	Ministrit të Mjedisit	1 Pa përgjigje
6	Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrit të Mjedisit	1 Pa përgjigje
7	Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit	1 Pa përgjigje
8	Ministres se Arsimit dhe Sportit	1 Pa përgjigje
9	Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	3 Pa përgjigje
10	Prokurorit të Përgjithshëm	2 Pa përgjigje
11	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	2 Pa përgjigje
12	Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor	1 Pa përgjigje
13	Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	10 Pa përgjigje
14	Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI Tiranë	1 Pa përgjigje
15	Kryeinspektorese të ALUIZNI-t	1 Pa përgjigje
16	OSHEE	1 Pa përgjigje
17	Drejtorise se Pergjithshme te RTSH dhe Keshillit Drejtues te RTSH	1 Pa përgjigje
18	ISSH	1 Pa përgjigje
19	DRSSH Tiranë	3 Pa përgjigje
20	DRSSH Durrës	2 Pa përgjigje
21	Bashkia Tiranë	1 Pa përgjigje
22	Kryetares së Njësisë Bashkiake nr.5Tiranë	1 Pa përgjigje
23	Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.1 Tiranë	1 Pa përgjigje
24	Kryetarit të Bashkisë Berat	1 Pa përgjigje
25	Kryetarit të Bashkisë Kavajë	1 Pa përgjigje
26	Kryetarit të Bashkisë Vlorë,	1 Pa përgjigje
27	Bashkisë Vlorë dhe Shërbimit Social Shtetëror	1 Pa përgjigje
28	Bashkisë Sarandë dhe Shërbimit Social Shtetëror	1 Pa përgjigje
29	Kryetarit të Bashkisë Fier	2 Pa përgjigje
30	Zyrës së Përmbarimit, Fier.	1 Pa përgjigje
31	Bashkia Lezhë	1 Pa përgjigje
32	Kryetarit të Bashkisë Peqin dhe Këshillit Bashkiak Peqin	1 Pa përgjigje
33	Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë dhe Këshillit Bashkiak Rrogozhinë	1 Pa përgjigje
34	Kryetarit të Bashkisë Fushë-Krujë dhe Këshillit Bashkiak Fushë-Krujë	1 Pa përgjigje
35	Kryetarit të Bashkisë Fushë Kuge dhe Këshillit Bashkiak Fushë Kuge	1 Pa përgjigje
36	Kryetarit të Komunës, Çërravë, Pogradec	1 Pa përgjigje
37	Kryetarit të Komunës, Leshnjë, Skrapar	1 Pa përgjigje
38	Kryetarit të Komunës, Velçan, Pogradec	1 Pa përgjigje
39	Kryetarit të Komunës, Vëndresh, Skrapar	1 Pa përgjigje
40	Kryetarit të Komunës Pojan	1 Pa përgjigje
41	Drejtorit të ARM Shkodër	1 Pa përgjigje
42	Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave,	1 Pa përgjigje
43	Kryeinspektorit të INUV Tiranë, Shefit të Komisarariatit nr. 3 Tiranë,	1 Pa përgjigje

**ANEKS 3 - TABELA E REKOMANDIMEVE TE REFUZUARA SIPAS INSTITUCIONEVE GJATE VITIT  
2014**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI QE ESHTE DERGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>NR. I REKOMANDIMEVE TE REFUZUARA</b>
1	DRSHTRR Shkodër, DSHTRR Tiranë dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës	1 Rekomandim
2	Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme	1 Rekomandim
3	Dr.Përgjithshme të Doganave	1 Rekomandim
4	Dr.Përgjithshme të Burgjeve	1 Rekomandim
5	Dr.Përgjithshme të Policisë së Shtetit	2 Rekomandim
6	Ministrisë së Kulturës/ TOB	1 Rekomandim
7	Prokurorit të Përgjithshëm	3 Rekomandim
8	Gjykates se Apelit, Tirane	1 Rekomandim
9	MMSR	1 Rekomandim
10	KMCAP Fier	1 Rekomandim
11	Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë	1 Rekomandim
12	DRSSH Durrës	1 Rekomandim
13	Ministrit të Brendshëm	1 Rekomandim
14	Ministrit të Arsimit dhe Sporteve	2 Rekomandim
15	Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, duke vënë në dijeni edhe Drejtorin e DAP.	1 Rekomandim
16	Ministrisë së Mbrojtjes	1 Rekomandim
17	Dr.Ndërmarrjes së Ujësllësit Tiranë	1 Rekomandim
18	Kryetarit të Komunës Mbrostar, Fier	1 Rekomandim
19	Kryetarit të Komunës, Trebinjë, Pogradec	1 Rekomandim
20	Zyra e Gjendjes Civile Lezhë	1 Rekomandim

**ANEKS Nr. 4 - TABELA E REKOMANDIMEVE LEGJISLATIVE TE NISURA GJATE VITIT 2014**

<b>NR</b>	<b>NR.DOCULIVE</b>	<b>DATA E NISJES</b>	<b>OBJEKTI I REKOMANDIMIT</b>	<b>INSTITUCIONI QE ESHTE DERGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>STATUSI I REKOMANDIMIT</b> <b>PRANUAR/MOSPRANUAR/PAPERGJIGJE/ZBATUAR OSE JO</b>
1	201400983	29.09.2014	Ndryshim i dispozites ligjore, neni 45 I Ligjit nr.122/2013	Kuvendit të Republikës. Ministrit të Drejtësisë	Përgjigje nga Ministri I Drejtësisë E Pazbatuar Drejtuar Gj.Kushtetuese dhe pritet vendimi
2	201302432	07.02.2013	Ndryshim legjislacioni në fushën e zbatimit të vendimeve penale	Ministrit të Drejtësisë	Kthyer përgjigje për marrjen konsiderat në të ardhmen të rek E Pa zbatuar
3	201400316	05.06.2014	Plotësimi i nenit 37 të Kodit të Punës lidhur me masat disiplinore	Min. Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	E zbatuar
4	201302317	07.02.2014	Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes"	Ministrit të Punëve të Brendshme	Pranuar E pazbatuar
5	201400209	17.02.2014	Për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të projektit të VKM "Për rregullimin e marrëdhënieve të Policisë së Shtetit me të tretët, për llojet e shërbimeve policore shtesë që ofron policia dhe tarifat e pagesës për këto shërbime", në bazë dhe për zbatim të neneve 48 dhe 129 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".	Ministrit të Punëve të Brendshme  Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	Pranuar E pazbatuar
6	201400203	17.02.2014	Për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të "Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore" dhe të "Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit"	Ministrit të Punëve të Brendshme	Pranuar Zbatuar
7	201400737	22.04.2014	Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 49, datë 10.01.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të papaguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete".	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	Pranuar Zbatuar
8	201402170	17.12.2014	Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e projekligjit për disa ndryshime dhe përmirësime të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë me qëllim zgjidhjen e problemit të ankuesve dhe dërgimin e tij në Këshillim e Ministrave.	Ministrit të Punëve të Brendshme Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës	Pranuar E pazbatuar
9	201302317	03.03.2014	Marrja e masave të nevojshme nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngujuara për shkak të fenomenit të gjakmarrjes.	Prokurorit të Përgjithshëm	Pranuar Zbatuar
10	201300786	05.10.2014	"Përmirësimi i Pikës 3 të nenit 121, të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007, "Për Policinë e Shtetit", për veprimtarinë e Punonjësve të Policisë të Strukturave Operacionale".	Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratës	Pranuar dhe vendosur në ligj ashtu si është kërkuar nga Avokati i

**ANEKS Nr. 4 - TABELA E REKOMANDIMEVE LEGJISLATIVE TE NISURA GJATE VITIT 2014**

				Publike dhe të Drejtave të Njeriut si dhe Komisionit për Sigurinë Kombëtare në Kuvendin e Shqipërisë.	Popullit.
11	201401585	21.10.14	Ndryshim KPrP	M Drejtësisë	Në shqyrtim
12	201400378	03.06.2014	Hapje shkollë edukimi	M.Drejtësisë	Pa përgjigje
13	201301426	10.01.2014	Ndryshim i Urdhërit Nr. 621, date 03.04.2013 i Ministrit të Mbrojtjes	Ministritë së Mbrojtjes	Refuzuar
14	201400439	14.08.2014	Ndryshimi i Urdhërit Nr.1587, datë 30.09.2011 i Ministrit të Mbrojtjes	Ministritë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA	Pranuar
15	201400896	25.06.2014	Perfshirja e per lehtesirat e shkollimit edhe te femijeve te ish te denuarve politik me “Debim internim”	Ministrise se Arsimit dhe Sportit	Pranuar
16	201400623	13.05.2014	Ndryshim I nenit 53/1 I ligjit nr 69/2012 “per sistemin parauniversitar ne RSH”	Ministrise se arsimit dhe Shkences	Pranuar
17	201400401	05.06.2014	Martjen e iniciativës ligjore për njohjen e viteve të punës së bërë gjatë vuajtjes së dënimit me burg për të dënuarit jopolitike, ordinerë.	MMSR	Mospranuar
18	201400740	05.05.2014	Nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.26/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”; të nenit 11 të Ligjit nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, të ndryshuar; të nenit 11 të Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”; të nenit 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit” si dhe të nenit 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 “Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”.	MPPT MMSR MF	Pranuar
19	201400741	21.05.2014	Nxjerrjen e Udhëzimit përkatës në zbatim të nenit 11 të Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.404 datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës së kritereve të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik për faturat e energjisë elektrike e telefonisë fikse”, me qëllim që të mundësohen përfitimet edhe për kategorinë e invalidëve që jetojnë në banesa me qera.	MMSR	Pa përgjigje
20	201401772	30.12.2014	T’i propozoni Këshillit të Ministrave ndryshimin e gërmës “dh”, të pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003, si dhe tabelës “C.f”, bashkangjitur këtij vendimi, me qëllim që efektet e shtesës në masën e pensioneve të plota të pleqërisë të përfshijnë edhe ato pensione të cilat janë lidhur në periudhën nga data 01.04.1996 deri më datë 31.12.1996. Gjithashtu rekomandojmë të parashikohet që, efektet financiare të prishme pas ndryshimit të kësaj VKM-je, të fillojnë që nga data 01.12.2003.	MMSR	Pa përgjigje
21		18.02.2014	Për miratimin e një ligji për hapjen e dosjeve	Kryeministrit Kryetarit të Kuvendit	Pa përgjigje

**ANEKS Nr. 4 - TABELA E REKOMANDIMEVE LEGJISLATIVE TE NISURA GJATE VITIT 2014**

22		7.04.2014	Per miratimin e nje ligji per mbrojtjen e individeve "Bilbilfryes".	Kryeministrit Kryetarit te Kuvendit	Pranuar Eshhtë pergatitur nje draft ligj qe i kaluar per diskutim Kuvendit
23	201302832	25.06.2014	Rekomandim per krijimin e nje strukture te re shtetërore, per kerkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave te ekzekutuar gjate viteve te regjimit komunist	Kryeministrit Ministrit te Mirëqenies Sociale dhe Rinise	Pranuar Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise është në proces draftimi të akteve që do të mundësojnë këtë gjë.
24	201203569	30.06.2014	Rekomandim për marrjen e masave për përmirësimin e standardeve të trajtimit të semurëve, me diagnozën "Dementia Alzhiemer".	Ministrit të Shëndetësisë Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinise	Ne shqyrtim (rek.legjislativ) Ka pergjigje pozitive vetem nga Ministria e Mirëqenies, nuk ka ende pergjigje nga Ministria e Shëndetësisë
25	201400343	13.11.2014	Rekomandim për ndërmarrjen e inisiativës legjislative për disa përmirësime në Ligjin "Për Sportin".	Ministres se Arsimit dhe Sportit	Në shqyrtim (pa pergjigje)
26	201401933	19.11.2014	Rekomandim legjislativ për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr.9482 datë 3.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.	Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Në shqyrtim (pa pergjigje)
27	201401774	12.12.2014	Rekomandim për gjetjen e një zgjidhje të shpejtë, që do të mundësojë trajtimin me strehim të individëve, apo familjeve qiramarrëse, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar.	Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Pranuar Në proces për zgjidhje, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit është në pritje të prononcimit nga ana e Ministrisë së Financave



**Aneks Nr 5 - TABELA E VIZITAVE STUDIMORE DHE TRAJNIMEVE GJATE VITIT 2014**

<b>NR</b>	<b>DATA</b>	<b>VIZITË STUDIMORE /TRAJNIM</b>	<b>OBJEKTI</b>	<b>INSTITUCIONI DHE VENDI KU ESHTË ZHVILLUAR VIZITA STUDIMORE/TRAJNIMI</b>
1	7-14 Korrik 2014	Kurs Universitarë	Mbi të drejtat e fëmijëve	Universiteti i Monctonit, Kanada
2	18.09.2014	Konferencë	Përfaqse të eksperincave të regjimeve juridike të së drejtës për informim dhe të institucioneve, kryesisht për vendet e Ballkanit, por edhe për disa vende të tjera europiane	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Prishtinë
3	30 Shtator-1 Tetor 2014	Seminar dhe vizitë studimore	Shkëmbimi i eksperiencave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në vendet e Ballkanit, përfshirë edhe Turqinë	Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Polonisë dhe Ombudsmeni Polak , Varshavë
4	11.06.2014	Për CEDAW me ekspertin ndërkombëtar e të Komitetit të Gjenevës.	Për raportimin kombëtar për Konventën CEDAW	Tiranë
5	17-18 Shtator 2014	Konferenca	Për të drejtat e fëmijëve dhe ndikimi i krizës ekonomike në shërbimet ndaj tyre. Shkëmbimi i përvojave me Ombudsmanët e rajonit	Ombudsmeni i Serbisë, Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Beograd
6	3-5 Nëntor 2014	Konferenca	Përvoja për krijimin e funksionimin e Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve	Ombudsmeni i Bosnjë Hercegovinës, Save the Children, Bosnjë-Hercegovinë
7	14-17 Dhjetor 2014	Vizitë studimore	Përvoja e krijimit dhe funksionimit të Komisionerit për të Drejtat e Fëmijëve.	Ombudsmeni Kombëtar i Hollandës, Hagë
8	21-23 Janar 2014	Vizite studimore	Shkëmbimi i përvojës rreth kuadrit ligjor respektiv si dhe praktikave më të mira	Pranë "Le Defenseur Des Droits", Paris, Francë
9	8-10 Dhjetor 2014	Vizite studimore	Marrje e përvojës rreth mënyrës së trajtimit të personave (12-18 vjeç) pranë qendrave të kujdestarisë.	Dutch Ombudsman for Children, në Qytetin e Hagës, Hollandë
10	20.01.2014	Trajnim	Per të drejtat e të miturve	Mbrojtësi i të drejtave, Paris Francë
	17.07.2014	Trajnim	Permirësimi i jetës së komunitetit LGBTI në nivel lokal	Shtëpia e te Drejtave te Njeriut, Tiranë
11	17.06.2014	Konferencë Kombëtare	Mbrojtja dhe Përkrahja për personat me aftësi të kufizuar	Tiranë
12	22-23 Janar 2014	Trajnim	Përsheptimi dhe anëtarësimi në BE: Mjetet praktike për zbatimin e legjislacionit Evropian	Ministria e Integritimit dhe EIPA, Tiranë
13	25-29 Nëntor 2014	Konferencë	Konferenca Vjetore e Eurochild	Rumani
14	09.10.2014	Seminarë	Hartimi i Planit të Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2015-2020.	Tiranë
15	02.06.2014	Seminarë	Përmirësimi e situatës së shëndetit mendor në burgje	Avokati I Popullit, Tiranë
16	2-13 Qershor 2014	Vizitë studimore	Shkëmbim eksperience	Zyra e Ombudsmanit të Maltës
17	22-26 Shtator 2014	Vizitë studimore	Shkëmbim eksperience	Zyra e Ombudsmanit të Hungarisë
18	22-23 Janar 2014	Trajnim	Mbi përshpejtimin e hyrjes në BE: Mjete praktike për zbatimin e Ligjit të BE-së	Instituti European i Administratës Publike, Ministria e Integritimit European, Tiranë

**ANEKS Nr. 6 - TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2014**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI I INSPEKTUAR</b>	<b>QËLLIMI I INSPEKTIMIT</b>	<b>DATA E INSPEKTIMIT</b>
1	Qendra e Zhvillimit, Edukimit dhe Integritimit "Lira", Berat	Kushtet e banimit, rritjes e edukimit të fëmijëve dhe PAK.	29.09.2014
2	Qendra për Trajtimin e Fëmijëve me Autizëm, Gjirokastrë	-/-	26.11.2014
3	Shtëpia e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër (parashkollori)	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit të fëmijëve 3-6 vjeç.	26.11.2014
4	Shtëpia e Fëmijës 0-3 vjeç, dhe Qendrën ditore 3-6 vjeç Shkodër	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit të fëmijëve 0-6 vjeç.	21.11.2014
5	Qendra Ditore ATELIE (Për riintegrimin nëpërmjet punës të PAK) Korçë	Kushtet e zhvillimit dhe riintegritimit të PAK	26.11.2014
6	Qendra Rezidenciale e Zhvillimit (për PAK) Korçë	-/-	26.11.2014
7	Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla" 0-6 Vjeç, Korçë	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit të fëmijëve 0-6 vjeç	26.11.2014
8	Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç, Shkodër	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit të fëmijëve 6-18 vjeç	24.12.2014
9	Shtëpia e Foshnjës, Vlorë	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit	9.09.2014
10	Shtëpia e Fëmijës Sarandë	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit të fëmijëve	10.09.2014
11	Shtëpia e Foshnjës, Durrës	-/-	10.07.2014
12	Qendra e Zhvillimit Durrës	Kushtet e banimit, mirërritjes e edukimit të fëmijëve dhe zhvillimit të PAK	10.07.2014
13	Burgu i Rrogozhinës, Peqinit dhe Spitali i Kavajës	Ngjarja e zjarrvënies në burgun e Rrogozhinës.	01.02.2014
14	Rruga "Don Bosko"	Verifikim i shqetësimit të disa banorëve të zonës, të cilëve do tu prisheshin shtëpitë në rrugën "Don Bosko me "Jordan Misja".	11.02.2014
15	Shishtufinë, Bregu i Lumit dhe Selitë	Dëbimi i një familje dhe problem i zvarritjes së procedurave të legalizimit dhe shpronësimit të banorëve(mes tyre edhe shumë romë).	16.04.2014
16	Drejtoria nr. 3 e Punëtorëve Bashkia Tiranë	Verifikim dokumentacioni	12.05.2014
17	Instituti i të Përndjekurve Politik	Verifikimi i fillimit të grevës së urisë të 10 të përndjekurve	28.05.2014
18	-/-	-/-	29.05.2014
19		Monitorim tek piramida për grevën e të larguarve nga administrata shtetërore.	30.05.2014
20		Monitorim në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" për të verifikuar mbarëvajtjen e grevës së urisë të të përndjekurve politik.	03.06.2014
21		Monitorim tek piramida për monitorimin e grevës të të larguarve nga administrata shtetërore	04.06.2014
22		Monitorim i protestës së tregtarëve të tregut ushqimor tek ish-uzina Dinamo, para Prefekturës së Qarkut Tiranë	17.07.2014
23		Inspektim i protestës së tregtarëve të tregut ushqimor tek ish-uzina Dinamo, kontakt me Kryetarin e Unionit.	18.07.2014
24	Rezidenca Universitare Studentore nr. 1 Tiranë	Verifikim dhe tërheqje dokumentacioni të marrëdhënieve të punës.	01.08.2014
25	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë	-/-	02.09.2014
26	Bashkia Vlorë	Verifikim i dokumentacionit dhe mos kthimit të një përgjigjeje zyrtare.	03.09.2014
27		Inspektim në segmentin e Lanës dhe pranë hotel "Dajtit" lidhur me problematikën e shfrytëzimit të fëmijëve për punë dhe lypje.	15.09.2014
28		Inspektim pranë kampit të romëve në Shkozë lidhur me problematikën e përhapjes së sëmundjes së verdhëzës tek fëmijët dhe banorët e tjerë të këtij kampi.	22.10.2014
29		Inspektim në zonën e Selitës lidhur me problemet e legalizimit	24.10.2014

**ANEKS Nr. 6 - TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2014**

		dhe prishjes së disa objekteve .	
30	Qendra Tranzitore e Emergjencave Tufinë	Inspektim lidhur me verifikimin e problematikave të ngritura nga komuniteti rom, si edhe të përgjigjes zyrtare të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror	29.10.2014
31		Inspektim në zonën e Selitës lidhur me problemet e legalizimit dhe prishjes së disa objekteve.	13.11.2014
32	Komisariati i Policisë Durrës	-/-	23.04.2014
33	Komisariati i Policisë Shijak	-/-	23.04.2014
34	Komisariati i Policisë Kavajë	-/-	23.04.2014
35	Stacioni i Policisë Rrogozhinë	-/-	23.04.2014
36	Stacioni i Policisë Fushë Krujë	-/-	22.04.2014
37	Komisariati i Policisë Krujë	-/-	22.04.2014
38	Komisariati i Policisë Elbasan	-/-	20.05.2014
39	Komisariati i Policisë Peqin	-/-	20.05.2014
40	Komisariati i Policisë Kurbin	-/-	23.05.2014
41	Stacioni i Policisë Mamurras	-/-	23.05.2014
42	Komisariati i Policisë Rrugore Tiranë	Respektimi i të drejtave të qytetarëve për gjykimin e kundërvajtjeve dhe monitorimi i sjelljes së punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët.	02.10.2014
43	Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit Tiranë	Respektimi i të drejtave të qytetarëve shqiptar e të huaj që paraqiten në këtë organ dhe monitorimi i sjelljes së punonjësve të policisë.	02.10.2014
44	Komisariati i Policisë Kufitare Rinas	-/-	02.10.2014
45	Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit Durrës	-/-	03.11.2014
46	Shtëpia e të Moshuarve, Tiranë	Zbatimi i standareteve të shërbimeve shoqërore	05.06.2014
47	Qendra e Zhvillimit Vlorë	-/-	09.09.2014
48	Qendra e Zhvillimit “Unë jam si ju”, Berat	-/-	30.09.2014
49	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	-/-	22.10.2014
50	Shtëpia e të Moshuarve, Fier	-/-	29.10.2014
51	Shtëpia e të Moshuarve, Gjirokastër	-/-	03.11.2014
52	Qendra Polivalente Ditore për të Moshuarit, Kamëz	-/-	20.11.2014
53	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	-/-	21.11.2014
54	Qendra e Zhvillimit Shkodër	-/-	24.12.2014
55	IEVP Rrogozhine	Vizitë inspektuese me iniciativë	01.02.2014
56	IEVP Peqin	-/-	11.02.2015
57	IEVP Zahari, Krujë	Vizitë monitoruese periodike	03.04.2014
58	Instituti i të miturve Kavajë	-/-	16.04.2014
59	Komisariati i Policisë Durrës (DPQarkut)	-/-	23.04.2014
60	Komisariati i Policisë Krujë	-/-	22.04.2014
61	Komisariati i Policisë Shijak	-/-	23.04.2014
62	Stacioni i Policisë Fushë-Krujë	-/-	22.04.2014
63	Komisariati i Policisë Kavajë	-/-	23.04.2014
64	Stacioni i Policisë Rrogozhinë	-/-	23.04.2014
65	IEVP “Ali Demi” (325)	-/-	30.04.2014
66	IEVP Vaqar	-/-	07.05.2014
67	IEVP Kosovë, Lushnjë	-/-	14.05.2014
68	Komisariati i Policisë Peqin	-/-	18.05.2014

**ANEKS Nr. 6 - TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2014**

69	Komisariati i Policisë Gramsh	-/-	18.05.2014
70	Komisariati i Policisë Librazhd	-/-	19.05.2014
71	Stacioni i Policisë Cërrik	-/-	18.05.2014
72	Komisariati i Policisë Elbasan (DPQarkut)	-/-	19.05.2014
73	Komisariati i Policisë Lezhë (DPQarkut)	-/-	23.05.2014
74	Komisariati i Policisë Kurbin	-/-	23.05.2014
75	Komisariati i Policisë Mirditë	-/-	23.05.2014
76	Stacioni i Policisë Mamurras	-/-	23.05.2014
77	Komisariati i Policisë Kufitare dhe Emigracionit Rinas	Vizitë monitorimi të procedurave të riatdhesimit	05.06.2015
78	IEVP Peqin	Vizitë monitoruese periodike	13.06.2014
79	IEVP Shën Koll, Lezhë	-/-	16.06.2014
80	Komisariati i Policisë Peshkopi (DPQarkut)	-/-	18.06.2014
81	Komisariati i Policisë Burrel	-/-	18.06.2014
82	Komisariati i Policisë Bulqizë	-/-	18.06.2014
83	IEVP Kukës	-/-	19.06.2014
84	Komisariati i Policisë Kukës (DPQarkut)	-/-	19.06.2014
85	Komisariati i Policisë Has	-/-	19.06.2014
86	Komisariati i Policisë Tropojë	-/-	20.06.2014
87	IEVP Tropojë	-/-	20.06.2014
88	Spitali Psikiatrik Elbasan	-/-	23.06.2014
89	IEVP paraburgim Elbasan	-/-	23.06.2014
90	IEVP "Jordan Misja" (313)	-/-	30.06.2014
91	IEVP Durrës	Vizitë inspektuese me iniciativë	31.07.2014
92	IEVP Durrës	Vizitë monitoruese periodike	29.09.2014
93	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	-/-	03.09.2014
94	IEVP Fushë-Krujë	-/-	01.10.2014
95	IEVP Burrel	-/-	06.10.2014
96	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut	-/-	08.10.2014
97	Komisariati i Policisë Kuçovë	-/-	13.10.2014
98	Komisariati i Policisë Çorovodë	-/-	13.10.2014
99	Komisariati i Policisë Berat	-/-	14.10.2014
100	IEVP Berat	-/-	14.10.2014
101	IEVP "Mine Peza" (302)	-/-	17.10.2014
102	Komisariati i Policisë Nr. 1, Tiranë	-/-	22.10.2014
103	Komisariati i Policisë Nr. 5, Tiranë	-/-	22.10.2014
104	Komisariati i Policisë Nr. 3, Tiranë	-/-	24.10.2014
105	Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë	-/-	24.10.2014
106	Drejtorja e Policisë së Qarkut Tiranë	-/-	24.10.2014
107	Komisariati i Policisë Ersekë	-/-	28.10.2014
108	Komisariati i Policisë Devoll	-/-	28.10.2014
109	IEVP Drenovë	-/-	29.10.2014
110	Komisariati i Policisë Korçë	-/-	30.10.2014
111	Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç	-/-	5,18.11.2014
112	Komisariati i Policisë Tepelenë	-/-	10.11.2014
113	Komisariati i Policisë Përmet	-/-	10.11.2014
114	IEVP Tepelenë	-/-	10.11.2014
115	Komisariati i Policisë Gjirokastër	-/-	11.11.2014
116	Komisariati i Policisë Delvinë	-/-	11.11.2014

**ANEKS Nr. 6 - TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2014**

117	IEVP Sarandë	-/-	12.11.2014
118	Komisariati i Policisë Sarandë	-/-	12.11.2014
119	Stacioni i Policisë Himarë	-/-	13.11.2014
120	IEVP Vlorë	-/-	13.11.2014
121	Komisariati i Policisë Vlorë	-/-	13.11.2014
122	Spitali Psikiatrik Vlorë	-/-	14.11.2014
123	Reparti Ushtarak Bunavi, Vlorë	-/-	14.11.2014
124	Reparti Ushtarak nr. 1200 Zall Herr, Tiranë	-/-	02.12.2014
125	Batalioni i Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë	-/-	02.12.2014
126	Komisariati i Policisë nr. 4	-/-	03.12.2014
127	Komisariati i Policisë nr. 6	-/-	03.12.2014
128	Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve	-/-	09.12.2014
129	Komisariati i Policisë Pukë	-/-	10.12.2014
130	Reparti Ushtarak nr.1010 Vau i Dejës	-/-	10.12.2014
131	Komisariati i Policisë Malësi e Madhe	-/-	11.12.2014
132	Komisariati i Policisë Shkodër (DPQarkut)	-/-	11.12.2014
133	Spitali Psikiatrik Shkodër	-/-	11.12.2014
134	Komisariati i Policisë Lushnjë	-/-	16.12.2014
135	Komisariati i Policisë Fier (DPQarkut)	-/-	16.12.2014
136	Komisariati i Policisë Mallakastër	-/-	16.12.2014
137	IEVP Rogozhinë	-/-	30.12. 2014